

---

ISSN 2309-3455

# Social Studies

Vol. 14, No. 1 (48), 2020



- Rexhep QOSJA • Shaban SINANI • Mehmet ELEZI • Monika STAFA
- Julian ÇOTA • Miranda RIRA • Fatmire KRASNIQI
  - Evis GARUNJA • Denada QUKU • Skënder DEMALIAJ
  - Albana DEMALIAJ • Fejzi LILA • Sola ALUKO-AROWOLO
  - Akinmayowa LAWAL • Isaac A. ADEDEJI • Oludele M. SOLAJA
  - Enida KUME • Leke SOKOLI • Sabri KIÇMARI

---

[www.sociology.al](http://www.sociology.al)



## Studime Sociale

Vëll. 14, Nr. 1 (48), 2020



## **Kriteret e botimit në revistën “Studime Sociale”**

Revista “Studime Sociale” është revistë e Institutit Shqiptar të Sociologjisë (Albanian Institute of Sociology, AIS) dhe Departamentit të Sociologjisë të Universitetit “Aleksander Moisiu” Durrës (UAMD), bazuar në marrëveshjen institucionale të datës 8 tetor 2018. Ajo botohet me ISSN ndërkombëtar (ISSN: 2309-3455) dhe është certifikuar si revistë shkencore nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) i Republikës së Shqipërisë, me vendim Nr. 170, datë 20. 12. 2010.

Studime Sociale/Social Studies, është revistë ndërkombëtare dygjuhëshe. Artikujt mund të botohen në shqip ose anglisht. Parimi bazë i saj është rigoroziteti shkencor. Çdo studim që dërgohet për t’u botuar revistën “Studime sociale”, i nënshtrohet një recensionimi të verbër (blind review). Ai u jepet për recension dy studiuesve të fushave ku bën pjesë studimi. Artikulli botohet nëse të dyja recensat janë pozitive. Detyra e përzgjedhjes së artikujve shkencorë është kompetencë ekskluzive e recensentëve anonimë.

Çdo material duhet të jetë në përputhje me standardet gjuhësore. Artikujt mund të jenë shkencorë ose recensionues, krijime origjinale ose përkthime. Çdo artikull duhet të dërgohet në word dhe të ketë këtë strukturë:

- (1) titulli, deri në 15 fjalë;
- (2) autori/autorët (emri mbiemri); institucioni ku është/janë; adresat elektronike – për çsonjërin prej tyre;
- (3) të dhëna për autorin/autorët, 4-6 rreshta, si tekst;
- (4) përmbledhje (shqip), me 200-250 fjalë dhe 4-6 fjalë kyçe;
- (5) teksti, si rregull me 7-9 faqe kompjuterike, me nga 2200 karaktere;
- (6) Referencat e plota;
- (7) abstract në anglisht (varianti anglisht i përmbledhjes).

Artikulli mund të shoqërohet me shënime në fund të faqes (footnotes). Por përparësi në përzgjedhjen për botim kanë artikujt me referenca sipas sistemit të Harvardit (referenca të shkurtuara përgjatë tekstit dhe lista me referenca të plota në fund të tij, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve).

Referencat duhet të përbëjnë pesë elemente, që janë:

- a. Referencat e librave:
  1. autori/ose autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i librit (në kursiv); 4. qyteti/vendi ku është botuar; 5. botuesi (për shembull: Merton, Robert. 1968. Social Theory and Social Structure. New York: Free Press).
- b. Referencat e artikujve nga revistat shkencore, ose përmbledhjet:
  1. autori/autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i artikullit (në thonjëza); 4. titulli i revistës/përmbledhjes ku është botuar (në kursiv); 5. vëllimi, numri dhe faqet (për shembull: Buss, Loreta. 2010. “Childhood in Sociology and Society; The US Perspective”, Currant Sociology, Vol. 58, No. 2, pp. 355-350).

Referencat e plota, të listuara në fund të tekstit, duhet të korrespondojnë me referencat e shkurtuara nëpër tekst, të cilat vendosen si në shembujt: Për një autor: Weber (1998); (Weber, 1998: 156); ose Weber (1998: 156); Për dy dhe tre autorë: (Lazesfeld & Berelson, 1990) e (Olzak, Shanahan & West, 1986); Për më shumë se tre autorë: (Larsen ed al., 1989); për seritë e referencave (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999). Në qoftë se për të njëjtin autor ka më shumë se një referencë në të njëjtin vit, atëherë shënohet: 2011a, 2011b.

# **SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]**

**Vol. 14, No. 1 (48), 2020**

Editor-in-Chief: **Lekë SOKOLI**

Associate Editor: **Sejdi CEKANI**

## **International Editorial Board**

**Chair: Servet PËLLUMBI**

*Academic Director of the Albanian Institute of Sociology (AIS)*

## **Members:**

**Aida GOGA** – University of Tirana, ALBANIA

**Ali PAJAZITI** – South East European University, Tetovo MACEDONIA

**Apostolos G. PAPADOPOULOS** – Harokopio University, GREECE

**Aylin TOPAL** – Middle East Technical University, Ankara, TURKEY

**Besim GOLLOPANI** – University Isa Boletini of Mitrovica, KOSOVA

**Besnik PULA** – Center for the Study of Social Organization; Princeton University, USA

**Borut RONČEVIĆ** – School of Advanced Social Studies, SLOVENIA

**Brunilda ZENELAGA** – University of Tirana, ALBANIA

**Doreta KUÇI** – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

**Ela GOLEMI** – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

**Elena ZDRAVOMYSLOVA** – European University at St. Petersburg, RUSSIA

**Enis SULSTAROVA** – University of Tirana, ALBANIA

**Faruk AJETI** – University of Vienna, AUSTRIA

**Goran BASIC** – Department of Sociology, Lund University, SWEDEN

**Ilir GËDESHI** – Center for Economic and Social Studies, ALBANIA

**Irena NIKAJ** – University Fan Noli of Korca, ALBANIA

**Jasminka LAŽNJAK** – University of Zagreb, CROATIA

**Jonida LAMAJ** – Marin Barleti University of Tirana, ALBANIA

**Klea FANIKO** – University of Geneva, SWITZERLAND

**Klejda MULAJ** – University of Exeter, ENGLAND

**Konstantin MINOSKI** – Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, MECEDONIA

**Ksanela SOTIROFSKI** – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

**Ledia KASHAHU** – University Aleksander Moisiu of Durres, ALBANIA

**Ligia FERRO** – University of Porto, PORTUGAL

**Marina DALLA** – University of Athens, GREECE

**Matilda LIKAJ** – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

**Miranda RIRA** – Albanian Sociological Association; ALBSA, ALBANIA  
**Olga KUTSENKO** – Taras Shevchenko National University of Kyiv, UKRAINE  
**Rando DEVOLE** – Researcher AIS Roma, ITALY  
**Roland SAHATCIJA** – Mediterranean University of Albania, ALBANIA  
**Sabri KIÇMARI** – University of Pristine, KOSOVO  
**Sergiu BALTATESCU** – University of Oradea, ROMANIA  
**Shaban SINANI** – Albanian Academy of Science, ALBANIA  
**Svetla KOLEVEA** – Institute for the Study of Societies and Knowledge, BULGARIA  
**Tonin GJURAJ** – European University of Tirana, ALBANIA

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee of the Republic of Albania;

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Rr. “Pjetër Bogdani”, Pall. 36/1, Tiranë – Shqipëri

Mobile: ++355(0)694067682

E-Mail: [albsa@sociology.al](mailto:albsa@sociology.al); [studime.sociale@gmail.com](mailto:studime.sociale@gmail.com);

[www.sociology.al](http://www.sociology.al)

## Contents:

---

Shaban SINANI	<i>Rreth një anketimi hetimor nga UDB-ja të hebrenjëve të strehuar në Shqipëri dhe të riktlyer në ish-Jugosllavi</i> ..... 5
Mehmet ELEZI	<i>Besa, por jo vetëm besa: interpretime rreth fakteve mbi shpëtimin e hebrenjëve në Shqipëri gjatë holokaustit</i> ..... 23
Monika STAFA	<i>Hebrenjtë në arealin shqiptar (prill 1941 - 8 shtator 1943)</i> ..... 35
Julian ÇOTA Miranda RIRA	<i>Anomia dhe vrasjet në çift në familjen shqiptare</i> ..... 45
Fatmire KRASNIQI	<i>Aspektet socio-juridike të kriminalitetit dhe varësisë nga dorga</i> ..... 63
Evis GARUNJA	<i>Mbrojtja sociale si garanci për një familje të fortë; një panoramë e kuadrit ligjor shqiptar</i> ..... 71
Denada QUKU	<i>Shqyrtim empirik i rolit të mësuesit në procesin mësimor</i> ..... 83
Skënder DEMALIAJ Albana DEMALIAJ	<i>Rreth integritetit politik, moral dhe profesional të intelektualit</i> ..... 97
Fejzi LILA	<i>Lidershipi Shërbëtor – Nënë Tereza mishërim i kësaj qasjeje</i> ..... 107
Sola ALUKO-AROWOLO Akinmayowa LAWAL Isaac A. ADEDEJI Oludele M. SOLAJA	<i>Observational Technique in Social Enquiry: Rationalization and Ethical Challenges</i> ..... 119
Enida KUME	<i>Job satisfaction of teachers in Albanian public high schools</i> ..... 129
Leke SOKOLI	<i>Politika ndërmjet utopisë dhe pragmatizmit</i> ..... 137
Rexhep QOSJA	<i>Kohzioni shoqëror e mbarëkombëtar dhe rrezikuesit e tij</i> ..... 147
	<i>Vëpra &amp; autorë</i> ..... 151



# RRETH NJË ANKETIMI HETIMOR NGA UDB-JA TË HEBRENJVE TË STREHUAR NË SHQIPËRI DHE TË RIKTHYER NË ISH-JUGOSLLAVI

Shaban SINANI

*Akademia e Shkencave e Shqipërisë*

E-mail: shsinani2000@yahoo.fr

---

## PËRMBLEDHJE

Ky punim u referohet, para së gjithash, disa fakteve të reja rreth një anketimi hetimor nga UDB-ja të hebrenjve të strehuar në Shqipëri por të rikthyer në ish-Jugosllavi, pas Luftës së Dytë Botërore. Pikënisje e tij janë konfirmimet e Rezolutës së Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të SHBA, në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo rezolutë certifikon mospjesëmarrjen e shqiptarëve në katastrofën e shekullit XX, me emrin *Shoab*. Jo vetëm kaq. Arsyetimit për miratimin e kësaj rezolute i janë shtuar disa të dhëna që ndryshojnë përfytyrimin e deritashëm mbi përmasat e përgjegjësive që morën shqiptarët për shpëtimin e hebrenjve prej rrezikut nazifashist të shfarosjes, pavarësisht rreshtimit politik dhe dallimeve fetare e kulturore. Për herë të parë, thuhet se në vitin 1938 në Shqipëri kishte 300 hebrenj vendës dhe më shumë se 1900 të tjerë të ardhur nga vende të Europës Qendrore dhe ish-Jugosllavia. Në këtë numër nuk përfshihen hebrenjtë që erdhën në Shqipëri nga Dalmacia (350), nga Mali i Zi (192) dhe nga Kosova (mbi 600) gjatë vitit 1942. Për herë të parë, theksohet se shqiptarët, siç u këshillonte toleranca e tyre ndërfetare e duke e konsideruar mbrojtjen e hebrenjve çështje të brendshme shtetërore (1) dhe çështje të nderit të tyre kombëtar (2), mbajtën *një qendrim të përbashkët për mbrojtjen e hebrenjve, në shtetin e tyre dhe në Kosovë*.

**Prof. Dr. Shaban SINANI** është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe sekretar shkencor i saj. Ai është studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist. Në vitin 1983 përfundoi studimet për gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës, ndërsa në vitin 1996 ka fituar gradën “Doktor i Shkencave”. Është autor i mbi 20 librave, nga të cilët veçojmë: “Një dosje për Kadarenë”, “Mitologji në Eposin e Kreshnikëve”, “Për prozën e Kadaresë”, “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të; Studime”, “Midis dy Rilindjesh”, “Etnos në epos”, “Letërsia në totalitarizëm dhe ‘Dossier K’, ‘Camaj i paskajuar’, ‘Kodikët e Shqipërisë në ‘Kujtesën e Botës’, ‘Njerëzit e krisur’ të Dritëro Agollit”, “Tradita gojore si etnotekst, studime për etno - folkloristikën krahasimtare”, “Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi” etj.

Në vitin 2009, në kohën e përgatitjes për botim të librit “Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi”, nuk kishim në duar disa dokumente të arkivave jugosllave, që certifikojnë qartësisht procesin e fabrikimit të “gjenocidit kosovar” ndaj hebrenjve që u gjendën atje. Me këto dokumente, merr përgjigje të plotë edhe pyetja më e vështirë, ajo për mospjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës në Shoah, ndryshe nga sa kanë propozuar një vargu studiuesish të Jugosllavisë së dytë, të mbështetur edhe prej historianësh me njohje dhe nderim në Shqipëri (si Berndt Fischer e Sir Noel Malcolm) të cilët, për fat të keq, s’kanë pasur mundësi të këshillojnë as burimet shqiptare, por me sa duket as ato jugosllave dhe hebraike. Ekzistenca e një divizioni të policisë politike naziste me emrin “Skanderbeg” e bënte të besueshme tezën se “në Kosovë fati i hebrenjve ka qenë disi më ndryshe.” Por rreth kësaj çështjeje ekziston një koleksion dokumentesh që provojnë një veprim shtetëror të orientuar mirë, me qëllim implikimin e shqiptarëve të Kosovës në judeofobi...

*Fjalë kyçe: shqiptarët, shpëtimi i hebrenjve, anketimi hetimor i UDB, gjenocid i fabrikuar kosovar*

## I.

Në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë (*commending the Albanian people on the 100<sup>th</sup> anniversary of the declaration of their independence*), Dhoma e Përfaqësuesve e Kongresit të SHBA, me Rezolutën *HRES 812 IH*, nderoi për herë të tretë brenda një dhjetëvjetëshi popullin shqiptar dhe Shqipërinë, si i vetmi vend në Europë ku kishte më shumë hebrenj në mbarim të Luftës së Dytë Botërore se në fillim të saj: *the only country in Europe that had more Jews in it after World War II than before it.*

Kjo rezolutë është rikonfirmuese e dy të tillave të mëparshme, por njëherësh zyrtarizon pjesën më të madhe të fakteve që janë propozuar prej dijes albanologjike për një vlerësim të certifikuar jo vetëm të mospjesëmarrjes së shqiptarëve në katastrofën e shekullit me emrin *Shoah*; jo vetëm të mungesës ndërshekullore të antisemitizmit tek shqiptarët, por edhe për çështje të tjera më të diskutueshme.

Arsyetimit për miratimin e Rezolutës i janë shtuar disa të dhëna që kanë të bëjnë me ndryshimin e përfytyrimit të deritashëm për përmasat e përgjegjësisë që morën shqiptarët, pavarësisht rreshtimit politik dhe dallimeve fetare e kulturore, për shpëtimin e hebrenjve prej rrezikut nazifashist të shfarosjes. Për herë të parë,

ndryshe prej shifrave të propozuara edhe prej gjithfarë vullnetarësh shqiptarë të shkencës historike, shenjohet se në vitin 1938 në Shqipëri kishte 300 hebrenj vendës dhe më shumë se 1900 të tjerë të ardhur nga vende të Europës Qendrore dhe ish-Jugosllavia: *In 1938, approximately 300 Albanian Jews lived in the Republic of Albania, and more than 1,900 escaped to Albania from Nazi-occupied Western Europe and the former Yugoslavia during World War II*; fakt që i përgjigjet së vërtetës historike, shpesh të zvogëluar e minimizuar prej mosnjohjes. Në këtë numër nuk përfshihen hebrenjtë që erdhën në Shqipëri nga Dalmacia (350), nga Mali i Zi (192) dhe nga Kosova (mbi 600) gjatë vitit 1942.

Për herë të parë cilësohet se shqiptarët, në shtetin e tyre dhe në Kosovë, siç u këshillonte toleranca e tyre ndërfaqetare, duke e quajtur mbrojtjen e hebrenjve çështje të brendshme shtetërore dhe gjithaq të nderit të tyre kombëtar, mbajtën një qëndrim të përbashkët për mbrojtjen e hebrenjve në zgrip, duke rrezikuar dhe jetën e vet (*Albanians in Albania and Kosova, based on their unique history of religious tolerance, considered it a matter of national pride and tradition to help Jews during the Holocaust*). Për herë të parë në një dokument të një rëndësie të tillë parësore pohohet në mënyrë të drejtpërdrejtë fakti që, pas pushtimit



nazist më 1943, kur Gestapo kërkoi të zbatonte projektin e vet të shfarosjes masive të hebrenjve, autoritetet zyrtare të Shqipërisë refuzuan të dorëzonin listat e tyre: *after Nazi Germany occupied Albania in 1943 and the Gestapo ordered Jewish refugees in the Albanian capital of Tirana to register, Albanian leaders refused to provide a list of Jews living in Albania.*

Për herë të parë pranohet si fakt historik i dëshmuar se, jo vetëm myslimanët shqiptarë, sikurse pohohet shpesh mendjelehtësisht, por të gjithë shqiptarët, pavarësisht besimit, duke përfshirë dhe klerikët vetë, mundësan fshehjen e identitetit të hebrenjve duke i pajisur ata me dokumente false: *Albanian clerks issued false identity papers to protect all Jews in the country.* Rezoluta është një model i arsytimit të mëtejme të preambolës, duke iu referuar fakteve të panjohur më parë, që argumentojnë pavërtetësinë e tezës së *dy qendrimeve* të shqiptarëve ndaj hebrenjve, që tradicionalisht i ka bërë shqiptarët e Kosovës përgjegjës për pjesëmarrje në Shoah. Çmohet lart familja e Arslan Reznit, shpallur në dhjetor të vitit 2008 si *Fisnik mes Kombesh* së bashku me djalin e tij Mustafa Reznit, sepse *u prinë 400 familjeve hebreje të Deçanit në brendësi të Shqipërisë, ku do të kishin më shumë siguri: Arslan Reznit was the first Kosovar Albanian recognized by Yad Vashem's 'Righteous among Nations Department', for leading 400 Jewish families from Decan, Kosova, into safety in Albania.* Dhoma e Përfaqësuesve, duke veçuar si shembull aktin e Arif Aliçkajt, sekretar i bashkisë së Deçanit, që ndihmoi hebrenjtë e qytetit të kalonin në Shqipëri duke i pajisur ata me pasaporta false dhe duke humbur për këtë shkak jo vetëm funksionin që kryente, por edhe jetën (*Arif Aliçkaj, the secretary of the municipality of Deçan, risked his job and his life helping the Reznit's rescue Jews in Nazi-occupied Kosova by issuing false identity papers to insure their safe passage to Albania*), i propozon Institutit *Yad Vashem* të shtojë kërkimet dhe nderimet për këtë pjesë të popullit shqiptar, sepse

Shqipëria dhe Kosova kanë mbrojtur e shpëtuar jetën e gjithë hebrenjve që jetonin në Shqipëri a kërkuan strehim atje (*the people of Albania and Kosova for protecting and saving the lives of all Jews who either lived in Albania or sought asylum there during the Holocaust*). Me këtë rezolutë, vlerësimi për shqiptarët mori vitin e kaluar një mirënjohje të tillë, me ndryshime cilësore, thelbi i të cilave qendron në referimin tek kombi shqiptar si i tillë.


## II.

Më e vështira ndër të gjitha pyetjet, që merr tashmë një përgjigje të katërciptë, ishte ajo për pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës në Shoah, e propozuar prej një vargu studiuesish të Jugosllavisë së dytë, më pas e mbështetur edhe prej historianësh me njohje dhe nderim në Shqipëri, si Berndt Fischer e Sir Noel Malcolm, të cilët, për fat të keq, s'kanë pasur mundësi të këshillojnë as burimet shqiptare, por me sa duket as ato jugosllave dhe hebraike. Ekzistenca e një divizioni të policisë politike naziste me emrin *Skanderbeg* e bënte të besueshme tezën se *në Kosovë fati i hebrenjve ka qenë disi më ndryshe*, mbështetur me një zell të habitshëm edhe nga shqiptarë. Në vitin 2009, në kohën e përgatitjes për botim të librit *Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi*, nuk i kishim në duar disa dokumente të arkivave jugosllave, që certifikojnë qartësisht procesin e fabrikimit të *gjenocidit kosovar* ndaj hebrenjve që u gjendën atje. Këto burime njoftojnë se në vitin 1960, vetëm pak kohë pasi ishte botuar libri me kujtime i H. Neubacher, ish-legat i Reich-ut në Beograd (për gjithë Ballkanin), me titullin *Sonderauftrag Südost, 1940-1945. Bericht eines fliegenden Diplomaten*, Sekretariati Federativ për Punët e Brendshme të Serbisë, saktësisht Drejtoria e Sigurimit (*Državni sekretarijat za unutrašnje poslove, Upravi državnom bjezbjednosti*), me anë të një qarkoreje, urdhërohej të merrte nën hetim të gjithë hebrenjtë që kishin gjetur


strehë e mbrojtje në Shqipëri gjatë luftës dhe të provoheshin krimet që kishin bërë shqiptarët ndaj tyre. Në shkresën urdhëruese thuhej se, me iniciativën e krerëve më të lartë të reaksionit shqiptar, gjatë vitit 1942, një numër hebrenjsh i internuan në Shqipëri, në Berat dhe në Elbasan; pastaj, gjatë vitit 1944, të gjithë hebrenjtë që gjendeshin në kampin e Prishtinës u internuan në kampin e Bergen-Belsenit (*Na inicijativu najistaknutiji šiptarskih reakcionara početkom 142 godine znatan broj jevrejskih porodivca interniran je za Albaniju u Beratu i Elbasanu; zatim, 1944 godine svi jevreji koji su zatekli u Prištinu internirani su od strane nemaca u logor Berben-Belzen. Smrt fašizmu - Sloboda narodu, Svetko Bogdanović, šef odseka UDB-e, 6.VIII.1960*).

Rreth kësaj çështjeje ekziston një koleksion dokumentesh, që provojnë një

veprim shtetëror të orientuar mirë. Në krye të nismës, siç vërehet nga kjo qarkore, përmendet vetëm *reaksioni shqiptar*, ndërsa përgjegjësia për hebrenjtë e zhdukur në kampin e Bergen-Belsenit bartet hë për hë mbi nazistët (*internirani su od strane nemaca*). Por shumë shpejt vërehet se qëllimi është për të implikuar shqiptarët e Kosovës në judeofobi. Në të njëjtën shkresë, institucionet që duhet të marrin në intervista hetimore hebrenjtë e mbijetuar, njoftohen se, sipas dëshmimeve të atyre hebrenjve që i kanë bërë ballë shfarosjes, para së gjithash të atyre të Prishtinës, ku ishte dhe përqendrimi i tyre më i madh, është bërë i ditur roli i reaksionit shqiptar, i agallarëve dhe bejlerëve, të cilët ishin në anën e pushtuesit dhe bashkëpunuan me të (*Prema izjavanja proživeli svedoka interniranje jevreja is Prištine, gde su bili*



*Përrgjyqje e UDB-së drejtuar Sekretariatit Federativ për Punët e Brendshme për hetimin e hebrenjve të strehuar në Shqipëri gjatë Luftës*



*Fleta e fundme e dëshmisë së të hetuarës Sarina Feta, e internuar në Bergen Belsen: Një oficer më foli në serbokroatisht dhe më tha: Zogu im (Jedan oficir omanjeg rasta rekao nam na srpskohrvatskom jeziku, čisto: ptice moje, a zatim: došle su, ptice moje).*

*najbrojnije nastanjeni, izvršeno je na zahtav šiptarske reakcije, aga i begova, koji su na okupatorom bili u saradnju).*

Ky hetim i orientuar do të çonte në marrjen në pyetje të të gjithë hebrenjve që pas lufte ishin kthyer në Kosovë, me qëllim që të nxirreshin prej tyre prova për inkriminimin e shqiptarëve. Kemi pasur në duar dëshmitë e hebreat Samuilo Mandil, i cili qysh në vitin 1945 pati botuar në të përditshmen *Bashkimi* një artikull mirënjohës për sjelljen e popullit shqiptar me hebrenjtë gjatë luftës; të Bosa Prlinčević, të Sarina Feta, të Hajim Adizez, të Nisim Navonović, të Hedwig Schönhein dhe të shumë të tjerëve. Të gjitha këto dëshmi ruhen në Arkivin e Jugosllavisë në Beograd (*Arhiv Jugoslavije, Beograd*),

sot pronësi intelektuale e Serbisë. Nuk janë dëshmi të mbijetuarish, që shprehin vullnet vetjak për të mbrojtur kujtesën e një historie traumatizuese globale, siç janë ato të hebreat Gavra Mandil, dërguar Institutit *Yad Vashem* në vitin 1988, duke u bërë i pari hebre që mendoi se duhej njohur e nderuar veprimi i shqiptarëve ndaj tyre.

Këto janë intervista hetimore të realizuara në zyrat e UDB-së, me nënshkrime të dy, tre e më shumë oficerëve që kanë marrë pjesë në proces. Prej këtyre intervistave, procesverbale të realizuara në hetuesi, duket qartë se të thirrurit në pyetje kanë qenë nën presion për të fabrikuar të dhëna të paqena. Në verbalin e Bosa Prlinčević-it (25.VII.1960), që identifikohet si një e



- 4 -


Dokoje br. I-A III. 12687  
 Spta br. 293  
 Strana br.

<p>54. <u>Miskija Josifović, sin, iseljen za Izr.</u> 59. <u>Lazar Mordehaj, umro u logoru</u>  <u>Regina " supruga, " " " Ester, supruga "</u>  <u>Leon " ,sin, " " " Avram, sin iseljen Izr.</u>  <u>Saramčenka " ,čerka, " " " Sabetaj, sin "</u></p> <p>55. <u>Elijaju Avram, iseljen za Izrael</u>  <u>" Sara, supruga " " " David, sin "</u>  <u>" Sami, sin, " " " Bela, čerka "</u>  <u>" Alegri, čerka " " " Moša, sin umro u logoru</u></p> <p>56. <u>Judić Josif, umro u logoru</u>  <u>" Ranela, " " " " Mazalto, supruga, umrla u logoru</u>  <u>" Leon, sin, " " " Monoh, sin, "</u>  <u>" Sami, sin, " " " Elijau, iseljen za Izrael</u>  <u>" Luča, čerka " " " Josif, sin živi u Beogradu</u>  <u>" David, sin živi u Beogradu " " " Gizela, streljana na Sajmiš.</u></p> <p>57. <u>Judić Inta, umro u logoru</u>  <u>" Ester, iseljena za Izr. " " " Reteka, "</u>  <u>" Luča, " " " " Benko, sin iseljen za Izr.</u>  <u>" Leon, sin umro u logoru " " " Bossa, živi u Prištinu</u>  <u>" " " " " Djoja, čerka iselj. Izr.</u></p> <p>58. <u>Lazar Nisim, iseljen za Izr.</u>  <u>" Sara, supruga " " " Džamila, "</u>  <u>" Solomon, sin " " " Nisim, sin "</u>  <u>" Meric, sin " " " Johan, sin "</u>  <u>" " " " " Isak, sin "</u>  <u>" " " " " Ester, čerka "</u>  <u>" " " " " Meri, čerka živi u Banatu</u></p>	<div style="border: 1px solid blue; padding: 2px; display: inline-block; transform: rotate(-45deg);">             Apas              Ispisivanje              Beograd         </div>
--	---

**NAPOMENA:** Od gore navedenih lica čiji ukupan broj iznosi 295 u logoru je umrlo 80, streljanih 7, (u logoru), streljanih u Prištinu 2, preživelih 206, od toga iseljeno iz FNRJ 185 i žive u FNRJ 21.

Napominjemo, da je u Prištini živeo veći broj Jevreja nego što smo naznačili u spisku, ali nismo bili u mogućnosti da ustanovimo tačan broj iz razloga što o tome nije bio nikakav pisani dokument.

Ovaj spisak je sačinjen po sećanju preživelih.




Operativni radnik,  
Miodrag Kratić

*Fleta e fundme e njërës prej listave të hebrenjve të thirrur për hetim nga UDB-ja më 1960.*

mbijetuar e kampit të shfrosjes të Bergen-Belsenit, dëshmitari ka aq pak njohuri për historinë për të cilën pyetet, sa edhe emrin e kampit e shkruan dy herë *Bergen-Bezel*. Një tjetër dëshmitar detyrohet të përmendë se hebrenjtë e Kosovës u internuan në kampin famëkeq të *Zhdukjes përfundimtare* të Bergen-Belsenit në vitin 1942, kur dihet

mirë se ky kamp është i fundmi që u ngrit nga nazistët dhe ka filluar të funksionojë vetëm në vitin 1944.

Megjithëse nën tryshinë e hetimit, hebrenjtë e mbijetuar pohojnë se qeveria e atëhershme shqiptare na mbrojti (*tadašnja albanska vlast da bi nas zaštila*); pa hezituar të përmendin se në kampin e *Sajmište-s*



*Nga dëshmia e Bosa Prlinçević - Beja Mandilović, Prishtinë 1960.*

ata u torturuan rëndë dhe u keqtrajtuar prej ustashëve (u Sajmištu bili smo teško mučeni i maltretireni od strane ustaša). Por dëshmia më e rëndësishme e gjithë këtij koleksioni është ajo e hebreo-jugosllavit Nisim Novanović, që shprehimisht pohon se për internimin e hebrenjve nga Prishtina në kampin e Sajmište-s arriti Divizioni SS *Hanxhar*, që ishte formuar me myslimanë vullnetarë nga Bosnja (za interniranje jevreja iz Prištine vršila Hadžar Divizija, mobilizana SS jedinice od muslimanima iz Bosne: gjithashtu dhe Sarina Feta).

Në asnjë rast nuk përmendet Divizioni SS

*Skanderbeg*, të cilit i është shtuar si përgjegjësi shoqërimi i hebrenjve nga kampi i Prishtinës deri në Beograd. Në asnjë rast nuk përmendet si keqbërës ndonjë autoritet apo ndonjë person shqiptar pa rol publik që të ketë luajtur ndikim dëmprurës ndaj hebrenjve.

Pothuajse nga të gjithë pohohet fshehja e 400-600 hebrenjve të Kosovës në brendësi të Shqipërisë së vjetër, me interesimin e autoriteteve të vendit, nga të cilët veçohet Ilijaz Agushi, ish-ministër i qeverisë së Shqipërisë (*Ilijaz Agushi, bivši ministar albanske vlade - Sarina Feta*), po dhe Shukri Bega, Vesel Sadiku, Xhemal Bega, Rushid

Bega, Shazivar N., Malush Kosova, Zenel Bajraktari (*Šukri Bega, Vëseli Sadika, Djemalji Bega, Rušid Bega, Šezivara N., Maljuš Kosova, Zenel Bajraktara, od nacionalnog albanskog komiteta*, idem), në të gjitha rastet si ndihmës të hebrenjve në kohë të vështirë.

Në përfundim të këtyre hetimeve Sekretariati Federativ i Punëve të Brendshme, drejtorja e Sigurimit (*bezdobjednosti*), një zyrë e posaçme e UDB-së, hartoi listat e plota të 62 familjeve hebreje të Kosovës, të internuara nëpër kampe përqendrimi ose të strehuara e të mbijetuara në Shqipëri. Listat përmbajnë 295 emra, nga të cilët 206 ishin ende gjallë në vitin 1960, në ish-Jugosllavi apo Izrael. Sipas punëtorit operativ të policisë së fshehtë (*operativni radnik*) Miodrag Kratić, hartues i listës emërore sintezë (vetëm të kryefamiljarëve) prej katër fletësh, 80 hebrenj vdiqën në kampin e Bergen-Belsen-it, 7 u qëlluan me armë atje dhe 2 në Prishtinë (*Od gore navedenih lica čiji ukupan broj iznosi 295 u logoru je umro 80, streljani 7 (u logoru), streljani u Prištinu 2, preživeli 206*).

Këto dokumente janë mbajtur sekret deri vonë, sepse është pretenduar krejt e kundërta: që numri i hebrenjve të viktimizuar në Kosovë gjatë luftës antifashiste ka qenë 260-400 veta dhe që internimi i tyre është bërë nga Divizioni SS *Skanderbeg*. Zbulimi i tyre, së pari, bën të ditur se ka pasur një projekt jugosllav për të gjetur një fajtor tek *reaksioni shqiptar* për numrin e hebrenjve të deportuar, gjë që nuk dëshmohet nga asnjë i mbijetuar. Nëse do të kishte qenë një çështje humanitare, pse duhej të ngarkohej me çështjen UDB-ja? Së dyti, është i dukshëm qëllimi për të ndërlikuar në gjithë këtë histori Divizionin SS *Skanderbeg*, por të mbijetuarit fajësojnë një tjetër Divizion, atë *Hanshar*, njëri prej gjashtë divizioneve vullnetare naziste SS që u krijuan në ish-Jugosllavi. Së treti, me gjithë përpjekjet për të rritur numrin

e hebrenjve të Kosovës viktimat të Shoah në Bergen-Belsen, ky numër raportohet 80, por prej verifikimit tonë emër për emër numri i saktë është 75 dhe, veç kësaj, në këto lista më shumë se gjysma gjenden si hebrenj të mbijetuar në Shqipëri në listat e arkivave të vendit. Në përfundim, rikonfirmohet se numri prej 34 hebrenjsh që rezultoi në listat e plota që ruhen në Shqipëri deportuar në Bergen-Belsen është më i padyshimti. I pashpjegueshëm mbetet fakti që, pikërisht në vitin 1961, edhe *Sigurimi* shqiptar urdhëron të njëjtin hetim ndaj hebrenjve, me një objekt pak më ndryshe, për qendrimin e tyre politik pas luftës<sup>1</sup>.

### III.

A ka pasur hebrenj të ardhur në Shqipëri me misione ideologjike, si komunistë, bolshevikë, veprimtarë të Comintern-it, të dërguar të sovjetikëve apo miqve të tyre, pjesë e aleancës së madhe antifashiste botërore? Kjo pyetje nuk është shtruar as prej studiuesve shqiptarë, as prej të huajve, me sa duket për shkak të numrit të vogël të hebrenjve vendës dhe relativisht të vogël të atyre jovendës. Nëse do të konsiderohej krejt i besueshëm në tërësinë e vet dokumentacioni i krijuar gjatë periudhës mbretërore, do të krijohej një përfytyrim i shmangur nga e vërteta. Monarku shqiptar shihte gjithkund rrezikun bolshevik dhe, ashtu si miqtë e tij në Perëndim, në radhë të pare Italia, bolshevizmi ishte i pandarë nga konsipracioni judaik. Shumë dokumente janë prodhuar nga zyrat e policisë sekrete të Zogut për hebrenj të dyshimtë të ardhur nga Parisi, nga Bullgaria, nga Greqia, nga Polonia, nga Rusia, madje dhe nga Spanja, si të dërguar prej lëvizjes komuniste botërore. Po aq vigjilente është dhe përfaqësia diplomatike italiane në Tiranë, Legazione d'Italia, e cila e shihte gati-gati si një lëvizje të qëllimshme ardhjen e hebrenjve

<sup>1</sup> Kastriot Dervishi: *Urdhri i Sigurimit për kontrollin e hebrenjve: 1961*, në të përditshmen 55, nr. 26, 30 janar, 2010, f. 16-17.

si faktor fuqizimi të lëvizjes komuniste<sup>2</sup>. Si gjatë periudhës mbretërore, ashtu dhe gjatë asaj fashiste e naziste, qendrimi ndaj hebrenjve komunistë ose të dyshuar si të tillë prej autoriteteve bashkëpunuese ka qenë ndryshe. Nga Prishtina Ministria e Punëve të Brendshme njoftohet për arrestimin e një studenti hebre për shkak të dyshimit për bindjet e tij komuniste<sup>3</sup>. Në mënyrë të veçantë nuk i shpëtojnë rrethit të dyshimit hebrenjtë e ardhur nga vendet sllave. Një hebreo-serb nga fshati Krushë i Kosovës që arrin të hyjë në tokat e Shqipërisë së vjetër arrestohet si emisar komunist<sup>4</sup>. Jo vetëm kaq, por një hebreo-komunist mund të arrestohet me shumë lehtësi se një komunist shqiptar. Madje në një rast policia pranon të lirojë disa komunistë shqiptarë si shpërblim për denoncimin e një grupi hebreo-komunistësh me qendrim në Tiranë<sup>5</sup>. Jo vetëm veprimi, por edhe dyshimi për veprimtari bolshevik, mjaftonte, në jo pak raste, që hebrenjtë të arrestoheshin. Për më tepër, edhe përfshirja në një veprimtari politike çfarëdo, edhe jokomuniste, mund të bëhej shkas për një

qendrim ndryshe ndaj hebrenjve<sup>6</sup>. Hebreu David Baruh urdhërohet të lerë Shqipërinë për faktin se janë dhënë dëshmi se është përkrahës i Bedri Pejanit, deri në atë moment i njohur si veprimtar i Comintern-it dhe vetëm pak kohë më vonë nismëtar për themelimin e Divizionit SS Skanderbeg<sup>7</sup>. Të dyshuarve për veprimtari bolshevik mund t'u shtohet lehtësisht dhe padia për spiunazh<sup>8</sup>. Teoritë e modës të konspiracionit botëror hebreo-bolshevik mjaftojnë që hebreu Paul Chapiron, i ardhur nga Parisi, i dyshuar si bolshevik, megjithëse njihet si rus i bardhë, carist e antikomunist, vihet nën mbikëqyrje si delegat i Comintern-it dhe doemos pas kësaj dhe si agent rus, francez, sionist etj<sup>9</sup>. Veçanërisht e trembur prej hebreo-rusëve, të cilët përgjithësisht barazohen si hebreo-komunistë, është ambasada italiane në Tiranë, që vazhdimisht raporton për agjentë të dyfishtë, në shërbim të bolshevizmit dhe të sionizmit<sup>10</sup>. Të paktën në një rast provohet se për shkak të bindjeve komuniste të një hebreu është vepruar me masa të dhunshme ndaj gjithë familjes së tij<sup>11</sup>.

<sup>2</sup> AQSH, F. 163, Legazione d'Italia, V. 1938, D. 214, fl. 3: Lajme për situatën politike të brendshme, masat kundër lëvizjes komuniste e aktivizimin e agjentëve të Zogut kundër komunistëve.

<sup>3</sup> AQSH, F. Ministria e Punëve të Brendshme, V. 1942, fl. 8: Telegram i prefektit të Prishtinës MP të Brendshme për arrestimin e Albero Muzahin, jahudi, student, i akuzuar për propagandë komuniste.

<sup>4</sup> AQSH, F. Ministria e Punëve të Brendshme, V. 1942, fl. 160: Njoftim i komandës së karabinierisë Këshillit të Ministrave për arrestimin si emisar komunist më 16 mars të çifutit Taja Angelkoviç nga Krusha e Kosovës.

<sup>5</sup> AQSH, F. 153, V. 1944, fl. 8-19: Njoftim i Drejtorisë së Policisë së Tiranës për prefekturën e Tiranës për arrestimin nga policia gjermane të të dyshimëve për propagandë komuniste me shtetësi italiane dhe racë çifute, denoncuar nga Ks. St., me qëllim që, në këmbim, të lirohen elementë komunistë [lista emërore dorëshkrim].

<sup>6</sup> AQSH, F. i Ministria e Punëve të Brendshme, V. 1944, D. 832: Korrespondencë e MP të Brendshme me drejtorinë e policisë e komandën e gjindarmërisë për nxjerrjen jashtë kufirit të katër grave me shtetësi të huaj të dyshuara politikisht, si dhe të dr. David Boruh, çifut, si përkrahës i komunistëve.

<sup>7</sup> AQSH, F. MPJ, V. 1944, fl. 1-4: Njoftim i MP të Jashtme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për MP të Brendshme për nxjerrjen jashtë kufirit të Bedri Pejës dhe dr. David Baruh, çifut, të padëshirueshëm nga komanda gjermane.

<sup>8</sup> AQSH, F. 163, Legazione d'Italia, V. 1939, D. 246, fl. 1-5: Legata Italiane njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë për hyrjen në Shqipëri të një çifuti rus që dyshohet për spiunazh.

<sup>9</sup> AQSH, F. 161, Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1941, D. 529, fl. 1-17: Mëkëmbësia e Përgjithshme i kërkon MP të Jashtme të dhëna rreth rusit të bardhë çifutit Paul Chapiron, me disa shtetësi të ndryshme, ofron informata për marrëdhëniet mes Francës e të kuqve spanjollë, ndiqet si kontrabandist dhe kërkohet si agjent i Comintern-it.

<sup>10</sup> AQSH, F. 163, Legazione Italiana, V. 1939, D. 246, fl. 1-5. Legata Italiane njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë për hyrjen në Shqipëri të një çifuti rus që dyshohet për spiunazh.

<sup>11</sup> AQSH, F. Ministria e Punëve të Brendshme, V. 1941, fl. 20, 28: Listë e personave komunistë, përfshirë çifutët: Areosti Jakov Jakovi, e ëma Kena, lindur në Bitol; Santigarlo Mushat Salamone, e ëma Rosa lindur në Bitol; Santigarlo Nejze Rifsha, e ëma Klara lindur në Sarajevë; Avramoviç Josif Avron, e ëma Solici, lindur në Beograd.



# I: rralitët në Shqipni: para okupacionit, gjatë okupacionit dhe mbas çlirimit nga okupatori

... Nga Samuilo Mandil, dhe...  
 ... Shqipëria...  
 ... okupacionit...  
 ... mbas çlirimit...  
 ... nga okupatori...

... dëshor dhe...  
 ... rralitët...  
 ... Shqipëria...  
 ... okupacionit...  
 ... mbas çlirimit...  
 ... nga okupatori...

Nga artikulli i Ing. Samuilo Mandil, Bashkimi, 1945.

I pari që pati shenjuar pjesëmarrjen e një numri hebrenjsh në luftën antifashiste të popullit shqiptar është Ing. Samuilo Mandil, i cili, në një artikull të botuar në të përditshmen Bashkimi në vitin 1945 propozoi që pesë hebrenjtë: *David Kohen, Jakov Avramovic, Josef Konforti, Josef Bivas, Zhak Ruben*, të shpallnin dëshmorë të popullit shqiptar<sup>12</sup>. Historia e pjesëmarrjes së hebrenjve në këtë luftë është ende e mjegullt. Të dhëna për të rindërtuar këtë histori mund të gjenden në historikët e qarkorëve, hartuar e redaktuar disa herë gjatë viteve 1970-1980. Gjithashtu të dhëna të vlerësueshme mund të gjenden në koleksionet e komiteeve të veteranëve të luftës, që ruhen pranë arkivave dhe muzeve vendorë. Në masën që kemi mundur t'i këshillojmë këto burime rezultojnë se pjesëmarrja e hebrenjve në luftën

antifashiste është më e madhe se sa dihet<sup>14</sup>. Disa nga hebrenjtë e internuar në Berat u rreshtuan përkrah partizanëve të Brigadës VII Sulmuese dhe morën pjesë në të gjitha betejat që zhvillonte ky formacion luftarak. Në betejën e Tendës së Qypit luftoi dhe ka trimërisht i riu hebre *Jakov Bahari*. Të rinjtë hebrenj *Bela* dhe *Rudi* morën pjesë në përirimin e batalionit të rinisë *Margarita Tutulani*. Në fshatin Bishqethm të Fierit gjendet një varr që vendësit e njohin si *varri i dëshmorit hebre*. Pjesëmarrja e izraelitëve në lëvizjen antifashiste ra në sy të autoriteteve fashiste, ndaj kuesturës së Beratit i kërkohesh të merreshin masa. Më 23 qershor 1943 i kërkohesh prefekturës largimi i 39 hebrenjve, sepse dyshoheshin për organizime subversive. Edhe pse kuestura dispononte emrat e tyre asnjë veprim konkret nga ana e saj, por

<sup>12</sup> Mandil, Samuilo [Ing.]: Izraelitët në Shqipni, në: Bashkimi, 20 shkurt 1945.

<sup>13</sup> Albania, War Resource Center: Early in 1944 the Gestapo ordered Jews in Tirana to register. Many Jews took this as a signal to flee to the Partisans outside the capital.



kërkesa reduktohej në përqendrimin e tyre në një qendër<sup>14</sup>. Është e njohur sakrificat e hebrenjve dëshmorë të rënë në territorin gjeografik të Beratit si: **1.** Jusef Solomon Konforti, internuar në Berat, inkuadruar në formacionet partizane të Brigadës VII. Ra duke luftuar në Selenicë të Vlorës më 1943. **2.** Jusef David Bivas, internuar po në Berat, pjesëmarrës në Brigadën VII Sulmuese. Ra në luftë në gusht 1943. **3.** Jakov Avramoviç i internuar në Berat më 1942, ra në luftimet në Lushnje, nëntor 1943. **4.** Jakov Josef Bahari, internuar në Berat më 1942. U vra në betejën e Tendës së Qypit, gjatë dimrit më 1944. **5.** Gjithashtu, vëllezërit Dedok: Manueli dhe Viktori, Pepe Kantozi, Manuel Rubeni, Moshë Rubeni, Albert Josef Asheroviç aktivë në luftën kundër pushtuesit nazist<sup>15</sup>.

Hebrenjtë e Beratit, më 22 tetor 1944, në emër të gjithë hebrenjve që ndodheshin në Shqipëri, shpreheshin: *Falenderojnë kryetarin e Komitetit Antifashist të Shqipërisë Enver Hoxhën, për gjithë çka populli shqiptar dhe ai i Beratit bëri për hebrenjtë gjatë luftës*. Ata i kërkuan udhëheqësit shqiptar të luftës antifashiste të ktheheshin në tokat e tyre. Siç dëshmon shembulli i Beratit, historia nuk është vetëm e shtypjes, urrejtjes dhe dhunës, por është edhe histori e rezistencës, humanizmit, dashurisë: Ajo që është ende e fshehur duhet të dalë në dritë dhe ajo që asnjëri nuk e di duhet të zbulohet.

Përveç faktit të njohur, që *dhjetë hebrenj u vranë si antifashistë në përbërje të ushtrisë vullnetare shqiptare*<sup>16</sup>, për çka, më 2 dhjetor 2008 i jemi drejtuar Presidentit të Republikës

së Shqipërisë Bamir Topi për shpalljen e tyre zyrtarisht dëshmorë (dhe morëm përgjigjen absurde se një gjë e tillë nuk mund të bëhej, sepse shpallja dëshmor duhej të vinte si propozim i njësisë vendbanuese të personit); përveç vdekjeve për shkaqe natyrore siç ndodh me jetën e njeriut, janë të paktën dy-tri raste burimore ku përmenden *vrasje të hebrenjve*, që pjesërisht kanë mbetur të mjegullta. Rasti i parë shenjohej në një korrespondencë të Ministrisë së Punëve të Jashtme me Kryeministrinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe bën fjalë *për disa njoftime për vrasje e plaçkitje të popullsisë çifute që ka marrë shtetësi shqiptare*<sup>17</sup>. Nga kërkimi ynë në dokumente nuk mundëm të certifikojmë këtë rast. Mungojnë të dhënat për emra të vrarësh, korrespondenca mbyllet në një mënyrë të tillë që nuk kuptohet nëse njoftimet ishin të vërteta apo jo. Lënda e dosjes që mban këtë titull më shumë të lë të kuptosh se pjesa e parë e njoftimit (*për vrasje*) ka të bëjë me *vrasset që kanë ndodhur në popullsinë civile shqiptare* në periudhë kohore që raportohet, kurse pjesa e dytë (*plaçkitje*) ka të bëjë me pronat e hebrenjve. Ndër të tjera, janë dhe vetë shtetasit shqiptarë që, vullnetarisht, mbajnë procesverbal për raste kur ushtria naziste ka kryer grabitje të tilla, si rasti i ndodhur në qytetin e Krujës<sup>18</sup>. Grabitjet e pasurive, sidomos të hebrenjve, kanë qenë një dukuri e shpeshtë. Për këtë shkak funksiononte dhe një komision i dëmshpërblimeve për dëme të shkaktuara nga lufta, komision që rezulton t'u jetë përgjigjur dhe ankimeve të hebrenjve<sup>19</sup>.

<sup>14</sup> AQSH, F. 253, D. 288, V. 1940; AQSH, F. 253, D. 288, V. 1942; AQSH, F. 253, D. 386, V. 1943.

<sup>15</sup> Idem.


<sup>16</sup> Në letrën nënshkruar bashkë me kryetarin e bashkisë së Beratit z. F. Nasufi, përmendeshin emrat e hebrenjve David Kohen, Jakov Avramovic, Jusef Konforti, Jusef Bivas, Zhak Ruben, Dario Arditi, Jakov Bahar, Leo Tjyer, Baruh Baruhoviç e Amuras Moiseb.

<sup>17</sup> AQSH, F. i MP të Jashtme, pa vit, D. 69.

<sup>18</sup> AQSH, F. i Ministria e Punëve të Brendshme, V. 1943, fl. 1: Procesverbal për grabitjet e ushtrisë gjermane në shtëpitë, dyqanet e banorëve të Krujës sidomos të çifutëve; AQSH, F. i MPB, V. 1943, D. 44: Procesverbal i mbajtur për rrëmbimin nga gjermanët të mallit të depos në Krujë të çifutëve Neseim Levi dhe Rafael Jakoel.

<sup>19</sup> AQSH, F. 193, Komisioni Qendror për shpërblimet për dëmet e luftës, V. 1942, D. 24, fl. 1-2; AQSH, F. MPB, V. 1943, D. 23.

KOMITETI KOMBETAR I VETERANEVE  
TE LUFTES SE POPULLIT SHQIPTAR  
KOMITETI I VETERANEVE TE RRETHIT Shkodër



KARTELA E DESHMORIT TE LUFTES NACIONALCLIRIMTARE

Emri, atësia, mbiemri Dario Zhak Arditi  
Datëlindja 20 Dhjetor 1917  
Vendlindja Tiranë

Kur dhe ku mori pjesë në lëvizjen Nacionalçlirimtare, aktiviteti dhe përgjegjësia që ka patur në atë periudhë. Aktivizuar me lëvizjen Nacionalçlirimtare në vitin 1942, si student në gjimnazin e Shkodrës. Me vonë si farmacist ka ndihmuar luftën Nacionalçlirimtare me ilaçe e mjekime të ndryshme për partizanët. Për veprimtari revolucionare arrestohet nga gestapaja e internohet në kampin e përqendrimit në Prishtinë në Verën e Vitit 1944.  
Kur dhe ku mori pjesë në formacionet partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, aktiviteti dhe përgjegjësitë që ka patur. Nuk ka marrë pjesë në formacionet partizane të ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Vendim Nr 31 dt. 6.4.1978 Kom. Elza K.P. Rreth Shkodër  
Kur, ku dhe kundër kujt ka rënë dëshmor. Pas shkatërruar nga Gjermanët, vendi e data ekrakte nuk dihet. 1944.

Vendi i varrimit Nuk dihet

Data 18.7.1984.

KOMITETI KOMBETAR I VETERANEVE  
TE RRETHIT  
Elza Zaja

*Kartela personale e Dario Arditi me motivacionin për shpalljen dëshmor të Shqipërisë për kontribut në luftën antifashiste, sipas vendimit të komitetit të veteranëve të Shkodrës, 1984.*

Në dëshmitë e të mbijetuarve dhe në burimet arkivore ky rast mbetet i pasqaruar, gjersa nuk përshkruhet asnjë situatë, nuk përmendet asnjë ngjarje dhe nuk shenjohet asnjë emër i përveçëm. I ngjashëm me të është ai i një dëshmie të të mbijetuarit Rudi Abravanel, që ruhet në *Yad Vashem Institute*, në të cilën thuhet se të afërm

të tij janë sulmuar e vranë prej hajdutësh shqiptarë, që besohej se ishin në ndihmë e në mbrojtje të tyre (*Rudi Abravanel reports that a group of his relatives were murdered by the Albanian smugglers who were supposed to help them cross into Albania*)<sup>20</sup>: as emra, as situatë, as ngjarje.

Një prej çështjeve më të diskutueshme

<sup>20</sup> Yad Vashem M. 31/5666.

për historinë e hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe sjelljen e shqiptarëve ndaj tyre është ajo që lidhet me *familjen Arditi*, banuese në Shkodër. Fati i kësaj familjeje dhe disa të dhëna që edhe shqiptarët mund të kenë rol në këtë fat e bën studiuesin të kujdesshëm, për të mos shqiptuar pohime kategorike, një prej të cilëve është: *Asnjë hebre nuk humbi jetën në Shqipëri gjatë luftës*. Dario Arditi u shpall dëshmor i luftës antifashiste të popullit shqiptar në vitet 1980, me propozimin e komitetit të veteranëve të kësaj lufte për qytetin e Shkodrës. Në listën e propozimeve të Samuil Mandil emri i tij nuk është. Ndërkohë, mbetet një pikëpyetje pse shpallja e tij dëshmor u vonua kaq shumë.

Duke qenë se në burimet arkivore shqiptare nuk kemi mundur të gjejmë të dhëna për deportimin e familjes Arditi fillimisht në kampin e Prishtinës dhe më pas në Dachau, Mathausen e gjetiu, kemi supozuar se rasti i përmendur në studimet për hebrenjtë në Shqipëri, për katër persona të arrestuar e të dërguar në kampet e shfarosjes me ndihmën e shqiptarëve si spiunë duhej të ishte ai që përmendet në letërkëmbimin midis prefekturës së Shkodrës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, më 2 maj 1944, për të ndërhyrë pranë autoriteteve naziste që *katër hebrenj të ardhur nga Prishtina e të arrestuar prej tyre të lirohen, pa e paguar kushtin prej 60 mijë franga shqiptare* - gjegjësisht katër mijë napolona ar, duke e konsideruar këtë si çështje të brendshme të qeverisë shqiptare. Dokumentet janë pjesë e këtij libri. Siç rezulton, katër hebrenjtë u liruan, por duke e paguar kushtin.

Në një artikull të botuar në tetor të vitit 2013 u bë e njohur se Muzeu Historik i Shkodrës ruan të plotë dosjen e familjes Arditi, ashtu siç ishte përgatitur nga komiteti i veteranëve të luftës antifashiste, certifikuar

nga kryetari e sekretari i tij Hysë Zaja e Jup Troshani<sup>21</sup>. Dosja përmban argumentet historike mbi bazën e të cilave Dario Arditi u shpall dëshmor, ndërsa pjesëtarët e tjerë të familjes Arditi: Leon, Luka, Luçie e Ugo, të gjithë pasardhës të Zhak Ardimit, u shpallën *viktima të luftës*. Ngjarja që u bë shkas për fundin tragjik të kësaj familjeje: arrestimi i tyre nga ushtria naziste, dërgimi fillimisht në kampin e Prishtinës, dhe së fundi shfarosja në kampet naziste, është paraqitur në disa versione. B. Bekteshi, që mund të konsiderohet më i besueshmi, sepse deri më tani është i vetmi që u referohet burimeve dokumentare, pohon se, nga dosja e shqyrtuar, *nuk ka kurrfarë të dhëne mbi armiqësitë që kjo familje mund të kishte pasur në rrugën 'Badra', ku kanë banuar Arditët*<sup>22</sup>. *Kësaj familjeje, nga disa familje shkodrane ju është lutur për ndihmë*, pohon autori, *pra, për t'i fshehur, dhe vetëm mospranimi në ardhjen e gjermanëve ka sjellë dhe pastaj arrestimin e tyre dhe vrasjen në kampet e përqendrimit*. Këtë pohim ai e konsideron të përforcuar dhe nga fakti që, duke kaluar nëpër vigjilencën e komitetit të veteranëve, edhe sjellja e *katër Arditëve viktima* shenjohej të ketë qenë *me qendrim të mirë politik*. Në disa komente thuhet se Arditët ishin të fuqishëm dhe nuk e ndienin nevojën për mbrojtje. Ndërkaq Dario Arditi nuk ka marrë pjesë në asnjë formacion partizan dhe megjithatë është shpallur dëshmor. Mund të mendohet se Arditët ishin në mbështetje të lëvizjes antifashiste, bazë e saj, ndoshta dhe në pikëpamjen materiale-financiare, dhe kjo u bë shkak që të veçohej si familje prej të tjerëve. Nuk kanë munguar dhe dëshmitë, në formën e të thënave, që Arditët u denoncuan prej shqiptarësh. Por më mirë e ndriçon këtë çështje dëshmia e Sara Ardimit, bashkëshorte e Xhorxhit, të vetmit që i mbijetoi luftës, që gjendet në fund të këtij kreu.

<sup>21</sup> Besi Bekteshi, Familja Arditi, dokumentat në dosje, hebrenjtë dhe Shkodra, botuar në të përditshmen Sot, 10 shtator 2013.

<sup>22</sup> Idem, ibidem.

Mund të thuhet, duke iu referuar dëshmimeve e burimeve, përmbledhtas: Një familje e vetme hebreje që jetonte përhershmerisht në Shqipëri nuk e pati të njëjtin fat si dy rastet e përmendura në shkresat e mësipërme. Bëhet fjalë për familjen Arditi: Yitzhak Arditi (lindur më 1880), gruaja e tij Luna (lindur më 1888), tre bijtë e tyre: Leoni (lindur më 1913, farmacist), Dario (lindur më 1917, mjek), Ugo (lindur më 1922, violinist), dhe vajza Lucia (lindur më 1910), që u arrestuan në tetor të vitit 1944 në Shkodër dhe u deportuan për në Prishtinë. Prej tyre vetëm babai i mbijetoi shfarosjes. Një nga bijtë, Moise Arditi, u fsheh prej miqve të familjes së tij Vasil dhe Kristina Kona<sup>23</sup>. Në *Yad Vashem* ky rast njihet sipas një dëshmie të të afërmeve të familjes Arditi, ku theksohet se arrestimi i tyre u bë për shkak të hebraizmit dhe që ata mendonin se asgjë e keqe nuk prisnin t'u ndodhte<sup>24</sup>. Ky është një rast për t'u ndriçuar, pavarësisht se sipas studuesve të Shoah *shqiptarët nuk kishin dorë në këtë ngjarje* (M. Sarfatti, *Grazie Albania*). Një pikëpyetje tjetër del nga fakti se emri i njërit prej pjesëtarëve të familjes Arditi, Dario, rezulton në listat e hebrenjve të propozuar për t'u shpallur dëshmorë të popullit shqiptar, rënë në luftë si antifashist, megjithëse në artikullin e hebreat Samuel - Samuilo - Mandil, botuar në gazetën

Bashkimi në vitin 1945, një artikull me karakter falënderues për qëndrimin e popullit shqiptar, ky emër nuk gjendet<sup>25</sup>. Kërkimi i mëtejshëm për të provuar apo mohuar pjesëmarrjen ose jo të Dario Arditi në luftën antifashiste do të përbënte një përgjigje të mundshme nëse ishte besimi dhe raca hebraike shkak i vetëm i dëbimit dhe viktimizimit tragjik të kësaj familjeje<sup>26</sup>. Por kjo do t'i shërbente edhe pasurimit dhe saktësimit të *Listës së Listave* të të viktimizuarve në Shoah, të të mbijetuarve, të ndihmuesve dhe shpëtuesve të tyre, të bashkëpunëtorëve të ushtrive pushtuesve, si dhe të të dhënave të tjera më të detajuara, duke përfshirë arsyet e zhdukjes. Kjo ishte arsyeja pse iu dejtua posaçërisht rekordeve të Yad Vashem për të dhëna të viktimizimit të hebrenjve në Shqipëri. E vetmja referencë që mundëm të gjejmë për këtë është dëshmia e *Yaffa Reuven née Bachar, who fled with her family from Prishtina to Berat was thirteen-yearsold when the Germans entered Albania. Her family was living with the Shkurti and Sfechi families*. Sipas dëshmisë së depozituar në Yad Vashem nga kjo familje, ka pasur një rast dekonspirimi të strehimit të hebrenjve në Shkodër, shkak prej të cilit e pësoi kjo familje, pjesërisht e internuar menjëherë në Prishtinë dhe më pas dhe e deportuar në Bergen Belsen, fatmirësisht e rikthyer pa humbje jetësh njerëzore<sup>27</sup>. Përkundër

<sup>23</sup> Yad Vashem M. 31/5665: In some cases the contact was of professional nature; in other instances it started with local Albanians who had rented some property to Jewish refugees before September 1943; in a few cases, we found an already existing personal friendship, as in the case of Kona and Arditi, which after September 1943, developed into a bond of rescue.

<sup>24</sup> Yad Vashem, M. 31/6736.

<sup>25</sup> Ing. Samuel Mandil, Izraelitët në Shqipëri, në: Bashkimi, 20 shkurt 1945.

<sup>26</sup> Nga kërkimet më të fundme rezultoi se me vendimin nr. 31, datë 6.4.1978, komiteti i veteranëve të luftës antifashiste të Shkodrës e ka shpallur dëshmor Dario Arditi, me motivacionin: Aktivizuar në Luftën Nacionalçlirimtare në vitin 1942, si student në gjimnazin e Shkodrës. Më vonë si farmacist ka ndihmuar luftën nacionalçlirimtare me ilaçe e mjekime të ndryshme për partizanët. Për veprimtari revolucionare arrestohet nga Gestapoja dhe internohet në kampin e përqendrimit në Prishtinë në verën e vitit 1944.

<sup>27</sup> Yad Vashem M. 31/5370: They knew we were Jews and helped us, protected us. Every time the Germans appeared in town, they would warn us and hide us outside the city until the difficult situation passed, when they would return us home. When the danger increased, the Bachars moved to Shkodra. We thought that in a bigger city they would not find us. We lived in a small rented apartment and hid there. Unfortunately there was persecution also in Shkodra. One day the Germans came to our home with a list of the entire family.

kësaj dëshmie, në një prej dokumenteve që kemi pasur mundësi të këshillojmë flitet dhe për akte vrasjeje, të pakonfirmuara, jo të motivuara nga qëllime racore apo antisemite, të paqarta në tekst por të nënkuptuara për motive grabitjeje<sup>28</sup>. Një rast i ngjashëm pohohet dhe në burimet e Yad Vashem: *In the Shpuza file, Rudi Abravanel reports that a group of his relatives were murdered by the Albanian smugglers who were supposed to help them cross into Albania*<sup>29</sup>. Këto lista janë në proces saktësimi e plotësimi që prej vitit 1995 dhe studiuesit e historisë së Shoah mund të ndihmojnë shumë që katalogët, inventarët, guidat, mjetet e informimit të *Holocaust Martyrs' and Heroes' Remembrance Authority* të ofronin më shumë informacion se ai që shërbehet në listat e deritashme (*Yad Va-shem, rashut ha-zikaron la-Sho'ah vela-gevurah. Arkhivon ha-merkazi la-Sho'ah vela-gevurah*). Në këta katalogë lista plotësuese e të mbijetuarve në Shqipëri mban titullin *List of Jews in Tirana, Albania and Goldesberg, Germany - Lista e hebrenjve në Tiranë, Shqipëria dhe Goldesberg, Gjermani*. Ajo përmban vetëm 50 *names or other entries* - emra dhe shtesa të fundme. Të gjithë janë emra të *Holocaust survivors - all of those listed are Holocaust survivors - Të mbijetuar të holokaustit, të gjithë emra të mbijetuarish të Shoah*. Lista është nxjerrë prej katalogut të *Yad Vashem Archive*, përgatitur në periudhën 1998-2002. *List of Lists*, edhe në rastin e Shqipërisë, është autentifikuar përmes një bashkëpunimi me *Memorial Museum of Holocaust* në maj të vitit 2005. Në *Listën e Listave* në Yad Vashem gjendet, krahas regestit të të

shpëtuarve dhe atij të shpëtuesve, edhe lista me emrat e kolaboracionistëve, duke përfshirë ata shqiptarë. *Memorial Museum of Holocaust*, qysh në vitin 2005, ka shprehur një interesim institucional, përmes një marrëveshjeje të propozuar e të validuar, edhe për kuislingët shqiptarë.

Në mbyllje të këtij artikulli, po japim dëshminë e Sara Arditit, bashkëshorte e të mbijetuarit të *Shoah* në Shqipëri, Xhorxhi Arditi:

“Jam Sara Arditi, e shoqja e Xhorxh Arditit nga Israeli. Me këtë rast do të jap spjegime ma të hollësishme në lidhje me shfarosjen e familjes Arditi në Shkodër. Pikë së pari e ndjej për detyrë të falënderoj popullin e Shkodrës dhe veçanërisht gjithë të njohturit tanë, për dashamirësinë dhe respektin që kanë ushqye ndaj familjes tonë. Dua të theksoj se shfarosja e pjesëtarëve të familjes Arditi nga nazistët gjermanë në asnjë mënyrë nuk cenon ndjenjat tona për popullin e Shkodrës. Tani po sqaroj se si nazistët kapën familjen Arditi. Ishte fillimi i Nëntorit 1944. Pjesa kryesore e familjes, e përbërë nga prindërit Zhak dhe Luna Arditi; djemtë Leoni, Ugo dhe Dario, si dhe vajza Lucia, jetonin në Shkodër. Ndërsa djali i madh Moisi jetonte në Tiranë me familjen e tij (i martuar me Stelan). Në këtë periudhë, gjermanët, të shoqëruar nga spiuinë shqiptarë, erdhën në shtëpi, që ishte në rrugën ‘Badra’ dhe morën të gjithë familjen, përveç Zhakut, i cili në atë kohë ishte në farmacinë e tij në pazarin e vjetër. Kur erdhi në shtëpi dhe nuk gjeti asnjë pjesëtar të familjes, pyeti komshinjtë, të cilët e informuan për çfarë kishte ndodhur. Ai menjëherë u drejtua në

---

My late father was not at home, and I was playing with the children of the neighborhood. My mother, sister and my two small brothers were taken to Pristina. From Pristina the deportees were taken to Bergen Belsen. Fortunately, they survived and returned after the war. In her testimony Yaffa Bachar goes on to describe her fate: I stayed alone and didn't know the fate of my father. The landlord kept me until my father learned of my location. The landlord blackmailed my father – all the furniture, money and jewelry remained with him.

<sup>28</sup> AQSH, F i MP të Jashme, pa vit, D. 69: Korrespondencë e MP të Jashme me Kryeministrinë dhe MP të Brendshme, për njoftimet për vrasje e plaçkitje të popullsisë çifute që ka marrë shtetësi shqiptare.

<sup>29</sup> Yad Vashem M. 31/5666.



KOMITETI I VETERANËVE TË RRËTHIT  
Seksioni Burg. Intern. politikë  
S H K O D Ë R

KARTELA E TË INTERNUARËVE NË KAMPET E PËRQENDRIMIT

Emri, stësi, - i emri Në Dakas - Gjermani  
Ugo Zhak Arditi

KATSELINDJA 1927 VENDLINDJA në Shkodër

DATA E ARR. SPIMIT 29-4-1943 VENDI I ARRESTIMIT në Shkodër

NË TË GJITHË BURG ËSHTË DERGUAR në Burgun e Hadh të Shkodër

PREJ BURGUT U DERGUA në Kampin e përqendrimit Prishtinë - Kosovë në datën  
29. Majë 1944

NË SE KËSHTU DERGUAR NË BURGJE TË TJERA TË VEHT DATA E BURGIMIT DHE  
SË ARRIMIT NË BURGJE INTERNALIT Internuar në muajin Majë 1944

NË TË CILIN KAMP PËRQENDRIMI ËSHTË DERGUAR, DATA, GJENERALITETI  
GJERËSSISHE I KAMPIT TË PËRQENDRIMIT Internuar në Kampin e përqendrimit  
Prishtinë dhe mbas dhjetë ditësh internuar në Kampin e përqendrimit në  
Dakas të Gjermanisë ku është mbytur me gazra vdekjeprurëse dhe është  
publikuar.

INFORMACIONE KA MARRË PJESE PËR ARRESTIMIT

*Kartelë vetjake e Ugo Arditit, shpallur viktimë e luftës me vendim të komitetit të veteranëve të Shkodrës.*

Gestapo, për t'u munduar me i shpëtue. Në këtë kohë gjermanët i kishin transportuar siç duket në drejtim të Jugosllavisë. Ata nuk u mjaftuan me kaq, por arrestuan edhe Zhakun. Me çlirimin e Shqipërisë, Moisi, djali i madh, që jetonte në Tiranë, shkoi në Shkodër për të kërkuar familjen. Nga të njohturit mori vesh për fatin e familjes. Mbas disa muajsh Zhaku kthehet i gjallë nga kampi i Prishtinës. Ai nuk arriti të takohet asnjëherë me gruan dhe fëmijët e deportuar. Kështu që fati i tyre nuk dihet se ku kanë përfundue. Zhaku, mbas pak kohe të kthimit të tij, vdiq, gjendja shpirtërore e tij ishte e mbaruar. Në vitet 1980 qeveria

në fuqi shpalli Dario Arditin si dëshmor dhe pjesën tjetër të familjes si viktimë të luftës. Me gjithë këto tmerre që i ndodhën familjes, Moisi dhe Stella që mberën gjallë, si dhe fëmijët e tyre: Silvia, Leni dhe Xhorxhi, u transferuan me banim në Shkodër. Jo vetëm që nuk i mbajnë mëri, por kanë respekt të veçantë për popullin e Shkodrës, i cili, në shumë raste i asht lutë familjes në kohë të luftës me i fshehtë nga gjermanët dhe pas luftës marrëdhëniet tona si israelitë kanë qenë për t'u admirue. Me kaq po e mbyll, me shpresë se miku ynë i familjes, zoti Paul Tedeschini, do të jetë ma i qartë për mënyrën e zhdukjes së familjes Arditi.”

---

**ABSTRACT**

---

This paper refers, first of all, to some new facts about a UDB investigative survey of Jews sheltered and saved in Albania, but returned to former Yugoslavia after World War II. Its starting point is the confirmation of the US House of Representatives Resolution on the 100th anniversary of Albania's independence, that certifies the non-participation of Albanians in the 20th century catastrophe by the name of "Shoah". Moreover, in the resolution's argumentative documents there are some dates that change the current view of the extent of the responsibility that Albanians took for saving Jews from the Nazi fascist threat of extermination. For the first time, it is said that in 1938 there were 300 indigenous Jews in Albania and more than 1900 others coming from Central European countries and the former Yugoslavia. This number does not include Jews who came to Albania from Dalmatia (350), Montenegro (192) and Kosovo (over 600) during 1942. For the first time, is declared that Albanians as their religious tolerance advised, and considering the protection of the Jews as internal state matter (1) and matters of their national honor (2) they held *a common position on the protection of the Jews, in their state and in Kosovo*, as well.

In 2009, at the time of preparing for the publication of the book "Jews in Albania: Presence and Salvation", we did not have access to some documents of the Yugoslav archives, which clearly certify the process of fabrication of the "Kosovo genocide" against the Jews found there. With these documents, the most difficult question to answer for the non-participation of the Albanians of Kosovo in the Shoah is fully answered, unlike what have proposed the scholars of the second Yugoslavia, and not only. But on this issue there is a collection of documents proving a state action aimed at implicating Kosovo Albanians in judeophobia....

*Keywords: Albanians, Jewish salvation, UDB investigative survey, fabricated genocide of Kosovo*





# BESA, POR JO VETËM BESA: INTERPRETIME RRETH FAKTEVE MBI SHPËTIMIN E HEBRENJËVE NË SHQIPËRI GJATË HOLOKAUSTIT

Mehmet ELEZI

E-mail:mehmetelezi@gmail.com

---

## PËRMBLEDHJE

Ky artikull është bazuar në librin “Hebrenjtëdhe Republika e Kanunit” (Elezi, 2013; Elezi, 2019). Ky libër nuk sjell fakte të reja, ai bën interpretime të reja. Të dhënat e derisotmetregojnë se gjatë Luftës së Dytë Botërore në një Shqipëri me njëmilion banorë janë shpëtuar 3.240 hebrenj. Matematikisht është sikur në Francën me dyzetmilionë të ishin shpëtuar 130 mijë. Në Shqipëri u mbrojtën hebrenjtë vendas dhe ata që erdhën nga jashtë. U mbrojtën nga shqiptarët e të gjitha trevave; të të gjitha klasave; të të gjitha feve e bindjeve politike, përfshi ata që njihen si kolaboracionistë. Është rast unik në vendet e pushtuara nga nazizmi. Disa që e kanë trajtuar çështjen, e kanë shpjeguar me Besën - fjalë shqipe e papërkthyeshme në gjuhët e tjera. Në thelb të Besës është mbajtja me çdo çmim e fjalës së dhënë. Disa e kanë argumentuar me Kanunin - kodi i lashtë dokesor i shqiptarëve. Kanuni mbështetet fort te nderi, në thelb të tij është demokracia. Primitive, por gjithsesi demokraci. Kanuni ka shërbyer si kushtetutë, kod penal, kod civil, kod etik, edhe si libër protokolli. Ka funksionuar pa ndihmën e një aparati shtrëngues, si policia. Ka qeverisur shoqërinë shqiptare si pushtet paralel, duke sfiduar ligjin e pushtuesve. Autori argumenton se shpjegimet me Besën dhe Kanunin janë të drejta, por jo të plota. Ai bën prerje në thellësi të strukturës shpirtërore të

**Mehmet ELEZI** është studiues, shkrimtar, publicist dhe diplomat. Ai është autor i një numri të madh shkrimesh publicistike e studimore të botuara ose të mbajtur nëpër takime e konferenca brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe i mbi 30 veprave të botuara në rreth pesë dekada (nga viti 1970). Ndër to, 16 botime janë të fushës së letërsisë (12 në prozë dhe 4 vëllime në poezë), 7 vepra të fushës së publicistikës dhe studimeve (kryesisht prova) si dhe 7 vepra nga fusha e gjuhësisë. Ndër to veçojmë veprën madhore “Fjalor i Gjuhës Shqipe” (2006), me 41 mijë fjalë dhe shprehje që nuk gjinden në FGJSSH të Akademisë së Shkencave, shoqëruar me shtjellime etimologjike. Mehmet ELEZI ka qenë ambasador i Republikës së Shqipërisë në Konfederatën Zvicerane (Bernë) dhe në Principatën e Lihtenshtejnit, në dy mandate, në periudhën 2006-2013.

shqiptarëve, të filozofisë dhe moralit tradicional. Artikulli, si vetë libri, ngrihet mbi dy shtylla të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

(1) Hebrenjtë në “Republikëne Kanunit” (hapësirat shqiptare). Prania e tyre dëshmoheq qysh në shekujt e parë pas Krishtit. Në toponime; në sinagoga; në legjenda; në këngë të moqme; në doke; në dokumente. Hebrenjtë kanë jetuar përherë në harmoni me vendasit. Janë integruar në shoqërinë shqiptare. Kanë kontribuar për zhvillimin e saj.

(2) Bota e “Republikës së Kanunit”. Argumentohet se Besa dhe Kanuni nuk janë “fëmijë të vetëm” në një familje vlerash. Në të njëjtin truall kanë spikatur edhe vlera të tjera të ngjashme. Ato i kanë rrënjët në kohët homerike dhe janë përcjellë gjatë shekujve, pa u tjetërsuar. Filozofia e përbashkët e tyre është mbrojtja e jetës së njeriut. Ajo përputhet me filozofinë e Biblës “Zot i mbron të pambrojturit”. Autori bën një vështrim krahasues të këtyre vlerave. “Ndorja”, “Ndorejeta” (“amaneti”), “Miku” kanë të njëjtën ADN si Besa. Më tej: harmonia ndërjetare; respektimi i pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera; nderimi i gruas deri në hyjnizim (vetëm prifti dhe gruaja nuk vriten për gjakmarrje!); përkushtimi ndaj fqinjit; sjellja kalorsiake me armikun e dobët ose të mundur; trajtimi me respekt i trupit të armikut të vrarë; trajtimi njerëzor i kafshëve shtëpiake. Kanunika dalë prej këtyre vlerave, i ka kodifikuar. Gjatë udhëtimit nëpër histori, Kanuni dhe këto vlera kanë ushqyer e fuqizuar ndërsjelltazi njëri-tjetrin. Parimet themelore të Kanunit vlerësohen edhe sot. Në Kanun të gjithë njerëzit janë të barabartë, gjaku i shërbëtorit është i barabartë me gjakun e princit; Kanuni nuk njeh klasa; nuk njeh raca; prona private është e patjetërsueshme; liria e individit e pacenueshme. Organi më i lartë vendimmarrës nuk është princi, është mbledhja e popullit. Në Kanun arma është mjet i fundit për zgjidhjen e konflikteve, kultura e negociatave dhe falja janë të parat. Parime të tilla përshkojnë edhe kartat e Të Drejtave të Njeriut.

Ciklin jetëgjatë të Kanunit e mbyll përfundimisht shteti ligjor. Ky kontekst ka frymëzuar dhe garantuar mbrojtjen e hebrenjve. Këto vlera kanë mbetur pak të njohura për shkak të rrethanave historike. Pas Luftës së Dytë Botërore izolimi pesëdhjetëvjeçar nga diktatura i fundosi në terr. Makina propagandistike i pasqyroi shtrembët, i nxiu. *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit* është vepra e parë që rreket me shpjegje në thellësi mbrojtjen e hebrenjve.

**Fjalë kyçe:** *hebrenj, holokaust, kanuni, besa, vlerat tradicionale, bota shqiptare*

## Në vend të hyrjes: Burri me mjekër të bardhë në Universitetin e Gjenevës

Qe mes nëntori dhe në brigjet e Liqenit Leman frynte veri i ftohtë, *la bise*. Malet e borme përballë kishin mbledhur shpatullat. Dukej sikur sapo kishin buthtuar prej thellësive dhe uji i ngrirë mbi lëkurë u ishte shndërruar në cipë të bardhë, që zdriste nëpër muzg.

Në auditoret e Universitetit të Gjenevës qe tjetër frymë. Ngrohtësia mbushte bulëzat e ajrit. Salla *M R08 e Uni Mailpo* mbushej, vendet po ziheshin nga studentë e profesorë, politikanë, intelektualë, diplomatë, veprimtarë,

kureshtarë të tipit pa ta shohim ç’do të thonë këta shqiptarët. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Bernë bashkë me ambasadën e Republikës së Kosovës dhe me Universitetin Popullor Shqiptar të Gjenevës kishim organizuar shfaqjen e filmit dokumentar *Shpëtimi në Shqipëri*, që bën fjalë për mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shfaqja bënte pjesë në programin e përbashkët të veprimtarive për 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Bashkorganizatore kësaj here ishte edhe Lidhja Ndërkombëtare Kundër Racizmit e Antisemitizmit (LICRA). E mbështesnin veprimtarinë Qyteti i Gjenevës dhe Republika e Kantoni i Gjenevës.

Pas filmit vijoi një panel i shkurtë, i ngjeshur me pyetje e përgjigje, me realizuesin e filmit D. Islami, gazetar nga Prishtina. Nga fundi i ndriçuar zbehtë i sallës u çua një hije e brishtë, gati e dridhshme. Mezi dallohej midis kokave të kthyer kureshtarë. Qe një burrë i imët, kohanik. Shqiptoi dy-tri fjali për, siç e cilësoi ai, madhështinë e Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke dëshmuar se e njihnte në thellësi, u shpreh po aq shkurt por idhshëm kundër disa keqinterpretimeve në media, dhe pyeti thjesht: duke pasur parasysh thelbin, a mendoni se shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri mund të shpjegohet me Kanunin? Mjekra e bardhë me majë e bënte të dukej sikur qe arratisur nga ndonjë muze i arteve të bukura. Prit kur të arratiset sërish e të zërë vend në katranëz, në ndonjë koleksion me piktura të viteve 1700.

### Disa fakte rreth shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri

Herman Bernshtain (Bernstein)<sup>1</sup>, i cili me 1934 pohonte se “s”ka asnjë gjurmë të diskriminimit të hebrenjve në Shqipëri” dhe shtonte se “Shqipëria është një nga vendet e pakta në Europë, ku paragjykimet fetare dhe urrejtja nuk ekzistojnë, edhe pse shqiptarët vetë janë të ndarë në tri fe”, kishte qenë i saktë si profet. Pa kaluar dhjetë vjet, vlerat që përlavdëron ai u përballën me një provë zjarri të pashembullt. Para dhe sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore shqiptarët mbrojtën çdo hebre të ndjekur nga zhbimja, si “zgjdhje përfundimtare”, sipas doktrinës naziste.

Avokati Uorren (Warren) Miller, Kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e

Trashëgimisë Amerikane Jashtë Vendi, vlerëson se “*danezët bënë një punë të madhe dhe heroike për shpëtimin e shumicës së hebrenjve të tyre... Bullgaria shpëtoi gjithashtu hebrenjtë e saj gjatë holokaustit, por ata u bënë bashkëfajtorë, sepse organizuan transportimin e tyre nga Traka dhe Maqedonia - rreth 11 mijë - dhe ata u vranë. Ndërsa në Shqipëri, heroizmi që u tregua ishte i plotë*”<sup>2</sup>.

“Midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera në mbrojtjen e hebrenjve të huaj ka një dallim kuptimplotë, ngul këmbë Harvej (Harvey) Sarneri në librin *Shpëtimi në Shqipëri*. Për shembull, qeveritë franceze e bullgare bashkëpunuan me nazistët dhe iu bindën kërkesave të tyre për arrestimin e hebrenjve të huaj, por i mbrojtën hebrenjtë vendas” (Sarneri, 1999)<sup>3</sup>. Në vijim citon Drejtorin Kombëtar të Lidhjes për Mbrojtjen e Hebrenjve, Abraham H. Foksmen (Foxman): “Ky komb i vogël jo vetëm që mbrojti hebrenjtë “e vet”, por nuk lejoi të dorëzohet te nazistët asnjë hebre tjetër, që fatmirësisht kishte mbërri në këtë vend”.

Shqiptarët ua çelën derën të gjithëve. Ia behnin prej kahmos, nga vendet fqinj dhe nga Europa Qendrore, në kulmin e luftës. Lypnin konak pasi kishin udhëtuar në këmbë, me makinë, me karrocë, nëpër terr, nëpër male, të sëmurë, të dëshpëruar. Dhe duke lënë pas vetes shumë varre të ditura e të paditura të njerëzve të shtrenjtë. Nuk shfaqeshin të stërkequr si lypës në dyert e pritësve. Në sjelljet e tyre kishte fisnikëri. Ata që i kanë pritur kujtojnë si visheshin pastër e me shije, punonin pa u ndier, mbanin syze, nuk i ndanin librat. Siç qet në pah H. Sarneri, “shpëtimtarët

<sup>1</sup> Ish-shefi i misionit diplomatik amerikan në Tiranë, diplomat e intelektual me emër, gazetar i të përditshmes *Nju Jork Tajms*, shkrimtar, përkthyes.

<sup>2</sup> Intervistë në *Radion Zëri i Amerikës*, marrë nga gazetari Ilir Ikononi.

<http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2008-05-07-voa7-85591837/420529.html>

<sup>3</sup> Harvej Sarneri, filantrop amerikano-hebre, ka hulumtuar rreth shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri. Kërkimet i ka kurorëzuar me librin *Hebrenjtë e Shqipërisë*, sjellë në gjuhën shqipe (me shkurtime) nën titullin *Shpëtimi në Shqipëri* (Tiranë, Koha 1999), nën kujdesin e Lidhjes Qytetare Shqiptaro-amerikane dhe të presidentit të saj Joe DioGuardi, ish-anëtar i Kongresit Amerikan.

shpeshherë nuk i njihnin fare hebrenjtë, për të cilët rrezikonin jetën”. Madje “në shumë raste s’komunikonin dot me ta, për shkak të mosnjohjes së ndërsjellë të gjuhës”. Mosnjohja e gjuhës e shtonte mundimin e dhimbjen e kresë. Por ata mësonin shqip shpejt, kallëzon Spiro Shqina, qytetar beratas. Kam qenë i vogël, mbaj mend dy gjëra që më tërhiqnin si fëmijë, thotë. Deri atëherë akulloret i përzienin me dorë, vu e vu. Hebrenjtë sollën një mekanizëm, nuk di e sollën a e shpikën vetë, por pasi mbërrinë ata akullorja nuk përzihesh më me dorë. Filluan të prodhojnë edhe pasta me shkumë. Më përpara shiteshin kryesisht sheqerka, me ngjyra e trajta të ndryshme. Kishte mbetur si traditë nga koha e Turqisë<sup>4</sup>.

Bota, kontinenti i vjetër sidomos, ishte e ndarë tragjikisht në vende ku mund të hynin hebrenjtë dhe në vende ku këmba e tyre vështirë mund të shkelte, se shkrepse këmbëzën e vdekjes. Të parët fare pak, të dytët mjerisht shumë. Vendi i shqiptarëve i përket grupit të parë. Të paktëve. Numri i shqiptarëve të shënuar si “fisnikët midis kombeve” në Muzeun e Holokaustit në Izrael, përkrahëzuar me numrin e shqiptarëve si popull, është më i madhi.

Në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë senatori nga Nju Jorku Çarls Shamer (Charles Shummer) paraqiti në senat një rezolutë, ku vlerësohet “populli i Shqipërisë dhe i Kosovës” për shpëtimin e jetës së hebrenjve. Rezoluta nënvizon se “në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, kur 6 milionë hebrenj u asgjësuan egërsisht, Shqipëria ishte i vetmi vend në Europë që kishte më tepër hebrenj se sa përpara fillimit të Luftës”<sup>5</sup>.

H. Sarneri thotë se numri i refugjatëve hebrenj që erdhën në Shqipëri llogaritej “me qindra, në mos me mijëra”(Sarneri,

1999). Dhe Shqipëria e pushtuar nga nazistët “mbajti rekord in e shpëtimit 100 për qind të tyre”. Në këtë vend “asnjë hebre nuk u vra gjatë holokaustit. Po ashtu çdo hebre grek, gjerman, jugosllav a austriak, që pati fatin me prekë tokën shqiptare, shpëtoi për mrekulli”. Dejvid Uajnberg (David Winberg), gazetar i *Zërit të Amerikës*, saktëson më tej:

Ndryshe nga shumë izraelitë në pjesë të tjera të Europës, që shpëtuan duke u fshehur nëpër tavane e bodrume, izraelitëve në Shqipëri iu dhanë emra myslimanë dhe u trajtuan si mysafirë të nderuar” (Winberg, 2010).

Kryetari i parlamentit të Izraelit (Knesset), Yuli-Yoel Edelstein:

“Unë nuk di asnjë shembull tjetër, të asnjë shoqërie tjetër në botë, në të cilën të gjithë pa përjashtim të kenë qenë aq vetmohues dhe aq të përkushtuar me mbrojtje jetën e tjetrit. Shqipëria ka qenë i vetmi vend i pushtuar në botë, ku popullsia e hebrenjve dhe numri i hebrenjve në vend u shtua gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore”(Edelstein, 2016).

Sa më shumë që mësoj dhe lexoj për krimet që ndodhën, aq më tepër ndiej detyrimin për t’i ngritur shqiptarët në pedestal, sepse ajo që ata bënë ishte e jashtëzakonshme”, pohon Johana Njumen (Johanna Newmann), e mbijetuar e holokaustit.

Studiuesit pohojnë se deri në fund të Luftës “në Shqipëri gjetën strehë e shpëtim afro tre mijë hebrenj, të shpallur e të fshehur prapa identitetesh të tjerë”. Kësisoj “numri i hebrenjve që gjeti fundi i Luftës ishte 15-fishi i numrit të hebrenjve shqiptarë të regjistruar si të tillë në vitin

<sup>4</sup> Nga shenimet e autorit, bisedë me Spiro Shqinën.

<sup>5</sup> *Zëri i Amerikës*, 100-vjetori i pavarësisë së Shqipërisë në Kongresin Amerikan, 29 nëntor 2012. <http://www.zeriamerikes.com/content/vjetori-kongres-voa-ditari-shqip-100/1555446.html>

1929-1931” (Sinani, 2014)<sup>6</sup>. Të dhënat e qartësuarra deri tashti, përfshi pjesën që nuk është gjetur nëpër lista, e çojnë numrin e hebrenjve të shpëtuar në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në 3.240 (Stafa, 2019).

Nuk dimë ç’ të reja mund të sjellin hulumtimet e mëvonshme. Veç atyre që dihen, të tjerë hebrenj u pajisën me pasaporta nga autoritetet shqiptare dhe u larguan si qytetarë shqiptarë, pa mbaruar Lufta. Gjetën shpëtim në SHBA e ngjeti. Sa janë ata? Cilët janë, a kishte midis tyre ndonjë emër të madh, siç mëtohet herë pas here në botime e media?<sup>7</sup> Për shkak të politikës zyrtare në kundërshtim me interesat

kombëtare, gjatë sundimit të Enver Hoxhës nuk është zënë kurrë në gojë shpëtimi i hebrenjve.<sup>8</sup>

Për të ka filluar të flitet vetëm pas hapjes së Shqipërisë. Në dhjetëvjeçarën e fundit më fort. Sipas Xheson Williams (Jason Williams), producent i filmit dokumentar *Besa*, shpëtimi i hebrenjve nga shqiptarët “është ndër ato historitë e jashtëzakonshme, të cilën... pjesa tjetër e botës nuk e ka dëgjuar kurrë. Është një ndër ato histori që duhet treguar...”<sup>9</sup>

Si për çdo temë të re, të parrahur, këndvështrimet janë të ndryshme. Të kushtëzuara prej shkallës së njohjes, konjunkturave politike, interesave. Drita mbi

<sup>6</sup> Shih Shaban Sinani, *Shqiptarët dhe Hebrenjtë, mbrojtja dhe shpëtimi* (Tiranë, 2014). Po ky autor i silltet një dokumenti të legatës italiane në Tiranë, ku flitet për “shumën që duhet të derdhë Komiteti Hebraik në New York për 500 familjet hebreje që gjenden në Shqipëri”, në vitet tridhjetë. Nëse një familje llogaritet mesatarisht me tre-katër vetë, del se numri i hebrenjve askohe ka qenë diku rreth 2000 ose afër dhjetë herë më i madh se numri 200 që është lakuar të shumtën e herës. Është afër mendsh që kërkimet e mëtejshme do të sjellin të dhëna të panjohura. Sinani shkruan se historiani hebreo-kanadez “Berndt Fischer dikur mendonte se në Shqipëri kanë hyrë rreth 1000 hebrenj, pastaj është shprehur se ky numër duhet të jetë te 1800-a, ndërsa kohët e fundit ka pranuar se mund të ketë qenë rreth 2000... Të dhënat e Berndt Fischer-it i janë afruar gjithnjë e më pranë së vërtetës. Por megjithatë ato janë të rishikueshme për faktin se Fischer asnjëherë nuk i ka shfrytëzuar burimet shqiptare”. Autori flet për një listë në Muzeun Përkujtimor të Holokaustit në Uashington, me emrat e 2265 hebrenjve që kanë hyrë në Shqipëri. Por, argumenton ai, në atë listë mungojnë shumë të tjerë, sepse s’kanë përfunduar kërkimet; dhe sepse shumë hebrenj, për t’iu shmangur sa më shumë rreziqeve, kanë kaluar nëpër kufij me emra dhe identitet të rremë.

<sup>7</sup> Një numër autorësh, ndër të cilët edhe studiuesi Sh. Sinani në burimin e përmendur, pohojnë ose lënë hapur mundësinë e një vizite të Albert Ainshtajnit në Shqipëri, ku, siç thuhet, është pajisur me pasaportë shqiptare. Gazetarin e të përditshmes zvicerane *Berner Zeitung* Andreas Saurer, me të cilin në vitet 2011-2013 autori i kësaj sprove është takuar disa herë në Bernë, e kishte intriguar kjo e dhënë dhe hulumtoi për të. Në përmbyllje kumtoi se, sipas të gjeturave të tij, nuk del se Ainshtajni ka vizituar Shqipërinë. A mshetet këtu çështja? Veç të tjerash, nuk përjashtohet që shkencëtari i madh (nëse) të ketë marrë pasaportë shqiptare me identitet të ndryshuar.

<sup>8</sup> Në konfliktin izrelito-palestinez diktatura komuniste e E. Hoxhës mbante à priori anën e arabëve, e quante Izraelin “kobure e imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme”, prandaj kishte fshirë çdo lidhje të shqiptarëve me hebrenjtë. Ndikonte edhe fakti se në mbrojtjen e hebrenjve kishin ndihmesë të drejtpërdrejta mbreti Zog dhe më pas Mustafa Kruja, Xhafer Deva e të tjerë; këta përshkrueshin me tërë të ligat e dheut, për ta nuk duhej thënë asnjë fjalë e mirë. Deri në ditët e sotme autorë ose botime të ndryshme, disa zyrtare, e lënë në hije ndihmesën e këtyre figurave. Në FESH (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, 2008), gati njëzet vjet pas përmbyesjes së diktaturës, në zërin *Hebrenjtë në Shqipëri* nuk thuhet një fjalë për rolin e këtyre figurave në këtë çështje.

S’ka dyshim që bashkëpunuesit u rreshtuan në anën e gabuar të historisë, por aty ku u rreshtuan, i bënë edhe një shërbim të madh kombit shqiptar, njerëzimit, vetes. Mund t’i kishin dorëzuar hebrenjtë, si gjenerali Petë (Petain) në Francë, ose thjesht mund t’i kishin lënë në fatin e tyre të mjerë, duke mbyllur një sy përballë zezonës. Nuk bënë njërin as tjetrin, u përfshinë vendosmërisht në mbrojtjen. Pa marrëveshjet dhe angazhimin e tyre populli mund t’i fshihte sa mund t’i fshihte hebrenjtë, por nuk mund ta përmbante furinë naziste kundër tyre, nuk mund t’i pajiste me dokumente zyrtare si shqiptarë, siç u pajisën shumë syresh dhe shpëtuan. Historia nuk është dyngjyrëshe, bardhë e zi.

<sup>9</sup> *Zëri i Amerikës*, 08 janar 2013

<http://www.zeriamerikes.com/content/filmi-besa-uashington/1579826.html>

ngjarjet herë-herë bie pjerrtas, njëanshëm. Vlerësohet lart vepra, vihet theksi te feja, ja çfarë bënë myslimanët shqiptarë. Te feja e ve theksin edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Ban Ki-Mun. Ngre lart “familjet myslimane shqiptare, që shpëtuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore...”<sup>10</sup>

Në kushtet e konfliktit izraelito-palestinez, në prapavijën e keqkuptimeve ose përplasjeve ndërmjet perëndimit e botës arabe dhe kulturave përkatëse për shkak të terrorizmit e fundamentalizmit islamik, nuk mund të mos kesh mirëkuptim për këtë nënvizim, le ta quajmë taktik ose diplomatik. Megjithatë, pavarësisht ku e ve theksin politika në një kohë të caktuar, historia është histori. Të vërtetat e saj duhen ndriçuar siç janë, në plotinë e tyre.

### **Besa po, por jo vetëm ajo**

Qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjëve në krizën më të rëndë të përbotshme të të gjitha kohëve qas një gjedhe humanizmi jashtë skemave fetare. Hebrenjëve ua çelën derën njësoj si familjet myslimane, ashtu edhe familjet katolike e ortodokse.

“Historia shqiptare është pa dyshim më e veçanta edhe për faktin se shumica e fisnikëve shpëtimtarë të hebrenjëve ishin myslimanë, ndonëse kishte gjithashtu edhe ortodoksë e katolikë..., nënvizon H. Sarneri. Veçantia e Shqipërisë si strehë e hebrenjëve bie edhe më shumë në sy po të kemi parasysh se më pak se dhjetë për qind e shtatëdhjetë

mijë hebrenjëve të Jugosllavisë arritën me i shpëtue holokaustit”. Edhe në Greqi tragjedia mori përmasa të skëterrshme. Robert Kaplan shkruan:

“Prej krejt qyteteve në Europën e pushtuar nga nazistët, Selaniku rreshtojë i pari për nga numri i viktimave çifute. 54 050 vetë nga një numër i përgjithshëm popullsie çifute prej 56 000 vetësh, ose 96.5 përqind, u shfarosën në Aushvic, Birkenau dhe Bergen-Belzen” (Kaplan, 2002).

Hebrenjtë u mbrojtën nga shqiptarët e tri besimeve kryesore, u mbrojtën edhe nga përfaqësuesit institucionalë të këtyre feve. Studiuesit kanë zbuluar dokumente për disa hebrenj, të cilët, në rrekte me i dalë duarsh zezonës, bëjnë kërkesë me u kthye në katolikë. Energjia me të cilën veprojnë në këtë rast Dom Shtjefën Kurti, meshtar i famullisë së Tiranës, dhe eprorët, ipeshkvi Atë Vincens Prendushi në Durrës, është në kundërshtim me ngurtësinë e rregullave kanonike të kishës. Kërkesa për leje pagëzimi nga famullia e Tiranës dhe miratimi nga arqipeshkvia në Durrës janë përmbushur të dyja brenda një dite, letërkëmbimi mes dy institucioneve kishtarë është bërë dorazi, s’kish kohë me pritë. Administrata kishtarë katolike shpërfilli si kurrë më parë procedurat: pagëzimin, krezmimin, rrefimin, kungimin, vojimin, bekimin. Ata ishin njerëz, bij të Zotit. Duhej ndërmarrë gjithçka me i shpëtue.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Mesazh i sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-Mun me rastin e hapjes së ekspozitës *Besa, një kod nderi* [Besa, a Code of Honor], Yad Vashem, 29 janar 2008.

<sup>11</sup> *Prania historike dhe shpëtimi i hebrenjëve gjatë Luftës (Studime e dokumente)*, albPAPER, Tiranë, 2008. Veç të tjerash, Dom Shtjefën Kurti kish përjetuar vetë furinë e skëterrshme të përndjekjes. Ishte njëri prej tre klerikëve atdhetarë, të cilët me 5 maj 1930 i kishin dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë Erik Drymo (Eric Drummond) një *Memoire*, ku zbuloheshin të dhëna tronditëse për krimet mbi shqiptarët në mbretërinë e atëhershme jugosllave. I kërcënuar me vdekje nga organizata terroriste serbe *Crna Ruka (Dora e Zezë)*, me 31 dhjetor 1930, natën e Vitit të Ri, kishte ikur bashkë me familjen nga Novosela e Epërme në Kosovë dhe kish mbërrirë në Shqipëri.

Ironia është se më pas ky burrë i shquar do të dënohej me vdekje nga regjimi i Enver Hoxhës, sepse paskesh pagëzuar në fshehtësi një foshnjë! Mbetet me u pa nëse shkaku i pushkatimit ishte ky pagëzim, apo pagëzimi shërbeu si vang (pretekst), për me i ba qejfin Beogradt, që kish kërkuar prej kohësh kokën e Dom Shtjefën Kurtit, siç ia kish marrë jetën edhe Shtjefnit tjetër, Gjeçovit, e shumë Shqiptarëve të tjerë.

Ortodoksët nuk mbetën më pas, myslimanët po ashtu. H. Sarneri (1999) dëshmon për një familje hebreje prej shtatë anëtarësh, që u strehuan në Zall Herr, në Tiranë. “Ushqimin ua çonte Mikel Kilica. Gjermanët e pikasën çfarë bënte Mikeli. Ai u detyrua të hiqte dorë dhe i çoi (hebrejntë) në Manastirin e Ardenicës. Prifti i manastirit i pajisi me pasaporta të rreme...”. Sipas Zërit të Amerikës:

Mijëra hebrej shkuan nga vende të tjera në Shqipëri, për t'u shpëtuar ndjekjeve të nazistëve. Ata u fshehën nga shqiptarët pa dallim feje, nga myslimanët dhe të krishterët, dhe Shqipëria u bë vendi i vetëm në Europë që e shpëtoi të gjithë popullsinë hebraike (Ikononi, 2010).

Qëndrimin e guximshëm njerëzor të shqiptarëve të huajt e kanë shpjeguar me Besën, si kod nderi. Edhe ekspozita fotografike e autorit amerikano-hebre Norman Gershman, kështu titullohet: *Besa*. Ekspozita është jetësuar me përkushtim, me fotografi dhe dëshmi të mbijetuarve dhe të atyre që i mbrojtën. Është hapur edhe në selinë e OKB-së në Nju Jork, ku është përshëndetur nga numri një Ban Ki-Mun. Vazhdon me u ra rreth shumë qyteteve të botës, nën kujdesin e Yad Vashem. Autori i këtyre shënimeve ka pasur rastin me qenë në përrurimin e saj në Vaduc (Vaduz), kryeqytet i principatës së Lihtenshteinit, në prani të personaliteteve shoqërore e intelektuale dhe të kryeministrit të vendit. *Besa*, me shkronja të mëdha, spikaste në ballinën e ndërtesës së muzeut kombëtar, ku u çel ekspozita. Njerëzit ndaleshin dhe këqyrnin së largu, që nga rruga, duke vënë dorën mbi ballë, germëzonin fjalën, rrekeshin me ia thithë përmbajtjen. Ç'do

të thotë *Besa*, është emri i ndonjë artisti të madh hebre? Vetë fjala e pakuptueshme, disi enigmatike, ngjallte kërshëri, grishte e joshte vizitorë.

Mbrojtja që shqiptarët u bënë hebrejve ftillohet pa dyshim edhe me Besën. Krist Maloki thotë se fjala *besë* “përmban në vete një forcë aq magjike... sa nuk i gjindet shoqja ndër gjuhë të huaja”. “Fuqia morale e theorisë dhe e vetëmohimit që përmbledhen në fjalën *besë* me të vështirë kuptohen prej kujdohit e ma më të vështirë mund të gjinden në ndonji popull...” (Maloki, 2005).

Siç pohon Konica,

“...fyerja më e rëndë në Shqipëri është ta quash dikë *të pabesë*”. Ai shton se në një varg hartash tregtare shoqëruar me tekst, të botuara me 1886 nga ministria franceze e tregtisë, fashikulli kushtuar Shqipërisë i njofton eksportuesit se s’ka nevojë për marrëveshje të shkruara me shqiptarët, “sepse fjala e tyre e thënë ka mjaft peshë dhe nuk njihet asnjë rast që ta kenë shkelur” (Konica, 1993).

Atë Zef Valentini (2005) vëren të njëjtën gjë. “Na shofim se në shoqin malsore kontratat lidhen vetëm me fjalë e se fjala është me të vërtetë, edhe në praktikë, gjâ shëjte...”. “*Besa*, kjo është feja shqiptare”, shkruan Godart (2015). Fjala *besë* ka hyrë pothuajse në të gjitha gjuhët ballkanike, duke përfshirë edhe turqishten, kumton Eqrem Çabej. Nuk mund të përkthehet, sepse nuk gjindet te të tjerët instituti që shpreh e përfaqëson ajo. Instituti i Besës është thjesht shqiptar. “Kjo fjalë vlen shumë midis shqiptarëve, thotë Mark Milani; dhe mund të them se e gjen veç ndër shqiptarë dhe askund tjetër”.<sup>12</sup>

<sup>12</sup> Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve*, shtypshkronja Muza, Tiranë 1995.

Ky vojvodë (1833-1901), prijës ushtarak malazez me emër, udhëhoqi beteja gjakatare me u rrëmbye shqiptarëve pjesë të trojeve të tyre. Kjo epikë është pasqyruar në muzën folklorike shqiptare. Mark Milani, Mark Milica/ Jam Kosova tanë me plisa.../ *Mark Milani në atë Previ/ Çka ka Lini që dirgjet zj/ Hajmedet, vojniket e mi!*

Obrej (Aubrey) Herberti, pohonte britanik, ku ishte i zgjedhur: “Kur shqiptari në Dhomën e Komuneve në parlamentin jep fjalën, mund të mbështetesh tek ai;

Megjithatë nuk i urren shqiptarët, nuk ua mohon vlerat, përkundrazi. Gjatë betejave kundër shqiptarëve - herë-herë edhe në aleancë me ta kundër sundimit otoman - dhe duke qenë prej Kuçi, i banuar historikisht me shqiptarë e malazezë, ai pati mundësi me i njohë shqiptarët për së ngjati e në thellësi, duke zhbiruar me mprehtësi në karakterin e doket, në shpirtin e mendësitë e tyre.

As bashkatdhetarët e tij nuk i idealizon, por u drejtohet: “... o serb. Ti duhet ta dish se nuk është e vështirë të punosh me shqiptarët. Nuk është ashtu si të duket ty... Edhe ndër ne ka njerëz të ulët, të cilët nuk dinë të nderojnë vetveten, dhe që nuk mund të vdesin trimërisht si shqiptarët, prandaj i përbuzin ata, pikërisht ngaqë nuk janë të zotët me e ba vetë një gjë të tillë... Ti duhet të njohësh edhe veten, edhe ata...”. Siç shihet, ndihet serb, Malin e Zi ai e shihet si pjesë të një Serbie të Madhe.

Duket se këtu nyjtohet synimi i tij me librin për shqiptarët. Duke përshkruar me realizëm doket e karakterin e tyre, ai kërkon që serbët “të njohin veten dhe ata”, rreket me u ndihmue serbëve me ndërtue marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët e vet. Është pragmatist, por gjithnjë nga skajimet (pozitat) e nacionalizmit serb. “...folat për shqiptarët në mënyrë që serbi t’i njohë zakonet e këtij populli dhe t’u afrohet... Ti, o serb, ke më shumë mundësi dhe më shumë të drejtë se të tjerët për një gjë të tillë, sepse ty ata (shqiptarët) ta kanë shkelur vatrën, mbretërinë tënde, trojet e gjyshëve...(!)”.

Në vijim i këshillon serbët se “nuk duhet me ua hedhë poshtë gjithë vlerat shqiptarëve” dhe as “me u dhanë shkëlqim e madhësi të rreme”, por vazhdimisht duhet “me i kënaqë me pak...”. “Tregoju në mënyrë atërore, me sjellje të mirë dhe jo me arrogancë brutale e imponuese, dhe ke për të parë se për çdo punë të ndershme e njerëzore ata do të jenë dakord.... përpiqu t’i vlerësosh të bukurën dhe të mirat që kanë. Në mënyrë të veçantë ofroji (shqiptarit) nder, e atëherë do ta shohësh se ai është i gatshëm të shkojë edhe në Stamboll, bile të vrasë vetë Sulltanin, dhe nuk pyet nëse një gjë e tillë është e mundshme apo jo. Atë (shqiptarin) duhet të dish vetëm ta mbrehësh (!) dhe lëre të lirë...”.

Pohon: “Unë vetëm sa e kam cekur pak shpirtin e këtij populli dhe mendoj se ka për ta njohur më mirë vetëm ai që do të punojë me ta, sepse sot për sot të gjithë e quajnë të vështirë të punuarit me shqiptarët, pasi nuk arrijnë t’ua kuptojnë mendimet; dhe fare kot prishin gjithçka, në një kohë kur së bashku me ta mund të ndërtonin për mrekulli”.

Këmbëngul: “Puno, o serb, me shqiptarët... me besnikëri të vërtetë dhe mos e mbështet fatin as në shkathësinë tënde as në thjeshtësinë e tyre, duke menduar se mund t’i mashtrosh lehtë. Edhe sikur ata të mos e dinë se ti punon më tepër për lavdinë tënde se sa për nderin e tyre, mos u lerë shkak të ngulim mbi ty njëmijë shikime. Mos e ul veten deri aty. Shqiptarët janë popull i thjeshtë, kur e shohin te ti të vërtetën e pastër, në flakë e në det hidhen bashkë me ty...”.

Fundja, thotë, “është e vështirë, qoftë me grabitje, qoftë me drejtësi, t’ia kalosh shqiptarit”.

Në vijim u kujton serbëve se shqiptarët “asnjëherë s’kanë pranuar të futen nëpër kallëpe, siç ua ka dashur qejfi të tjerëve. Ata duhet të ndihmohen, pa u kërkuar që të ndërrojnë diçka apo t’i tjetërsojnë zakonet e tyre. Ata duhet të merren ashtu siç janë, siç i kanë pranuar në kohët e lashta grekët dhe romakët e vjetër, të cilët vërtet e shfrytëzuan trimërinë e tyre, por edhe shqiptarët mbetën ata që ishin” (vihet re kundërshtia e tij me veten: pranon se shqiptarët janë aty, qysh me grekët e lashtë e romakët, në anën tjetër thotë shqiptarët ua kanë shkelë serbëve “vatrën, mbretërinë, trojet e gjyshëve”!).

Duke nënvizuar se shqiptarët ruajnë krenarinë dhe nderin “vetëm për vete, sepse është shkëlqimi i tyre”, tërheq vëmendjen se ata (serbët) “nuk janë fuqi”, prandaj me shqiptarët duhet të ndjekin rrugën e afrimit deri aty ku arrijnë mundësitë e tyre.

Me gjithë përbirimet plot zgjuarsi në botën shqiptare dhe këshillat e mençura për bashkatdhetarët nuk u shpëton paragjyqimeve me ngjyresë raciste. As fuqitë e mëdha “nuk do të mund t’i shkulin (shqiptarët) nga opingat dhe zhguni i tyre, dhe as t’i pastrojnë prej zakoneve të ashpra, duke i dërguar nëpër shkolla për të mësuar gjuhën e tyre apo për të përvetësuar modën e shkëlqimin e tyre. Këto gjëra nuk i përshtaten shqiptarit. Ai nuk dëshiron asgjë të huaj, qoftë kjo e shenjtë apo e mallkuar”.

Dyshues ndaj Europës, gjithnjë nga skajimet e nacionalizmit serbomadhi, M. Milani synon një Serbi të Madhe. “Nuk mund t’u besohet të mëdhenjve se u bëjnë të mira popujve. Këtë mund ta vënë re fare mirë të populli serb, të cilin e shpëtuan nga Turqia, por ia zhatën Bosnjën e Hercegovinën. I thoni ambasadorit austriak, që t’i thotë perandorit të vet, se do fati e ia zdrat mendjen që ta bashkojë serbizimin: Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë dhe Serbinë e Vjetër (Kosovën - m.e.)”.

Edhe citimet e tjera nga ky autor janë prej të njëjtit libër.



besimin mund ta lësh në nderin e tij, njëlloj si të jesh në besën e oficerit britanik”.<sup>13</sup>

Por a është i plotë shtjellimi që lidh gjithçka me Besën, a mbaron këtu njëjtësimi (identifikimi) i burimit energjizues që çoi në mbrojtjen e hebrenjve? Vetë Besa, si dukuri e mirëfilltë shqiptare, ku e ka filluesin, rrënjët, fyllimin?

E papërkthyeshme përballë një të huaji nuk është vetëm fjala *besë*.<sup>14</sup> Është tërë përmbajtja e saj, arkitektura, vetë thelbi. Në rrekte me ua fillue të huajve, rreziku i parë është thjeshtësimi sipas stereotipeve kalorësiake, njëjtësimi me *la parole d'honneur*, *la parole donnée* (fjala e nderit, fjala e dhënë). Gjetja dhe pranimi i një dytësi të thjeshtuar të Besës, do të ishte shkatërrues për të. Duke qenë i lehtë në të kuptuar, gjedhe e gatshme, ky kipc a dytësor i zbehtë, skematik, në shikim të parë mjaft i afërt ose i njëllojtë, do të zinte vend fill. Dhe do të hijezonte e do të fshinte përmasat e një instituti të ndërthurur e madhështor si Besa. Nuk është puna se do ta zhvishte nga *sharmi ekzotik*. Do t'ia birrte tharmin, thelbin identitar. Do t'ia tjetërsonte ADN-në.

## REFERENCAT

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. 2008. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë: Botimet Akademia
- Edelstein, Knessetit Yuli-Yoel. 2016. “Fjala e mbajtur në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë”, *Gazeta Shqiptare*: 17 shkurt.
- Elezi, Mehmet. 2019. *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit; botimi i dytë i plotësuar*, Tiranë: Botimet Fishta.
- Elezi, Mehmet. 2013. *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit; botimi i parë*, Tiranë: Botimet Fishta.
- Godart, Justin. 2015. *Shqipëria në 1921*, Tiranë: Klubi i Poezisë
- <http://www.zeriamerikes.com/content/shqiptaret-shpetojne-hebretje-gjate-luftes-se-dyte-boterore-111767114/456187.html>
- Ikonomi, Ilir. 2008. “Uoren Miller: Shqipëria, një vend që përfaqon pluralizmin kulturor”, Intervistë në radion Zëri i Amerikës, <http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2008->

<sup>13</sup> *Miku i madh i shqiptarëve. Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditare dhe Letra 1904-1923*, me parathënie të Noel Malkolmit, Via Egnatia, Tiranë 2012. Edhe referimet e tjera të Herbertit janë prej të njëjtut burim.

<sup>14</sup> M. Krasniqi citon autorin gjerman Klaus Lange, në një studim për botëkuptimin e Naim Frashërit në veprën letrare: “Fjala *besë* nuk mund të përkthehet në gjuhën gjermane, përveç si premtim që do ta mbash fjalën”.

<sup>15</sup> Duke iu referuar studiuesit Emin Fazliu, M. Krasniqi mbron pikëpamjen se Besa ka qenë e njohur dhe e respektuar edhe në fiset ilire. “*Hyjnitë ilire kishin bekuar besën dhe lidhjen e njerëzve me anën e besës...*”.

Në kulturën e trashëguar shqiptare Besa nuk është institut pa vëlla, pa kushërinë e fis. Ka një pemë gjenealogjike, së cilës i përket. Është bijë e një dere të madhe. Besa është vetëm njëra prej pjellave në një familje të fisme me gjak të hershëm, të papërzier, ku të gjithë janë aq ngjashëm dhe njëherësh të ndryshëm, me personalitet vetjak.

Një familje e tillë me vetvetësi (identitet) të qartë, me pinjollë të shquar që plotësojnë njëri-tjetrin, gjallon e mund të kuptohet vetëm si një e tërë, me të gjithë pjesëtarët të vlerësuar, secili në vendin e vet.

Besa është më i përmenduri i këtyre pjesëtarëve. Më i moçmi apo, me gjasë, të gjithë kanë afërsisht të njëjtën moshë?<sup>15</sup> Duke ia rizbuluar vëllezërit pjesërisht të mbetur nën hijen e saj, duke qitur në spikamë krejt trungun familjar, me të përbashkëtat e të veçantat e gjithsecilit, rimerr peshë edhe vetë Besa.

E vetmuar, do të ishte më e dobët, më e pakuptueshme. Për të mos thënë e pashpjegueshme.

Besa po.

Por jo vetëm ajo.

- 05-07-voa7-85591837/420529.html
- Ikonomi, Ilir. 2010. “Hebrenjtë e Nju Jorkut nderojnë familjen nga Shqipëria”, *Zëri i Amerikës*, 27 shkurt; <http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2007-01-19-voa5-85737947/442020.html>
- Kaplan, Robert D. 2002. *Greqia, dashmoria e Perëndimit dhe gruaja e Lindjes*, Tiranë: Dituria.
- Konica, Faik. 1993. *Vëpra*, Tiranë: Shtëpia botuese “Naim Frashri”.
- Kurti, Dom Shtjefën. 2008. *Prania historike dhe shpëtimi i hebrenjëve gjatë Luftës (Studime e dokumente)*, Tiranë: albPAPER
- Maloki, Krist. 2005. *Refleksione*, Prishtinë: Faik Konica.
- Milani, Mark. 1995. *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve*, Tiranë: Muza.
- Sarneri, Harvej. 1999. *Shpëtimi në Shqipëri*, Tiranë: Koha.
- Sinani, Shaban. 2014. *Shqiptarët dhe hebrenjtë; Prania dhe shpëtimi*, Tiranë: Naimi.
- Stafa, Monika. 2019. *Hebrenjtë në Shqipëri*, Tiranë: Onufri.
- Valentini, (Zef) Giuseppe. 2005. *Vëpra I*, Tiranë: Plejad.
- Winberg, David. 2010. “Shqiptarët shpëtojnë hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore”, kronikë në *Zëri i Amerikës*; 12 dhjetor.

## ABSTRACT

This article is based on the book “The Jews and the Kanun Republic” (Elezi, 2013; Elezi, 2019), which does not bring forth new facts. It just makes new interpretations. Available evidence shows that, during the Second World War, 3,420 Jews were protected in Albania – a country which at the time had a mere million residents. Proportionally, it’s as if France with its forty million people would have saved 130,000 Jews. In Albania, Jews were saved regardless if they were from Albania or if they came from abroad. They were protected by Albanians living everywhere in the Balkans; coming from all classes, religions and political convictions, even by those known to be collaborators. This is a unique case in the lands occupied by the Nazis. Some who have done research on the matter have explained it through the *Besa* – an Albanian word that cannot be easily translated into other languages. At core, the *Besa* is about honoring your word at any price. Some have argued that it was because of the *Kanun* – the old customary law governing Albanians. The *Kanun* is heavily based on honor and – in its core – on democracy. A primitive form, yes, but definitely a democracy. The *Kanun* was everything - constitution, criminal law, civil law, ethical code, even a book of protocols. It worked without the assistance of a repressive apparatus such as the police. It governed Albanian society as a parallel government, challenging the laws of the occupiers. The book argues that the existing explanations based on the *Besa* and on the *Kanun* are correct, but incomplete. The author therefore cuts through the structure of Albanian spiritual, philosophical and moral life. The book is built on two interconnected pillars.

(1) The Jews in the “Kanun Republic” (lands inhabited by Albanians). Their presence has been documented since the first centuries A.D. It can be traced through toponyms; synagogues; legends; old songs; traditions and documents. The Jews always lived in harmony within Albanian society. They integrated within it and contributed to its development.

(2) The World of the “Kanun Republic”. The book argues that *Besa* and *Kanun* are not “single children”, but part of a family of values. Similar values have flourished in the same space. Their roots are in Homeric ages and they were transmitted generation after generation almost intact. The common principle uniting them is the protection of human lives. It fits in well with the Bible’s philosophy: “God protects the vulnerable!” The author engages in a comparative evaluation of these values. The concepts of *Ndorja*, *Ndorejeta* (supreme will),

*Mikë* (Albanian concepts, close to the *Besa*, that are elaborated in-depth in the book) – all have the same DNA as *Besa*. This set of values also includes interfaith harmony; respect for national and other minorities; honoring of women to the point of sainthood (only priests and women cannot be killed in blood feuds!); commitments to neighbors; knightly treatment of the weakened or wounded enemy; respect for the body of the deceased enemy; humane treatment of domestic animals. The Kanun came out from these dominant values – it codified them. In its journey through history, the Kanun and these values fed off one another. The central principles of the Kanun are highly esteemed to this day. In the Kanun, everyone is equal; the blood of the servant is equal to the blood of the prince; the Kanun recognizes no classes or races; private property is an inalienable right; the freedom of the individual is inviolable. The highest decision-making authority is not the prince, it is a gathering of the people. In the Kanun, weapons are the last means to resolve conflicts – the culture of negotiations and forgiveness comes first. Such principles are also part of modern human rights charters. The Kanun's long cycle of history ended with the modern state and its rule of law. This is the context that inspired and guaranteed the protection of the Jews. These values are not widely known because of historical circumstances. After the Second World War, Albania's fifty-year-long dictatorship and isolation buried them into darkness. The regime's propaganda machine portrayed them wrongly and negatively. *The Jews and the Kanun Republic* is the first book that aims to explain in depth why the Jews were saved in Albania.

**Keywords:** *Jews, Kanun Republic, Holocaust, Besa-code of Honor, Traditional values, Albanian world*



# HEBRENJTË NË AREALIN SHQIPTAR

## (PRILL 1941 - 8 SHTATOR 1943)

Monika STAFA

*Top Channel*

E-mail: monikastafa@yahoo.com

---

### PËRMBLEDHJE

Administrimi italian i Shqipërisë mbart karakteristika të cilat i gjejmë edhe në territoret e tjera të pushtuara nga Italia gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vendi i shqiponjave, ashtu sikurse Etiopia dhe Greqia u pushtua nga italianët pa pëlqimin e aleatit gjerman, pesë muaj para fillimit zyrtar të Luftës së Dytë Botërore. Nën mbulesën e një *bashkimi personal*, pushtuesit italianë krijuan një administratë nën kontrollin e plotë të tyre, por me pjesëmarrjen e gjerë të personaliteteve shqiptare të kohës. Trajtimi i hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore përbën një rast studimi për komunitetin hebre në Ballkan dhe krijon hapësira për të kuptuar në mënyrë krahasimore, sesa e ashpër ka qenë politika antisemite gjatë kësaj periudhe në Serbinë e pushtuar nga Rajhu i Tretë apo edhe në Maqedoninë e pushtuar nga Bullgaria. Është një meritë e autoriteteve shqiptare të periudhës midis dy Luftërave, të cilët kishin siguruar një status të tillë për hebrenjtë në Shqipëri, i cili e bënte të vështirë adaptimin e një politike shfarosjeje nga ana e pushtuesve italianë. Në prill të vitit 1941, territori i Kosovës, që ishte pjesë e Jugosllavisë dhe e banuar kryesisht nga shqiptarë etnikë, iu aneksua Shqipërisë dhe u vendos nën “kontrollin shqiptar”, i cili në fakt ishte një kontroll italian. Hebrenjtë e këtyre territoreve “të aneksuara” nuk ishin me aq fat sa dhe hebrenjtë që jetonin në Shqipërinë e kufijve të vitit 1913.

**Fjalë kyçe:** *pushtimi italian; bashkim personal; Kosova; hebrenjtë*

**Monika STAFA** është gazetare dhe autore e disa programeve të njohura televizive në ekranin më të madh të shqiptarëve Top Channel. Ajo ka marrë gradën shkencore “Doktor” në Institutin e Historisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike me temën “Hebrenjtë në Shqipëri 1933- 1946”, studim i botuar me parathënie të shkrimtarit të madh Ismail Kadare. Më herët ka mbrojtur tezën shkencore me titullin “Sistemet politike në Shqipëri: Shkaqe të Paqëndrueshmërisë” për Akademinë e Studimeve Politike në Tiranë, e ngritur me mbështetjen e Këshillit të Europës, Strasburg. Ndërsa ka mbrojtur tezën e Masterit Shkencor “Cështja e Shën Naumit” në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë. Është autore e gjashtë librave, kryesisht historik dhe publicistik. Ndër to edhe një novelë me titullin “Një ditë si Sofia” në 2013.

Në prill të vitit 1941, territori i Kosovës, që ishte pjesë e Jugosllavisë dhe e banuar kryesisht nga shqiptarë etnikë, iu aneksua Shqipërisë dhe u vendos nën “kontrollin shqiptar”, i cili në fakt ishte një kontroll italian. Së pari, duhet të theksojmë se gjermanët imponuan ligje ndaj persekutimit të hebrenjve, të njëjtat ligje që ata kishin ushtruar në vendet e tjera të pushtuara. Por ato nuk ishin të zbatueshme për Shqipërinë. Për shembull, hebrenjve në territoret e aneksuara u ishin kërkuar të vendosnin “J” ose “Jew” në veshjet e tyre dhe këto ligje ishin të panjohura në Shqipëri. Hebrenjtë e këtyre territoreve “të aneksuara” nuk ishin me aq fat sa dhe hebrenjtë që jetonin në Shqipërinë e kufijve të vitit 1913. Jeta për ata ishte e pasigurt dhe ka pasur mjaft raste incidentesh të pafat të hebrenjve nga vendasit (Sarner, 1997: 37). Dhjetëra e qindra hebrenj nga Serbia e Kroacia erdhën në këto territore por, megjithëse refugjatë, ata u trajtuan relativisht mirë nga shqiptarët dhe italianët deri në një moment të caktuar kur autoritetet italiane vendosën të bashkëpunonin me gjermanët. Por situata nuk ishte e njëjtë për territoret e Shqipërisë londineze, ku shqiptarët refuzuan të dorëzonin tek autoritetet pushtuese, listat e hebrenjve duke mos bashkëpunuar me ta.

Autoritetet italiane të pushtimit por dhe ato lokale, përgjithësisht u rezervonin klandestinëve dy mundësi trajtimi: atë të dëbimit drejt Serbisë (të pushtuar nga nazistët) dhe drejt Kroacisë (e cila në atë kohë, ishte shpallur shtet i pavarur nën drejtimin e Ante Pavelić), ose një trajtim më pak tragjik, si ai i internimit që shpesh ndodhte që të realizohej edhe në Itali. Në të vërtetë, mes pranverës së vitit 1940 dhe verës 1943, regjimi i Musolinit, edhe pse i kishte mbyllur kufijtë dhe kishte shpallur me një dekret të veçantë deportimin, autorizoi në një mënyrë krejt të jashtëzakonshme, hyrjen në territorin vendas të rreth 4000 refugjatëve hebrenj të internuar nga Ministria e Brendshme nëpërmjet prefekturave. Bëhej fjalë sidomos për ata persona që pas shumë

peripecive që kishin jetuar, u gjendën në territoret e pushtuara italiane si (Mal i Zi, Shqipëri, Slloveni, Dalmaci, Libi dhe në një grup ishujsh në Greqi) ku pjesa më e madhe e tyre më pas u internua (Rodogno, 2003: 352).

Politikat antisemite mes vitit 1941 dhe 1943 ndaj hebrenjve serbë dhe maqedonas, viktimë të Shoah i detyruan ata të largohen drejt territoreve të Kosovës dhe Shqipërisë. Duhet konsideruar se Serbia e viteve 1941- 1944 kish një pamje tjetër kufijsh të stabilizuara nga pushtuesit e huaj, afërsisht të përshkruara kështu: në veri lumenjtë Danubi dhe Sava, në perëndim Bosnja, në lindje nga Rumania në drejtim të zonave të pushtuara bullgare (Piroto –Vlasotince-Vranje- Uroshevac- Prizren) dhe italiane në Kosovë e Mal të Zi. Përsa i përket Maqedonisë që konsiderohej si zonë e pushtimit bullgar, bënte përjashtim vetëm krahina e Dibërës e cila ishte nën kontrollin italian. Në këtë rajon në vitin 1941 jetonin rreth 21.000 hebrenj, nga të cilët rreth 13.000 ishin në Serbi dhe 7.762 në Maqedoni (Pisari, 2010: 170).

Në Serbi shumica e tyre, 11.800 vetë ishin të përqendruar në Beograd ndërsa në Maqedoni ishin ndarë në dy komunitete kryesore: në Shkup 3.793 vetë dhe në Manastir 3.351. Komunitetet më të vogla jetonin në qytete të tjera si në Serbi dhe në Maqedoni. Në Serbi kishte nga 5000 deri 6000 hebrenj refugjatë nga Europa Qendrore dhe Lindore, që gjendeshin atje të bllokuar në pritje për të vazhduar drejt Palestinës. Në fund të luftës i mbijetuan peripecive më pak se 3.000 prej tyre. Komunitete të ndryshme hebraike, sidomos ato më të voglat u shkatërruan plotësisht.

Sapo ushtarakët gjermanë hynë në Beograd kërkuar menjëherë të identifikonin dyqanet e hebrenjve. Për pak ditë ata demonstruan sjelljen e një terrori të organizuar dhe më 16 prill të vitit 1941 u vendos të merret e para masë antisemite: urdhri i firmosur nga kreu i policisë gjermane në atë qytet parashikonte që të gjithë hebrenjtë

brenda datës 19 prill duhet të paraqiteshin për t'u regjistruar, ndryshe do të pushkatoheshin. Nga 11.780 hebrenjtë banues në Beograd para shpërthimit të luftës u paraqitën si të tillë vetëm 8.500; të tjerët u fshehën apo u arratisën në drejtime të ndryshme. Urdhri ishte i vlefshëm për të gjithë Serbinë: në rajonin e Serbisë Qendrore u regjistruan 843 hebrenj, nga të cilët 177 ishin të huaj; për pjesën tjetër të vendit si në Kosovën dhe Serbinë Perëndimore nuk disponohen të dhëna, por komunitetet e vogla ka mundësi të kenë mbetur të bashkuara pa u arratisur. Që nga ky moment e deri në fund të muajit maj, gjermanët imponuan një sërë ligjesh antisemite. Me anën e tyre goditej çdo ditë e më shumë dinjiteti i hebrenjve si qenie njerëzore, ndërsa paralelisht liria e tyre blihej ende në pazar si një plaçkë tregu.

Në verën e vitit 1941 shqetësimi për t'u çliruar nga "elementët e padëshiruar" i shtyu autoritetet gjermane të ndërtonin kampet e përqendrimit ku të mund të internonin popullsinë hebreje të seksit mashkull. Ky vendim u mor papritmas nga autoritetet e larta naziste në Serbi, pikërisht një muaj pasi po këto autoritete kishin urdhëruar pushkatimin jo vetëm të hebrenjve por dhe të romëve. Kampet e para në Serbi u ngritën në gusht të vitit 1941 në Sabac, qytet në Serbinë Veriperëndimore dhe në Beograd. Në kryeqytetin jugosllav u ngritën disa të tillë, njëri pas tjetrit, ndërkohë që në gjysmën e tetorit një tjetër u ngrit në Nish, ku u internuan hebrenjtë meshkuj të qytetit. Gjatë gjysmës së nëntorit një lloj kampi përqendrimi u krijua në Mitrovicë (Kosovska Mitrovica), në brendësi të burgut të qytetit ku mbaheshin mbyllur hebrenjtë e seksit mashkull që tashmë kishin detyrimin të bënin punë të sforcuar, mes të tjerave pastrimin e rrugëve dhe WC-ve publike.

Si rezultat i marrëveshjeve mes gjermanëve

dhe italianëve për ndarjen e territoreve të Mbretërisë së Jugosllavisë, pjesa më e madhe e Kosovës (përfshi qytetin e Prishtinës) dhe rajonin e Dibrës ishin përcaktuar nga Italia, që t'i bashkoheshin Shqipërisë. Një pjesë e Kosovës (përfshirë qytetin e Mitrovicës) i ishte caktuar Gjermanisë, që ia bashkëngjiti Serbisë së pushtuar. Si kjo e fundit ashtu dhe Maqedonia e pushtuar nga Bullgaria, kufizohej jo me Shqipërinë por me Kosovën dhe rajonin e Dibrës së Madhe bashkangjitur. Dhuna e bombardimeve mbi Beograd, që kishte shkaktuar vdekjen e të paktën 2.000 personave dhe që kishte goditur shumicën e lagjeve më të mëdha të qytetit (ku kish shumë hebrenj), dhe akoma më shumë hyrja e shpejtë e gjermanëve, kishin detyruar hebrenjtë e shumtë të iknin nga qyteti që nga pranvera e vitit 1941 (Pisarri, 2010: 171). Mes tyre megjithatë, të paktën deri në pushkatimin e parë masiv, vështirë se kuptohej se çfarë rreziku i priste ata në harkun e pak muajve, që nga reprezaljet, internimet e deri te asgjësimet ndaj tyre. Ky ndërjegjësim sidoqoftë sollti një erë të re arratie mes fundit të verës dhe vjeshtës, periudhë në të cilën megjithatë kontrolli gjerman u bë dhe më i ashpër dhe mundësia e ikjes u bë dhe më e vështirë.

Mungesa e dokumenteve dhe kërkimeve specifike mbi këtë argument, përjashtuar disa studime me ndikim të gjerë, na shtrengojnë të përdorim veçanërisht dëshmitë e të mbijetuarve dhe të provojmë të ndërtojmë historinë nëpërmjet tyre. Në korrik të vitit 1941, tre muaj pas regjistrimit të popullsisë nga autoritetet gjermane, rreth dy mijë hebrenj ende nuk ishin paraqitur. Një pjesë e tyre kishte vendosur të fshihej në qytet apo në fshatra, mes popullsisë lokale dhe refugjatëve serbë që mbërritën në vazhdimësi si pasojë e persekutimit të forcave ustash të Kroacisë<sup>1</sup>. Të tjerë të shtyrë dhe nga rrëfimet mbi

<sup>1</sup> Është e vështirë të stabilizosh një numër të saktë të hebrenjve që shpëtuan falë bujarisë së popullsisë lokale serbe që i fshehën, por bëhet fjalë ndoshta për disa qindra. Cituar sipas Pisarri, "La Shoah in Serbia e Macedonia (1941-1943)...", f. 192.

situatën në Gjermani të hebrenjve të Europës Qendrore, vendosën t'u ikin gjermanëve dhe të kalojnë në zonat e pushtuara prej hungarezëve në veri, bullgarëve në jug dhe në përgjithësi drejt territoreve të aneksuara nga italianët, ku thuhej se kushtet ndaj hebrenjve ishin më pak të egra.

Por problemi kryesor ishte si mund të tejkaloheshin kontrollet e shumta, veçanërisht në kufi. Një nga mënyrat për të ikur, ishte natyrisht duke paguar mirë kontrabandistët. Ikte të këtij tipi mbanin me vete shumë rreziqe si p.sh. “fshehtësia” e ikjes ose mungesa e dokumenteve, apo dhe nevoja e përhershme për t'u fshehur edhe pas zbritjes në çfarëdo toke, sidomos ata që zbrisnin në veri, në territorin hungarez. Më pas një tjetër modalitet i radhës u kërkua: dokumentet false me të cilat pasi kalonin kontrollet gjermane kudo ku ata ishin, edhe nëpër stacionet e trenit, shumë hebrenj udhëtonin drejt Nishit, më pas drejt Shkupit dhe në shumë raste përtej kufirit italian, përgjithësisht në Prishtinë.

Një tjetër rrugë, e përdorur sidomos që nga fillimi dhe më vonë, më pak e frekuentuar ishte ajo e kalimit mes për mes shtetit të pavarur kroat për të shkuar drejt territorit italian në Dalmaci<sup>2</sup>. Të tjerë në përpjekje për të mbërritur në të njëjtat qytete dalmate, preferonin sidoqoftë të drejtoheshin drejt Shqipërisë dhe që aty drejt bregdetit. Nxjerrja e dokumenteve të nevojshme, sipas dëshmvive arrihej në sekret të plotë falë punës së disa prej autoriteteve qeverisëse nga administrata lokale dhe qendrore, të cilët arrinin të nxirnin

shumë dokumente në një kohë të shkurtër. Një i tillë ishte Nebojska Kulacic, banues në Beograd, i cili në muajin gusht 1941 u bë personi çelës, për shumë familje që ikën në Shqipëri. Falë tij dhe kontakteve pranë ambasadës italiane, u arrit të siguroheshin të gjitha dokumentet e nevojshme për t'u larguar drejt Shqipërisë.

Në shumë raste, dokumentet false lëshoheshin edhe nga vetë nëpunësit e ambasadës italiane në Beograd, çmimi i së cilës shkonte deri në 30.000 dinarë për një dokument personal. Sigurisht këto raste, nuk u lanë pa u gjurmuar nga hetuesit e Gestapos dhe autoritetet serbe, të cilat nisën hetimet për të verifikuar statusin e atyre që kishin përfituar dokumente kalimi (Pisarrri, 2010: 193). Në këtë mënyrë (por ka dhe raste të kalimit klandestin, pa dokumente), gjatë vitit 1941 arritën në Prishtinë të paktën 150 hebrenj serbë si refugjatë, që u gjetën së bashku me një grup tjetër hebrenjsh prej 45 vetash nga Europa Qendrore dhe Lindore që deri në fund të konfliktit jetuan të izoluar në Kursumlijska Banja<sup>3</sup>, ndërsa të tjerët kaluan thjesht nga Kosova për të shkuar drejt Shqipërisë ose në Dalmaci. Sapo arrinin në Kosovë refugjatët që hynin “legalisht” viheshin menjëherë nën kontrollin e autoriteteve italiane, që në shumë raste ishin në dijeni të hebrenjve në arrati të pajisur madje dhe me dokumente false. Pa marrë asnjë masë, ata i lejonin të ardhurit e rinj të sistemoheshin apo të kishin besim tek komuniteti lokal hebre<sup>4</sup>. Të tjerë, që kishin pasur probleme me autoritetet, u fshehën tek

<sup>2</sup> Dalmacia ishte një territor i bashkuar me Mbretërinë e Italisë. Kjo u realizua në prill të vitit 1941, pas pushtimit ushtarak të Dalmacisë jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore. Guvernorati i Dalmacisë italiane u krijua në bazë të dekretit mbretëror të ligjit nr. 452 të datës 18 maj 1941. Musolini e ndau territorin në tre provinca: provinca e Zarës, e Spalatos dhe Kotorrit.

<sup>3</sup> Qytezë e vogël në Serbinë Jugore.

<sup>4</sup> Një refugjat nga Beogradi, Isak Eskenazy, kujton se gjatë pyetjeve nga ana e autoriteteve italiane të Prishtinës, rezultuan e qartë për të gjithë që megjithë dokumentet false, ai dhe shokët e tij ishin refugjatë hebrenj, dhe kështu iu kaluan nën kujdes komunitetit lokal hebre: “Ishte e dukshme se situata ishte e qartë për ta, sepse nuk ishim të parët refugjatë atje. E kuptuan menjëherë me kë kishin të bënin dhe për çfarë bëhej fjalë”. Pak përpara ai sjell një rast të një të afërmi të tij, Samuil Mevorah i cili “pati fatin të dëbohej nga Prishtina dhe të kthehej mbrapsht në territorin e pushtuar nga nazistët. Megjithatë, polici që e shoqëronte deri në kufi dhe



familje serbe në Prishtinë apo dhe në qytete të tjera si në Prizren. Në këtë të fundit arritën të paktën 5-6 familje, edhe falë ndihmës së anëtarëve të tjerë të komunitetit lokal hebre.

Po ashtu është i njohur fakti që, megjithëse “kufiri i mosndërhyrjes” së dy ushtrive aleate, italiane dhe gjermane, ishte përcaktuar, statuti i Mitrovicës, i miratuar më 6 gusht 1941, në mënyrë të tërthortë u njihnte ushtrive aleate edhe të drejtën për të hyrë pa ndonjë leje a autorizim në Kosovë, brenda së cilës formalisht gjendej edhe Mitrovica. Kjo ishte një arsye e mjaftueshme që hebrenjtë e Kosovës ta ndienin veten të pasigurt. Në një kuptim, për shkak të këtyre kushteve, në Kosovë nuk ishte e njëjta gjendje si në “Shqipërinë e vjetër”. Pikërisht përftimi i këtyre rrethanave si lehtësim rreziku, bëri që një shumicë hebrenjsh të Kosovës, rezidentë atje, të shpërnguleshin thuajse tërësisht në drejtim të “Shqipërisë së brendshme”, ku ndiheshin më të qetë.

Sipas historianëve jugosllavë Bogumil Hrabak dhe Živko Avramovski, në Kosovë deri në shpërthimin e luftës kishte afërsisht 600 hebrenj. Mund të thuhet se ata thuajse të gjithë erdhën në Shqipëri dhe pjesa më e madhe e tyre u vendosën në Berat. Jo më pak se 94 kryefamiljarë erdhën bashkë me pjesëtarët e familjeve të tyre, po ashtu edhe 87 persona të tjerë. Listat e tyre ruhen në AQSH. Ardhja e tyre u përgatit përmes një korrespondence zyrtare mes disa ministrive të qeverisë së Tiranës dhe prefektit të Prishtinës. Nga ana e prefektit të Prishtinës janë përdorur edhe slogane e frazeologji antihebraike të tilla si “nuk duam që jahuditë të na marrin pasuritë tona” etj., si këto, por duket qartë se ky ka qenë thjesht një konformizëm për të

mbuluar qëllimin e vërtetë të shpërnguljes së hebrenjve nga Kosova në Shqipëri.

Në Prishtinë, dukej tashmë e qartë se ishte aktiv edhe një kanal tjetër arratie, i organizuar drejt jugut, përmes së cilit edhe para luftës kalonin refugjatë të shumë hebrenjsh të Europës Qendrore dhe Lindore. Shumë prej tyre falë komitetit të përbërë nga rabini i Prishtinës, Josif Levi, në periudhën e mëparshme të pushtimit nazifashist kaluan nëpër Shqipëri ndërsa ata që lufta i mori, duket se u arrestuan dhe u dërguan drejt gjermanëve gjatë ditëve të para të pushtimit (Pisarrri, 2010: 195).

Gjurmë, sa i përket përpjekjeve të Josif Levit në lëvizjen e hebrenjve drejt Shqipërisë ka pasur edhe në verë të vitit 1941, kur fluksi i ri i refugjatëve, kësaj radhe nga Beogradi, ishte bërë tashmë shumë i dendur. Rabini i drejtohet kreut të prefekturës në Prishtinë, Prenk Uli, duke i kërkuar ta ndihmojë në transferimin e refugjatëve në Shqipëri sepse si ai thotë, “në Prishtinë nuk kishin të hanin”. Prenk Uli i sugjeron atij t’i pajisë ata fillimisht me certifikata mbi bazën e të cilave, ai nga ana tjetër do t’u japë të tjera dokumente me të cilat, refugjatët të mund të shkojnë në Shqipëri. Në këtë lloj mënyre duket që janë zhvendosur në Shqipëri rreth 52 refugjatë hebrenj. Por aktiviteti i rabinit nuk mbaron këtu. Ai u përfshi edhe në shpëtimin e të tjerë refugjatëve hebrenj, që duke ardhur me tren deri në Prishtinë, mund të zbuloheshin dhe të ktheheshin në Serbi. Një i dërguar i komunitetit të Prishtinës në stacionin hekurudhor të Lipjanit, gjithmonë në Kosovë, kishte për detyrë të lajmëronte hebrenjtë që ishin në tren nga Beogradi se ku duhej të zbrisnin dhe më pas ku duhet

---

që do duhej ta dorëzonte tek gjermanët, në stacionin e parë hekurudhor u zhdruk dhe Mevorah duke parë që u gjend i lirë, zbret nga treni në Uroshevac dhe shkon në Prizren”. Cituar sipas dëshmive dhënë studiuesit Milovan Pisarrri. Në një tjetër dëshmi, një hebre që kish mbërritur në Tetovë të Dibrës së Madhe, kujton se “gjatë pyetjeve në polici, një togër i policisë më tha se dyshonte në autencitetin e dokumenteve që posedoja, por megjithatë ai nuk provokoi asnjë incident të mundshëm”; M. Pisarrri “La Shoah in Serbia e Macedonia (1941-1943)...”, f. 193.

të shkonin për t'u fshehur<sup>5</sup>. Në janar të vitit 1942, shumë refugjatë që ishin në Kosovë, duke përjashtuar veçanërisht ata klandestinë u arrestuan dhe më vonë u internuan në Shqipëri së bashku me popullsinë hebraike të Prishtinës, të gjinisë mashkullore që përfshinin moshat nga 15 deri në 65 vjeç. Por, 51 nga refugjatët e arrestuar, pjesa më e madhe nga Beogradi, më 14 mars 1942, nga autoritetet italiane të Prishtinës, iu dorëzuan atyre gjermane të Serbisë, të cilët i çuan më pas në kampin e Sajmishtes<sup>6</sup>.

Shqipëria nuk përbënte vendin shpëtues vetëm të refugjatëve që vinin nga Serbia përmes Kosovës. Në të vërtetë edhe nga Maqedonia, hebrenj të shumtë nga zona të thella arritën të kapërcenin kufirin dhe të shpëtonin. Arratisjet ndodhën sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 1942 dhe deri në deportimin e 11 marsit 1943. Të krijohet përshtypja se kjo nuk ishte një rrugë që ndiqej nga të shumtët, sepse deportimi i hebrenjve maqedonas u mbajt i fshehtë deri sa papritmas u kthye në një projekt zbatues. Veç të tjerash, duhet të theksojmë se kushtet në të cilat jetonin hebrenjtë maqedonas, megjithëse të vështira, ende nuk të jepnin idenë e një fundi të shpejtë.

Zëra nga Beogradi ku Shoah kish arritur në fazat përfundimtare, shtynë shumë familje të Shkupit të përgatisnin dokumente false apo të kalonin në këmbë malet e Maqedonisë dhe Shqipërisë<sup>7</sup>. Për këtë arsye në gjysmën e dytë të vitit 1942 disa prej tyre vendosën t'u bashkohen partizanëve nëpër male apo të arratisen në Shqipëri. Në ditët e

fundit të shtatorit, u kapën 15 hebrenj të cilët kishin siguruar nga nëpunësit e prefekturës së Ferizajt, dokumente të përkohshme shqiptare me qëllim që të lëviznin lirshëm nëpër Shqipëri. Gjithashtu, besohej se, nga këto anë hynin shumë hebrenj të cilët kalonin drejtpërdrejt për në Prizren e Tetovë (AQSH, 1941c; AQSH, 1943c) prej nga futeshin në Shqipëri (AQSH, 1943b). Edhe nga Struga dhe Prespa vazhdonin të hynin ilegalisht hebrenj, të cilët më pas merrnin dokumente me emra myslimanë.

Dëshmi e lëvizjeve nga kjo anë e kufirit, janë hebrenjtë maqedonas të cilët ranë nën pushtimin bullgar. Nga shtatë mijë që ishin para fillimit të luftës, vetëm rreth një mijë prej tyre arritën të shpëtonin falë kalimit të kufirit dhe futjes në pjesën shqiptare. Në historitë e ndihmës humanitare dhe po aq të guximshme, ka raste kur individë të ndryshëm ndërmjetësonin dhe me pak para u nxirrnin hebrenjve dokumente false nga organet lokale. I tillë është rasti i David Samuel Davidit apo Isak e Sollomon Aroetit (AQSH, 1943a). Në këtë periudhë organet zyrtare shqiptare iu dhanë mundësi hebrenjve të pajiseshin me pasaporta shqiptare. Në Tiranë p.sh. u pajis me pasaportë shtetasja gjermane Gerda Elisabetta Spitz (AQSH, 1942b)<sup>8</sup>.

Gjatë pushtimit italian ka pasur ardhje të hebrenjve jo vetëm nga vendet fqinje, por dhe nga pjesë të ndryshme të Europës, si Çekosllovakia, Gjermania etj (AQSH, 1942d)<sup>9</sup>. Megjithëse fillimisht ata ndeshën një qëndrim pak të vrazhdë të italianëve, këta të fundit më

<sup>5</sup> Dëshmia e Luci Petrovic, në studimin e Pisarrit në: "La Shoah in Serbia e Macedonia (1941- 1943)...", f. 195.

<sup>6</sup> Ky episod ka qenë i panjohur për shumë kohë, vetëm tani në sajë të studimit të Pisarrit-t është ndriçuar disi. Shih: Michele Sarfatti, "Aleatët e zellshëm të Hitlerit", në *Corriere della Sera*, 16 prill 2010, f. 55.

<sup>7</sup> Dëshmi e Ljubica (Buba) Milivojevic – Poleksic, në: *Mi smo Prezivali Jevreji o Holokaustu*, n. 5, 2009, f. 338 – 339.

<sup>8</sup> Bëhet fjalë për një letërkëmbim e Mëkëmbësisë së Përgjithshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë mbi internimin e Helmut Paul Enrico dhe Spitz Gerda, nënshtetas gjerman me kombësi hebraike, si elementë të dyshimtë, banues në Tiranë, i pari i punësuar në një laborator fotografik tek një shtetas italian në rrugën "Beshiri" nr. 68, dt. 1.4.1942-4.5.1942.

<sup>9</sup> Ky dokument përmban një letërkëmbim të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën e Përgjithshme të Karabinierisë, prefekturat e Beratit, Durrësit, Dibërës, Pejë, Prishtinës, Shkodrës, etj., mbi masat që duhet të merren kundrejt hebrenjve që kanë ardhur në Shqipëri si rrjedhojë e luftës, përqendrimi i tyre në Berat, Durrës, Kavajë, Krujë, Shijak dhe Burrel, dt. 14.3.1942- 26.10.1942.

vonë e ndryshojnë kursin e tyre nën tryshninë e autoriteteve shqiptare<sup>10</sup>. Në gjurmë të këtij pohimi gjejmë të dhëna që kur, Sofja dhe Berlina ranë dakord për transferimin e hebrenjve të huaj nga shteti bullgar, ambasadori italian në Sofje, Massimo Magistrati i mori në mbrojtje hebrenjtë me shtetësi italiane dhe shqiptare që gjendeshin në Bullgari<sup>11</sup>.

Studiues bullgarë bëjnë me dije se të paktën 24 hebrenj u liruan nga kampet e vdekjes në Bullgari si shtetas italianë ose shqiptarë dhe më pas shkuan në drejtim të zonave shqiptare nën pushtimin italian, kryesisht në drejtim të Prishtinës. Nga frika se trupat gjermane mund të pushtonin edhe zonat italiane më vonë, pra në Kosovë, në fillim të vitit 1943 prefektura e Prishtinës këshilloi me autorizimin nr. 98/54 që familjet hebraike të cilat kishin gjetur mikpritës në Shqipëri mund të zhvendoseshin për atje. Duket se pas kësaj, dhjetëra familje morën një vendim të tillë (AQSH, 1943d)<sup>12</sup>. Zhvendosja e tyre ashtu sikurse kish ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 1942, vazhdoi akoma dhe më me intensitet edhe gjatë vitit 1943.

Ka pasur raste të tjera ku bëhej fjalë për goditje të forta si p.sh. mes 9 dhe 10 marsit të vitit 1943 dhjetëra hebrenj nga Shkupi arritën të arratiseshin në Shqipëri pas një informacioni sekret të një polici bullgar, i cili i njoftoi se pas deportimeve në atë vend, ata do të dërgoheshin drejt kampeve shfarosëse në

Europë (Matkovski, 1959). Arratisja e një grupi hebrenjsh drejt Shqipërisë, kur ata u internuan në kampin e Shkupit, duke kërkuar të arrinin në zonat italiane të pushtimit shtoi më shumë kontrollat dhe sigurinë policore rreth kampit por dhe gjatë kufirit shqiptar. Sigurisht fati i tyre ishte tragjik. Ata u kapën dhe u pushkatuan ndaj dhe për hebrenjtë e tjerë të internuar në kamp, kjo ngjarje ishte një paralajmërim i hapur fatal. Prej dëshmive mësojmë gjithashtu se disa familje hebraike në Manastir u fshehën nga vetë qytetarët për disa ditë dhe më pas ato u larguan drejt Shqipërisë. Në ndonjë rast, ata u larguan edhe përmes liqenit të Ohrit. Rrethanat e ndërlikuara të kohës kanë regjistruar disa kategorizime të popullatës hebraike në territoret e Shqipërisë së vjetër:

- Grupi i parë ishte ai i hebrenjve që gëzonin nënshtetësi shqiptare. Këta ishin ajo kategori e cila gëzonte të gjitha të drejtat që gëzonte edhe një nënshtetas shqiptar, madje edhe lirinë e besimit fetar. Ndaj tyre nuk u vendos asnjë masë penalizimi.
- Grupi i dytë ishte ai i hebrenjve ‘turistë’, ardhur para pushtimit italian dhe që u transferua drejt qendrave në thellësi të vendit, sipas zgjedhjes së tyre.
- Grupi i tretë ishin hebrenjtë ‘kosovarë’, të cilët pavarësisht se siguruan nënshtetësi shqiptare ndanë fatin e njëjtë me ata të grupit të dytë<sup>13</sup>.

<sup>10</sup> “Ky ishte njeri me zemër të mirë (e ka fjalën për kryeministrin Kruja) dhe me ndihmën e tij nëpërmjet përfaqësive tona jashtë shtetit u furnizuan mjaft hebrenj gjermanë, bohemë, hungarezë dhe rumunë me pasaporta shqiptare. Ata i shpëtuan përndjekjeve racore duke gjetur vendstrehim në Shqipëri”. F. Jakomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri...*, f. 304.

<sup>11</sup> F. Jakomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri...*, f. 305.

<sup>12</sup> Lista emërore, qarkore e Kuesturës së Prishtinës dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, letërkëmbim i kësaj drejtorie në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kuesturat e Durrësit, Beratit, Korçës, Prishtinës, Pejës, etj., mbi hetimin e ardhjes në Shqipëri të hebrenjve, qëndrimin dhe dërgimin e tyre në fushat e përqendrimit në Berat, Durrës, Kavajë, Krujë, Shijak, Dibër dhe Burrel, dt. 13.3. 1943; po aty, F.153, V.1943, D.386, fl.52-69. Letërkëmbim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me Mëkëmbësinë e Përgjithshme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kuesturën e Elbasanit mbi dërgimin në fushën e përqendrimit në fshatin German të Matit të Alegra Semienev dhe Padre Niko të ardhur nga Bullgaria, dt. 8.4.1943.

<sup>13</sup> AQSH, F.153, V.1943, D.386, fl.70-281. Lutje e disa e hebrenjve drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, skeda emërore të tyre, letërkëmbim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kuesturat e Tiranës, Shkodrës, Pejës dhe Prizrenit mbi ardhjen në Shqipëri të hebrenjve, hetime mbi qëndrimin e tyre dhe dërgimin në fushat e përqendrimit në Berat, Lushnjë, Kavajë, Krujë dhe Shijak, 13.4.1943-7.10.1943.

- Grupi i katërt ishin hebrenjtë e huaj të vendosur fillimisht në Kosovë, që pasi grumbulloheshin në kampin e përqendrimit planifikoheshin t'i dorëzoheshin gjermanëve. Studiuesi Sarfati shkruan se 51 prej tyre u deportuan nga gjermanët ndërsa të tjerë arritën të shpëtonin me ndërhyrjen e autoriteteve shqiptare duke u transferuar në drejtim të Shqipërisë, në ato që u quajtën 'kampe internimi'.

Gjatë periudhës fashiste njihen dy raste të ardhjes masive të hebrenjve në Shqipëri, që u takojnë viteve 1941 dhe 1942. Dokumentet arkivalë flasin për 350 hebrenj të ardhur nga Dalmacia, 192 nga Kotorri dhe 94 familje me 87 pjesëtarë të tyre nga Kosova, të cilët u arratisën drejt Shqipërisë prej rajoneve të ndryshme të Europës Juglindore, nga ku përjetonin një situatë terrori dhe përndjekjeje të pashembullt shfarosëse.

Ardhja e parë e tyre dëshmohej prej një koleksioni dokumentesh që i përket gjysmës së dytë të vitit 1941. Prej studiuesit italo-hebre Michele Sarfatti (2005: 34-35), autor i librit "*La legge antiebraiche spiegate agli italiani di oggi*", është i njohur botërisht rasti i shpërnguljes së 192 hebrenjve nga Kotorri në Kavajë dhe zhvendosja më pas e tyre në Itali. Ky rast çmohet si një shprehje humanizmi dhe solidariteti, sa i takon popullit shqiptar, por dhe vetë autoriteteve italiane. Nëpërmjet dokumenteve arkivalë mësohet mbi rrugëtimin e tyre prej qytetit bregdetar të Kotorrit derisa u vendosën në kampet e përqendrimit në Shqipëri. Për këtë rast, përveç listës së plotë të emrave të përveçëm të të gjithë grupit, gjendet edhe një letër që këshilltari i përhershëm i policisë, G. Travaglio i ka dërguar Luogotenencës,

ku pohohet shprehimisht se 'këto familje në përputhje të plotë me listën, janë transportuar dhe vendosur në kampin e përqendrimit në Kavajë, ku tani për tani ndodhen nën mbikëqyrjen e autoriteteve ushtarake të këtij kampi' (Sarfatti, 2005).

Ardhja e dytë e një grupi të madh hebrenjsh ndodhi po ashtu gjatë verës së këtij viti. Dokumentet arkivalë flasin për plot 350 hebrenj të arrestuar në Dalmaci nga autoritetet italiane dhe dërgimin e tyre në kampin e përqendrimit në Kavajë. Dërgimi i tyre aty është vendosur përmes një letërkëmbimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme me komandën eprorë të fuqive të armatosura<sup>14</sup>. Hebrenjtë e Dalmacisë mbërritën në Durrës në fund të korrikut dhe u vendosën në Kavajë rreth dy muaj më vonë, pikërisht në fund të shtatorit të vitit 1941.

Politika e lejimit të hyrjes së hebrenjve në Shqipëri në kushtet e rrezikut të luftës dëshmohej edhe përmes letërkëmbimit të Këshillit të Ministrave me Mëkëmbësinë e Përgjithshme për lejimin e ardhjes në Prishtinë të hebrenjve të pajisur me dokumente serbe, të legalizuara nga autoritetet konsullore italiane në Serbi (AQSH, 1941b).

Megjithëse në kushte terrori duket qartë se autoritetet italiane dhe ato shqiptare kanë bashkëpunuar për zhvendosjen e hebrenjve të rrezikuar në territoret shqiptare ndërsa prurjet e tyre kanë vazhduar si në grupe ashtu dhe në mënyrë individuale gjatë gjithë vitit 1942. Gjatë pranverës dhe vjeshtës së këtij viti dokumentet arkivalë flasin për një korrespondencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën e Përgjithshme të Karabinierisë për masat që duhet të merren për hebrenjtë që kanë mbërritur në Shqipëri si pasojë e luftës (AQSH, 1942e). Prurjet më të mëdha të tyre sipas dëshmive duken se kanë qenë prej Bullgarisë nga ku hebrenjtë

<sup>14</sup> Letërkëmbim i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën Eprorë të Fuqive të Armatosura, prefekturën e Durrësit mbi arrestimin në Malin e Zi të 350 hebrenjve, dërgimin e tyre në fushën e përqendrimit në Kavajë dhe trajtimin e tyre si robër lufte, dt. 29.7.1941- 23.9.1941.

largoheshin nën syrin kërcënues të asgjësimit të menjëhershëm (AQSH, 1943b). Prej raporteve policore të kohës kuptohet se ndonëse ardhja e hebrenjve të keqtrajtuar

nga autoritetet bullgare paraqitet më fragmentare, pra jo në grupime të mëdha, është interesante të shenjohet se pranimi i tyre ka vazhduar deri në vitin 1943<sup>15</sup>.

## REFERENCAT

- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1941a. “Letërkëmbim i Mëkëmbësisë së Përgjithshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë...”, F.153, D. 160, fl.30-50.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1941b. “Letërkëmbim i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën Eprorë të Fuqive të Armatosura...”, F.152/2, D.141, fl. 8- 9.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1941c. “Njoftim i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar prefekturës së Dibërës”, F. 152/2, D. 141, fl. 10.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1942a. “Letërkëmbim i Kryesisë së Këshillit të Ministrave me Mëkëmbësinë e Përgjithshme...”, F.161, D.430, fl.1- 2.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1942b. “Letërkëmbim i Mëkëmbësisë së Përgjithshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë...”, F. 161, D. 350, fl. 1-4.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1942c. “Letërkëmbim i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Mëkëmbësinë e Përgjithshme...”, F... D. 410, fl. 2-6.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1942d. “Letërkëmbim i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën e Përgjithshme të Karabinierisë...”, F. 152/2, D. 319, fl. 11.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1942e. “Letërkëmbim i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Komandën e Përgjithshme të Karabinierisë...”, F.152, D. 319, fl.1-16.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1943a. “Letërkëmbim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme...” F. 153, D. 386/2, fl. 201-269.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1943b. “Letërkëmbim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme...”, F. 153, D. 386/2, fl.24-30.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1943c. “Letërkëmbim i Kuesturës së Elbasanit me prefekturën e Elbasanit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme”, F. 271, D. 272, fl. 1-2.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1943d. “Lista emërore, qarkore e Kuesturës së Prishtinës dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë...”, F.153, D. 386, fl.16.
- Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH). 1943e. “Lutje e disa e hebrenjve drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë...” D. 386, F.153, fl.70-281.
- Jakomoni, Francesco. 2018. *Politika e Italisë në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55.
- Matkovski, Aleksandar. 1959. “The destruction of Macedonian Jewry in 1943”, In: *Yad VaShem Studies* 3, p. 203– 258 <https://>

<sup>15</sup> Në një raport të Zyrës Policore në Prishtinë, dt. 30 qershor 1943, në lidhje me Solomon Hazmonay, thuhej: “Emri i babait Haim, emri i nënës Sara, lindur në Sofje të Bullgarisë më 1913. I pyetur përse ai erdhi në Shqipëri në rrugë të paligjshme ai shkruan se: “Më 6 qershor u larguam nga Shkupi dhe mbërritëm në Ferizaj nëpërmjet një vagoni treni, i cili përdorej për të mbajtur kafshët. Kur zbritëm që andej na kapi policia dhe u dërguam në burg. Arsyeja që ne erdhëm në Shqipëri, ishte se autoritetet bullgare donin të na konfiskonin pasurinë dhe të na dërgonin në kampet shfarosëse të Europës. Erdhëm në Shqipëri pikërisht për t’i shpëtuar rrezikut. Kishim fare pak dollarë me vete”. Nga ky raport, shkruan Harvey Sarner në librin e tij, ne nuk e dimë se çfarë i ndodhi kësaj familje, por ajo që dimë, sqaron më tej ai, është se autoritetet shqiptare të kohës, jo vetëm i strehuan hebrenjtë e ikur por dhe i siguruan një asistencë të vogël ekonomike familjeve hebraike refugiate.

- suedosteuropaeischehefte.files.wordpress.com/2013/10/troebst\_sh\_2\_1.pdf (parë më 25 janar 2020).
- Pisarri, Milovan. 2010. "La Shoah in Serbia e Macedonia (1941-1943)" në *Gli ebrei...* (a cura di M. Sarfatti dhe L. Brazzo), Firenze: Giuntina.
- Rodogno, Davide. 2003. *Il nuovo ordine del mediterraneo, Le politiche di occupazione dell'Italia fascista (1940-1943)*, Torino: Bollati Boringhieri.
- Sarfatti, Michele. 2005. "Grazie Albania. Solo in Albania la tremenda macchina della Shoah conobbe un arresto", *Bota Shqiptare*, N. 127, 27 janar-9 shkurt 2005; <http://www.giovanniarmlotta.it/ospiti/sarfatti.html> (parë më 25 janar 2020)
- Sarfatti, Michele. 2005. *La legge antiebraiche spiegate agli italiani di oggi*, Torino: Giulio Einaudi Editore
- Sarfatti, Michele. 2010. "Aletët e zellshëm të Hitlerit", në *Corriere della Sera*, 16 prill.
- Sarner, Harver. 1997. *Rescue in Albania, One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust*, California: Brunswick Press.

## ABSTRACT

The Italian administration of Albania carries characteristics that we find in other territories occupied by Italy during World War II. The land of eagles, like Ethiopia and Greece, was occupied by the Italians without the consent of the German ally, five months before the official start of World War II. Under the cover of a personal union, the Italian invaders created an administration under their full control, but with the broad participation of Albanian personalities of the time. The treatment of Jews in Albania during World War II constitutes a case study of the Jewish community in the Balkans and creates spaces for comparative understanding of how harsh anti-Semitic politics was during this period in Serbia occupied by the Third Reich or even in the Macedonia occupied by Bulgaria. It is a merit of the Albanian authorities of the period between the two wars, who had secured such a status for the Jews in Albania, which made it difficult for the Italian occupiers to adopt a policy of extermination. In April 1941, the territory of Kosovo, which was part of Yugoslavia and inhabited mainly by ethnic Albanians, was annexed to Albania and placed under "Albanian control", which was in fact an Italian control. The Jews of these "annexed" territories were not as fortunate as the Jews living in Albania on the borders of 1913

**Keywords:** *The Italian occupation; personal union; Kosovo; Jews*

# ANOMIA DHE VRASJET NË ÇIFT NË FAMILJEN SHQIPTARE

**Julian ÇOTA**

*Universiteti Aleksander Xhuvani Elbasan*

E-mail: julalb@yahoo.it

**Miranda RIRA**

*Universiteti Aleksander Xhuvani Elbasan*

E-mail: mirandarira@hotmail.com

---

## PËRMBLEDHJE

I have chosen this topic, due to my expertise in the history of education and pedagogical ideas, one of the fields of study is that of American education and culture and English influence on us. Another important reason is the great scientific discoveries and technological- revolutions from 1947 to 1994, which were crucial to humanity in general, thanks to education. I was also concerned about the idea of learning more about the

**Julian ÇOTA** ka kryer studimet e larta në Universitetin “La Sapienza”, Romë. Në studimet e tij bachelor, është diplomuar në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Në ciklin e dytë të studimeve, ka mbrojtur diplomën me temën “Ikonografia rajonale, kufinjte dhe vetëpërfaqësimi”. Pas një periudhe studimore dhe kërkimore 4-vjeçare, në të njëjtin universitet ka kryer edhe studimet e doktoraturës, ku ka mbrojtur temën “Marrëdhëniet shqiptaro-britanike 1940-1950”. Prej vitit 2013 deri në vitin 2018 ka mbajtur pozicionin e përgjegjës të departamentit të Shkencave Politike në Albanian University. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga viti 2018 e në vazhdim, është lektor me kohë të plotë pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në Universitetin Aleksander Xhuvani të Elbasanit.

**Miranda RIRA** ka kryer studimet e larta në degën Filozofi-Sociologji, në viti 2003, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2005 ka kryer studimet dy-vjeçare pasuniversitare (SHPU) për sociologji, pranë këtij fakulteti. Më pas, në vitin 2006-2007, ka përfunduar studimet Master pranë shkollës “The Patterson School of Diplomacy” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Që nga viti 2007 deri në vitin 2013 ka qenë lektore në lëndën e sociologjisë politike, sociologjisë së komunikimit, sociologjisë së punës dhe sociologjisë së devijancës në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në vitin 2018, merr gradën “Doktor i Shkencave Sociologjike” pranë Universitetit të Tiranës, departamenti i sociologjisë. Nga viti 2013-2015 ka qenë deputete në Kuvendin e Shqipërisë, për qarkun e Elbasanit. Pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, ajo është zgjidhur Kryetare e Bashkisë Përrrenjas, përgjatë viteve 2015-2019.

development and characteristics of today's education in the US. Certainly, most of us know less about education and schools in this country during the years between the two world wars and after 1945. One of the reasons is that is not written much about US in Albania, especially before 90s. American thinking and activity attracts not only because this problem is not treated in pedagogical sciences, especially in Albania, but even though from American pedagogical legacy can be learned a lot by considering the interplay of problem and chronological criterion. There are many core foundations and factors of the development of education in American society. In this paper are highlighted the following moments and preconditions of this education: a) Historical development of schools and education in USA in the period of study and importance of this heritage; b) Rapid economic, technological and scientific-cultural development of the country after 1947, constitutional documents and legal acts on education, c) social changes, demographic structure and migrations of different people towards this developed country; and d) "Marshall" Plan, which started in a meeting on 5 June 1947 in Paris, attended by 16 European countries. Analyzing these factors, we come to the most credible scientific results that the United States is today the place of learning, work, major changes, developmental tendencies, and more and more the birth of technical intelligence and other intellectuals such as the place of spiritual progress of people themselves.

**Key words:** *Educational system, school, economics, science, technology, culture.*

## Anomia dhe kuptimi sociologjik i saj

Termi anomi ka filluar të përdoret pothuajse dendur në dhjetëvjeçarët e fundit në shkencat sociale dhe ato juridike, megjithëse rrënjët i ka më thellë në histori, rreth 25 shekuj kur termi anomi u përdor për herë të parë. Për disa autorë, anomia është mungesa e ligjeve në një shoqëri; për disa të tjerë anomia është mungesa e qëllimeve humane; për disa anomia përshkruan mungesën e barazpeshës ndërmjet qëllimeve kulturore dhe mjeteve institucionale; për disa të tjerë anomia përbën një rrethanë psikologjike në të cilën njeriu tjetërsohet; për disa një lloj krize në nivelin individual ose në nivelin institucional (Pridemore, W. A., 2005: 113).

Problemi për të përcaktuar anominë nuk është vetëm i shkencave sociale. Kuptimi etimologjik i anomisë lidhet me termin "*anomias*", në greqisht, që do të thotë "mungesë e ligjit" ose "pa ligj" (Orru, M., 1987: 45). Por një përkufizim i tillë është shumë i gjerë dhe për pasojë, shpesh

i pavlefshëm. Megjithatë, kur shfletojmë literaturën sociologjike, hasim në ndonjë kuptim ekuivok të këtij termi. Kjo për faktin se një filozof diskuton për anominë në terma filozofikë, një sociolog në terma sociologjikë, një teolog në terma teologjikë dhe një jurist në terma ligjore.

Në literaturën filozofike të Greqisë së Lashtë, vëmë re se ato e analizojnë anominë në dy plane kryesore:

Së pari, këndvështrimi transhendental i mendimit social të Platonit, i cili e konsideron anominë si thelbin e së keqes, si shkakun kryesor të prishjes së rendit social.

Këndvështrimi i dytë, i cili e shikon anominë si problemin e një shoqërie në tranzicion, një shoqërie që ndryshon (Polanyi, K., 2001:54).

Por në disa raste *anomos* përshkruante mungesën e cilësive njerëzore tek një individ, i cili do të kryente vepra të tmerrshme, të dhunshme, monstruoze. Së dyti, *anomos* u referohej normave fetare dhe rregullave hyjnore. Ai, i cili i shkelte këto norma, cilësohej si i pafe, i paudhë, i pashenjtë. Së treti, *anomos* lidhej me



shkeljen e rregullave apo zakoneve sociale tradicionale dhe normat e sjelljes së duhur (Orru, M., 1987: 16).

Anomia është koncept i përdorur dendur jo vetëm në shkrimet greke, por edhe në ato hebraike, në shkrimet e Testamentit të Vjetër, por edhe në ato të Testamentit të Ri. Në Testamentin e Vjetër në greqisht, fjala “*anomia*” është përkthimi për të paktën njëzet fjalë të ndryshme hebraike që përkthehen si: ligësi, papastërti, mbrapshtësi, padrejtësi, keqësi, mëkat dhe padrejtësi (Holy Bible, Good Neës Editon, 1976: 65, 168). Në kuptimin e mëkatit dhe padrejtësisë, anomia shpesh ngatërrohej me fjalën greke *hamartia*. Gjatë gjithë Septuaxhintës, përkthimit në greqisht të Testamentit të Vjetër, fjala anomia përdoret më shumë se 300 herë.

Në shkencat sociologjike, termi anomii lidhet me dy autorë që janë themelues të disiplinës sociologjike: Emile Durkheim dhe Robert Merton. Anomia lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimet që kërkon t’i përmbushë individi në jetë. Ja si shprehej Merton në librin “Struktura sociale dhe anomia”:

Në strukturën social-kulturore dy janë qëllimet tona kryesore. E para, qëllimet, interesat dhe arritjet që gjenden brenda sistemit tonë kulturor, të cilat na shtyjnë për të arritur më shumë prestigj në jetë. Faza e dytë e strukturës sociale përcakton, rregullon dhe kontrollon mënyrat e arritjes së këtyre qëllimeve. Të dy këta elemente, qëllimet kulturore dhe normat institucionale, duhet të operojnë në mënyrë sa më të ngushtë për integrimin e plotë brenda strukturës sociale. Kur kjo nuk ndodh, integrimi në grupin social bëhet i vështirë dhe anomia zë rrënjë.... Më tej krimi, si pasojë e gjendjes anomike, është një rrethanë sociale, ku individi dështon të arrijë qëllimet që ai ka në jetë, kur ai dështon të arrijë suksesin që ka arritur grupi social, të cilit ai i përket. Kështu, individi irritohet dhe shpërthen ndaj shoqërisë me forma të ndryshme kriminale (Merton, 1938: 675).

Siç e shohim edhe në analizën e mësipërme të Mertonit mbi anominë, vëmë re se perceptimi i tij për këtë koncept lidhet ngushtë me raportin që krijon vetë individi ndërmjet normave kulturore dhe qëllimeve që ai i vë vetes.

Ndërsa Durkheim-i në punimin “Vetëvraska”, pohonte se anomia është një rrethanë psikologjike, ku qëllimet e individit nuk merren parasysh ose shtypen, prandaj individi përjeton një gjendje tjetërsimi (Durkheim, 1979: 11). Është pikërisht kjo gjendje tjetërsimi, tëhuajësimi që e bën individin të ndihet i huaj, i papërfshirë në kontekstin social, të ndihet i paintegruar me grupin social, të cilit ai i përket. Kjo gjendje krijon tek ai një ndjenjë harrese dhe papërshtatshmërie të cilën Durkheimi e etiketoi me emri anomii. Në një kuptim të përgjithshëm anomia është konsideruar si gjendje e kundërt me rregullin social, me natyrën humane, e kundërt me ligjin, me arsyen dhe me moralitetin. Shumica e sociologëve mendojnë se merita për termin anomie i takon Durkheim-it, i cili e përdori për herë të parë këtë term në vitin 1893 në veprën: “Ndarja e punës në shoqëri” (Besnard, 1988: 95).

Në literaturën sociologjike, është mjaft i njohur edhe një grupim sociologësh të cilët besojnë se anomia është shkak kryesor që i shtyn njerëzit të kryejnë akte devijante, aq sa ata kanë krijuar edhe teorinë e tyre e njohur si teoria anomike. Teoricienët që i përmbahen kësaj qasjeje sociologjike janë të shumtë. Përveç disa autorëve klasikë që i referohen anomisë, si: Durkheim, Merton, Jean Guyay, kjo teori është përqafuar edhe nga autorë të tjerë, si p.sh: Robert Agnew, Steven Stack, William Alex Pridemore, Gordon Rose, Harry Cohen, etj. Por, autorët e mësipërm ndryshojnë nga përcaktimi dhe këndvështrimi që ata kanë për anominë ose gjendjen anomike. Për më tepër, Stack shkruante se sa më i lartë të jetë niveli i pabarazisë ekonomike në një shoqëri ose në një grup social, aq më shumë stres dhe

irritim përjetojnë ata individë që nuk mund të përmbushin qëllimet e tyre.

Duke patur një diferencë e madhe ekonomike ndërmjet individëve, ata përpiqen që të arrijnë sukses me çdo kusht. Kështu ata përjetojnë anomi, gjendjen e vështirë dhe të pashpresë, e cila i shtyn në vrasje, vetëvrasje ose veprime kriminale ndaj të tjerëve (Stack, 1983: 340). Është shumë e thjeshtë të ngatërrosh shkaqet e anomisë me kuptimin e anomisë në vetvete. Sipas sociologut britanik Rose vlen të theksohet se anomia është një koncept sociologjik. Anomia i referohet një sistemi social dhe jo gjendjes individuale mendore të një individi që jeton brenda këtij sistemi. Anomia i referohet thyerjes së standardeve sociale që drejtojnë sjelljen njerëzore duke shkaktuar shtrëngim social. Kur shoqëria përjeton një goditje të lartë anomie, rregullat që e qeverisin atë, humbin forcën dhe legjitimitetin e tyre (Rose, 1966: 30).

Sipas sociologut Rose, kur shoqëria dhe individët e saj nuk respektojnë rregullat e sjelljes, ata nuk udhëhiqen më nga rregulli social, por nga kjo gjendje anomike, e cila gjithmonë lind sjelljen deviante dhe krimin. Gjendja anomike, për Rose nuk është individuale ashtu siç është për Durkheim-in, por është një gjendje sociale dhe shoqërore. Për më tepër, teoria thekson se anomia është një term kryesor që na ndihmon të kuptojmë lidhjen ndërmjet strukturës sociale, kulturës dhe sjelljes deviante. Ajo që është thelbësore në teorinë e anomisë është se njerëzit mendojnë dhe veprojnë në bazë të kuptimeve të tyre të përbashkëta që ata kanë për traditën dhe për normat sociale. “Kuptimet e përbashkëta që njerëzit kanë për konvencionet sociale në një mënyrë apo në një tjetër, ndikojnë në përcaktimin e sistemeve vlerore të tyre. Me fjalë të tjera, ato konstituojnë moralitetin dhe etikën në shoqëri” (Bernburg, 2002: 234). Vlerat dhe normat kulturore nuk bëjnë gjë tjetër veçse përcaktojnë dhe sanksionojnë qëllimet e njerëzve dhe

mjetet që ata përdorin për të arritur këto qëllime. Anomia është kushtëzim, situatë që ndodh atëherë kur forca e vlerave sociale dobësohet dhe kur ajo nuk mundet që të rregullojë mjetet me anë të të cilave njerëzit arrijnë qëllimet e tyre (Po aty).

John Horton jep një përshkrim të qartë të transhedentalizmit të Durkheim-it: Duke u shqetësuar më shumë për natyrën e rregullit sesa atë të ndryshimit në shoqëri, Durkheim-i theksoi rolin e marrëdhënies, njeri-shoqëri, sesi shoqëria i krijon dhe i shtrëngon njerëzit (Horton, J., 1964:13). Përkufizimi i tij i anomisë, i cili lidhet ngushtë me rregullin social dhe moralitetin, presupozon një dallim absolut dhe të përjetshëm ndërmjet njeriut dhe shoqërisë dhe një konception dualist të natyrës njerëzore.

Njeriu i Durkheim-it është homo duplex, pjesërisht egoist, anarkist dhe pjesërisht moral, sepse ai shtrëngohet dhe rregullohet nga shoqëria, e cila është burimi i gjithë logjikës dhe moralitetit” (Horton, 1964: 54). Sociologu që e etiketoi këtë term ishte Emile Durkheim, i cili e formoi këtë kuptim në lidhje me situatën franceze të kohës dhe me sfidat që ajo po kalonte përgjatë periudhës industriale. Sipas tij, kur shoqëria është duke kaluar në ndryshime të shpejta, qëllimet vlerore të individëve perceptohen gabim nga njerëzit. Ajo që njihet si ndërgjegje kolektive fillon të priset dhe njerëzit gjenden të humbur, ata nuk dinë se çfarë bëjnë dhe se çfarë kërkojnë (Durkheim, 1897: 56). Neodurkheimiani dhe profesori amerikan William Alex Pridemore e shtjellon më tej idenë e anomisë së Durkheim-it duke e shtrirë këtë koncept përtej individit dhe brenda shoqërisë, pra tek institucionet. Anomia institucionale krijohet kur institucionet sociale, ekonomike dhe politike nuk janë në unitet me njëra-tjetrën.

Në kushtet e një shtrëngimi social të tillë, njerëzit ndihen të përhumur, të palumtur, të pashpresë (Pridemore, W., 2005: 378). Kriminologët amerikanë Steven Messner

dhe Richard Rosenfeld, në librin e tyre “Krimi dhe ëndrra amerikane”, shkruanin: “...në shoqëritë kapitaliste, për shkak të një kulture kapitaliste ku çdokush dëshiron të përmbushë qëllimet e veta, individi përjeton një tension për të arritur sukses ekonomik. Në këto kushte, institucionet e tjera sociale, si: familja, feja dhe arsimi vihen në funksion të ëndrrës amerikane për sukses ekonomik. Struktura sociale dobësohet dhe ajo mbizotërohet nga struktura ekonomike. Sidomos në vendet ish-komuniste që lëvizin drejt ekonomisë së tregut të lirë, njerëzit adoptojnë ideologjinë kapitaliste, ndryshon e gjithë struktura sociale duke prodhuar një shoqëri në tension ose në anomia. Kjo është anomia institucionale (Messner, S., dhe Rosenfeld, R., 2012: 379).

Pra, për Durkheim-in, anomia i referohet një perceptimi të gabuar, të shtrembëruar të qëllimeve kulturore në shoqëritë industriale, ndërsa për shoqërinë amerikane, anomia i referohet një gjendjeje pamjaftueshmërie, një mospërputhjeje ndërmjet qëllimeve individuale dhe pamjaftueshmërisë së mjeteve për të realizuar qëllimet kulturore të përcaktuata nga shoqëria.

Asnjë qenie e gjallë nuk mund të jetë e gëzuar ose edhe të ekzistojë nëse nevojat nuk i plotësohen ose nuk janë në raport me mjetet e saj. Nëse nevojat janë më të shumta sesa mjetet që ka në dispozicion, ajo do të funksionojë jo në mënyrë të qenësishme e të kënaqshme. Prirjet e kënaqësisë atrofizohen dhe ajo që mbetet është impulsi për të jetuar. Të kafshët, kur ato janë në kushte normale, ky ekuilibër zhvillohet spontanisht, sepse kafshët varen kryesisht nga nevojat fiziologjike. Me njerëzit nuk ndodh e njëjta gjë, sepse nevojat e tyre nuk lidhen thjesht me organizmin e tyre, natyra humane kërkon që kënaqësitë e veta përtej instikteve njerëzore, orekseve dhe lakmive të tilla, herët ose vonë, të kenë një limit. Në asnjë shoqëri ato nevoja nuk plotësohen njësoj të të gjithë anëtarët e saj, por natyra njerëzore në thelb është e njëjtë të të gjithë

njerëzit, përse u përket cilësive themelore. Duhet të kuptojmë se, nga njëra anë, kemi impulset biologjike të njeriut që kërkojnë shpërthimin dhe shprehjen e tyre dhe, nga ana tjetër, kemi rregullin social, i cili shërben si aparat për menaxhimin e impulseve, si rregullator për tensionet njerëzore. Në këtë situatë, individi përjeton një lloj gjendjeje të paplotësuar, të tjetërsuar, të humbur, të cilën Durkheim-i e etiketoi me termin “anomi” (Durkheim, E., 1897:31).

Vitet e fundit shikohet një interes i sociologëve dhe kriminologëve amerikanë për të ndërtuar teoritë dhe këndvështrimet e tyre mbi anominë, duke e parë atë si një nga konceptet kyçe për shpjegimin e krimit dhe të sjelljes deviante. Një grup autorësh të njohur, si p.sh: Richard Rosenfeld, Steven Messner, Albert Cohen, etj, i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë këtij këndvështrimi sociologjik.

Një nga ato qasje, e cila e çoi më tej teorinë anomike, ishte edhe teoria e anomisë institucionale. Kjo teori ofron një këndvështrim makrosociologjik, duke mos u përqendruar vetëm tek individi, por te një rrjet i gjerë i rolit të institucioneve në shoqëri. Një nga pionierët e kësaj teorie është padyshim sociologu amerikan Robert King Merton. Merton shpjegon se shfaqja e anomisë lidhet me gjendjen e institucioneve në shoqërinë bashkëkohore. Duke u përqendruar jo te revolucioni francez, i cili kishte shkaktuar anominë e shoqërisë franceze, por te ndryshimet që sillnin ndryshimet moderne të shoqërive liberale, Merton mendonte se gjeneratori i anomisë është te globalizmi, tek ekonomia e tregut, te politikat neoliberalë sociale, te zvenitja e shtetit të mirëqenies sociale. Të gjithë këta faktorë janë promotorë të ndryshimit social dhe, rrjedhimisht, të sjelljes deviante, e cila lind nga anomia e institucioneve sociale.

Dy dhjetëvjeçarët e fundit ndryshimet e shumta ekonomike, politike dhe sociale shpjegohen nëpërmjet teorisë anomike

institucionale duke treguar se jo vetëm shqiptarët janë duke jetuar në anomi, por edhe institucionet, në vazhdim do të mundohen të hedhin dritë mbi tezën e mësipërme edhe për faktin se teoria e mësipërme ka frymëzuar kërkimet empirike të kohëve të fundit.

Teoria e anomisë institucionale nuk është gjë tjetër veçse një pjesë integrale e traditës klasike të teorisë së anomisë, e cila shpjegon korrelacionin ndërmjet niveleve të krimit, dinamikave strukturore dhe atyre kulturore (Messner & Rossenfeld, 1997: 97). Duke qenë se kjo teori bazohet më shumë në barazpeshën e institucioneve sociale, siç është ekonomia e shoqërisë, familja ose shteti, ajo ndihmon që të kuptohet se në të gjitha shoqëritë integrimi i brendshëm i këtyre institucioneve është gjithmonë problematik. Kjo ndodh pasi rolet sociale të këtyre institucioneve konkurojnë dhe kundërshtojnë njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera kërkohet një barazpeshë institucionale e pushtetit. Dhe kur kjo barazpeshë institucionale e pushtetit zotërohet nga ekonomia, atëherë qëllimet ekonomike kanë një përparësi më të madhe ndaj atyre joekonomike, siç mund të jenë lidhjet familjare ose elemente të tjera vlerore.

Pavarësisht se cili është roli i impulseve njerëzore te njeriu, pyetja që shtrohet është: si ka mundësi që deviancat kanë forma dhe mënyra të ndryshme në strukturat e ndryshme sociale? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, Robert Merton shkroi një nga esetë e tij më të njohura: "Struktura sociale dhe anomia", e cila nuk është gjë tjetër veçse një manifest i anomisë së institucioneve sociale.

Në këtë ese Merton shkruante se anomia është karakteristikë unike dhe e pandashme e shoqërive të hapura dhe shoqërive demokratike. Kur shoqëria është më e mbyllur, atëherë anomia është më pak ose aspak e ndjeshme pasi njerëzit, edhe pse u përkasin stutuseve të ndryshme në shtresëzimin social, e njohin vendin e tyre

në këtë strukturë sociale. Në një shoqëri demokratike njerëzit mund të lëvizin më lehtë përgjatë mobilitetit vertikal dhe atij horizontal pra, një sistem politik demokratik ose liberal ka më shumë gjasa që të risë anominë (Merton, R., 1938:672, 682). Me përhapjen e sistemeve demokratike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, duket sikur anomia është rritur më shumë në shoqëritë perëndimore (Cao, L., 2004:87). Në teorinë e Merton-it vlerat sociale përcaktohen qartë në një shoqëri të barabartë. Anomia shkaktohet nga një mungesë barazpeshë ndërmjet qëllimeve dhe dëshirave njerëzore dhe mjeteve për të përmbushur këto qëllime. Nëse për Durkheim-in mungojnë normat që rregullojnë qëllimet e individëve, për Merton-in mungojnë normat, me anë të të cilave njerëzit arrijnë qëllimet e tyre. Kjo natyrisht e ka një shpjegim, sepse kushtet historiko-sociale të Europës ishin të ndryshme nga ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Hipoteza e Merton-it mbi anominë sociale ngrihet mbi dy koncepte kryesore, mbi marrëdhënien ndërmjet qëllimeve kulturore dhe normave institucionale. Qëllimet kulturore konsistojnë në qëllime dhe interesa të përcaktuara që perceptohen si objektiva legjitime nga të gjithë. Ato janë pak a shumë të integruara dhe shkalla e integritit është një fakt empirik që nuk lidhet me ndonjë hierarki vlerash, por që "ia vlen të luftosh" për to. Ato janë qëllime bazë të njerëzve dhe, ashtu siç e përshkruan edhe Linton, këto qëllime kulturore lidhen me nevojat biologjike të njerëzve dhe nuk përcaktohen nga vetë ata.

Normat institucionale, nga ana tjetër, nuk përcaktojnë mënyrat se si arrihen qëllimet kulturore. Çdo grup social në mënyrë të pashmangshme lidh qëllimet kulturore me rregullat, të cilat janë të rrënjësura në institucionet apo në normat kulturore të një sistemi social të caktuar. Pra, normat institucionale dhe qëllimet kulturore bashkëveprojnë ngushtë me njëri-tjetrin

(Merton, R., 1983:671). Kur një shoqëri është e qëndrueshme, konformizmi kundrejt qëllimeve kulturore dhe institucionale do të thotë që shoqëria arrin të ruajë ekuilibrin e saj. Merton tregon se përse ndodh anomia institucionale. Njerëzit përshtaten ose keqpërshtaten në këtë sistem, por kur ata kundërshtojnë edhe qëllimet, edhe mjetet, ata janë në një shoqëri së cilës nuk i përkasin. Duke mos ndarë të njëjtat vlera me pjesën dërmuese të shoqërisë, ata bëhen një pjesë e paqenësishme e saj. Në këtë grup hyjnë: psikopatët, vagabondët, pijanecët dhe narkomanët. Ata kanë braktisur qëllimet kulturore dhe sjellja e tyre nuk përshtatet me normat institucionale. Ekziston një konflikt i brendshëm te këta individë, i cili zgjidhet duke braktisur si mjetet, ashtu edhe qëllimet. Devianti që është rebel, ka lidhje të dobëta me grupin social të cilit i përket, por ai është tip depresiv, i rebeluar dhe shkatërrues për shoqërinë. Për ta përmbyllur, anomia shfaqet sipas Merton-it atëherë kur ka shkëputje ndërmjet qëllimeve kulturore dhe mundësive sociale, pra midis qëllimeve dhe normave. Merton ka bërë një dallim të qartë ndërmjet anomisë individuale dhe anomisë sociale, e para e quajtur “anomia” dhe e dyta “anomie”. Anomia i referohet një gjendjeje kur normat e humbin vlefshmërinë e tyre, që do të thotë se ka një mënyrë të paqartë, se cila është rruga për të vepruar në një situatë sociale. Ajo që duhet të kuptohet me termin “anomie” është se ka përmbajtje sociologjike. Anomia i referohet një sistemi social dhe jo një gjendjeje të mendjes njerëzore. Ajo i referohet një krijese, një çarjeje të standardeve sociale, standarde të cilat udhëheqin sjelljen njerëzore dhe ndikojnë në kohezionin social (Cohen, 1999: 39).

Kur struktura sociale përjeton një nivel të lartë anomie, atëherë rregullat që orientojnë sjelljen njerëzore e kanë humbur forcën e tyre. Ato nuk formojnë një rregull social, të cilët individët mund t'i besojnë në mënyrë të sigurt, sepse nuk

ka një këndvështrim të përbashkët mbi sistemin social se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon, çfarë është legjitime dhe çfarë është ilegjitime, çfarë është e lejuar dhe çfarë është e ndaluar. Le të themi se kemi anomi kur burrat ose gratë hezitojnë të frekuentojnë parqet nga frika se mos ata sulmohen në park, në vend që të qetësohen. Me fjalë të tjera, shkalla e anomisë në një sistem social tregohet nga masa në të cilën ka mungesë të konsensusit mbi normat e vlerësuara si legjitime, nëse normat nuk kanë të njëjtin kuptim për të gjithë, atëherë askush nuk e di se çfarë të presë nga tjetri.

Pra, anomia është humbje e legjitimitetit të normave, gjendje e mungesës së lumturisë. Në një gjendje të tillë individ i ndihet i humbur. Kjo mund të shkaktohet nga varfëria ose nga patologji të tjera të personalitetit ose të realitetit social. Shpesh anomia është konsideruar si gjendje e mungesës së normave, pra situatë pa norma (Johnson, M., dhe Ferraro, K., 2000:196). Në këtë prizëm mund të dallojmë tri lloj situatash lidhur me normat: norma shumë të dobëta, kur individ i nuk gjen pikë lidhjeje me normat konfliktuese, kur ato janë të forta, por në konflikt me njëra-tjetrën dhe norma të panjohura ku sjellja në kundërshtim me këto norma vjen si pasojë e mungesës së njohurive rreth tyre.

### **Vrasjet për nder dhe krimet për pasion - analizë ndërkulturore historike**

Kur flasim për vrasjet në çift, është e pamundur të anashkalojmë tipologjinë e këtyre vrasjeve, sidomos vrasjeve për nder dhe vrasjet për pasion që kryhen në marrëdhëniet intime apo ato bashkëshortore. Gjatë 30 viteve të fundit janë bërë përpjekje të shumta nga sociologë, kriminologë dhe psikologë socialë si: Nancy Baker, Peter Gregware, Margery Cassidy, Martin Daly, Margo Wilson, William Pridemore, Joshua Freilich dhe Richard Cohen për të shpjeguar krimin brenda

familjes, krimin për pasion, viktimizimin e grave për shkak të xhelozisë seksuale mashkullore, rëndësinë e sjelljes së femrave në të ashtuquajturat “kultura nderi” si edhe korrelacionet e mëdha në vrasjet e grave dhe viktimizimin gjinor. Krimet për pasion ose krimet për çështje nderi, janë të përhapura pothuajse në të gjitha shoqëritë, megjithëse ato ndryshojnë nga një kulturë në tjetrën.

Vrasja ose krimi në familje nuk është çështje e re në sociologjinë e devijances dhe në kriminologji. Studime të shumta tregojnë për një korrelacion ndërmjet krimin në përgjithësi dhe anomisë (Agnew, R., dhe Broidy, L., 2008:276; Bernburg, Jon G., dhe Rose, G., 2002: 732). Në literaturën e huaj sociologjike dhe kriminologjike ekziston njëllojshmëri e gjerë punimesh dhe qasjesh sociologjike që pohojnë korrelacionin ndërmjet krimin dhe kushteve socio-ekonomike (Stack, S., 1983: 340; Williams, K., 1984: 283; Lee, M., 2000: 191).

Studime të tjera në lidhje me krimin në familje, përqendrohen në marrëdhëniet ndërmjet krimeve dhe përkatësisë gjinore (Di Cristina, B., 2006:214). Ka disa autorë, të cilët e vënë theksin në aspektin kulturor duke theksuar se faktorët kulturorë janë ata që nxisin konfliktin social dhe krimin në familje (Margery A., 1999: 168; Wilson, M., Daly, 1982: 372).

Kur flasim për lidhjen që ka vrasja ose krimi me varfërinë, ka autorë që mendojnë se krimi nxitet më tepër nga pabarazia ekonomike, sesa nga varfëria. Në studimin e kryer me popullsinë latine në Amerikë, Ramiro Martinez shkruante: “ndarja e pabarabartë e burimeve ekonomike inkurajon nivele të larta të krimin dhe vrasjes.

Në literaturën sociologjike dhe në kriminologji, janë të njohura edhe mendimet e disa studiuesve që besojnë se krimi në familje ka një korrelacion të fortë me përkatësinë gjinore dhe në shumicën e rasteve viktimat janë gratë. Xhelozia mashkullore, kodi i nderit, tradhëtia

bashkëshortore, sindroma e nderit dhe e turpfit, përdhunimi etj, janë disa nga konceptet kryesore që shpesh bëhen shkak kryesor për vrasjet në çift. Vrasjet për çështje nderi nuk janë të panjohura për realitetin shqiptar. Jo pak raste të vrasjeve të dhëna në shtypin e përditshëm si edhe në deklaratimet e policisë së shtetit, thuhet se janë kryer për shkak të xhelozisë. Në disa intervistime të kryera në burgjet shqiptare me të dënuar që kanë kryer vrasje në çift, të dënuarit e pranonin se e kishin vrarë gruan e tyre pasi ishin ndier të tradhëtuar ose, sepse ata vetë besonin se gruaja e tyre i kishte tradhëtuar. Xhelozia, vazhdon të mbetet një nga shkaqet kryesore të vrasjes në çift. Të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit, dëshmojnë se numri i vrasjeve për xhelozinë në marrëdhëniet në çift nga viti 2009 deri në vitin 2016, shkon në 26 raste.

### **Rrënjët historike të vrasjes për çështje nderi**

Besimi se bashkëshorti kishte të drejtë të vriste gruan bashkë me të dashurin e saj, shkon më tej sesa koha romake. Këtë të drejtë e gjejmë në ligjin e Hammurab-it (1792-1790 p.e.s.), ku besimi se virgjëria e një gruaje i përkiste vetëm bashkëshortit të saj, është i qartë.

Shumë vite më parë, oratori romak Marcus Porcius Cato, 234-149 para erës së re shkruante: “Nëse e kap në flagrancë gruan tënde me dikë tjetër, ti mund ta vrasësh atë, ndërsa ajo nuk mund të guxojë të drejtojë as gishtin, nëse ti kapesh në flagrancë me dikë tjetër duke shkelur kurorën, sepse kështu e thotë ligji” (Shih: Goldstein, M. A., 2002:29). Kjo deklaratë që lidhej me statusin e grave në shoqërinë romake ka qenë e mirëpranuar për shumë kohë nga opinionin publik i burrave. Babai kishte të drejtën e jetës dhe të vdekjes mbi vajzën e tij dhe, kur vajza martohej, e drejta e jetës dhe e vdekjes kalonte tek i shoqi.

Tradhëtia e femrave konsiderohej shkelje dhe ligji romak persekutonte anëtarët e familjes që nuk kishin kontroll mbi familjarët e tyre të gjinisë femërore.

Norma deri diku të ngjashme me këto që përmendëm më lart, i gjejmë edhe te disa kultura apo fise indigjene të hershme amerikane, të cilat u larguan nga Euroazia shumë kohë para se të fillonte epoka babilonase, hititase, asiriane dhe ajo romake (Goldstein, M. A., 2002: 29-30). Në Peru, nga vitet 1200 para lindjes së Krishtit deri në vitet 1532 të pas lindjes së Krishtit, nëse një grua kapej në tradhëti bashkëshortore, inkasit i dënonin të dy “dashnorët” duke i lidhur këmbë e duar në një mur dhe duke i lënë aty derisa të vdisnin nga uria ose nga dhimbja (McLennen, R., 2001: 89). Ligjet e inkasve u jepnin të drejtë bashkëshortëve të mbroheshin nëse ata vrisnin gratë e tyre për tradhëti bashkëshortore, por, nga ana tjetër, gratë varehin nga këmbët derisa t’u dilte shpirti nëse ato vrisnin bashkëshortët e tyre për të njëjtën arsye (Moore, S., 1958: 78).

Nga viti 150 para erës sonë dhe deri në vitet 1521 të erës sonë në Lëndinën e Meksikos, ligjet azteke dënonin me vdekje pothuajse çdo lloj krimi. Dënimet me vdekje për tradhëti bashkëshortore kryheshin duke e mbytur ose duke e vrarë me gurë gruan që tradhëtonte bashkëshortin e saj. Ndërkohë që as ligjet azteke dhe as ato romake nuk sanksionin ligje për burrat, në rast se ata kryenin tradhëti bashkëshortore. Një burrë që kapte në flagrancë gruan e tij nuk mund ta vriste atë, por ai duhet të priste vendimin e gjyqit më parë që në atë kohë bëhej nga paria e fisit ose e fshatit. Nëse ai kryente vetëgjyqësi dhe vriste gruan e tij për tradhëti bashkëshortore, atëherë edhe ai duhej të vritej bashkë me viktimën (Soustelle, J., 1962: 185).

Vrasja me gurë, ose copëtimi me gurë i kokës dhe trupit të viktimës, përdoret edhe sot e kësaj dite në disa nënkultura të Lindjes së Mesme. Krimet për pasion, ose krimet për çështje nderi, janë të përhapura pothuajse

në të gjitha shoqëritë, megjithëse ato ndryshojnë nga një kulturë në tjetrën. Edhe mënyrat sesi ato trajtohen ose mbrohen nga ligji janë të ndryshme. Në fakt termi “krim për pasion” (crime passionnel, vjen nga frëngjishtja-MR) i referohet një veprimi ku dhunuesi kryen një krim (vrasje, përdhunim, goditje, etj) për shkak të një impulsi të fortë e të menjëhershëm dhe jo të një skenari të paramenduar. Një rast tipik i një krimi për pasion mund të jetë rasti i një bashkëshorti, i cili zbulon se gruaja e tij e ka tradhëtuar dhe ai vendos që të vrasë gruan, në disa raste edhe veten ose fëmijët. Vrasjet për çështje nderi ndodhin më shumë në ato shoqëri, ku kodi i nderit është shumë i fortë dhe ku ai shërben si rregullator social jo vetëm në raportet burrë-grua, por edhe në aspekte të tjera sociale të një shoqërie. Vrasjet për çështje nderi nuk janë thjesht dukuri e kulturës islame ose e vendeve myslimane, por ato kanë qenë gjithashtu dukuri e kulturave të tjera në të gjitha kohërat. Kështu, në fiset gjermanike të Europës Perëndimore, në kulturat kineze, në kulturën japoneze dhe atë aziatike, ka qenë e sanksionuar me ligj vrasja e grave kurorëshkelëse (Daly, M., dhe Wilson, M., 1991: 97).

Pra, vrasjet për pasion, ndodhin në të gjitha kulturat, në kulturat baritore apo pasmoderne, në shoqëri të zhvilluara ose shoqëri në zhvillim. Ka shumë raste të dokumentuara, ku meshkujt kanë vrarë gratë, motrat ose kushërirat e tyre pasi kanë dyshuar se ato kanë pasur lidhje të fshehta gjatë martesës me një mashkull tjetër, ose marrëdhënie seksuale paramartesore. Në disa raste edhe viktimat e përdhunimit mund të bëhen viktimat të “nderit” (Goldstein, M., 2002: 39).

### **Vrasjet për çështje nderi në shoqërinë shqiptare**

Vrasjet për çështje nderi nuk janë ngjarje të reja në shoqërinë shqiptare. Madje, vlen të theksohet se vrasjet për nder,

shpeshherë kanë tërhequr edhe vëmendjen e studiuesve të huaj. Jana Arsovska dhe Mark Craig në një studim në vitin 2005, analizojnë kulturën tradicionale shqiptare si edhe konceptualizimin e dhunës në një shoqëri me bazë etnike.

Krahasimi bëhet edhe më i plotë kur ata e krahasojnë çështjen e nderit dhe të normave kulturore tradicionale të shoqërisë shqiptare me kodin e triadave kineze dhe të drejtën zakonore kineze. Triada kineze ka kuptimin e trekëndëshit kryesor qiellit-tokës-njeriut, tri shtyllat kryesore të kozmosit sipas mitologjisë kineze. Triadat janë grupe kriminale dhe aktiviteti i tyre është shitblerja e drogës, organizimi i bixhozit, organizimi i prostitucionit dhe shantazhe të ndryshme, përfshirë tregtinë me armë, me femra dhe organizimin e trafikut ilegal të emigrantëve (Kim, Sang. W., dhe Pridemore, W., 2005:122). Ja si shprehen ata në një pjesë të këtij punimi: “Studiuesit e Europës Perëndimore kanë një perceptim se në Shqipëri dhe në Kinë, dhuna është e përhapur në të gjitha nivelet e shoqërisë, për shkak të qeverisjes së varfër. Dështimet e qeverisjes për të themeluar ligjin për trafikimin e qenieve njerëzore, vrasjet për gjakmarrje, për dhunimin e të drejtave të grave e të fëmijëve, janë vetëm disa anë që tregojnë shpirtin e luftës së shqiptarëve, të cilin ata e mbrojnë me krenari, sepse thonë se është pikërisht kjo frymë dhe karakteri i tyre kombëtar që i kanë ruajtur gjatë shekujve. Gjatë qindra viteve që ata janë udhëhequr nga pushtues brutalë, për të mbijetuar iu deshtë krijonin këtë mekanizëm mbrojtës, i cili mbetet edhe sot e kësaj dite pjesë e mentalitetit të tyre” (Arsovska, J., dhe Craig, M., 2005: 217).

Një nga parimet kryesore në Kanunin e Lekë Dukagjinit, është edhe kodi i nderit, prandaj në këtë kanun i kushtohet një vëmendje të veçantë grave dhe sjelljes së tyre në në kulturën shqiptare. Shoqëria shqiptare ka një histori të gjatë patriarkale, në të cilën gratë duhet t’u binden bashkëshortëve të tyre

dhe të pranojnë rolet e tyre të nënshtruara (Arsovska, J., & Craig, M. 2005:227). Ajo që bie në sy edhe në studimet e të huajve, për normat kulturore të shoqërisë tradicionale shqiptare dhe kryesisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit, është koncepti i nderit, i cili vlerësohet shumë në shoqërinë shqiptare.

Shoqëria shqiptare është një shoqëri me elementë tradicionalë. Kodi i nderit është një ndër kodet me thelbësore të këtij sistemi vleror, prandaj, shpeshherë nderi vishet me një aureolë të shenjtë. Përgjithësisht, nderi konceptohet si parimi më thelbësor dhe në jetë. Në shumicën e rasteve të të intervistuarve, burrat që kishin vlarë gratë e tyre, pohonin se e kishin kryer vrasjen për çështje nderi, se nderi është më i rëndësishëm se gjithçka tjetër. Madje në raste të tilla kur ata e kishin vlarë gruan e tyre për çështje nderi, nuk shprehnin asnjë pendesë për veprimin e kryer.

Koncepti i nderit është bërë objekt studimi edhe nga studiues të huaj, amerikanë por jo vetëm. Ja si shprehen një grup psikologësh socialë amerikanë lidhur me nderin dhe kulturat shoqërore: “Nderi është një atribut i burrave të lirë e të pavarur, jo i grave, jo i skllëvërve, as i shërbëtorëve ose burrave të vegjël, i cili arrihet me lavdi dhe dukepërlulur tjetrin/tjetren, atë ç’ka humb njëri, e fiton tjetri. Ai nuk lind dhe nuk zhvillohet në boshllëk, por në sisteme të caktuara kulturore, të njohura si kultura nderi (Cohen, D., Nisbett, R., Boudle, Brian F., & Schwartz, N., 1996: 946).

Në tipologjinë e kriminimit në familje, vitet e fundit janë vënë re një sërë vrasjesh që kanë ndodhur ndërmjet bashkëshortësh ose te persona që kanë patur marrëdhënie intime me njëri-tjetrin. Raste të tilla, si nga shtypi i shkruar shqiptar, ashtu edhe nga Drejtoria e Policisë së Shtetit shqiptar, janë emërtuar si vrasje për pasion. Shumica prej këtyre vrasjeve, përfshin individë që janë në marrëdhënie jashtëmartesore me partnerin a partneren e tyre. Një marrëdhënie intime, një tradhëti bashkëshortore, një histori



dashurie mes dy njerëzve me diferencë të madhe moshe, një raport i fshehtë disavjeçar i kushtëzuar nga disa faktorë, të gjitha këto mund të jenë tipare dhe premisa që përfundon me vrasjen e njërit prej partnerëve apo dashnorëve. Këto vrasje njihen si vrasje për pasion prandaj i kemi trajtuar te kategoria e krimit në familje, për shkak se këto vrasje mund të kryhen në çift, në njerëz që kanë marrëdhënie intime me njëri-tjetrin.

### Vrasjet për xhelozia te shqiptarët

Xhelozia mashkullore duket se është një aspekt i kudondodhur i psikologjisë mashkullore. Psikologë socialë dhe sociologë të sociobiologjisë kanë folur shumë për xhelozinë, sidomos pas vitit 1980. Ndër këta autorë mund të përmendim psikiatrin amerikan me origjinë polake, Edward Podolsky i cili ka shkruar me dhjetëra libra dhe artikuj mbi çrregullimet psikiatrike, psikologët dhe bashkëshortët kanadezë Martin Daly dhe Margo Wilson (1992), si dhe psikologët socialë Mathew Goldstein (2002), Christine Harris (2003) e të tjerë. Duke iu referuar studimit të kryer nga Daly dhe Wilson, xhelozia mashkullore ishte një nga shkaqet kryesore të vrasjeve dhe konflikteve sociale në Detroit në vitet 1970.

Xhelozia seksuale, ishte motivi kryesor i vrasjeve në Detroit, në vitin 1974. Harold Rose and Paula McClain studiuuan profilet e 690 vrasjeve, nisur nga seksi, nga statusi i tyre dhe nga marrëdhënia viktimë-agresor dhe vuri re se 360 prej vrasjeve të kryera, u përkisnin atyre të kryera nga konflikti i xhelozisë. Shumica e arsyeve lidhej me tradhëtinë bashkëshortore ose rivalitetin seksual (Rose, H., dhe McClain, P., 1974:122) Për këtë arsye shumë prej kriminologëve i monitoronin këto raste si trekëndëshi i dashurisë. Edhe kriminologët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitet 1970-1980, kanë pohuar se xhelozia seksuale është një nga shkaqet kryesore të vrasjeve, kryesisht ato të raportit burrë-grua.

Kështu, kriminologu i njohur amerikan, njëkohësisht edhe profesor i universitetit të Filadelfias Marvin Wolfgang, studioi të dhënat e marra nga policia lidhur me 588 vrasje të kryera në Filadelfia përgjatë viteve 1950-1975. Wolfgang renditi 11 motive kryesore të këtyre vrasjeve. Xhelozia renditej si motivi i tretë (Wolfgang, M., 1982: 145).

Në shoqërinë shqiptare po përjetohet aktualisht kjo fazë e zhvillimit shoqëror të lidhur me zhvillimin e kriminalitetit, sidomos krimit në familje. Nëse bëjmë një studim ndërkulturor të vrasjeve, vëmë re se xhelozia është një faktor që haset dendur.

### Analizë empirike dhe krahasuese mbi krimit në familje për periudhën 2005-2015

Kur flasim për krimet në familje duhet të kemi parasysh se nuk i referohemi vetëm veprave të tilla penale si: vrasja, plagosja e rëndë me dashje, shtyrja në vetëvrasje ose shtyrja në prostitucion. Edhe dhuna është një lloj krimi, dhuna e bashkëshortëve kundrejt bashkëshorteve të tyre, dhuna e prindërve ushtruar kundrejt fëmijëve të tyre, dhuna e gruas ndaj burrit të saj, dhuna e fëmijëve ushtruar ndaj prindërve të tyre, dhuna e vëllait ndaj motrës/motrave, e vjehrrës ndaj nuses, etj.

Në këtë pjesë të këtij punimi, është bërë një përmbledhje mbi vrasjet e ndodhura në një periudhë dhjetëvjeçare, 2005 -2015. Periudha, në mënyrë analitike është ndarë në vite dhe është bërë edhe krahasimi, ku në mënyrë të detajuar janë renditur e krahasuar treguesit lidhur me vrasjet e ndodhura dhe motivet e kryerjes së vrasjeve, mjetet e kryerjes së krimit dhe vendin ku kanë ndodhur vrasjet (fshat-qytet) dhe vrasjet sipas qarqeve. Po ashtu, janë paraqitur në mënyrë grafike dhe empirike dhe numri i vrasjeve në çift, numri i grave të viktimizuara, krahasimi i viktimave në aspektin gjinor dhe grup-moshat e viktimave të vrasjeve në tërësi dhe vrasjeve në çift në

veçanti. Të gjitha të dhënat empirike dhe tabelat e mëposhtme janë marrë nga sektori i statistikës dhe i kriminalitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.


### Motivet e vrasjeve të ndodhura sipas viteve 2006-2010

Për të kuptuar motivet e vrasjeve në familje, është e rëndësishme që t'i referohemi numrit total të këtyre vrasjeve të ndodhura në Republikën e Shqipërisë. Lidhur me motivet e vrasjeve në familje për periudhën që kemi si objekt studimi nga 491 vrasje të ndodhura në total, rezultojnë se:


- 16 vrasje kanë ndodhur nga pakujdesia, ose 3.2%
- 252 vrasje kanë ndodhur për motive të dobëta, ose 51.3 %
- 14 vrasje kanë ndodhur për motive xhelozie, ose 2.8 %
- 84 vrasje kanë ndodhur për konflikte të ndryshme brenda familjes, ose 17.1 %
- 25 vrasje janë kryer me motiv hakmarrjen, ose 5 %
- 14 vrasje janë kryer duke pasur si motiv gjakmarrjen, ose 2.8 %
- 32 vrasje kanë ndodhur për motive pronësie, ose 6.5 %
- për 54 vrasje nuk dihet motivi (të pazbuluara), ose 10.9 %

Nëse krahasojmë numrin e vrasjeve në familje, për vitet 2006, 2007 dhe 2008 do të vëmë re se ky numër ka ardhur duke u ulur,

**Grafiku 1:** *Kurba e krimit në familje në vitet 2006-2010*



**Grafiku 2:** *Raporti gjinor autorëve të krimeve*



respektivisht nga 23 raste ne 2006, në 18 raste në vitin 2007 dhe 12 vrasje në familje në vitin 2008. Për vitin 2009, numri vrasjeve në familje ishte 11 raste, dhe në vitin 2010 ky numër do të dyfishohet, pra 20 raste të vrasjeve në familje.


Pyetja që shtrojnë shpesh studiuesit, sociologët, kriminologët, është se përse gratë janë më të viktimizuara se burrat? Përse gruaja shqiptare përbën objektin e krimit brenda familjes? Për këtë mund të ngrejmë disa hipoteza. Kështu mund të themi se jetojmë në një shoqëri ku integrimi gjinor është akoma i dobët dhe i zbehtë. Jetojmë në një shoqëri që e toleron dhunën ndaj grave dhe në disa familje kjo dhunë “legjitimohet” ose shikohet si çështje private, familjare. Në përgjithësi, gratë e keqtrajtuara nuk dëshirojnë të flasin për dhunën në familje, për problemet familjare sepse besojnë se dhuna apo forma të tjera të errëta të jetës familjare janë çështje private, dhe si e tillë dhuna duhet të mbahet brenda mureve të shtëpisë. Gjithashtu, ka të dhëna se gratë jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por edhe në vendet me të zhvilluara, janë në shumicën e rasteve viktimat të krimit në familje.

Është e qartë se përgjatë viteve 2008-2015, në shumicën e rasteve, viktimat e krimit në familje, janë gratë.

### Vendi ku kanë ndodhur vrasjet, qytet ose fshat sipas viteve 2006 – 2010

Lidhur me vendin ku ka ndodhur krimi i vrasjes, duke i ndarë në qytet dhe fshat

**Grafiku 3: Raporti i vrasjeve burrë-grua.**




për periudhën që kemi si objekt studimi, rezulton se nga 491 vrasje të ndodhura, 199 prej tyre kanë ndodhur në qytet dhe 292 kanë ndodhur në fshat. Më poshtë, në mënyrë më të detajuar po rendisim vendet e ndodhjes së krimit ( qytet -fshat ) të ndodhura në vite.


**Vrasjet në familje dhe vrasjet në çift, në vitet 2005 – 2015**

Gjatë periudhës 10-vjeçare (2005-2015), numri total i vrasjeve të raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ishte 797 raste. Kurba e vrasjeve 10 vitet e fundit tregon se krimet e vrasjeve kanë pësuar një rënie vitet e fundit, ka një rënie, e cila ka filluar në vitin 2012 dhe ka vazhduar deri në vitin 2015. Rënie ka pasur edhe nga viti 2005 në 2006, 2007 deri në 2009, ndërsa në periudhat e tjera vihet re

**Grafiku 4: Shpërndarja e krimeve sipas vendit, fshat/qytet.**




**Grafiku 5: Vrasjet në familje, sipas vendit ku kanë ndodhur**




një prirje rritëse e numrit të vrasjeve. Ajo që ne na intereson, është të shohim vrasjet në familje dhe vrasjet në çift, në raport me numrin total të vrasjeve të ndodhura në vendin tonë. Ja si paraqitet në mënyrë grafike situata e krimeve:

Grafiku 6, na jep një ide të qartë të kurbës së vrasjeve në familje në raport me vrasjet në total. Nga numri total i vrasjeve

**Grafiku 6: Kurba e vrasjeve totale dhe vrasjet në familje**



**Grafiku 7:** Përqindja e vrasjeve në familje, per vitet 2005-2015




(n=797), 179 janë vrasje në familje. Grafiku 7 tregon numrin në përqindje të vrasjeve brenda familjes, nga viti 2008 deri në vitin 2015.

Vlen të theksohet fakti, se nga përgjatë viteve 2008-2014, kemi luhatje të shkallës së vrasjeve në familje, duke shënuar rënie dhe ngritje të lehta nga një vit në tjetrin. Kurba e mëposhtme tregon sesi ka ndryshuar numri i vrasjeve në familje dhe vrasjeve në çift nga viti 2008 deri në vitin 2015. Shihet se, nga viti 2008 deri në vitin 2011 ka pasur një shtim të vrasjeve në familje, ndërsa pas vitit 2011 ka pasur një prirje rënëse. E njëjta prirje vihet re edhe për vrasjet në çift. Ka një përputhshmëri të lartë mes vrasjeve në familje dhe vrasjeve në çift. Krimi në familje “godet” femrën. Kjo duket qartë në grafikun e mëposhtëm, i cili paraqet raportet viktime bashkëshortja


- viktime bashkëshorti, në vrasjet në familje. Shihet se ka një dominancë të thellë të numrit të bashkëshorteve të vrara, krahasuar me bashkëshortët, në të gjitha vitet. Përqindjet janë përfutur nga raporti mes numrit të individëve të vrarë, në secilën kategori (bashkëshort ose bashkëshorte) me numrin e vrasjeve në familje.

Ajo që vihet re në këtë grafik është se vrasjet në çift përbëjnë numrin më të madh të vrasjeve në familje ose me fjalë të tjera, aty ku ka rritje të vrasjeve në çift, ka edhe rritje të numrit të krimeve në familje. Pra, raporti burrë-grua është raporti familjar që përjeton më shumë dhunë, më shumë devijancë, për pasojë dhe më shumë vrasje dhe krime. Shpesh krime të tilla degjenerojnë në vrasje të shumëfishta, ku viktimat janë më shumë se dy. Këto vrasje në sociologjinë e devijancës njihen me emrin familicide.

**Grafiku 8:** Vrasjet në total, vrasjet në familje dhe vrasjet në çift



**Grafiku 9: Viktimat e vrasjeve në çift.**



Grafiku 9 paraqet numrin e femrave dhe bashkëshorteve të vrara. Shihet një përputhje e lartë mes tyre, çka do të thotë se shumica e femrave të vrara në familje kanë statusin e bashkëshortes së autorit. Në këtë grafik duket qartë se viktimat e vrasjeve në familje dhe vrasjeve në çift, në shumicën e rasteve janë gratë ose femrat (edhe bashkëjetueset).


Ndërsa kurba paraqet në mënyrë të përmbledhur situatën sesi kanë ndryshuar krimet e vrasjeve: vrasjet totale, vrasjet në familje, vrasjet e femrave, nëse viktimat është bashkëshort apo bashkëshorte me autorin/autoren. Të gjitha kurbat tregojnë një prirje rënëse duke filluar nga viti 2011, përveç kurbës së vrasjeve të femrave, e cila shënon luhajtje nga një vit në tjetrin.

Krimet brenda familjes, siç janë: vrasja, plagosja me dashje, kanosja, shtyrja në vetëvrasje, krime kundër jetës, krime

seksuale dhe krime të tjera të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, janë shqetësime të vazhdueshme sidomos në periudhën e tranzicionit pas shpërbërjes së sistemit totalitar. Krimi brenda familjes është një plagë sociale, një dukuri e cila mbetet në shifra të larta. Kriminologë të ndryshëm, psikologë socialë, sociologë dhe studiues të disiplinave të përafërta, janë përpjekur të paraqesin teoritë e tyre që shpjegojnë dhe shtjellojnë rrënjët e krimit dhe natyrën e tij. Për më tepër edhe shkaqet e krimit, studiuesit i shohin ose te vetë individi ose te shoqëria që brumos dhe influencën në mënyrë të pareshtur individin, te mënyra e jetesës së njeriut, te gjendja psiko-sociale e tij, te realiteti social të cilit ai i përket, etj.

Në këtë punim kemi paraqitur të dhëna dhe shpjegime të ndryshme që lidhen me natyrën e krimit, me konceptin e anomisë

**Grafiku 10: Viktimat e vrasjeve në familje dhe vrasjeve në çift.**



me tipologjinë dhe faktorët që e shtyjnë dikë të kryejë një vepër penale brenda familjes. Ky është edhe kontributi i këtij studimi, të paraqesë një tablo të plotë të vrasjeve në familje, kryesisht të vrasjeve në çift, si një dukuri që e ka shoqëruar familjen shqiptare edhe përgjatë periudhës së shpërbërjes së regjimit socialist totalitar.

Asnjë grua nuk lind kriminele, por bëhet e tillë. Edhe pse viktimizimi i grave, është më i lartë jo vetëm në shoqërinë tonë, por në çdo shoqëri, qoftë edhe në atë belge, gratë belge shfaqen më të ndërgjegjësuarat për të drejtat që kanë dhe e dënojnë më fort dhunën e ushtruar ndaj tyre.

Pse xhelozia?-Pse shqiptarët qenkan

kaq xhelozë në krahasim me kulturat e tjera? Vrasje për motive xhelozie kryhen edhe në shoqëri apo në kultura të tjera, por në shoqërinë shqiptare numri i vrasjeve të kryera për xhelozë është i lartë, pasi në botëkuptimin e shqiptarëve një vend të veçantë zë kodë i nderit. Pra, *vrasjet për xhelozë, që përbëjnë edhe shkakun kryesor të vrasjeve në çift, janë në thelb vrasje nderi*. Edhe pse prononcohen ose kategorizohen si vrasje për xhelozë, vrasje të tilla në shoqërinë tonë kryhen për shkak të krisjes së këtij kodë të fortë moral, siç është kodë i nderit. Në studimet psiko-sociale janë bërë kërkime të shumta mbi nderin dhe ndikimin që ai ka, në numrin e vrasjeve të një shoqërie të caktuar.

## REFERENCAT

- Agnew, R. (1992). Foundation for a General Strain Theory of Crime and Delinquency. *Criminology*, Vol. 30, pp. 47-87.
- Arsovska, J. (2005). Honorable Behavior and the Conceptualization of Violence in Ethnic based organized Crime groups, *Global Crime*, vol. 23, pp. 214-246.
- Bernburg, J. G. (2002). Anomie, Social Change and Crime. A theoretical examination of Institutional-anomie theory. *The Centre for Crime and Justice Studies*, Vol. 42 : pp. 729-742.
- Besnard, P. (1988) The true meaning of Anomie. *Sociological Theory*, Vol. nr 6, pp:91-95.
- Cao, L., Zhao, R., Ren, L., & Zhao J. S. (2004). Social Support and Anomie: A Multilevel Analyses of Anomie in Europe and North America. *International Journal of Offender Therapy and Comparative Sociology*, Vol. 54. Nr.4, pp. 635-639.
- Cohen, A. K., (1999). The Study of Social Disorganization and Deviant Behavior. *Sociology Today*, New York: Basic Books 1959, pp 464-465
- Cohen, D., Nisbett, R., Bowdle, B., and Schwarz, N. (1996). Insult, Aggression, and the Southern Culture of Honor, *Journal of Personality and social Psychology*.
- Daly, M., Wilson, M., & Weghorst, S. J. (1991). Male Sexual Jealousy. *Etiology and Sociobiology*. Vol. 3. pp. 11-27.
- DiCristina, B. (2004). Durkheim's Theory of Homicide and the Confusion of the Empirical Literature. *Theoretical Criminology*, vol.8(1), pp.57-91. USA: Sage Publications.
- Durkheim, E. (1897). *The Division of Labor in Society*. Edited by Steven Lukes. pp:34-35. Free Press London.
- Goldstein, M. A. (2002). The biological roots of heat-passions crimes and honor killings. *Politics and the Life Sciences*. Vol. 21, No. 2, pp.28-37.
- Horton, John. (1964). *The dehumanization of anomie and alienation*, JSTOR.
- Johnson, M. and Ferraro, K. (2000), "Family Law and Parenthood", *Research on domestic violence in the 1990s*, Making distinctions, Free press.
- Lee, M. (2000), "Concentrated poverty, Race and homicide", *The Sociological Quarterly*, Thomson, London.
- McCarthy, B., & Casey, T. (2008). Love, Sex and Crime. *American Sociological Review*, Vol. 73(6), pp. 921-943.

- Merton, R. K. (1938). Social Structure and Anomie. In S.H. Traub, and C. B. Little, eds., Theories of Deviance, 4th edition, 114-48, Itasca, IL: F.E. Peacock
- Messner, S. F., & Rosenfeld, R. (2002). Political Restraint of the Market and Levels of Criminal Homicide: A Cross- National Application of Institutional-Anomie. Social Forces, Vol. 75, Nr 4, pp. 1393-1416.
- Orru, M. (1985). Anomie and Social Theory in Ancient Greece. Cambridge: Cambridge University Press.
- Podolsky, E. (1961), "Jealousy as a motive in homicide", American Sociological Review, vol.4.
- Polanyi, K., (2001). The Great Transformation: The Political and Economic Origins of our time. Boston, MA: Beacon.
- Pridemore, W. A. (2005). Poverty, Socio economic change, Institutional Anomy and Homicide. Social Science Quarterly. 86(S1): 1377–1398.
- Pridemore W. A., & Kim, S. (2006). Democratization and Political Change as Threats to Collective Sentiments: Testing Durkheim in Russia. The Annals of the American Academy of Political and Social Science, pp.82-103.
- Rose, G. (1966). Anomie and Deviation, A conceptual framework for Empirical Studies. The British Journal of Sociology, Vol.17 (1), pp. 29-45.
- Rose, H., and McClain P., (1974), "Race, Place and Risk: Black homicide in Urban America", Detroit, Printed in United States of America.
- Soustelle, J. (1962). The Daily life of the Aztecs. New York: Macmillan
- Stack Steven," Homicide and Property Crime: the relationships to Anomie", Aggressive Behavior, vol. 9, 1983.
- Wilson, M. and Daly M., (1999), "la violence contre Lepouse, un crime passionnel", Criminologie, vol.29, 1999.
- Wolfgang, M. (1958). "The Origins of the American Criminology", American Journal of Sociology.

## ABSTRACT

### **Anomie and homicides in the Albanian families**

This article aims at elaborating and understanding anomie and the causes of homicide within the Albanian family, especially in the wife-husband or intimate relationships. Referring to Durkheimian's paradigm on anomie as the first leading cause to crime and deviance, we will go further by explaining that when people are living in anomic state due to rapid changes in transitional societies, a revival of old canonical, patriarchal norms is seen which controls and constructs human behavior. Sometimes they might be conceived as honor killings. Honor killings and passionate crimes, are widespread in all societies, although they may differ from one culture to another.

*Keywords: anomie, honor killings, family crime, homicide, suicide*





# ASPEKTET SOCIO-JURIDIKE TË KRIMINALITETIT DHE VARËSISË NGA DORGA

Fatmire KRASNIQI  
Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Kosovë  
E-mail: fatmire.krasniqi@uni-gjilan.net

---

## PËRMBLEDHJE

Në përpjekje për të mos e quajtur dukuri apo fenomen social por gjithnjë me synimin që, narkomania përcjellur me të gjitha pasojat e saj të vështrohet në nivelin e rasteve të paraqitura dhe të trajtuara pranë institucioneve relevante në vendin tonë, megjithatë gjendja ekzistuese e prezencës dhe pasojave të saj duket të jetë mjaft brengosëse. Mbështetur veçanarisht në rastet e proceduara në aspektin penalo-procedural madje të konkretizuara edhe me shifra numrike, të dhënat flasin për një numër të lartë të prezencës së personave të cilët në një formë ose formën tjetër ndërlidhin sjelljet e tyre me substancat narkotike. Rrjedhimisht, meqenëse pasojat negative të ardhura prej narkomanisë në radhë të parë godasin jetën e përdoruesve të substancave të tilla, duke ndikuar që të njejtë varësisht nga situatat e paraqitura të mund të jenë kryes të sjelljeve devijante apo edhe viktimë të sjelljeve të tilla, jo rrallë herë pasojat e ardhura nga dukuria e tillë socio-patologjike godasin edhe familjen e tyre si qelizë fundamentale sociale dhe po ashtu edhe mjedisin social në tërësi. Rrjedhimisht, narkomaninë do ta vështrojmë në një kënd hulumtues më specifik. Përtej përcjelljes kuptimore të nocionit të narkomanisë, rrjedhën e shqyrtimit të problematikës së theksuar do ta drejtojmë edhe në të përcaktuarit e narkomanisë posaçërisht në dimensionin juridiko-penal.

Veçanarisht, me interes të veçantë do të jetë të trajtuarit e fenomenologjisë kriminale të narkomanisë në periudhën kohore e cila përfshinë vitet 2014-2018 në Republikën e Kosovës. Ndërkohë që, propozimi i masave parandaluese dhe luftuese të një çështjeje të tillë problematike socio-institucionale do të zë hapësirë të veçantë. Qëllimi i hulumtimit do të jetë

---

Fatmire KRASNIQI është asistente e rregullt për grup lëndësh nga: *E drejta penale*, në Fakultetin Juridik të Universitetit “Kadri Zeka”, në Gjilan. Është doktoruar në *Fakultetin Juridik* të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.

i fokusuar veçanarisht në paraqitjen pasqyrore të një problematike socio-patologjike nëpër të cilën është duke kaluar shoqëria jonë. Të trajtuarit e tematikës së zgjedhur për studim do të mbështetet në aplikimin e: metodës historiko-juridike, metodës analitike, metodës komparative si dhe metodës statistikore.

*Ejalëtkyçe: narkomania, kriminaliteti, masat parandaluese dhe luftuese, Kodi Penal i Republikës së Kosovës*

**T**ë trajtuarit e narkomanisë si një nga faktorët socio-patologjikë që në situata të caktuara është drejtpërdrejtë e lidhur edhe me aktivitete të ndryshme anti-sociale të qytetarëve në shoqëri, rezulton të jetë trajtim mjaft i hershëm. Referuar aspektit të përgjithshëm të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, që në periudhat e hershme janë vërejtur efektet shumëdimensionale negative të substancave narkotike. Rrjedhimisht, substancat e tilla duke u konsideruar të dëmshme jo vetëm për shëndetin e njeriut por edhe për raportet e tij sociale filluan të ndaloheshin edhe përmes dispozitave ligjore.

Megjithatë, përkundër problemeve ekonomiko-sociale nëpër të cilat vazhdon të kalojë shoqëria jonë, duke mos theksuar llojet e tjera të problematikave të saj, një nga problemet me të cilat vazhdon të ballafaqohet ajo, për të mos thënë çdo ditë e më shumë, është edhe ballafaqimi me individët të cilët realizojnë veprime të ndryshme anti-sociale dhe të cilët në një formë ose tjetrën veprimet e tyre i kanë të ndërlydhura me dukurinë socio-patologjike të narkomanisë.

Në këtë drejtim, duke analizuar situatën konkrete në Republikën e Kosovës, do të bëjmë përpjekje që përtej përcjelljes së nocioneve themelore për trajtimin që do të bëjmë në vazhdim, gjithnjë duke u mbështetur në të dhënat statistikore reale të cilat flasin qartë për prezencën dhe pasojat e ardhura prej narkomanisë, e që pasojat e tilla shpalosen veçanarisht edhe në ekzistimin e formave të ndryshme të veprave penale të narkotikëve, gradualisht do të shpalosim edhe të dhënat relevante për periudhën kohore e cila përfshinë vitet 2014-2018.

Po ashtu, me theks të veçantë do të jetë edhe përcjellja graduale e rekomandimeve në lidhje me parandalimin dhe luftimin e dukurisë së tillë negative në vendin tonë.

### **Nocioni i narkomanisë**

Termi *narkotik* rrjedh nga fjala greke *narkotikos*, që nënkupton një gjendje letargjive ose amullie. Farmakologët faktikisht i klasifikojnë drogat narkotike si substanca që lehtësojnë dhembjen dhe prodhojnë gjumë. (Saferstein, 2014, p. 251) Ndërkohë që, vështruar në një kënd më të gjërë narkomania manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike (Halimi, 2007, p. 36) Megjithatë, që në kohën e lashtë, njerëzit kanë përdorur ekstrakte me efekte të posaçme të ekstraktuara nga bimët: Papaver Somniferum-Opiumi, Hashashi, Erythroxyton Coca – Koka, Kanabis Sativa-Marihuana etj., ku në fillim këto ekstrakte bimore janë përdorur nëpër ceremoni fetare dhe më vonë, për të kënaqur ndjenjat që krijojnë këto bimë. (Ademaj, 2010, p. 323) Por, substancat narkotike dhe drogat dehëse, për shkak të cilësive të veta kimike dhe fizike, ndikojnë dukshëm në shëndetin psikik dhe fizik të personave që janë të varur nga to. Te disa individë, në këtë drejtim, pason shkatërrimi i sistemit nervor, çrregullimi i qendrave vitale dhe organeve kryesore, si: dobësimi i zemrës, sëmundjet e veshkëve, shkatërrimi i mëlçisë etj. Shumë prej tyre vdesin me mundime të mëdha ose ngelin invalid të përherëshëm (Halili, 2016, p. 312), për rrjedhojë, duke parë këto dhe efekte të tjera negative në raportet familjare dhe sociale të krijuara

nën ndikimin negativ të substancave të tilla, përmes dispozitave juridiko-penale janë të përcaktuara në mënyrë konkrete edhe rastet se kur blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike, në periudhën e sotme konsiderohet veprë penale.

### **Veprat penale të narkotikëve sipas legjislacionit penal të Republikës së Kosovës**

Të përcaktuarit e veprave penale të narkotikëve përmes dispozitave juridiko-penale në vend është mjaft i qartë. Rrjedhimisht, përmes *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, në kapitullin e veçantë referuar veprave penale në fjalë, përcaktohen një nga një veprat penale të narkotikëve, duke përcjellur në mënyrë konkrete dhe për secilën veprë penale objektin mbrojtës, subjektin kryes të veprës penale, veprimin/et e kryerjes, llojin e dënimit, formën e kualifikuar të veprës penale etj.

Mbështetur në *Kapitullin e XXIII-të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, vërejmë gjithsejt dhjetë nene ku janë të inkrinuara veprat penale të narkotikëve. Pra, nga neni 267 deri në nenin 276, janë të inkrinuara veprimet e kundërligjshme të cilat në njërin ose formën tjetër kanë të bëjnë me veprat penale të narkotikëve. Në këtë drejtim, veprat penale të narkotikëve të cilat në mënyrë konkrete janë të përcaktuara me legjislacionin penal në vend janë (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 23 nëntor 2018, Neni 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 275 dhe 276), si në vijim:

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge; Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike; Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge; Intoksikimi i

personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope; Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge; Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese të kokainës ose bimëve të kanabisit; Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope; Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull; Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky kapitull si dhe Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit.

Gjithsesi, meqenëse në studimin tonë i jemi referuar hulumtimit vetëm të periudhës kohore e cila përfshinë periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018, për të parë më afër llojin e veprës penale më prezente në shoqërinë tonë si dhe të përcaktuarit nëse veprat penale nga fusha e tillë janë duke pësuar rënie apo ngritje në aspektin numerik, nga të dhënat e gjetura rezultojnë se nga të gjitha llojet e veprave penale të narkotikëve të inkrinuara në kapitullin e XXIII-të të *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, për nga shkalla e lartë numerike prijnë veprat penale të emërtuara si: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge si dhe vepra tjetër penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”. Gjithsesi, meqenëse shifrat numerike nga të dhënat statistikore të cilat u referohen personave madhorë por edhe personave të mitur, flasin për prezencën e shtuar të këtyre dy llojeve të veprave penale, atëherë ne do të trajtojmë në veçanti vetëm dy llojet e tilla të veprave penale, në mënyrë që edhe hulumtimi ynë të jetë sa më konkret.

Rrjedhimisht, kur flasim për inkriminimin e veprës penale më prezente në vendin tonë, e cila është *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*, në nenin 267 përcaktohet se, kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të

shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet. Gjithashtu përcaktohet se, kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. Ndërsa, kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja “analog” nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon. Ndërkohë që, substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 23 nëntor 2018, Neni 267, parag. 1, parag. 2, parag. 3, parag. 4 dhe parag. 5)

Gjithnjë mbështetur në të dhënat statistikore të hulumtura, në aspektin numerik, menjëherë pas shkallës së lartë të prezencës së veprës penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* ndodhet vepra tjetër penale e përcaktuar në nenin 269 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe e cila është e emërtuar *posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*. Në dispozitën juridike penale përkatëse, pra në nenin 269 theksohet se, kushdo që pa autorizim posedon

narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet. Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1., i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Ndërkohë që, substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 23 nëntor 2018, Neni 269, parag. 1, parag. 2 dhe parag. 3).

### **Karakteristikat fenomenologjike të narkomanisë gjatë periudhës 2014-2018 në vendin tonë**

Duke e ditur se, kriminaliteti paraqet grupin e të gjitha veprimeve që e rrezikojnë dhe/ose dëmtojnë vlerat themelore të njeriut (të mbrojtura me ligj) dhe se ato vlera themelore mund të jenë individuale (jeta e njeriut, integriteti fizik apo trupor, liria, pasuria, siguria etj.), apo kolektive - vlerat e përbashkëta (rregullimi shoqëror, siguria e shtetit / institucioni, sistemi ekonomik apo shoqëror i shtetit, etj., (Šabani, Budimlić, 2007, p. 6), megjithatë marrë në tërësi, nga kriminaliteti i përgjithshëm i cili rezulton të jetë i pranishëm edhe në bazë të të dhënave statistikore në vendin tonë, gradualisht do të ndajmë dhe do të përcjellim në mënyrë konkrete numrin e personave të dënuar për veprat penale të narkotikëve. Për rrjedhojë, fillimisht do t'i referohemi numrit të përgjithshëm të personave të dënuar për të gjitha llojet e veprave penale dhe më pas nga një numër i tillë do të ndajmë dhe do të paraqesim edhe numrin konkret të personave të dënuar për veprat penale të narkotikëve. Gjithsesi, orientimi ynë do të jetë i fokusuar në periudhën kohore të zgjedhur për studim, pra nga viti 2014 deri në vitin 2018, gjë që, aspektet fenomenologjike për periudhën e theksuar do të prezantohen gradualisht.

Duhet të theksojmë se, në vazhdimësi

shoqëria jonë është duke u përballur me pasoja negative të ardhura nga kryesit e veprave penale të ndryshme. Megjithatë, një fakt mjaft brengosës del të jetë edhe prezenca e theksuar e veprave penale të narkotikëve. Një prezencë e veprave penale përkatëse del të jetë jo vetëm të personat madhorë por edhe të personat e mitur, gjë që, situatën e prezencës dhe pasojave nga veprat e tilla penale e rëndon edhe më shumë.

Rrjedhimisht nga të dhënat e gjetura, referuar kategorisë së personave të mitur gjatë periudhës kohore hulumtuese del se, prezenca e veprave penale të narkotikëve nuk ka shënuar aspak rënie në aspektin numerik. Pra nga viti në vit, numri i personave të mitur të dënuar për ndonjë nga llojet e veprave penale të narkotikëve në shoqërinë tonë ka shënuar një ngritje të lehtë në aspektin numerik. Për më tepër, në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2014, krahasuar me numrin e përgjithshëm të personave të dënuar për të gjitha llojet e veprave penale dhe e cila rezultoi të jetë rreth 840 persona të mitur, prej tyre rreth, 15 persona apo 1.78% janë të dënuar për veprat penale të narkotikëve. Në periudhën kohore vijuese, pra në vitin 2015, nga gjithsejt 563 persona të mitur të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale, rreth 29 persona apo 5.15 % prej tyre janë të dënuar për vepra penale të narkotikëve. Ndërkohë që, në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2016, nga gjithsejt 692 persona të mitur të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale, rreth 24 persona apo 3.46% e tyre janë të dënuar për ndonjë nga veprat penale të narkotikëve. Situata edhe më brengosëse del të jetë periudha kohore e cila përfshinte vitet 2017 dhe 2018, për faktin se, në periudhën kohore të vitit 2017, nga gjithsejt 776 persona të mitur të dënuar për ndonjë nga lloje të ndryshme të veprave penale, del se afro 38 persona apo 4.89 % e tyre janë të dënuar për ndonjë lloj të veprave penale të narkotikëve ndërkohë që, në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2018, numri

i personave të dënuar për ndonjë nga llojet e veprave penale të narkotikëve shkon duke u rritur në aspektin numerik gjë që vërehet se afro 41 persona apo në gjithsejt 5.7 % të rasteve personat e mitur janë të dënuar për veprat penale në fjalë gjithnjë krahasuar me numrin e përgjithshëm të personave të dënuar për ndonjë nga llojet e ndryshme të veprave penale e që megjithatë numri i përgjithshëm i personave të tillë të dënuar për periudhën e theksuar rezultoi të jetë rreth 713 persona të mitur.

Vlenë të theksohet se, gjatë gjithë periudhës hulumtuese në aspektin numerik prijnë personat e mitur të gjinisë mashkullore, të cilët janë kryes të veprave penale në rreth 95.9% të rasteve, gjithnjë krahasuar me personat e gjinisë femërore, me një pjesëmarrje në rreth 4.0%. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur, publikimet 2014-2018).

Në anën tjetër edhe të dhënat statistikore rreth prezencës dhe pasojave të ardhura nga veprat penale të narkotikëve të cilat u referohen kategorisë së personave madhorë si kryes të veprave penale përkatëse bëjnë të qartë se, numri i kryesve të veprave penale të tilla gjithnjë e më tepër është në rritje në aspektin numerik. Për rrjedhojë, mbështetur në të dhënat zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, bëhet e qartë se në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2014, nga 17.490 persona të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale, rreth 306 persona madhorë apo rreth 1.74% e tyre ishin të dënuar për ndonjë nga llojet e veprave penale të narkotikëve. Pothuajse gjendje e njejtë përcillet edhe në periudhën kohore vijuese e cila përfshinte periudhën kohore të vitit 2015, ku nga gjithsejt 16.344 persona të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale, rreth 297 apo 1.81% prej tyre rezultojnë të jenë të dënuar për ndonjë nga llojet e veprave penale të narkotikëve. Periudhë kohore brengosëse konsiderohet

të jetë edhe ajo e cila përfshinte vitin 2016, kjo për faktin se nga numri i përgjithshëm i personave madhorë të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale dhe i cili rezultoi të ishte rreth 17.859 persona, rreth 471 persona madhorë ose 2.63 % ishin të dënuar për ndonjë nga llojet e ndryshme të veprave penale të narkotikëve. Është gjithsesi me rëndësi të theksojmë se, dy vitet vijuese shënojnë rritje të shkallës së kriminalitetit në vendin tonë gjë që, për shoqërinë dhe institucionet e drejtësisë një gjendje e tillë natyrisht se përbënë brengosje. Rrjedhimisht, në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2017, nga gjithsejt 18.753 persona të dënuar, rreth 675 persona apo 3.59% e tyre vërehet qartë se ishin të dënuar për ndonjërin nga veprat penale të narkotikëve. Natyrisht, shifër mjaft e lartë e personave madhorë të dënuar vijonte të ishte e pranishme edhe në periudhën kohore e cila përfshinte vitin 2018, ku nga gjithsejt 19.721 persona të dënuar për lloje të ndryshme të veprave penale, rreth 993 persona madhorë apo rreth 5.03% e tyre ishin të dënuar për ndonjërin nga llojet e veprave penale të narkotikëve.

Edhe në situatën e të trajtuarit të çështjes së prezencës dhe pasojave të veprave penale të narkotikëve të kryera nga personat madhorë, është e rëndësishme të theksojmë se për nga shkalla e pjesëmarrjes në realizimin e veprave të tilla negative prijnë në aspektin numerik personat madhorë të gjinisë mashkullore me një pjesëmarrje rreth 97.8 %, ndërkohë personat e gjinisë femërore vetëm me rreth 2.1 % të rasteve. Megjithatë, fakt tjetër mjaft brengosës del të jetë edhe përfshirja gjithnjë e më e madhe e personave të gjinisë femërore në kryerjen e veprave penale të narkotikëve, gjendje e cila vërehet në procesin krahasues të të dhënave statistikore të siguruar. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Jurisprudencës për personat madhorë, publikimet 2014-2018).

### **Parandalimi dhe luftimi i narkomanisë**

Duke qenë se numri i rasteve të paraqitura dhe trajtuara pranë institucioneve të drejtësisë si vepra penale të narkotikëve, nuk është duke shënuar rënie në aspektin numerik, një situatë e tillë është tregues i qartë se fillimisht në jetën sociale do të duhej të ndikohej edhe më shumë, gjithnjë në kuptim të fuqizimit dhe bashkëpunimit akoma më të madh të institucioneve fundamentale sociale, me ndikim të drejtpërdrejtë në eliminimin e faktorëve kriminogjen.

Rrjedhimisht, procesi i parandalimit të kriminalitetit, e në këtë kuptim edhe të parandalimit të narkomanisë si dukuri e rrezikshme anti-sociale do të duhej të ishte një proces i planifikuar mirë, i mbështetur në strategji preventive adekuate, i ndërthurur në bashkëpunim, bashkëkoordinim dhe në ndihmë reciproke ndërmjet institucioneve relevante dhe të çdo lloji subjekti i cili do të mund të kontribuonte pozitivisht në eliminimin e faktorëve ndikues në paraqitjen e dukurive negative sociale.

Pra, konsiderojmë që fokusi kryesor do të duhej të ishte në realizimin e aktiviteteve strategjike që është e domosdoshme të implementohen brenda qëllimeve preventive dhe të cilat mund të realizohen në format më të ndryshme. Në këtë kontekst duhet nisur nga eliminimi i përgjithshëm i kushteve objektive sociale që prevalojnë në dukurinë e kriminalitetit në një hapësirë të caktuar, e me siguri mund të pohohet se ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme edhe në fenomenin e hulumtuar të sjelljes së dënueshme. Kjo veprimtari para se gjithash nënkupton reagonin social pasi që fjala është për dukuritë që janë rezultat i një pasqyre sociale të shoqërisë (varfëria, papunësia etj.), identifikimi i vatrave që dijagnostifikohen në bazë të vlerësimeve kualitative të rrezikimit paraqesin fundamentin për ndërmarrjen e masave të nevojshme me qëllim të zvogëlimin të situatave potenciale që mund të shkaktojnë lindjen e sjelljeve kriminale.

Dizajni ekologjik i mjedisit, shumësia e masave tjera që ndërmerren në një masë të madhe paraqesin hap të sigurt drejtë sigurimit edhe të bashkësisë nga kriminaliteti, (Muratbegović, 2007, p. 8) e në këtë kuptim edhe të mbrojtjes së personave nga dukuria e rrezikshme e narkomanisë.

Pjesëmarrja gjithnjë e më e lartë e personave të mitur në kryerjen e veprave penale të narkotikëve është dukuri jashtëzakonisht brengosëse, sidomos për faktin e ndjeshmërisë së personave të tillë jo vetëm sa i përket moshës së brishtë të tyre por edhe personalitetit të tyre, i cili është në formim e sipër. Kur gjendjes së tillë i shtohet edhe fakti se në kryerjen e veprave penale të theksuara gjithnjë e më shumë janë duke u përfshirë edhe personat e gjinisë femërore, konsiderojmë që gjendja e përgjithshme sociale rëndohet akoma më shumë gjithnjë duke marrë parasysh pozitën e ndjeshme të femrës në familje dhe shoqëri.

## Përfundime

Mbështetur në të dhënat e trajtuara në lidhje me prezencën dhe pasojat e narkomanisë në vendin tonë, të përcjellura në formën e studimit të rasteve reale të cilat janë evidentuar edhe nga institucionet relevante në vendin tonë del se narkomania gjegjësisht numri i veprave penale të narkotikëve është duke shënuar rritje në aspektin numerik.

Po ashtu, gjithnjë e më tepër në kryerjen e veprave penale përkatëse janë duke u rritur rastet e pjesëmarrjes edhe të personave të mitur si dhe personave të gjinisë femërore, natyrisht përveç personave madhorë të gjinisë mashkullore. Kur kësaj çështje i shtohet edhe *nurmi i errët* i rasteve kriminale situata e prezantuar bëhet edhe më brengosëse.

Rrjedhimisht konsiderojmë se, në shoqërinë tonë duhet gjetur dhe aplikuar mekanizma edhe më të fuqishëm në drejtim të parandalimit dhe luftimit më adekuat të sjelljeve devijante. Për më tepër, duhet fuqizuar akoma më shumë bashkëpunimi reciprok që nga institucionet fundamentale sociale e deri në rangun më të lartë të institucioneve shtetërore. Gjithsesi, roli dhe rëndësia e ekspertit në cilësinë e psikologut në gjithë këtë proces dhe në të gjitha hallkat sociale duhet fuqizuar akoma më shumë.

Në anën tjetër, ndërrmarrja e të gjitha aktiviteteve në drejtim të zbulimit të *delikuentëve potencialë* do t'i kontribuonte edhe më shumë uljes së rasteve të prezencës së veprave penale të narkotikëve. Natyrisht edhe kontrollimi më i shpeshtë i mjedisit social dhe i vet personave të dyshimtë gjithashtu do të ishte i mirëseardhur në kuptim të një parandalimi të sjelljeve devijante, me theks të veçantë te personat e mitur.

Padyshim, në gjithë këtë proces të parandalimit të sjelljeve devijante, ndikim pozitiv do të kishte gjetja dhe eliminimi i faktorëve kriminogjen, me çka do të zvogëlohej edhe numri i rasteve problematike të ndodhura në shoqëri.

Përfundimisht mund të konstatojmë se, gjendja e prezencës dhe pasojave të ardhura nga kryesit e veprave penale të narkotikëve është mjaft brengosëse, megjithatë një situatë e tillë është e menaxhueshme nga institucionet e drejtësisë. Rrjedhimisht, për të krijuar një ambient të shëndoshë, të sigurtë dhe të qetë për të gjithë, përveç funksionimit adekuat të institucioneve relevante shtetërore, kontribut të drejtpërdrejtë në kuptimin pozitiv do të kishte edhe gjithsecili qytetarë i cili me sjelljet e tij adekuate dhe bashkëpunuese me institucionet përkatëse do të ndikonte në parandalimin dhe luftimin edhe më të fuqishëm të sjelljeve devijante sociale.

## REFERENCAT

- Ademaj, Xhemajl, (2010). *Ekspertizat kriminalistike*, Prishtinë: Policia e Kosovës.
- Halili, Ragip, (2016). *Kriminologjia*, Prishtinë: XHAD studio-Prishtinë.
- Halimi, Armend, (2007). *Faktorët negative që nxisin të rinjtë në sjellje delikuede*, Prishtinë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Rinisë.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 23 nëntor 2018.
- Muratbegović, Elmedin, (2007). *Parandalimi i kriminalitetit*, Sarajevë/Prishtinë: Universiteti AAB, Prishtinë.
- Šabani, Alisabri, Budimlić, Muhamed, (2007). *Kriminologjia*, Sarajevë/Prishtinë: Universiteti AAB, Prishtinë. Univerzitet u Sarajevu, Fakultet Kriminalističkih Nauka.
- Saferstein, Richard, (2014). *Kriminalistika-Një hyrje në shkencat ligjore*, Shkup: Tabernakul.
- Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur (publikimet 2014-2018), Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Statistikat e Jurisprudencës për personat madhorë (publikimet 2014-2018), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

## ABSTRACT

### Socio-legal aspects of criminality and drug addiction

In an attempt not to call it an occurrence or a social phenomenon nevertheless continuously aiming that the drug addiction followed with all its consequences to be seen at the level of cases reported and addressed by the relevant institutions in our country, the existing situation of the presence and its consequences seems to be rather worrying. Based particularly on processed cases in the criminal-procedural aspect even materialized with numerical figures, the data shows a high number of presence of persons who, in one form or another, associate their behavior with narcotic substances. Accordingly, since the negative consequences of drug addiction primarily affect the lives of users of such substances, influencing that the same, depending on the situations presented, may be the cause of deviant behavior or even the victim of such behaviors, not infrequently the consequences of such socio-pathological phenomenon likewise affect their family as a fundamental social cell as well as the social environment as a whole. Consequently, we will look at drug addiction in a more specific research angle.

Beyond the meaningful pursuance of the notion of drug addiction, the course of consideration of the highlighted problem will be directed to the definition of drug addiction, mainly in the juridical-criminal dimension. Specifically, of particular interest will be the treating of drug addiction criminal phenomenology in the period of 2014-2018 in the Republic of Kosovo. Meanwhile, the proposal of preventive and combat measures of such a problematic socio-institutional issue will occupy a special space. The purpose of the research will be specifically focused on the presentation of a socio-pathological problem that our society is experiencing. The handling of the selected topic of study will be based on the application of historical-legal method, analytical method, comparative method as well as statistical method.

**Keywords:** *drug addiction, criminality, preventive and combat measures, Criminal Code of the Republic of Kosovo.*



# MBROJTJA SOCIALE SI GARANCI PËR NJË FAMILJE TË FORTË; NJË PANORAMË E KUADRIT LIGJOR SHQIPTAR

**Evis GARUNJA**

*Universiteti Aleksander Moisiu Durrës (UAMD)*

*Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike*

Email: evigarunja2000@yahoo.com

---

## PËRMBLEDHJE

Mbështetja sociale për familjet përbën një shqetësim kombëtar. Legjislacioni përcakton kushtet në të cilat familjet në vështirësi mund të përfitojnë nga ndihma shtetërore. Por përsëri, situata mbetet problematike. Ky studim ofron të dhëna mbi mbështetjen konkrete për familjet me probleme socio-ekonomike nga autoritetet publike dhe OJF-të. Të dhënat për këtë studim janë marrë nga databaza e të dhënave të Shërbimit Kombëtar Social, nga zyrtarë të qeverisjes vendore dhe OJF-të aktive. Për më tepër, iu shtuan edhe të dhënat demografike dhe ato mbi familjet me probleme socio-ekonomike. Këto të dhëna u krahasuan me ato të regjistrimit kombëtar. Identifikimit të faktorëve, ndërmarrjes së veprimeve dhe përcaktimit e mekanizmave për përmirësimin e situatës do ta ndihmojë më shumë kuadri ligjor dhe studimet mbi këtë çështje. Gjetjet treguan se familjet në Shqipëri po kalojnë vështirësi në rritjen e fëmijëve të tyre. Problemet ekonomike dhe sociale janë shkaktuar nga disa faktorë si papunësia, dhuna gjinore dhe pabarazia, standardi i lartë i jetesës, braktisja e shkollave, migracioni, divorci, apo varfëria. Kjo gjendje ndikon në nevojën që kanë familjet për mbështetje dhe ndihmë

**Evis GARUNJA** është lektore pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ajo ka kryer studimet doktorale dhe post doktorale në Universitetin e Pavias, Itali. Ndër botimet e saj përmendim: “Reformimi i sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri dhe roli i shtetit në subvencionin e nxënësve” (Regional Journal of Social Sciences Nr.6/2018); “Domestic violence in Albania: New albanian law of measures against DV in Family relationship” (Journal Social Issues and challenges for women: A world perspective; women’s condition in 21st century); “Domestic Violence: A Phenomenon for the Albanian family and Society” (Feminisms in a transnational perspective 2018, Fear, Resistance, imagination IUC Dubrovnik, May 21-25 2018); “Integrimi i psikologut në strukturat e sistemit gjyqësor shqiptar” (Avokatia, Nr. 12, 2014, fq. 63-82) etj.

nga autoritetet përgjegjëse. Autoritetet publike dhe lokale në bashkëpunim me OJF-të janë përpjekur të plotësojnë nevojat e tyre, por duhet bërë akoma dhe më shumë. Këto familje janë të ekspozuara ndaj faktorëve të rrezikut gjë që kërkon një vigjilencë më të madhe nga ana e autoriteteve kompetente, duke ndërhyrë me mjetet e nevojshme dhe në kohën e duhur. Gjetjet tregojnë rëndësinë e krijimit të një axhende më rigoroze ndërdisiplinore, kërkimeve shkencore në informimin mbi shërbimet e nevojshme në mbështetje të familjeve në nevojë. Përmirësimi i këtyre shërbimeve, masat direkte dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e jetës së familjeve bëjnë pjesë në analizën e këtyre shërbimeve.

*Fjalëkyçe: Shërbime familjare, mbrojtje sociale, korniza ligjore, institucione publike, gra, kujdestari të fëmijëve.*

**M**brojtja sociale është një nga aspektet më integrale të jetës socio-ekonomike në të cilën institucionet janë përpjekur të sigurojnë një bazë solide për zbatimin e reformave gjatë tranzicionit. Njëzet e nëntë vjet pas rënies së komunizmit, zbatimi i reformave dhe përmirësimi i kushteve ekonomike, nevoja për mbrojtje dhe shërbime sociale cilësore dalin në plan të parë.

Ndër qëllimet afatshkurtra të politikës sociale gjatë periudhës së tranzicionit mbetet zgjidhja e problemit të papunësisë afatgjatë dhe varfërisë absolute, kjo, sepse shumica e shqiptarëve jeton nën kushtet minimale të jetës. Politika e centralizuar e paraveve 90të ndikoi që popullsia të ishte e papërgatitur për të mbijetuar në një ekonomi të orientuar drejt tregut. Deri në vitet 1990, papunësia në Shqipëri nuk njihej (të paktën zyrtarisht) dhe koncepti i cenueshmërisë si mohim dhe përjashtim i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut nuk kishte asnjë vlerë praktike e aq më shumë institucionale, për shkak të mungesës së instrumentave dhe autoriteteve përgjegjëse për të luftuar pikërisht përjashtimin dhe cenueshmërinë shoqëror. Në vitet '90, Shqipëria hyri në rrugën e tranzicionit pa një bazë të mirëfilltë ligjore dhe institucionale në fushën e mbrojtjes sociale. Privatizimi i sektorëve ekonomikë dhe ekonomisë rurale, ka zhvendosur forcat e punës dhe i ka përqendruar ato më shumë në zonat urbane.

Urbanizimi solli probleme ekonomike dhe sociale për shkak të humbjes së

vendeve të punës ose të tokës nga familjet. Marrëdhëniet shoqërore u shndërruan në marrëdhënie individualiste të orientuara nga interesat e momentit. Kjo u shoqërua me ndryshime në perceptimin e familjes apo fqinjësisë si koncept, grupet vulnerabël (si fëmijët) dhe personat në nevojë (të moshuar, të paaftë), u shndërruan në grupe sociale “në rrezik” përjashtimi, të cilët për shkak të rritjes së nivelit të varfërisë janë të parët që kërkojnë ndërhyrjen përmes politikave sociale dhe ofrimin e garancive mbi mbrojtjen sociale nga institucionet shtetërore. Kjo situatë evidentoi nevojën për një monitorim të vazhdueshëm duke filluar nga raportet që ekzistojnë midis uljes së varfërisë dhe përjashtimit social, në mënyrë që të ndikohet në zbutjen e varfërisë, përjashtimit social dhe ndryshimeve sociale midis grupeve të ndryshme shoqërore.

Sistemi i sigurimeve shoqërore ka patur në qendër të tij mbrojtjen sociale për personat e papunë të siguruar për një periudhë të caktuar, e cila ka krijuar kushtet për ofrimin e mbështetjes për personat të cilët mbeten të papunë për një periudhë të gjatë kohore edhe pas mbarimit të ndihmës ekonomike të papunësisë. Të ardhurat e përfituara nga të moshuarit prej pensionit të tyre të pleqërisë u garantojnë atyre një jetesë minimale, gjë që nuk mund të thuhet për të gjithë atë pjesë të shoqërisë e cila nuk mundet të përfitojë dot nga kjo skemë e mbrojtjes sociale për shkak se pë shumë vite ka qenë jashtë rritjetit të kontribuesve.

Rrjeti për ofrimin e mbrojtjes sociale

konsiston në sigurimin në rast papunësie dhe për pension pleqërie, por ai duhet të shtrihet në mbrojtjen e papunësisë afatgjatë dhe për grupe të tjera në rrezik duke përfshirë këtu të varfërit dhe njerëzit në nevojë. Kjo është arsyeja pse u pa e nevojshme ngritja dhe funksionimi i institucioneve të asistencës sociale, të karakterizuara nga një kornizë ligjore mbi ndihmën sociale sipas modelit perëndimor (1), nga institucionet e ndihmës sociale dhe institucionet e tjera, pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (2) si dhe nga strukturat administrative, materialet dhe burimet njerëzore për të zbatuar këtë program social në praktikë (3).

### Shifra dhe fakte

Transformimi i familjeve gjatë periudhës së tranzicionit ka nxjerrë në pah kaq shumë problematika që kanë e bëri të pamundur trajtimin e tyre pa ndërhyrjen e shërbimeve specifike. Kjo vihet re me fenomenin e shkurorëzimeve, të cilat po rriten vit pas viti, mesatarisht rreth 3500 shkurorëzime për vit. Kështu, në vitin 2001, në çdo 100 martesë, 9.6 prej tyre përfunduan me divorc, ndërsa në vitin 2012 kjo shifra arriti rreth 16 shkurorëzime për 100 martesë, ndërsa shkalla mesatare e shkurorëzimeve përkundrejt martesave gjatë periudhës 2001-2012 ishte rreth 14.5% (INSTAT, 2013). Në krahasim me SHBA (CDCC, 2014) dhe Europën (Eurostat, 2014), ku gati gjysma e martesave përfundojnë në divorc, shifrat në Shqipëri janë shumë më të ulëta. Në Evropë, numri mesatar i martesave për 1000 banorë u ul nga 7.9 në 1970 në 4.8 në 2008, dhe numri i shkurorëzimeve për 1000 banorë u dyfishua gjatë kësaj periudhe me 1 divorc për 1000 banorë në 1970 dhe dy divorce për 1000 banorë në 2008 (Eurostat, 2014). Pas vitit 2001, ka një rritje të numrit të përgjithshëm të martesave gjatë dy viteve në vijim, e ndjekur nga një rënie e tyre duke treguar përsëri një trend në rritje pas vitit 2009.

Sipas Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Shërbimit Social Shtetëror, mesatarja e ndihmës sociale për familje në fund të vitit 2015 është 4.286 lekë, në vitin 2016 është 4.280 lekë, në fund të 2017 është 4.174 lekë dhe në tremujorin e tretë të vitit, 2018 është 5.081 lekë.

Në vitin 2015, sipas të dhënave nga Anketimi i Forcës së Punës, shkalla e papunësisë për atë pjesë të popullsisë së moshës 15-64 vjeç është 17.5%. Shkalla e papunësisë për meshkujt ka rënë me 2.5% krahasuar me 2014 (nga 19.7% në 17.1%). Ndërkohë, situata e papunësisë duket më e rëndë për femrat, duke u rritur me 2% krahasuar me vitin 2014. Si pasojë, në 2015, ekzistojnë të njëjtat të dhëna mbi punësimin si për meshkujt ashtu edhe për femrat.

Këto të dhëna ofrojnë një përmbledhje të përgjithshme të vështirësive me të cilat përballen sot qytetarët shqiptarë në planet personale, familjare dhe sociale. Në këtë këndvështrim, do të jetë gjithashtu e rëndësishme se si institucionet përgjegjëse ndërhyjnë për të përmirësuar situatën dhe për të zbutur këto probleme.

### Kuadri ligjor

Familja si një koncept shoqëror është në evolucion të vazhdueshëm. Në fillim, familja ishte e bazuar në marrëdhëniet e gjakut për të ndryshuar nga “vullneti” (lidhja e bashkëshortëve në martesë) me bashkëjetuesin *more uxorio*. Si koncept juridik, familja nuk ka një përcaktim përfundimtar.

Ligji Nr. 9355 (KSH, 2005), “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” përcakton se:

Familja është një grup individësh që janë të lidhur në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, anëtarë të familjes dhe marrëdhënie të kujdestarisë të cilët jetojnë nën të njëjtën çati.

Sipas Kodit të Familjes të vitit 1982, neni 4 ofron këtë përkufizim: “Familja është qeliza themelore e shoqërisë në të cilën mbështeten marrëdhëniet e lindura bazuar në martesë, gjini dhe birësim”.

Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (OKB, 1948):

“familja është njësi natyrore themelore dhe kryesore e shoqërisë” (neni 16/3) dhe “burri e gruaja, në një moshë të përcaktuar e pa asnjë diskriminim racor, kombësie, fetare kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje” (neni 16/1).

Kështu familja konceptohet si: “një njësi themelore e shoqërisë”, “njësi kryesore natyrore”. Sipas Ulpianit, juristi mirënjohur romak:

“Familja në kuptimin strikt të saj (proprio iure), është një qelizë ose një bashkim i njerëzve nën fuqinë e vetme dhe njëjtë të paterfamilias, dhe janë të bashkuar me njëri-tjetrin për shkaqe natyrore ose ligjore” (Digesto D. 50, 16, 195, 1-5, 46 lib. ad Edictum)

Marrëdhëniet midis familjes dhe shoqërisë janë shumë të gjalla. Familja është një njësi sociale dhe ligjore. Martesa dhe familja janë institucione shumë të rëndësishme jo vetëm mbi baza sociale, por edhe juridike, prandaj, një pjesë shumë e rëndësishme është përqendruar në marrëdhëniet midis Shtetit dhe familjes.

Kodit të Familjes (KSH, 2003) neni 3, përcakton:

“Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbështetur fëmijët e tyre, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes”.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 53/2, “Martesa dhe familja

gëzon mbrojtje të veçantë nga Shteti”. Pra, është një detyrim i shtetit që të kujdeset për qëndrueshmërinë e familjes, veçanërisht kur kjo është në nevojë. Këtë detyrim e përçon gjithashtu edhe ligji “Për ndihmë ekonomike dhe shërbimet sociale” (KSH, 2005).

Burimet e së drejtës së familjes janë aktet normative që përbëjnë rregullimin juridik në sferën familjare, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara, Kodi i Familjes, ligji “Për Gjendjen Civile”, vendimet e unifikuara të Gjykatës së Lart, vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata e Strasburgut) - vendimet e së cilës janë të detyrueshme për sistemin gjyqësor shqiptar etj.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri u krijua midis viteve 1992-1993 dhe përbëhet nga ai mbrojtja sociale (1), sigurimet shoqërore (2), ndihma sociale (3) dhe programet e zhvillimit të tregut të punës (4). Në fillim të implementimit të cilitdo program, fillohet me identifikimin e grupeve vulnerabël ose ata që kanë të drejtë të përfitojnë. Objektivi fillestar në krijimin e Institutit të ndihmës social-ekonomike ishte të siguronte kushtet minimale të jetesës për popullsinë që ishte e kërcënuar nga uria, duke u përpjekur të lehtësonte tensionet sociale për shkak të transformimit ekonomik dhe në ndërtimin e një rendi të ri shoqëror.

Në programet e përgjithshme, përfitimet janë konsideruar si e drejtë sociale e secilit anëtar të shoqërisë, shtetas ose rezident në një vend, pa marrë parasysh të ardhurat, punësimin dhe mjetet e tjera të jetës, pa dallim race, besimi politik, fetar, si shkollat publike, kujdesi shëndetësor parësor që garanton nevojat themelore dhe promovon mirëqenien individuale të shoqërisë. Kjo paraqet një kosto ose kompensim të pjesshëm për pasigurinë që duhet të paguajë shoqëria për zhvillimin e shpejtë teknologjik dhe ndryshimet urbane pa bërë një vlerësim bazuar në nevojat e veçanta të secilit individ.

Në programet e zgjedhura, grupi i përfituesve, pjesë e shoqërisë përkon me grupin e njerëzit në nevojë, kjo bazuar në kriteret specifike si vendi ose koha, si dhe në konceptin e nevojës financiare dhe mundësinë e arritjes së këtyre nevojave.

Programet kompensuese ofrojnë përfitime për njerëzit me merita të veçanta ose programet kategorike për ndihmën sociale që gërshetojnë statusin shoqëror me verifikimin, kompensimin dhe kriteret diagnostikuese (për personat e paaftë dhe të verbrit).

Sistemi i ndihmës sociale përbëhet nga (1) skema e përgjithshme që ofron përfitime në para për familjet e varfra: skema e ndihmës ekonomike dhe (2) skema speciale që ofron përfitime për personat “me aftësi të kufizuara që në foshnjëri”<sup>1</sup> dhe që nuk përfitojnë nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Ky sistem i asistencës është i lidhur ngushtë me shërbimet sociale për grupet vulnerabel, në veçanti, fëmijët e braktisur në jetimore, shtëpi e strehimit (azilet) për të moshuarit dhe qendrat për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike.

Mënyra e ofrimit të shërbimeve:

- Shërbimi social me pagesa në “para” (kesh/në dorë)
- Shërbime sociale në ndihmë në natyrë (materiale)
- Shërbime sociale si ndihmë sociale

Shërbimet e ndihmës sociale, sipas organizatave dhe aktiviteteve të tyre janë:

- Shërbime të strehimit;
- Shërbime të asistencës në komunitet.

Përfituesit e shërbimeve sociale janë fëmijë, të rinj deri në moshën 25 vjeç, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, gra, vajza në nevojë dhe njerëzit në rrezik janë pjesë e grupit të personave në nevojë.

Të miturit janë përfituesit e

drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale sipas kategorive të më sipërme. Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (KSH, 2005) pasqyron rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë përfituesit e shërbimeve sociale, përfshirë fëmijët, si “përfitues” të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të kësaj kategorie. Shërbimet sociale synojnë të plotësojnë nevojat e te gjitha grupeve vulnerabel si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë në vështirësi, të moshuarit.

Fakt është që, programet e mbrojtjes sociale kanë qenë objekt i reformave të vazhdueshme dhe strategjive të ndërmarra nga qeveritë të cilat nëpërmjet instrumentave institucionalë, kanë krijuar çelësat e nevojshme për zhvillimin e vendit në përgjithësi dhe, veçanërisht, mbi përmirësimin e politikave sociale. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit, Strategjia indirekte mbi Përfshirjen Sociale, Strategjia për Mbrojtjen Sociale dhe Strategjia për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale, janë dokumente të rëndësishme politike dhe strategjike që kanë përcaktuar përparësitë strategjike të vendit, treguesit për një orientim të politikës sociale drejt ofrimit të ndihmës ekonomike në para.

Në nëntor 2005, një sistem planifikimi i integruar u programua për të siguruar një përmbledhje të këtij programi, parimet e funksionimit dhe strukturat mbështetëse që synojnë të garantojnë implementimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve në një mënyrë efikase dhe harmonike. Komponentët kryesorë të sistemit të planifikimit janë Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit (SKZHI) dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Në një shoqëri pluraliste, shteti i ligjor merr një rol të rëndësishëm në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në mbrojtje të Kushtetutës, shtetin juridik, demokracisë,

<sup>1</sup> Termi “Të paaftë që nga fëmijëria” përfshin të gjithë personat që kanë paaftësi fizike ose mendore përpara se ata të arrijnë moshën 21 osë 24 vjeç, nëse janë në vazhdim të studimeve universitare (Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 311 datë 07.11.1994).

të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve.

Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale si pjesë e pushtetit ekzekutiv, realizon misionin e saj brenda kontekstit të marrëdhënieve të punës dhe çështjeve sociale, marrëdhënie të krijuara dhe mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me një kornizë ligjore dhe rregulla që sistemojnë në mënyrë specifike të gjitha fushat e këtij misioni.

Paragrafi i dytë i nenit 15 të Kushtetutës konfirmon pikërisht këtë detyrim: “Autoritetet Publike për të mbështetur funksionet e tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe duhet të kontribuojnë për realizimin e tyre”.

Për më tepër, në Kapitullin IV të Kushtetutës (neni 52) janë përcaktuar të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale dhe kulturore, duke deklaruar se:

“Çdo person ka të drejtë të garantojë mjetet e jetës përmes një punë e ligjshme [...] ai është i lirë të zgjedh profesionin e tij, vendin e punës dhe formimin profesional, punëtorët kanë të drejtën e mbrojtjes sociale në punë”, “Secili ka të drejtë për të patur një mbrojtje sociale në pleqëri ose kur përfituesi humbet aftësinë për të punuar, sipas një sistemi të përcaktuar me ligj..” (KSH, 1998).

Kushtetuta siguron mbrojtje të veçantë për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat, në fushën e marrëdhënieve të punës dhe mbrojtjes sociale, “Fëmijët, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes speciale nga shteti” (Neni 54)

Vendosja e sistemit të ndihmës sociale në Shqipëri është programi i parë kombëtar shtetëror që adreson dhe kërkon të zgjidhë gjendjen e varfërisë (KSH, 1993). Ligji përkufizon standardet dhe objektivat afatgjatë dhe afatshkurtra të strategjisë në trajtimin e varfërisë që nga fillimi i tranzicionit. Institucioni i ndihmës sociale ka si qëllim kryesor përcaktimin e një minimum jetik si dhe kushtet e jetesës për

popullatën e kërcënuar nga uria. Lehtësimi i tensioneve sociale si element i rëndësishëm i transformimit ekonomik dhe garant për një rend të ri shoqëror përbëjnë boshtin e aktivitetit të këtij institucioni. Kjo është e shprehur konkretisht në ligjin nr. 9355, neni 2 (KSH, 2005), ku thuhet:

“Ulja e varfërisë dhe përjashtimi social për individë dhe familje, ashtu si dhe krijimi i mundësive për integrimin e tyre, përmes një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh në përmirësimin e mënyrës së jetesës së tyre”.

Nga viti 1993, kur hyri në fuqi ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, për herë të parë në Shqipëri u krijua sistemi i ndihmës sociale. Me kalimin e kohës legjislativi mbi të drejtat sociale i është nënshtruar përmirësimeve të konsiderueshme. Por, ky ligj është dokumenti i parë që ka garantuar bazat e reformës së mbrojtjes sociale. Ligji përcakton kushtet e parashikuara në të cilat mund të përfitonin familjet dhe personat pa të ardhura, ose me të ardhura të pamjaftueshme duke u siguruar atyre të drejtën e një përfitimi në vlerë monetare si ndihmë ekonomike mujore, në bazë të vlerësimit të kushteve të jetesës reale në të cilën ata ndodhen. Në raste të veçanta, familjet gjithashtu mund të përfitojnë nga ndihma ushqimore dhe ndihma në para si një lloj tjetër pagese. Ligji gjithashtu përcaktoi kushtet mbi të cilat do të ofrohen shërbimet publike të mbrojtjes sociale, ashtu sikundër kushtet e ndihmës ekonomike, ose elementet e tjera që e plotësojnë atë.

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (KSH, 2005), pasqyron rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët të cilët mund të jenë përfitues të shërbimeve sociale dhe përcaktimi i standardeve mbi të cilën mbështet ky përcaktim do të ndikojë në përmirësimin e zbatimit të këtyre parimeve. Ky ligj synon të caktojë ndihmën dhe shërbimet sociale të nevojshme për personat dhe grupet në

nevojë, të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat themelore të jetës së tyre, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale dhe mbrojtjes së integritetit të tyre për shkak të aftësive të kufizuara fizike dhe mundësive ekonomike, psikologjike dhe sociale. Ky ligj synon të lehtësojë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë dhe ofrojë mundësi për integrimin e tyre. Ai, gjithashtu, përcakton kushtet e specifike në të cilat Shteti siguron mbështetje për familjet shqiptare (në përgjithësi) dhe individët (në veçanti) që janë tërësisht pa të ardhura, ose me të ardhura të pamjaftueshme. Ligji ofron një ndihmë ekonomike bazuar në matjen e të ardhurave dhe mjeteve të jetesës për secilën familje kandidate. Në kushtet e Shqipërisë (me një buxhet të kufizuar publik, një ekonomi të fortë informale, një traditë familjare e jetesë të përbashkët midis brezave të ndryshëm, mundësi të kufizuara të institucioneve shqiptare në shkëmbim të një informacioni të vazhdueshëm dhe monitorimi i efektivitetit të sistemit), mbrojtja e familjes u vlerësua si një princip më i vlefshëm sesa mëshjetja financiare e një personi të vetëm.

Ligji parashikon parimet themelore mbi të cilat vepron sistemi i ndihmës dhe shërbimeve sociale, përfshirë këtu respektimin dhe garancinë për vlerat dhe personalitetin individual; universalitetin; mundësitë e barabarta për të gjithë; të drejtën për të përfituar; partneritetin; transparencën dhe paanshmërinë; decentralizimin; autonominë, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit; mosdiskriminimin dhe karakterin e tij subsidiar (KSH, 2005/3).

Rëndësia e standardeve të përcaktuara lidhjet me:

Së pari, për të garantuar dhe për të zhvilluar më tej të drejtat e qytetarit të

sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria Shqiptare. Hartimi për herë të parë e një pakete të plotë të standardeve shqiptare mbi shërbimet sociale në përputhje me ligjet në fuqi dhe standardet e kërkuara ndërkombëtare përbëjnë një hap i rëndësishëm për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian<sup>2</sup>.

Së dyti, për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale. Për sa i përket zhvillimit të sektorit privat në fushën e shërbimeve sociale, është e nevojshme që shteti të vendos disa rregulla dhe standard të nevojshme për cilësinë e shërbimit, të cilat duhet të respektohen nga të gjithë ofruesit e shërbimi, institucionet publike (kombëtare ose lokale), organizata jofitimprurëse (OJF) dhe ofruesit privatë. Zbatimi i standardeve kombëtare është kushti i pare që duhet të përmbushet gjatë procesit të autorizimit, monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale.

Së treti, proceset e decentralizimit imponojnë përgjegjësi më të madhe për autoritetet lokale në kuadër të ofrimit të shërbimeve sociale<sup>3</sup>. Në kushtet në të cilat organet e pushtetit lokal nuk kanë përvojë në implementimin e këtij aktiviteti të ri, përcaktimi i standardeve ndihmon në përmbushjen e një funksioni të kënaqshëm mbi nevojat sociale të komunitetit, si pjesë e ushtrimit të autoritetit të tyre. Këto funksione kanë të bëjnë me planifikimin, implementimin e shërbimeve sociale dhe zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit në nivel lokal ose rajonal.

Së katërti, zbatimi i standardeve ndikon në rritjen e kapitalit shoqëror. Kapitali shoqëror në perspektiva praktike ka të bëjë me zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe burimeve sociale, përfshirë këtu institucionet,

<sup>2</sup> Sipas ligjit "Për ndihmën sociale dhe shërbimet shoqërore" (KSH, 2005/18), "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta është autoriteti përgjegjës për hartimin e standardeve të shërbimeve sociale.

<sup>3</sup> Sipas ligjit 9355/2005, neni 17 "Këto shërbime janë të financuara nga buxheti qëndror dhe buxheti i pavarur i autoriteteve të qeverisjes qëndrore."

marrëdhëniet dhe normat që formësojnë cilësinë dhe sasinë e ndërveprimeve sociale.

Strategjitë e qeverisë shqiptare, si “Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020” (KM, 2015) etj., kanë synuar reformimin e sistemit të ndihmës sociale, në mënyrë që të garantojë të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe trajtimin e barabartë në sektorin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë. Për një përgjigje më të mirë të nevojave sociale në rritje, kërkohet domodoshmërisht të rritet jo vetëm përgjegjësia e qeverisë lokale, por edhe e gjithë komunitetit, për të përfshirë më shumë aktorë dhe burime financiare / logjistike në shërbimet sociale.

Qëllimi i kësaj strategjie është: a) të ndryshojë llojin e shërbimeve sociale, duke rritur diversitetin e tyre konform nevojave, zgjerimin e rrjetit të institucione të ndihmës sociale me shërbime të reja të ofruara nga organet publike ose jopublike, në nivel rajonal dhe bashkiak, me institucionet e strehimit, qendrat ditore, shërbimet për familjet ose shërbimet e mobilitetit në komunitet; b) zhvillimi i rrjeteve të bashkëpunimit dhe burimeve shoqërore, një situatë që kërkon ndërhyrjen e standardeve, të cilat do të jenë një pikë referimi për të gjitha llojet e shërbimeve sociale, për të gjithë grupe të cënueshme si: fëmijë, gra, persona me aftësi të kufizuara, të rinj në vështirësi, të moshuar..., për të përmirësuar nevojat e tyre.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ky ligj parashikon përcaktime thelbësore të llojeve të shërbimeve që u ofrohen familjeve në

nevojë duke i ndarë ato në shërbime para-shoqërore (neni 10); b) shërbime të ofruara në qendrat e komunitetit (neni 15), përfshirë qendrat e zhvillimit (neni 16); c) shërbimet në qendrat e residenciale, përfshirë shelterat; ç) shërbime sociale në një situatë emergjente; d) shërbime alternative të kujdesit për fëmijë pa përkujdesje prindërore; dh) shërbime të specializuara (neni 13); e) këshillim telefonik ose i këshillimit online (neni 11). Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur ky shërbim është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm të ofrohet në familje (neni 12) ose në komunitet (neni 8). Sipas nenit 9, shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas procesit të financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.<sup>4</sup>

Subjektet e mbështetura janë: a) familjet me fëmijë, si dhe fëmija që si subjekt gëzon mbrojtjen ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin; b) personat me aftësi të kufizuara; c) të rriturit me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë nga droga dhe nga alkooli; ç) vajzat shtatzëna ose prindërit beqarë me fëmijë deri në moshën një vjeç; d) të miturit dhe të rinjtë në kundërshtim me ligjin, të cilët kanë përfunduar periudhën e dënimit, dhe që ka nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror me qëllim që të riintegrohet në shoqëri dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare konform vendimit të autoritetit përgjegjës për dhënien e azilit dhe statusit refugjatë në Republikën e Shqipërisë; dh) të moshuarit në nevojë.

Ofruesit e shërbimit të kujdesit shoqëror<sup>5</sup> janë: Njësitë e qeverisjes vendore<sup>6</sup>, Punonjësit socialë<sup>7</sup> të njësisve të qeverisjes vendore,

<sup>4</sup> “Shërbimet Sociale Publike” përfshijnë shërbimet e kujdesit shoqëror ofruar nga qendrat komunitare, qendrat residenciale, qendrat e kujdesit ditor ose në shtëpi, ndërsa “Shërbimet Jo-publike” janë klasifikuar si jofitimprurëse dhe fitimprurëse.

<sup>5</sup> Sipas ligjit 121/2016 (neni 27.1): Shërbimet e Kujdesit Shoqëror janë të ofruara nga persona legalë publikë dhe privatë të licensuar për këtë qëllim.

<sup>6</sup> Janë Bashkitë dhe Qarqet, siç përcaktohen nga legjislacioni në fuqi mbi ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes lokale.

<sup>7</sup> Është profesionisti, sipas legjislacionit në fuqi, që në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të çështjeve do të jetë përgjegjësi për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin, përcjelljen dhe ndjekjen e çështjeve.



Subjektet jopublike si ofrues<sup>8</sup> të shërbimeve sociale, Punonjësi i Shërbimeve Sociale<sup>9</sup>. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitojnë shërbime publike, të tilla si arsimim dhe shëndetësi. Shpenzimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

### Përfundime

Ndryshimet sociale dhe ekonomike me të cilat përballet familja në vitet e fundit kanë nxjerrë në pah nevojën për mbështetje të specializuar nga institucionet publike dhe private. Probleme të tilla si rritja e numrit të divorceve, rënia e nivelit të lindjeve, rritja e moshës së martesës, rënia e numrit të martesave dhe shtimi i numrit të personave që zgjedhin beqarinë si status të tyre familjar, rritja e numrit të partnerëve që jetojnë në bashkëjetesë ose rritja e numrit të fëmijëve të lindur jashtë martese, ka sjellë një transformim të ri të familjes, e cila kërkon një ndërhyrje ligjore dhe politika sociale adekuate. Përmes politikave sociale, Shteti kërkon të sigurojë një ekuilibri midis shërbimeve sociale për familjen dhe format e tjera të tyre, politikat e kujdesit për fëmijët, leja e lindjeve, përfitimet financiare, mbrojtja sociale për të moshuarit dhe çështjet e mbështetjes sociale lokale.

Këto politika janë të nevojshme për të ulur varfërinë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e personave në nevojë në tregun e punës.

Mbrojtja sociale që, gjatë sistemit totalitar u ofrua tërësisht nga shteti, tashmë është deleguar në institucionet përgjegjëse publike dhe private. Grupet shoqërore, pjesë e kësaj skemë, kanë një nivel të ulët arsimimi, shkallë të lartë papunësie, nivel të ulët ekonomik, me një angazhim të ulët në aktivitetin fizik, me një prevalencë të

lartë të gjendjes së dobët shëndetësore, fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe të papunë, nivel të ulët psikologjik, nivel më të ulët të kënaqësisë së shoqërinë ndaj politikave aktuale, vetëbesim të ulët se situata do të përmirësohet, pjesëmarrje të ulët në politikë dhe në aktivitetet shoqërore, mbështetje më të ulët për miqtë ku ata janë në nevojë, nivele të larta mosbesimi, veçanërisht ndaj zyrtarët të pushtetit qendror dhe local si dhe nivele të larta të paafësisë për të paguar qiranë, kujdesin shëndetësor ose ushqimin e nevojshëm për mbijetesë për shkak të gjendjes së varfërisë në të cilën këto grupe ndodhen. Një nga masat institucionale të ndërmarra përmes politikave sociale në zbatimin e varfërisë është shpërndarja e ndihmës ekonomike për të gjithë ata individë që janë të papunë, invalidë, familje të divorcuara ose në nevojë dhe pa mbështetje ekonomike. Fakti është që, procedurat e parregullta dhe jo-transparente, numri i madh i dokumenteve për tu plotësuar, informacioni jo i plotë dhe i paqartë i ofruar nga media ose institucionet përgjegjëse mbi kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për të marrë ndihmë ekonomike, përbëjnë një element që parandalon përfshirjen e të personave të interesuar në këtë skemë. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë stimujt e duhur për t'u angazhuar në çështjet e mbrojtjes sociale dhe ato janë relativisht të paqartë në lidhje me funksionet dhe rolet e tyre se si të arrijnë qëllimet e tyre ose si të sigurojnë mbrojtje sociale për personat në nevojë, ose, të koordinojnë veprimet e tyre me institucionet e tjera përgjegjëse.

Një problematikë tjetër është shuma e ndihmës financiare, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike ose pagesa të tjera të mbrojtjes sociale. Kjo shumë është shumë e ulët dhe nuk mund të përbushë nevojat

<sup>8</sup> Është çdo ofrues jo-publik i licensuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social nga autoritetet përgjegjëse, conform legjisllacionit më fuqi për licensimin.

<sup>9</sup> Është zyrtari që shërbime ndaj kategorisë së përfituesve të shërbimeve të kujdesit social si pjesë e sistemit publik dhe jo publik në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.

themelore mujore të një familjeje. Për 90% të rasteve, kjo shumë mbulon shpenzimet vetëm për një javë. Kontributi financiar i ndihmës ekonomike nuk ka qenë kurrë i indeksuar në bazë të rritjes së pagesës minimale të papunësisë. Për shumë vite ajo u llogarit në bazë të niveleve të përcaktuara nga VKM e 2005, por bazuar në VKM 2016, kjo shumë u rrit. Kjo sepse, pagesa e ndihmës ekonomike bëhet sipas strukturës familjare në një mënyrë “matematikore”, duke nënkuptuar konceptin se “familje më e madhe (më shumë familje anëtarët) më e lartë sasia e parave”. Por fakti është se familjet me më shumë anëtarë janë duke marrë gjithnjë e më pak para nga skema e ndihmës ekonomike për secilin anëtar të familjes së tyre, madje edhe kur numri i anëtarëve të tyre rritet. Në të njëjtën kohë, sasia e kësaj ndihme ekonomike nuk duhet të jetë më shumë se tetë mijë lekë në muaj<sup>10</sup>. Në terma realë, aktualisht ndihma ekonomike është tërësisht e papërshtatshme për të përmbushur nevojat themelore, veçanërisht të familjeve me shumë-anëtarë, dhe efektet e saj në zvogëlimi i varfërisë ose ndryshimi i gjendjes së tyre ekonomike janë minimale, ose më mirë inekzistente.

Sidoqoftë, përfitimet e ndihmës ekonomike në vlerë monetare janë shumë të ulëta, prandaj është akoma “më tërheqëse” puna sesa të jesh/mbetesh pjesë e kësaj skeme. Nga ana tjetër, fakti pse njerëzit qëndrojnë kaq gjatë në skemën e ndihmës ekonomike janë të lidhura me: marrjen e borxheve, huazimin e parave, dërgesave të parave nga të afërmit emigrantë ose dështimin e politikave sociale në promovimin e punësimit për këtë grup vulnerabel.

Në nivel vendi, vetëm 5.1% e të papunëve të regjistruar përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike (burimi Shërbimi Social Shtetëror). Rregulloret në

fuqi janë shumë të rrepta, duke zvogëluar në maksimum gamën dhe numrin e përfituesve. Gratë, si një nga kategoritë në nevojë janë të “bllokuara në situatën e varfërisë”, shfaqin më pak vetëbesim në kapacitetet e tyre, një pakënaqësi ndaj politikave aktuale sociale, duke kërkuar shpesh mbështetjen e familjes së tyre krahasuar kjo me qasjen që kanë burrat, duke ndikuar në pjesëmarrjen e tyre në skemë dhe mbetjen e tyre në “kthetrat” e varfërisë.

Legjislacioni aktual dhe politikat e mbrojtjes sociale po adresojnë çështjet e fuqizimit të grave dhe vajzave përmes ofrimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore si dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna në shoqëri. Por ndikimi i tyre nuk është ai i prituri. Garancia për punën e paguar si një element thelbësor i qytetarisë dhe një mjet i fuqishëm për fuqizimin e grave ofron akses në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre si pjesë e të drejtave themelore të njeriut.

Prandaj, politikat e punësimit të grave do të kishin një ndikim të rëndësishëm në fuqizimin e këtij grupi në nevojë në shoqërinë tonë. Niveli i ulët i besimit tek zyrtarët publikë ndikon në perceptimin që grupet vulnerabel kanë mbi mbështetjen që mund të marrin prej tyre. Kjo ndikon në qasjen e tyre ndaj shërbimeve dhe realizimin e të drejtave nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, dëshmon për dështimin e shtetit dhe institucioneve përgjegjëse në ofrimin e këtyre shërbimeve. Për këtë arsye, Shteti nevojitet të marrë masa serioze për të hequr kufizimet që ndalojnë hyrjen e grupeve në nevojë në skemën e mbrojtjes shoqërore, duke lehtësuar procedurat, duke rritur transparencën dhe koordinimin e tyre veprime midis institucioneve përgjegjëse

<sup>10</sup> Sipas VKM 955/2016, llogaritja e të gjithë shumës së Ndihmës Ekonomike për familjet e përzgjedhura në bazë të formulës progressive, kalkulum ky i bërë mbi strukturën përbërëse familjare por, që nuk mund të jetë më e madhe se vlera 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

për të përmbushur këtë të drejtë të tyre. Sigurimi i informacionit përkatës për të gjithë personat e interesuar përmes mediave dhe institucioneve përgjegjëse do t'i ndihmojë ata të njohin të drejtat e tyre dhe të përfitojnë nga shërbimi.

Gratë, si një grup shumë i prekshëm, në mesin e personave në nevojë, duhet të jenë pjesë aktive e përfituesve të shërbimeve për të lehtësuar varfërinë, për të arritur integrimin shoqëror, punësimin, trajnimin,

ose ndërtimin e kapaciteteve të tyre. Gjithashtu, ndërhyrja direkte në vazhdim përmes ndihmës financiare nga Shteti, ulja e varfërisë duhet të adresohet konkretisht pronë në krijimin e një jete të qendrueshme të grupeve të marginalizuar dhe orientimi i tyre në tregun e punës ose drejt programeve që promovojnë përfshirjen sociale.

Puna në komunitet mund të jetë një përgjigje e mirë ndaj politikave të kujdesit shoqëror dhe përfshirjes sociale.

## REFERENCAT

- Center for Disease Control and Control (CDCC). 2014. National marriage and divorce rate trends, Provisional number and marriages rate: United States, 2001-2001; [http://www.cdc.gov/nchs/nvss/marriage\\_divorce\\_tables.htm](http://www.cdc.gov/nchs/nvss/marriage_divorce_tables.htm) (Konsultuar në Gusht 2014).
- Eurostat. 2014. "Marriage and divorce statistics", [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics\\_explained/index.php/Marriage\\_and\\_divorce\\_statistics#Main\\_statistical\\_findings](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php/Marriage_and_divorce_statistics#Main_statistical_findings) (Konsultuar në Gusht 2014).
- INSTAT. 2013. "Female and Men in Albania", [http://www.instat.gov.al/media/226355/femra\\_meshkuj\\_2013.pdf](http://www.instat.gov.al/media/226355/femra_meshkuj_2013.pdf) (konsultuar më 20 gusht 2019).
- Këshilli i Evropës (KE). 1996. "Karta Sociale Europiane (e rishikuar)", <https://rm.coe.int/168047e169> (parë më 20 gusht 2019).
- Këshilli i Ministrave (KM). 1994. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 311, datë 07.11.1994
- Këshilli i Ministrave (KM). 2000. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 315 datë 23.06.2000
- Këshilli i Ministrave (KM). 2006. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 857 datë 20.12.2006 "Mbi financimin e shërbimeve të kujdesit parësor nga skema e sigurimit social"
- Këshilli i Ministrave (KM). 2006. Vendimi i Këshillit të Ministrave: Standartet cilësore të Shërbimeve Shoqërore.
- Këshilli i Ministrave (KM). 2015. "Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020", [http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Mbrojtjen\\_Sociale\\_2015-2020.pdf](http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf) (parë më 15 janar 2020)
- Këshilli i Ministrave (KM). 2016. Vendimi Nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës, dokumentimit dhe masave mbi përfitimin e ndihmës ekonomike" (ndryshuar nga VKM Nr. 592, datë 18.10.2017).
- Këshilli i Ministrave (KM). 2017. Udhëzim nr. 3, datë 17.02.2017, i ndryshuar, për zbatimin e VKM nr. 955.
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 1972. Ligji Nr. 4976 datë 29.06.1972 "Për Pensionet e anëtarëve të kooperativave agrare";
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2007. Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005, dhe ndryshimet deri në vitin 2007 "Mbi Asistencën Sociale dhe shërbimet e mbrojtjes sociale";
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2011. Ligji Nr. 7710, shfuqizuar në 2005, ndryshuar me Ligjin Nr. 10399 datë 07.03.2011.
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 1993. Ligji Nr. 7703, dhe ndryshimet e tij deri në vitin 2007 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" datë 11.05.1993;
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 1995 Ligji Nr. 7995 datë 20.09.1995 "Mbi nxitjen e punësimit"; <http://www.infocip.org/al/?p=6776> (parë më 14 dhjetor 2019).

- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 1998. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, [http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta\\_2016\\_1082.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf) (parë më 20 dhjetor 2019).
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2000. Ligji 8626 datë 22.06.2000
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2001. Ligji Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse”; [http://www.akdie.org/sites/default/files/ligj\\_per\\_ojf.pdf](http://www.akdie.org/sites/default/files/ligj_per_ojf.pdf) (parë më 20 janar 2020)
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2003. “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”; <https://qbz.gov.al/preview/615c6db4-cfa8-4800-ba51-0444026e441d> (parë më 22 dhjetor 2019).
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2005. Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”; <http://www.vendime.al/ligji-nr-9355-date-10-3-2005-per-ndihmen-dhe-sherbimet-shoqerore-i-perditesuar/> (parë më 22 dhjetor 2019).
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2015. “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), *Fletore zortare*, nr. 220, fq. 1450-14471.
- Kuvendi i Shqipërisë (KSH). 2016. Ligj Nr. 121 “Për shërbimin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”
- Merdani A, Çanaku D, Toçi E, Dedja B. 2014. Analizë e të dhënave të sistemit të survejancës së abortit për vitin 2012; *Buletini i Institutit të Shëndetit Publik*, 2014, fq. 28-32.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). 1948. “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut”; <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf> (parë më 25 janar 2020).
- Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). 1989. “Konventa mbi të drejtat e fëmijës”, [https://sq.wikibooks.org/wiki/Konventa\\_mbi\\_t%C3%AB\\_drejtat\\_e\\_f%C3%ABmij%C3%ABs\\_\(CRC\)/I](https://sq.wikibooks.org/wiki/Konventa_mbi_t%C3%AB_drejtat_e_f%C3%ABmij%C3%ABs_(CRC)/I) (parë më 25 janar 2020).

## ABSTRACT

### Social protection a guarantee for a strong family; Excursus in the Albanian Legal Framework

Social service support to the families is a major national concern. The legislation defines the conditions under which families in difficulties can benefit from state assistance. But the situation remains problematic. This study provided data on the concrete support offered to the families with socio-economic problems by public authorities and NGOs. Data for this study were drawn from the National Social Services database, Local Government officers and active NGOs. In addition, household demographic data and data on families with socio-economic problems were collected. These data's were compared with national census data. Legal framework and studies on this issue will help on identification of factors, undertaken actions and mechanisms to improve the situation. Findings indicated that families in Albania are passing through difficulties on raising their children, economic and social problems caused by several factors like as unemployment, gender violence and inequality, high standard of living, schools abandonment, migration, divorce, poverty. Mostly, families need the support of the authorities on offering them protection and help. Public and local authorities in collaboration with NGOs try to fulfill their needs, but much more need to be done. Moreover, these families are exposed to risk factors and the authority should be more vigilant to action when it's needed. These findings underscore the importance of establishing a more rigorous interdisciplinary, scientific research agenda to inform about the necessary services on supporting the families in need. How to improve the quality of these services, the direct measures and their impact on the improvement of families life's.

*Keywords: family services, social protection, legal framework, public institutions, women, children custody*

# SHQYRTIM EMPIRIK I ROLIT TË MËSUESIT NË PROCESIN MËSIMOR

**Denada QUKU**  
*Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës*  
*Fakulteti i Edukimit*  
*Departamenti i Psikologjisë*  
E-mail: denada.quku@hotmail.com

---

## PËRMBLEDHJE

Nëpërmjet këtij punimi, i cili i referohet shkollës jo - publike Turgut Özal Durrës, synohet të shqyrtohen rolet që ndërmer mësuesi gjatë procesit mësimor, metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies që mësuesi vë në përdorim në klasë, për të motivuar nxënësit, por, edhe ajo çfarë mund të bëhet për të nxitur nxënësit që të jenë të motivuar dhe aktiv në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Qëllimi i këtij punimi përshkruet, empirik i mbështetur në metoda mikse, është të tregojë se sa i rëndësishëm është motivimi në procesin e mësimnxënies dhe në arritjen e rezultateve të larta akademike, identifikimi i teknikave, metodave dhe strategjive efektive motivuese dhe bashkë kohore të përdorura nga mësuesit e shkollës jo - publike "Turgut Ozal" Durrës. Të identifikojë perceptimet e nxënësve dhe mësuesëve lidhur me rëndësinë e këtyre strategjive motivuese dhe ti krahasojë këto perceptime në mënyrë që të identifikohen teknikat më pëlqyera nga nxënësit, pasi vetëm në këtë mënyrë do të kemi nxënës të motivuar së brendshmi. Të sjellë kontributin e tij në rinovimin e metodave tradicionale motivuese, duke nxitur kështu hartimin e politikave të reja arsimore nga vendimmarrësit, si edhe përhapja e këtyre strategjive motivuese në mbarë institucionet e tjera arsimore. Mbledhja e informacionit u realizua nëpërmjet pyetësorëve gjysëm të strukturuar të zhvilluar me 236 nxënësit të klasave X, XI, XII të shkollës "Turgut Ozal" Durrës, me 10 mësues po të këtyre klasave, si edhe me intervista të strukturuar të thelluara me 5 mësues të kësaj shkolle. Nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar rezultoi, se strategjitë që përdorin mësuesit dhe që pëlqehen më shumë nga nxënësit për të motivuar në klasë janë: Ndërtimi i marrëdhënieve

**Denada QUKU** ka përfunduar studimet universitare në programin "Psikologji – Sociologji", sikurse edhe studimet Master Shkencor në "Mësimdhënie në Psikologji – Sociologji" pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Fushat e interesit të autores janë: kërkimi shkencor, shërbimet psiko - sociale dhe edukimi në vazhdim.

të mira me studentët, nxitja e interesit të nxënësve duke e bërë sa më të këndëshëm orën e mësimit, të zbulojë paqartësitë e nxënësve dhe tu japë shpjegim atyre, t'ia bëjë me dije nxënësve që gabimet janë pjesë normale e të mësuarit, të sigurohet që vlerësimi i bërë të reflektojë përpjekjet dhe punën e nxënësit, debatet konstruktive (Tod Talk) konkurse shkencore dhe sociale (ASEF) ku nxënësit promovojnë risitë e tyre, përkushtimi i mësuesve ndaj paqartësive që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor (orët ekstra pa pagesë), teste provë on – line etj. Në vijim të studimit sugjerohen disa rekomandime konkrete sesi të nxisim motivimin e nxënësit në mënyrë që ai të jetë aktiv dhe entuziast gjatë zhvillimit të procesit mësimor dhe jo vetëm.

*Fjalëkyçe: motivim, shpërblim, sukses, përfshirje, strategji motivuese, vlerësim*

## Hyrje

*Në këtë botë ka më tepër guru të shtirur dhe mësues të rremë se sa yje në qiell. Mos i ngatërmoni njerëzit egoistë që tërhiqen nga pushteti me mësuesit e vërtetë. Një mjeshtër i vërtetë shpirtëror nuk e drejton vëmendjen tënde drejt vetes së tij, por të ndihmon të çmosh dhe të adhurosh vetëdijen tënde. Mësuesit e vërtetë janë po aq të tejdukshëm sa dhe qelqi. Ata e lenë Dritën e Zotit t'u kalojë mospërmes. Shamsi i Tabrizit*

Shkolla, si institucion social, e formon, kultivon dhe e laton shpirtin njerëzor. Ajo shërben si një urë lidhëse për formimin e personalitetit të individit, pasi thelbi i profesionit të mësuesit është edukimi dhe arsimimi i nxënësve. Ky profesion është plot me vështirësi, i ndërlikuar dhe i përgjegjshëm. Çdo njeri nuk mund të jetë arsimtar i mirë nëse nuk është i pajisur me virtyte e aftësi, siç janë – qëndrueshmëria, zhdërvjelltësia, këmbëngulja, dituria, kreativiteti, entuziazmi, dashuria e vërtetë ndaj profesionit (Tusha, 2016).

Sipas studiuesit Nuredin Nazarko (2014), shkolla është një institucion ku një rol të rëndësishëm luan grupi i mësuesve. Ky rol ka rëndësi në drejtim të transmetimit të një mënyre sjelljeje e cila është model për nxënësin (Nazarko, 2014). Mësuesit janë të aftë të nxisin nxënësit për ushtrimin e një sërë aftësishë për edukimin e sjelljes së tij në jetën e përditshme (Marinescu,

2002). Mënyra se si sillet mësuesi ndikon në krijimin e një situatë pune në shkollë, apo në të kundërt, për krijimin e një situatë tensioni në klasë (Rapi, 2014). Të gjithë e dimë tashmë dhe e pranojmë se një ndër hallkat më të rëndësishme që lidh nxënësin me rrugën e dijes është mësuesi, i cili me rolin pozitiv dhe misionin e tij fisnik përgatit dhe ndihmon nxënësit për hapat drejt së ardhmes (Faber & Mazlish, 2005). Një mësues që është i aftë profesionalisht dhe me formim të plotë pedagogjik, arrin të jetë edhe një mësues model për nxënësit (Velkani, 2017).

Sipas “Programit Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve” (PISA 2015), ku morën pjesë 28 milion studentë të moshës 15 vjeçare nga 72 shtete, të cilët iu nënështruan testimit 2 orësh në lëndët matematikë, shkencë dhe gjuhë u vu re që kishte një rritje në pikët e marra në këto lëndë, megjithëse ndodheshin poshtë mesatares së përgjithshme në krahasim me Testin e Standartizuar të PISA 2009, ku deklarohesh se Shqipëria kishte vlerësimin më të ulët në Europë në arritjet në matematikë, duke u renditur në vendin e fundit. Megjithatë, problemet janë ende ekzistuese, sepse niveli i nxënësve është akoma larg standarteve të dëshiruara. Nevoja që ka vendi ynë për të përmirësuar arritjet akademike të nxënësve, përbën pikënisjen e këtij hulumtimi duke u bazuar tek literaturat dhe studimet e autorëve të njohur, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh për vendet e tyre edhe më gjërë, duke i konsideruar këto arritje si me shumë vlerë për të ardhmen e vendit tonë.

Profesori i njohur i Psikologjisë B. Musai (1998) në librin e tij “Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies”, shprehet se mungesa e motivimit të nxënësve përbën një shqetësim konstant për institucionet përkatëse (Musai, 1998). Shpesh mësuesi bazohet në një përforcues të vetëm për të motivuar një nxënës për të ndryshuar sjelljen e tij. Problemi është se ka gjasa që forca motivuese e një pasoje të ndryshojë në varësi të individualitetit të nxënësit dhe gjenjdes së tij momentale. Pra, një element mund të mos jetë gjithmonë përforcues. Mësuesit duhet të kenë parasysh që nxënësit kanë nevojë të ndihën të motivuar në procesin e tyre mësimor. Mësuesit duhet të përdorin metoda, teknika apo strategji të ndryshme për të bajtur lart motivimin e nxënësve, i cili rezulton një komponent shumë i rëndësishëm në një pjesëmarrje aktive në orën e mësimi si dhe në një nxënie efektive (Premarck, 2003). Kjo shkollë u zgjodhë nisur nga rezultatet e larta akademike të arritura prej nxënësve të saj në rang lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe nga fakti se duke qenë më e integruar me sistemet bashkëkohore perëndimore të mësimdhënies, pasi një nga kushtet e pranimit në universitetet më të mira botërore është rezultatet e larta në provimin e TOEFL, IBT, SAT, IELTS.

Ndër më të njohurit janë: Gledisi Kallço, që është ndër shqiptarët e rrallë që kanë arritur të pranohen në Massachusetts Institute of Technology (MIT) në SHBA, universiteti i cili në pjesën më të madhe të rankimeve renditet i pari në botë (Albeu. Com, 2017). Gledisi shprehet se:

Ajo që doja të theksoja është fakti se në këtë kolegji bëhet një punë e diferencuar dhe cilësore me talentet. Jo rastësisht të gjithë nxënësit më të mirë në Shqipëri ndjekin këtë kolegji. Personalisht në kolegji m'u krijuan mundësitë që të studioj me metoda bashkëkohore, të marr pjesë në kurset javore të matematikës me pedagogë të njohur, të

studioja një muaj në Turqi para olimpiadave, të merrja pjesë me mbështetjen e kolegjit në olimpiadat ballkanike, të më krijoheshin të gjitha kushtet për të thelluar njohuritë e mia në matematikë dhe shkencë.

## Metodologjia dhe struktura e studimit

### *Struktura e studimit*

Në mënyrë për të identifikifikuar teknikat efektive motivuese, të përdorura nga mësuesit e Shkollës jo - Publike “Turgut Ozal” Durrës, si dhe opinionet e ndryshme të nxënësve në lidhje me këto teknika, si dhe me rëndësinë e përdorimit të metodave specifike motivuese, u zhvillua një studim përshkrues, dhe empirik duke përdorur metodat cilësore dhe sasore në mbledhjen e të dhënave. Përdorimi i metodave mikes në këtë studim synonin përshkrimin, shpjegimin dhe kuptimin e procesit, ku janë zhvilluar pyetësorëve gjysëm të strukturuar dhe intervistave gjysëm të strukturuar të thelluar me 10 mësues të klasave të X, XI, XII të Shkollës “Turgut Ozal” Durrës, si edhe pyetësorë gjysëm të strukturuar me 236 nxënës të po kësaj shkolle, përkatësisht të klasave të X, XI, XII.

### *Pyetjet kërkimore*

Sfida është që të gjithë nxënësit të jenë anëtarë të një bashkësie plotësisht të angazhuar në pjesëmarrje, sepse motivimi buron si nga identiteti, ashtu dhe nga pjesëmarrja legjitime (Mash, 2015). Pyetjet kërkimore mbështen në disa pika (pyetje) kyçe të rëndësishme për motivimin e nxënësve, të tilla si:

1. Cilat janë strategjitë që përdorin mësuesit për të motivuar nxënësit në klasat e X, XI, XII?
2. Si ndikon atmosfera në klasë në motivimin e këtij target grupi nxënësish për të mësuar?
3. Cilët janë faktorët që ndikojnë në motivimin e këtyre nxënësve në klasë?
5. Si ndikojnë metodat dhe teknikat

gjithpërfshirëse të përdorura nga mësuesit për të nxitur motivimin e nxënësve të marrë studim?

6. Cili është roli i mësuesit në angazhimin e nxënësit në procesin mësimor?

#### *Instrumentat kërkimotë të përdorur*

Në këtë studim përshkruet, dhe empirik janë përdorur një larmi instrumentash (pyetësorë dhe intervista)

#### *Pyetësorët e drejtuar nxënësve*

Pyetësori i ndërtuar është huazuar nga Dörnyei & Csizér (1998), një pyetësor i standartizuar, i bazuar në teoritë motivacionale (teoria e atribuimit dhe teoria e qëllimit, të cilat janë të rëndësishme për mënyrën se si shkaqet i atribuohen arritjet e mëparshme, pasi arritjet ndikojnë në pritjet e ardhshme të qëllimit; 2. teoritë njohëse (kognitive) të motivimit, i cili është një funksion i mendimeve të një personi, veçanërisht ato që lidhen me “vetë” i nxënësit, të tilla si vetë - efikasiteti, vetëbesimi dhe nevoja për arritje; dhe 3. situata e të mësuarit në klasë) dhe i ndërtuar mbi bazën e 30 strategjive, por duke qenë se në focus të studimit tim përfshiheshin 27 strategji u shtuan në pyetësor dhe pyetje të hapura, në mënyrë që mësuesit të kishin sa më shumë mundësi të shprehnin mendimet e tyre.

Përsa i përket strukturës së pyetësorëve ato janë ndarë në 3 blloqe: të dhëna demografike emri i shkollës, klasa, gjinia) 27 pyetje me alternativa, ku për formulimin e këtij pyetësori është përdorur shkalla Likert e ideuar nga psikometriku amerikan Rensis Likert (1932) me qëllimin e krijimit të një instrumenti më të thjeshtë për matjen e opinionëve dhe sjelljeve të njerëzve. Në këtë rast variablat e përdorura janë ordinale (alternativat renditen sipas shkallës Likert: shumë e rëndësishme, e rëndësishme, relativisht e rëndësishme, pak e rëndësishme, aspak e rëndësishme) dhe 4 pyetje gjysëm të strukturuar ku nxënësve u kërkohet të thonë se, në çfarë formash shpërblehen për detyrat

e realizuara me sukses, si vepron mësuesi për të ndaluar sjelljet jo të mira, ose cilat janë disa nga aktivitetet e tyre të parapëlqyera, si edhe sa të rëndësishme janë disa metoda dhe teknika motivuese në dallim nga disa të tjera.

#### *Pyetësorët drejtuar mësuesve*

Përsa i përket strukturës së pyetësorëve ato janë ndarë në 3 blloqe: të dhëna demografike (emri i shkollës, lënda që jepni mësim, mosha, përkatësia etnike, arsimi, vjetërsia e punës), 27 pyetje me alternative. Pyetjet e paraqitura janë të grupuara në disa 9 kategori, në sajë të përmbajtjes që mbartin (karakteristikat e sjelljes së një mësuesi efektiv, vërejtja e përpjekjeve të nxënësve ,nxitja e vetëbesimit të nxënësit, etj) dhe për formulimin e këtij pyetësori është përdorur Shkalla Likert, e ideuar nga psikometriku amerikan Rensis Likert (1932) me qëllimin e krijimit të një instrumenti më të thjeshtë për matjen e opinionëve dhe sjelljeve të njerëzve. Në këtë rast variablat e përdorura janë ordinal (alternativat renditen sipas shkallës Likert: shumë e rëndësishme, e rëndësishme, relativisht e rëndësishme, pak e rëndësishme, aspak e rëndësishme), si edhe 4 pyetje të hapura për të dhënë mundësi mësuesit të shprehet më shumë rreth strategjive motivuese që përdorin me nxënësit gjatë procesit mësimor, faktorët që ndikojnë në motivimin e nxënësve dhe disa nga problemet që lidhen me motivimin e nxënësve në klasat përkatëse.

Pyetësori është ndarë në 9 kategori specifike, si më poshtë:

I. “Karakteristikat e sjelljes së një mësuesi efektiv” (Të shpjeguarit të lëndës me pasion. Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me studentët).

II. “Mësuesi duhet të vërejë përpjekjet e nxënësve” (Të sigurohet që vlerësimi i bërë të reflektojë përpjekjet dhe punën e nxënësit. Të monitorojë sukseset e nxënësve dhe të festojë arritjet e tyre. T’i bëjë të ditur nxënësve se sa ata kanë mësuar apo kanë bërë progress).



III. “Metodat që nxisin vetëbesimin tek nxënësit” ( T’i përgjigjet menjëherë nxënësit kur bëjnë pyetje lidhur me mësimin. T’ia bëjë me dije nxënësve që gabimet janë pjesë normale e të mësuarit).

IV. “Metodat që ndjekin mësuesit për krijimin e një atmosfere sa më të këndëshme në klasë” ( Përdorimi dhe inkurajimi i humorit në klasë. Nxitja e interesit të nxënësve duke e bërë sa më të këndëshme orën e mësimit. Bërja e detyrave tërheqëse, duke përdorur lojra të ndryshme e konkurrese. Përdorimi i aktiviteteve të shkurtra e tërheqëse, si teknikë interesante para nisjes së shpjegimit të mësimit).

V. “Metodat që përdorin mësuesit për të paraqitur qartësisht detyrat” (Shoqërimi i të shpjeguarit të lëndës me shembuj të kuptueshëm nga jeta e përditshme. Shjegimi dhe kuptimi se përse një detyrë është e rëndësishme të kryet. Përdorimi i shembujve individual për përgatitjen e nxënësve për situatat reale të jetës).

VI. “Metodat që përdorin mësuesit për të orientuar nxënësit në vendosjen e qëllimeve” ( Të inkurajojë studentët për vendosjen e qëllimeve individuale. Të zbulojë paqartësitë e nxënësve dhe t’u japë shpjegim atyre).

VII. “Metodat që përdorin mësuesit për të nxitur përqëndrimin e nxënësve në mësim” ( Realizimi i orës mësimore në formë të ndryshme, jashtë formatit standart. Dhënia e detyrave sfiduese. Të fillojë gjithnjë mësimin me një teknikë prezantimi).

VIII. “Metodat që përdorin mësuesit për të nxitur punën në grup dhe arritjen e objektivave të përbashkëta tek nxënësit” (Nxitja e studentëve për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Të lejojë dhënien e sugjerimeve nga nxënësit lidhur me rregullat në klasë. Të ftojë studentët më të mirë për të ndarë eksperiencat e tyre sesi të arrijnë një të mësuar të suksesshëm. Të nxisë nxënësit të njohin njëri-tjetrin. Zbatimi i detyrave që nxisin ndërveprimin e nxënësve me njëri-tjetrin).

IX. “Metodat që përdorin mësuesit për t’i inkurajuar nxënësit, të mësuarin e pavarur” (Të inkurajojë nxënësit të gjejnë vetë gabimet në detyrat e tyre. Mundësimi i një larmie zgjedhjesh, kur dhe si mund të testohen njohuritë. Përkrahja e nxënësve në mënyrë që të kenë kurajë të ndërrmarin iniciativa të ndryshme).

#### *Intervistat e zhvilluara me mësuesit*

Lloji i intervistës së përdorur me 5 mësuesit është ajo gjysëm e strukturuar e thelluar, e cila u jep atyre më shumë mundësi për tu shprehur dhe për të dhënë opinionet e tyre në lidhje me motivimin e nxënësve (Corbetta 1999). Intervista konsiston në 9 pyetje të hapura lidhur me rëndësinë e rolit të mësuesit si figurë nxitëse në motivim, si dhe strategitë, teknikat dhe metodat e përdorura nga ata për të nxitur nxënësit gjatë procesit mësimor.

#### *Popullata e përzgjedhur e nxënësve*

Popullata e marrë në studim përbëhet nga 236 nxënës të moshave 16 - 18 vjeç në Shkollën jo - Publike “Turgut Ozal” të qytetit të Durrësit. Ajo është një popullatë heterogjene e shtresëzuar. Përsa i përket gjinisë së tyre, 56 % janë vajza dhe 44 % janë djem. Sipas studimit të kryer 2 vite më parë nga (Quku, 2017) është rritur me 2 % dhe arsimimi i djemve në këtë shkollë. Nxënësit i përkisnin arsimimit të mesëm, veçanërisht klasat e X, XI, XII. Përkatesisht, XA, XB, XC, XD; XIA, XIB, XIC, XID; XIIA, XIIB, XIIC.

#### *Popullata e përzgjedhur e mësuesve*

Popullata e marrë në studim përbëhet nga mësues, të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre në ciklin e mesëm të Kolegjit “Turgut Ozal” Durrës. Në studim marrin pjesë 10 mësues të moshave 32 - 72 vjeçare. Nga studimi i kryer 2 vite më parë është shtuar marrja e mësuesve me eksperiencë të lartë, duke nisur nga 10-15 vite - mbi 25 vite, përfshirë mësues me titullin “Mjeshtër” (Quku, 2018).

Popullata e marrë në studim është heterogjene, nëse merret si kriter moshë, gjinia, përkatësia etnike niveli i kualifikimit dhe vjetërsia e punës, 70% prej të subjekteve të studiuar mbartnin titullin 'master' ndërsa 30% e tyre kishin kryer vetëm 'arsimin e lartë'. Përsa i përket gjinisë së tyre, 80% të tyre rezultojnë të jenë femra dhe 20% të tyre meshkuj, 90% janë shqiptarë dhe 10% të huaj (turq).

#### *Çështjet etike të studimit*

Studimi u zhvillua, duke respektuar çështjet etike, si me subjektet dhe me procesin e mblledhjes së të dhënave. U respektua anonimati i mësuesve dhe nxënësve tek plotësimi i pyetësorve, si dhe konfidencialiteti i mësuesve tek faza e intervistimit. Subjekteve të studimit (mësuesve) iu kërkua të shënonin vetëm inicialet e emrit, duke i mundësuar kështu një lirshmëri në të shprehur. Në të dyja fazat e studimit, subjektet u informuan për qëllimin e studimit, llojin e pyetjeve dhe mënyrën sesi do të përpunoheshin, analizoheshin dhe paraqiteshin rezultatet

e marra. Mësuesve dhe nxënësve iu bë e qartë, se ishin të lirë të mos i përgjigeshin pyetjeve, të cilat cënonin në një farë mënyre privatësinë e tyre. Si dhe iu bë e qartë, se mund të tërhiqeshin nga procesi i intervistimit në momentin kur ata ndiheshin nën presion apo kishin mungesë interesi. Për të ruajtur konfidencialitetin, asnjë prej të dhënave identifikuese të marra nga intervista e mësuesve nuk u nda verbalisht me shkrim, ose me dëgjim me asnjë nga anëtarët e institucionit shkollor. Para administrimit të instrumentit, u shpjegua qartësisht se intervista ishte plotësisht vullnetare dhe kishin lirinë për të refuzuar vazhdimin e saj.

#### **Gjetje dhe diskutime**

Teknikat e paraqitura në pyetësor janë të grupuara në disa 9 kategori, në sajë të përmbajtjes që mbartin (karakteristikat e sjelljes së një mësuesi efektiv, vërejtja e përpjekjeve të nxënësve ,nxitja e vetëbesimit të nxënësit etj). Sipas perceptimeve të marra nga mësuesit dhe nxënësit dhe duke i krahasuar ato midis njëri – tjetrit arritëm

**Tabela 1:** *Krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga mësuesit dhe nxënësit*

Metodat e motivimit	Perceptimi i mësuesve në %	Perceptimi i nxënësve në %
Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me nxënësit	90	84
Të sigurohet që vlerësimi i bërë të reflektojë përpjekjet dhe punën e nxënësve	90	55
Nxitja e interesit të nxënësit, duke e bërë sa më të këndshme orën e mësimit	90	71
Nxitja e nxënësve për arritjet e qëllimeve të përbashkëta	80	48,3
Shoqërimi të shpjeguarit të lëndës me shembuj të kuptueshëm nga jeta e përditshme	70	55,9
Të inkurajojë nxënësit për vendosjen e qëllimeve individuale	60	56
T'ia bëjë me dije nxënësve që gabimet janë pjesë normale e të mësuarit	30	60
Dhënia e detyrave sfiduese	30	34,5

**Tabela 2:** *Krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga djemtë dhe vajzat*

Metodat e motivimit	Perceptimi i vajzave në %	Perceptimi i djemve në %
Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me nxënësit	48	36
Përdorimi i aktiviteteve të shkurtra e tërheqëse, si teknikë interesante përpara nisjes së shpjegimit të mësimit	39,9	31,3
Të sigurohet që vlerësimi i bërë të reflektojë përpjekjet dhe punën e nxënësve	38	21
T'ia bëjë me dije nxënësve që gabimet janë pjesë normale e të mësuarit	37,2	23,3
Nxitja e nxënësve për arritjet e qëllimeve të përbashkëta	34,7	25,4
Shoqërimi të shpjeguarit të lëndës me shembuj të kuptueshëm nga jeta e përditshme	33	21
Të zbulojë paqartësitë e nxënësve dhe tu japë shpjegim atyre	30	25
Realizimi i orës mësimore në forma të ndryshme, jashtë formatit standart	19	19

në disa tema të rëndësishme që ia vlen të diskutohet, pasi prioritet në studim i jepet mënyrës sesi ta nxisim dhe motivojmë nxënësin për të dalë me rezultate të larta akademike, të motivohet së brendshmi për të studiuar dhe për ndërë kënaqësi nga marrja e njohurive të reja.

Si edhe një element tjetër i rëndësishëm për tu diskutuar janë dhe dallimet gjinore në perceptimet që kanë vajzat dhe djemtë në lidhje me teknikat motivuese nga ana e mësuesve. Le të shqyrtojmë disa çështje.

E para, krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga mësuesit dhe nxënësit. Në tabelën 1 është paraqitur krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga mësuesit dhe nxënësit. Më pas, është diskutuar rreth dallimeve ose ngjashmëive rreth këtyre perceptimeve.

Nga të dhënat lidhur me kategorinë I (Karakteristikat e sjelljes së një mësuesi efektiv), del se, së bashku, si mësuesit dhe nxënësit (90% mësues dhe 84% nxënës) e shohin shumë të rëndësishme teknikën e ndërtimit të marrëdhënieve të

mira me nxënësit si të shprehurit e fjalëve duke përdorur gjestet, shprehjet e fytyrës, gjuhën e trupit dhe ndryshimet e tonit të zërit për të komunikuar me nxënësit, duke qenë të ndjeshmëm ndaj shqetësimeve e vështirësive që kanë një kategori nxënësish, të cilët bartin probleme sociale e familjare, ekonomike e psikologjike, pavarësisht kulturave të ndryshme, nuk paragjykojnë askënd, madje ineresohen ti njohin nxënësit dhe trashëgimitë që ata mbartin. Të gjithë këta elementë ndihmojnë në motivimin e nxënësve dhe kjo reflektohej dhe në arritjet e tyre të larta akademike.

Për kategorinë IV (Metodat që ndjekin mësuesit për krijimin e një atmosfere sa më të këndëshme në klasë; Nxitja e interesit të nxënësve duke e bërë sa më të këndëshme orën e mësimit), mund të shtojmë se jo vërehet dhe në literaturën e gjetur ku një strategji të shumë e rëndësishme e cila nxit pjesëmarrjen e nxënësit në orën mësimore është përdorimi i lojrave. Kur lojrat apo konkurset janë prezente gjatë orës mësimore, motivimi i nxënësve rritet në një mënyrë dramatike (Afari et al., 2012).

Duke qënë se lojrat janë shumë të pëlqyera nga nxënësit. Ndodh shpesh kur mësuesit vënë në përdorim interesat apo kënaqësitë personale të nxënësve si mënyrë për të nxitur motivimin e tyre (Rissanen, 2014).

E dyta, krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga vajzat dhe djemtë. Në tabelën 2 është paraqitur krahasimi i perceptimit të metodave të motivimit të pëlqyera nga vajzat dhe djemtë dhe më pas është diskutuar rreth dallimeve ose ngjashmëive rreth këtyre perceptimeve.

Nga të dhënat e marra shikohet se ka një diferencë prej 10% dallueshmërie midis metodave të pëlqyera nga djemtë dhe vajzat. Për t'u theksuar është konstatimi lidhur me diferencat gjinore në marrëdhënien me mësuesit. Sipas analizës përshkruese të përdorur për të mbledhur të dhënat e marra nga përgjigjet e vajzave dhe djemve (48% vajza dhe 36% djem) për të parë nëse kishin dallime gjinore në përzgjedhjen e teknikave të caktuara, dolëm në rezultatin se mësuesve i del si detyrë që të forcojnë marrëdhënien me nxënësit, sidomos me nxënësit e viteve më të larta dhe sidomos me djemtë, pasi numëri i tyre vjen në ulje me kalimin e viteve dhe të rrisin komunikimin efektiv me vajzat, pasi nga të dhënat e marra edhe numëri i vajzave është në ulje me kalimin e viteve. Sipas analizës përshkruese të përdorur për të mbledhur të dhënat e marra nga përgjigjet e vajzave dhe djemve (39,9% vajza dhe 31,3% djem) për të parë nëse kishin dallime gjinore në përzgjedhjen e teknikave të caktuara. Përgjigjet u vlerësuan për dallimet gjinore në preferencën e stilit të mësimi.

Nga pyetjet e hapura drejtuar nxënësve, mund të veçojmë:

Së pari, pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se format më e shpeshtë të shpërblimit janë: lavdërimet, vlerësimi me PLUS për detyrën e kryer me sukses dhe pluse për aktivizimin e nxënësve në mënyrë që ti motivojnë ato. Ata shprehen se 3 pluse = 10, dhe e komentuar me fjalë (lavdërim) nga ana e mësuesit, përdorimin

e teknologjisë, heqjen e detyrave që duhet të realizoheshin në shtëpi, si dhe aktivitetet sportive në oborrin e shkollës.

Së dyti, pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se metodat që përdorin mësuesit për të ndaluar sjelljet jo të mira janë: Pjesa më e madhe e nxënësve u shprehën se ata ndëshkoheshin me minuse për mos realizimin e detyrave të kërkuara nga mësuesja. Për çdo sjellje të pahijshme gjatë orës mësimore hiqen pikë minus, dhe në qoftë se nxënësi merr shumë minuse, atij rrezikohet ti ulet një notë. Në rast se sjelljet pahijshme ndodhin shpesh, nxënësve u hiqen pike në disipline dhe dërgohen në "Komisionin e Disiplinës", ku marrin pezullime deri në përjashtime. Në udhëzuesin dhe rregulloren e shkollës që u jepet si mësuesve, nxënësve dhe prindërve në fillim të vitit të ri shkollor janë paraqitur se çfarë sjelljesh priten nga prindërit, nxënësit, rregullat e klasës dhe mësimi, rregullat e shkollës, rregullat e veshjes, rregullat e menzës dhe kafeterisë, rregullat e bibliotekës, rregullat e internetit, rregullat e mjekut, rregullat e vizitorëve.

Së treti, pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se aktivitetet që pëlqenin më shumë të zvilloheshin gjatë procesit mësimor janë të renditura për nga rëndësia: mësimi i shoqëruar me praktikë (1), puna në grup (2), debatet konstruktive (3), konkurse midis klasave (4), veprimtari humane (5), takim me ekspertë të fushave të ndryshme për të folur rreth profesionit të tyre (6), olimpiadat shkencore (7).

Së katërti, pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se aktivitetet që pëlqenin më shumë për t'u zvilluar jashtë procesit mësimor janë të renditura për nga rëndësia: eskursion jashtë vendit (1), eskursion brenda vendit (2), piknik (3), kinema (4), klube sportive (5), shkolla verore (6).

Le të kalojmë tek analizimi dhe diskutimi i gjetjeve të marra nga të dhënat e grumbulluara nga intervista individualve me mësuesit:

1. Nga të dhënat e mbledhura nga

intervistat e kryera me mësuesit e shkollës jo – publike “Turgut Ozal”, u vu re se motivimi i nxënësve është shumë i rëndësishëm, pasi e bën nxënësin më të përgjegjshëm, rrit vetëbesimin e tij, zhvillon personalitetin, nxit atë emocionalisht dhe rrit progresin në mësim.

2. Nga të dhënat e mbledhura nga intervistat e kryera me mësuesit e shkollës jo – publike “Turgut Ozal”, u vu re se nxitja e kureshtjes është një faktor i rëndësishëm në të nxënëet e tyre. Prandaj realizimi i orë mësimore në mënyrë sa më të këndëshme, duke paraqitur temën në forma të ndryshme; power - point, video online, lojra, konkurse midis grupeve do të nxiste interesin dhe kureshtjen e nxënësve për të mësuar gjëra të reja.

3. Metodatat e përdorura nga mësuesit për ta mbajtur nxënësin aktiv por edhe entuziast në lidhje me mësimnxënien. Mësuesit shprehen se Konkursi shkencor dhe Inxhinierik i Shqipërisë (ASEF) është një nga metodatat për të mbajtur nxënësin aktiv pasi i ofron nxënësve mundësinë të paraqesin studimet e tyre (shoqërore apo shkencore), duke i nxitur ata të jenë kërkues të vazhdueshëm ndaj informacioneve bashkëkohore.

4. Strategjitë e ndjekura nga mësuesit për të shpjeguar paqartësitë e nxënësve gjatë procesit mësimor. Mësimet ekstra dhe pa pagesë në fundjavë, ose përgjatë orëve të pushimit do ti mundësojnë nxënësve të rikuperojnë boshllëqet dhe vështirësitë që hasin ato gjatë temave të caktuara mësimore.

5. Metodatat e përdorura për të mbajtur mësuesit në kontakt me teknikat e reja bashkëkohore, të tilla si: trajnimet e vazhdueshme nga shkolla (kombëtare dhe ndërkombëtare) si në fillim të vitit shkollor por edhe përgjatë tij, i ndihmon mësuesit të jenë në kontakt me teknikat e reja të mësimdhënies.

6. Motivimi dhe vlerësimi i mësuesve nga drejtuesit e institucionit për punën e arrirë. Stimujve moral, falenderimeve,

vlerësimeve pozitive për punën e bërë, eskursioneve që bëhen me përgjysmim pagese për të gjithë stafin pedagogjik, dhe kjo shërben dhe si nxitje për të ndërtuar marrëdhënie sa më të mira midis kolegëve. Marrja e letrës së performancës në fund të vitit bën që edhe vetë mësuesit kanë mundësi të kontrollojnë dhe vetë objektivat e arritura prej tyre, si edhe ti përmirësojnë ato gjatë vitit pasardhës. Sipas totalit të pikëve të marra, gjithsecili prej tyre paguhet me një shtesë rroge e cila vijon nga 3 000 – 5 000 lekë të reja, në vitin pasardhës.

7. Promovimi i nxënësve të suksesshëm, si shembull për tu marrë nga bashkëmoshatarët. Ata paraqiten si të ftuar para një audience, e cila konsiston nga nxënës të rritur, ku diskutojnë e flasin rreth rrugëtimit të tyre, përpjekjeve të shumta humbjeve por edhe suksesve. Kështu këto mbledhje që tashmë janë bërë traditë e kësaj shkolle, kanë marrë më së shumti një karakter të një ligjërate motivuese, që ka për qëllim nxitjen e brezave të ardhshëm.

8. Nxitja e nxënësve të punojnë në grup dhe dhënia e ndihmesës së tyre në komunitet jashtë procesit mësimor, si: dhënia e mësimeve falas në gjuhën angleze një herë në javë për fëmijët e komunitetit, projekte të ndryshme fitimprurëse për të siguruar të ardhura për njerëzit në nevojë si psh: njoftimi për grumbullimin dhe mbledhjen e tapave plastike dhe lidhja e marrëveshjeve me bankat e ndryshme për konvertimin e tyre në para për të siguruar karrocë invaliditeti. Të qenurit pjesë e programeve vullnetare apo shërbimeve sociale në kuadër të përmirësimit të komuniteteve përkatëse në nevojë. Vetë shkolla ndërmerr nisma të tilla si: ‘Grupi Shpresa’, i cili është i formuar nga një grup nxënësish përfaqësues të të gjithë nxënësve të kësaj shkolle, të cilët organizojnë mbledhjen e ndihmave, që konsistojnë në ndihma ushqimore, veshmmbathje, materiale didaktike për komunitetet në nevojë.

## Përfundime dhe rekomandime

Nga studimi që u krye u vu re se roli i mësuesit është një hallkë kyçe në motivimin e nxënësit, prandaj bashkëpunimi mësues – nxënës është shumë i rëndësishëm në arrijtjet e larta akademike të nxënësve, si edhe motivimi është një komponent shumë i rëndësishëm për përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor, së bashku me përforsuesit si: vlerësimet e vazhdueshme (“lexuesi i muajit”, “klasa e muajit”), duke e vënë theksin tek përpjekja dhe se me vullnet mund të arrihet gjithçka, vlerësimi me certifikata pjesëmarrjeje dhe fituese si dhe shpërblimi me eskursionë jashtë dhe brenda vendit. Nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar rezultoi, se strategjitë që përdorin mësuesit dhe që pëlqehen më shumë nga nxënësit për të motivuar në klasë janë: Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me studentët, nxitja e interesit të nxënësve duke e bërë sa më të këndëshme orën e mësimit, të zbulojë paqartësitë e nxënësve dhe tu japë shpjegim atyre, t’ia bëjë me dije nxënësve që gabimet janë pjesë normale e të mësuarit, të sigurohet që vlerësimi i bërë të reflektojë përpjekjet dhe punën e nxënësit, shoqërimi i të shpjeguarit të lëndës me shembuj të kuptueshëm nga jeta e përditshme, përkrahja e nxënësve në mënyrë që të kenë kurajë të ndërmarrin iniciativë të ndryshme, nxitja e studentëve për arrijtjen e qëllimeve të përbashkëta, debatet konstruktive (Tod Talk) konkurse shkencore dhe sociale (ASEF) ku nxënësit promovojnë risitë e tyre, përcaktimi i objektivave bashkë me nxënësit, përkushtimi i mësuesve ndaj paqartësive që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor (orët ekstra pa pagesë), lavdërimet e ndryshme, teknikat që nxisin të mësuarin në mënyrë të pavarur, parapregatitje me teste on – line, prezantimi i temës ditore me Power Point dhe Video Online duke bërë orën e mësimit sa më interesante, teknikat mësimdhënëse jashtë standartit të përcaktuar për të nxitur kureshtjen e nxënësve, duke i dhënë kështu

mësuesve të vendosin në mënyrë individuale sesi mund ta realizojnë ata një orë mësimi duke marrë dhe opinionin e nxënësve, etj. Një faktor tjetër motivues është dhe marrja parasysh dhe aktiviteteve që nxënësit pëlqejnë gjatë orës mësimore, si: 1. Mësimi i shoqëruar me praktikë. 2. Puna në grup. 3. Debatet konstruktive dhe aktivitete jashtë procesit mësimor: 1. Eskursion jashtë vendit. 2. Eskursion brenda vendit. 3. Piknik, pasi do të shërbejnë si përforsues nga mësuesit për të nxitur sjelljet e dëshiruara. Një faktor i rëndësishëm në motivimin e nxënësit dhe në formimin e plotë të personalitetit të tij është dhe vullnetarizmi. Vullnetarizmi zhvillon ndjenja humane dhe rrit përgjegjshmërinë e individëve. Të mësuarit nga puna sociale, është një strategji e cila konsiderohet të jetë mjaft e suksesshme për të rikrijuar lidhje midis nxënësit dhe shkollës. Në kohën e sotme është mjaft e lehtë për fëmijën të shkëpusë lidhjet me shkollën, por nëse ata lidhen me një ambient siç janë qendrat vullnetare, ku ato bashkëpunojnë në grup, kjo lidhje do të ketë ndikim dhe në sfera të tjera. Prindërit nisin të shohin potenciale të reja, mundësi të reja, elemente të reja të shfaqura tek fëmija e tyre. Mësuesit arrijnë të shohin aftësitë e reja tek ky fëmijë dhe në këtë mënyrë hapen shumë rrugë të reja për ta. Të mësuarit nga puna sociale është një burim i cili rrit motivimin e nxënësit.

Duke qenë se motivimi është ai, i cili të gjallëron, drejton dhe mbështet sjelljen e njeriut, mësuesit të cilët e duan profesionin e tyre dhe e ushtrojnë atë me pasion, do ta nxisin nxënësin ta dojë dhe ta studiojë librin, pasi të lexuarit dhe të mësuarit zgjat gjatë gjithë jetës, sepse sa më i paditur të jetë njeriu aq më tepër trembet jetës dhe vështirësive të saj. Ja edhe disa rekomandime për mësuesit:

Së pari, nga ky studim shihet që roli i mësuesit është një hallkë kyçe në motivimin e nxënësit, prandaj bashkëpunimi mësues – nxënës është shumë i rëndësishëm në arrijtjet e larta akademike të nxënësve dhe në këtë mënyrë mësuesit i del si detyrë duhet

të forcojnë marrëdhënien me nxënësit, sidomos me nxënësit e viteve më të larta dhe veçanërisht me djemtë.

Së dyti, duhet të merren për bazë edhe opinionet e nxënësve, perceptimet e nxënësve dhe të zhvilluarit e mësimit jashtë standartit.

Së treti, shtimi i trajnimeve në lidhje me këtë larmi të stileve të të nxënit, pasi edhe nga studimi doli që djemtë dhe vajzat kishin perceptime të ndryshme në lidhje me metodat e mësimit.

Së katërti, të merren parasysh aktivitetet që parapëlqejnë nxënësit, për tu përdorur më pas si përforcues nga mësuesit.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, strategjitë motivuese, teknikat e mësimit dhe metodat që këta mësues përdorin duhet të shqyrtohen dhe të testohen nëpër shkolla pilot, pasi kanë qenë shumë efektive në

rritjen e motivimit të nxënësve dhe kjo pasqyrohet në rezultatet dhe arritjet e tyre të larta, si edhe tek dëshira që ata kanë për të lexuar, studiuar dhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me të rejtat e fundit nga arti dhe shkenca, për të parë efikasitetin e tyre dhe më pas organet vendimmarrëse që hartojnë politikat shkollore të dalin në përgjithësi konkrete duke ia parashtruar mësuesve të çdo shkolle, pasi ne duam që nxënësit të besojnë se suksesi vjen nëse ata zbatojnë strategji të mira mësimore, në vend që të besojnë se i vetmi opsion i tyre është të përdorin strategji të pafrytshme, thjesht për të shmangur dështimin dhe për të ruajtur aparençën. Kur gjërat të vëshyrosohen, ne duam që nxënësit të qëndrojnë të përqendruar në detyrë dhe të mos shqetësohen deri në atë masë për dështimin, sa të “mpihen.”

## REFERENCAT

- Allan, B., & Pease, B. (2014). *Gjuba e trupit*. Tiranë: Liloprinting
- Bandura, A. (1995). *Self-Efficacy in Changing Societies*. New York: Cambridge University Press.
- Biçaku, N. (2018). “Drejtori IZHA - s, Janaqi: trajnimet e mësuesve, të vlefshme për punën e tyre”. *Portali Shkollor*. Gjetur 12 Prill Tetor 2019 nga: <http://www.portalishkollor.al/news/drejtori-izha-s-janaqi-trajnimet-e-mesuesve-te-vlefshme-per-punen-e-tyre>
- Blaceri, M. (2017). “Albanian student admitted to one of world’s best Universities”. *Agjensia Telegrafike Shqiptare*. Gjetur 12 Prill 2019 nga: <http://arkiva.ata.gov.al:8080/albanian-student-admitted-to-one-of-worlds-best-universities/>
- Boeree, G. C. (2004). *Teoritë e Personalitetit*. Tiranë: Plejad
- Bronfenbrenner, U. (1976). *Ecological Models of Human Development*. New York: W.H.Freeman
- Brophy, J. E. (2010). *Motivating Student To Learn*. New York: Routledge
- Bruner, J. S. (1960). *The Process of Education*. USA: Haward University Press
- Callahan, M. (2012). How Do I Motivate My Students? *Teacher’s Guid*. Gjetur: 05 Mars 2016, nga: [https://www.depts.ttu.edu/tlpdc/Resources/Teaching\\_resources/TLPDC\\_teaching\\_resources/Documents/HowdoIMotivateMyStudentswhitepaper.pdf](https://www.depts.ttu.edu/tlpdc/Resources/Teaching_resources/TLPDC_teaching_resources/Documents/HowdoIMotivateMyStudentswhitepaper.pdf)
- Cela, A. (2018). Procesi i të nxënit dhe portofoli i nxënësit. *Portali Shkollor*. Gjetur: 4 Mars 2019 nga: <http://www.portalishkollor.al/kuriozitet/procesi-i-te-nxenit-dhe-portofoli-i-nxenesit>
- Covey, S. R. (1989). *The Seven Habits of Highly Effective People*. New York: Print (Hardcover, Paperback).
- DeLong, M., & Winter, D. (2002). “*Learning to Teaching and Teaching to Learn Mathematics*”: *Resources for Professional Development*. United States: Mathematical Association of America
- Dolto, F. (1994). *Etapat Kryesore të fëmijërisë*. Tiranë: Toena

- Dörnyei, Z., & Csizér, K. (1998). Ten commandments for motivating language learners: results of an empirical study. *Language Teaching Research* 2, 3 (1998); pp. 203–229. Gjetur: Prill 2019 nga: <https://pdfs.semanticscholar.org/aa56/1ec94222106e367cde1aed0bc308b74b3297.pdf>
- Epstein, J. L. (2001). *School, Family and Community Partnerships*. California: Corwin Press, Inc
- Erikson, E. H. (1950). *Childhood and Society*. New York: W.W. Norton & Company, Inc
- Faber, A., & Mazlish, E. (2005). *Si të flasim me adoleshentët*. Tiranë: Kristalina
- Forsyth, D. R., & McMillan, J. H. (1991). What Theories of Motivation Say About Why Learners Learn. *New Directions for Teaching and Learning*. 45: 39-51.
- Freiberg, H. J (1999). *Perceiving, Behaving, Becoming: Lessons Learned*. Alexandria, Virginia USA: ASCD
- Goleman, D. (2018). *Inteligjenca Emocionale*. (Pse mund të ketë rëndësi më shumë se IQ – ja?) Prishtinë: Pema
- Hoxhaj, A. (2018). “PARIMET E KODIT TË ETIKËS: Kodi i etikës së mësuesit në Amerikë”. *Portali Shkollor*. Gjetur: 4 Mars 2019 nga: <http://www.portalishkollor.al/kuriozitet/kodi-i-etikes-se-mesuesit-ne-amerike>
- Karaj, Th. (2005). *Psikologjia e stresit*. Tiranë: Emal
- Karaj, Th. (2010). *Psikologjia e Zhvillimit Të Fëmijës*. Tiranë: Emal
- Kashahu, L & Karaj, S. (2016). “Academic Achievements of Adolescents and Family Functioning.” Gjetur: 3 Mars 2019
- Kirby, E., & McDonald, J. (2009). *Engage Every Student (Motivation, Tools for Teachers and Parents)*. Minneapolis, MN: Search Institute Press.
- Malby, J., Day, L., & Macaskill, A. (2010). *Personality, Individual, Differences And Intelligence*. England: Pearson Education Limited
- Marinescu, A. (2002). *Kodi i sjelljeve të përqyeshme sot*. Tiranë: OMSCA-1
- Maslow, A. H. (2008). *Drejt Psikologjisë së Qenies*. Tiranë : Plejad
- MASH. (2013). Udhëzimi nr 5 për standartet e përgjithshme të mësuesit. Gjetur: 3 Maj 2017 nga: <http://www.ver.al/files/ligje%20etj/Udhezimi%20nr%205%2025.02.2013%20Per%20standardet%20e%20pergjithshme%20te%20mesuesit.pdf>
- McRea, B. (2004).” *Coach Your Teen to Success: 7 simple steps to transforme relationships and enrich lives*”. Colorado, Springs CO: Achievers Trade Press
- Musai, B. (1998). *Mjeshtëritë Themelore Të Mësimdhënies*. Tiranë: Libri Universitar
- National Research Council & the Institute of Medicine. (2004). “Engaging Schools: Fostering High School Students’ Motivation to Learn. Committee on Increasing High School Students’ Engagement and Motivation to Learn”. Washington, DC: The National Academies Press.
- Nazarko, N. (2014). “Roli i prindit në procesin e edukimit dhe arsimimiti.” *Drita Islame*. Gjetur: 03 Shtator 2014, nga <http://www.dritaislame.al/roli-i-prindit-ne-procesin-e-edukimit-dhe-arsimimit/>
- Orhani, Z. (2011). *Trajtesë Psikologjike*. Tiranë: Vllamasi
- Paçukaj, S. (2011). *Metodologjia dhe teknikat e kërkimit social*. Tiranë: Vllamasi
- Piaget, J. (1964). *Development and Learning*. New York: W . H. Freeman and Company
- Portal Shkollor (2017). “Roli i prindit - Marrëdhënia prind - mësues, çelësi i suksesit të fëmijës.” *Albas Portali Shkollor*. Gjetur: 3 Qershor 2017 nga: <http://www.portalishkollor.al/argetim/marredhenia-prind-mesues-celesi-i-suksesite-femijes>
- Premarck, D. (2003). “Psychology of Education & Principles.” *Educational Psychology*. Gjetur: 31 Mars 2016, nga: <http://study.com/academy/lesson/david-premack-psychology-of-education-principles.html>
- Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER). (2017). Etika në sistemin arsimor Shqiptar”. Raport Studimi. Tiranë: Mirgeeralb. Gjetur: 27 Maj 2019 nga: <https://ec.europa.eu/epale/sites/epale/files/raport-studimin-etika-ne-sistemin-arsimor->



- ne-shqiperi.pdf
- Quku, D. (2018). “Motivimi nxit përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor”, (Rasti i shkollës 9 vjeçare jo – publike “Turgut Ozal” Durrës, Klasa VIII – IX). *Studime Sociale*. Vol. 12, No. 1 (42).
- Reschly A, L., & Christenson, S. L. (2012). *Handbook of Research on Student Engagement*, New York: Springer and Business Media
- Reçka, L. (2016). *Diversiteti dhe komunikimi në klasë*. Gjirokastër: Argjiro
- Woolfolk, A. (2010). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: CDE

## ABSTRACT

The purpose of this study is to explore the roles that teachers undertake during the teaching process; methods, techniques, teaching strategies that the teacher uses in the classroom, so that the students will be active during the teaching and learning process. Therefore, the job of the teacher is to know how to motivate his students in the most effective way. The purpose of this descriptive, empirical work based on combined methods is to show the importance of motivation during the learning process, in reflecting high academic achievements, identifying the effective motivational and time - consuming techniques, methods and strategies used by the non - public school “Turgut Ozal” Durrës. This study also aims to gather the perceptions of teachers and students on motivational strategies and compare these perceptions in order to represent the techniques mostly preferred by students. This study will contribute to the rejuvenation of traditional motivational methods, by encouraging the development of new educational policies made by decision - makers, as well as the dissemination of these motivational strategies to other schools.

The collection of information was carried out through semi - structured questionnaires developed with 236 students from X, XI, XII classes - of the “Turgut Ozal” Durrës school, with 10 teachers of these classes, as well as structured in depth interviews with 5 teachers of this school. From the conducted interviews and questionnaires, we came in the conclusion that the strategies teachers use and which are most favored by students to motivate them in the classroom are: Building good relationships with students, encouraging students’ interests by making the lesson as inviting as possible, disclose student ambiguities and clarify them, letting students know that mistakes are a normal part of learning, making sure that the assessment made reflect student ‘s efforts and work, developing constructive debates upon certain topics (Tod Talk), making scientific and social competitions (ASEF) where students promote their innovations, teachers showing commitment to the uncertainties faced by students during the teaching process (extra free classes), online tests, etc. The following study suggests some concrete recommendations on how to encourage student’s motivation so that they are active and enthusiastic during the lesson.

**Keywords:** *motivation, reward, success, involvement, motivational strategy, appreciation*



# RRETH INTEGRITETIT POLITIK, MORAL DHE PROFESIONAL TË INTELEKTUALIT

**Skënder DEMALIAJ**

*Universiteti "Mesdhetar" i Shqipërisë, Tiranë*

*Departamenti i Shkencave Politike*

E-mail: skender.demaliaj@umsh.edu.al

**Albana DEMALIAJ**

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë*

E-mail: demaliaja@gmail.com

---

## PËRMBLEDHJE

Në këtë artikull shqyrtohen disa koncepte që, në gjykimin tonë, mund të konsiderohen si 'parakushte' për "intelektualin me integritet" të tilla si: papajtueshëmria me të gabuarën, shpallja publikisht e mendimeve - edhe kur të tjerët nuk janë dakord, të qënë katalizator për proceset demokratike etj., sikurse raporti i intelektualit me lirinë e individit, me të vërtetën etj. Në të jepen shembuj dhe referenca të cilat ilustrojnë faktin se intelektualit me integritet ka kurajo për t'i thënë gjërat troç pa u trembur nga presionet dhe ndëshkimet e pushtetit, se ai nuk tërhiqet kur është fjala për të mbrojtur lirinë, të drejtën dhe të vërtetën, pavarësisht nga pasojat që mund të ketë; se intelektualit me integritet beson në të vërtetën, në njerëzit që e mbrojnë të vërtetën, në të drejtën; beson në doktrinën dhe programin që u shërben qytetarëve, që i ndihmon të ecin përpara në rrugën e dijes, të demokracisë dhe

**Skënder DEMALIAJ** - Doktor i Shkencave, është pedagog në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë si dhe drejtues i Departamentit të Shkencave Politike të tij. Ka punuar si drejtues i disa shkollave të mesme në Tropojë dhe në Tiranë, si dhe në sektorin e kualifikimit të mësuesve në Tropojë. Ai ka kryer edhe detyra të tjera, si këshilltar i Ministrisë të Integritetit Europian. Është autor i disa botimeve në fushën e psikologjisë, pedagogjisë, sociologjisë, historisë, letërsisë dhe etnografisë. Botimi i tij i fundit është: "Kthimi i shpejtë i shqiptarëve të Kosovës në trojet e tyre mijëvjeçare në verën e vitit 1999" (monografi, UMSH Press, 2020).

**Albana DEMALIAJ** ka kryer studimet e larta në degën e Administrimit Publik, si dhe studimet master shkencor në programin Psikologji Komunitare. Ka marrë pjesë në studime, trajnime dhe projekte në fushën e psikologjisë e sociologjisë, në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe ka disa botime në revista shkencore, në Shqipëri e vende të tjera.

në rrugën e progresit. Në të kundërt, shqyrtpohet koncepti i pseudointelektualit që beson vetëm në doktrinën dhe programin që i sjell përfitime e privilegje...

*Fjalët kyçe: intelektual me integritet, liri e pavarësi mendimi, kurajo intelektuale.*

## Hyrje

Fjala “integritet” ka të njëjtën rrënjë nga italishtja, ashtu si fjala “integer” - numër i plotë, tërësi. Pra përmban të njëjtin kuptim: kuptimin e tërësisë. Një person me integritet, ashtu si një numër i plotë, është një person i plotë, një person në një farë mënyre, pa mëdyshje. Integriteti pa njohuri është i dobët dhe i padobishëm dhe njohuria pa integritet është e rrezikshme dhe e tmerrshme.

Sipas Carter (2008: 21-23) intelektualit me integritet duhet “të dallojë të duhurën nga e gabuara (1), të bëjë diçka për të duhurën dhe të jetë i papajtuashëm me të gabuarën (2), të shpallë publikisht se është duke bërë atë që mendon se është e drejtë dhe kur të tjerët nuk janë dakord (3). Ndërsa sipas James M. Gustafson “konsekuenca dhe parashikueshmëria janë thelbësore për integritetin” (Cit. Carter, 2008: 32)

Një politikë me integritet nuk vendos arbitrarisht dhe nuk përjashton qytetarët, kur elitat e ndryshme nuk janë dakord me ta. Qëndrimet politike të intelektualëve duhet të jenë të tilla që t’u bëjnë thirrje qytetarëve për të mbrojtur interesat më të larta. Një politikë me integritet - është një politikë që përcakton përparësitë. Një politikë me integritet kërkon që të përpiqemi për të vënë në jetë idealet tona (Carter, 2008: 241-246). Vetëm mbrojtja dhe zbatimi i këtyre parimeve të rëndësishme zhvillon dhe thellon më tej demokracinë në një vend.

Intelektuali me integritet është katalizator për proceset demokratike. Intelektuali pa integritet i vonon dhe i pengon proceset demokratike. Të bërit e gjësë së duhur, në vend të së gabuarës, nuk është as zakon as instikt. Është vullnet. Sipas Rusoit, duke kaluar nga gjendja e

natyrshmërisë në shtetin civil, ne kuptojmë se “zëri i përgjegjësisë ze vendin e impulseve fizike dhe drejta atë të dëshirës”. Intelektuali i vërtetë në gjithë veprimtarinë e tij shpreh përgjegjshmëri të lartë dhe mbron me vendosmëri të drejtën, të drejtën dhe vetëm të drejtën. Integriteti është përpjekja për të jetuar në përputhje me ndjenjën e detyrës. Detyra përbën bazën e jetës integrale. Nëse ne vendosim që nuk kemi kohë për të ndaluar e për të menduar në lidhje me të duhurën e të gabuarën, atëhere ne nuk kemi kohë për të dalluar të drejtën nga e gabuara, që do të thotë se ne nuk kemi kohë për të jetuar sipas modelit tonë për të drejtën dhe të gabuarën, që do të thotë, e thënë thjesht se ne nuk kemi kohë për të jetuar me integritet (Carter, 2008 : 42). Demokracia funksionale ka nevojë për dialog publik, një dialog ndërmjet njerëzve me integritet që janë të gatshëm të debatojnë për vizionin e tyre konkurrues të së duhurës.

Fan Nolit i kërkuan miqtë e tij, në vitet ‘1930-të, që të kthehej në Shqipëri dhe të zinte “vendin që meritonte në qoshen e përgatitur për të me kohë”. Përgjigja e tij ishte: “S’kam vdekur akoma sa të rri në qoshen e përgatitur e t’i shohë këto zullume e të hesht. Prandaj po rri këtej jashtë në kurbet, në syrgjyn, ku mund të paktën të flas atë që ndjej në zemër, ato që më urdhëron ndërgjegjja dhe ato që kam detyrë t’i them popullit prej së largu, gjersa të vijë dita t’ua them edhe për së afërmi (Fan Noli, gazeta “Republika”, nëntor 1930).

## **Intelektuali me integritet, pavarësia e mendimit dhe lufta për të mbrojtur lirinë e individit**

Liria do të ndryshket, do të dalë jashtë përdorimit, do kalbet nëse nuk vihet në

punë, shkruante Stefani, 2011: 285. Liria është një pasion për hir të vetë lirisë dhe jo thjesht për shkak të interesave materiale.

Fan Noli shkruan:

Liria mbrohet nga shkelësit e huaj me trimërinë e pushkës, nga shkelësit e brendshëm me trimërinë e shpirtit, me kurajë civile, e cila është më e lartë se e para (Noli, 1968: 26).

Ndërsa në tragjedinë “Persët”, Kori këndon: “Flet lirisht, veç ai popull që nga zgjedha është çliruar” (Eskili, 1986: 199).

Tri gjëra janë të domosdoshme për njeriun (aq më tepër për intelektualin) për të qenë i lirë: të dijë çfarë beson, të dijë çfarë kërkon, të dijë çfarë bën (Imeraj, 2012: 299). Pikërisht në këto tre gjëra, thelbësore është ndryshimi, dallimi i intelektualëve nga pseudointelektualët.

Filozofë, politologë dhe sociologë të mëdhenj kanë mbrojtur idenë se një shoqëri e begatë dhe paqësore duhet të jetë e lirë. Në qoftë se nuk është e lirë, ajo nuk mund të jetë as e begatë, as paqësore. Liria dhe vetëm liria është ajo që i jep kuptim jetës njerëzore. Liria nuk mund të eliminohet. Ajo vjen e buron nga thelbi i gjërave më jetike dhe trazon shpirtat e një numri të pafund qëniesh njerëzore (Berlini, 2012: 181-182 & 225). Janë aktualë edhe sot vargjet e Pablo Nerudës: “Saherë që vritet liria, poetët vdesin”.

Jo vetëm mosekzistenca e opinioneve të gjera publike, në mbështetje të lirisë, por edhe mungesa e këtyre elitave të përkushtuara ndaj lirisë kanë ndihmuar sharlatanët politikë të rrëmbejnë kreun e proceseve politike në shumë vende, në të cilat bën pjesë edhe Shqipëria.

Zhan Zhak Ruso ironizon fort ata krijues, filozofë dhe shkrimtarë që mendojnë se “U mjafton që të mos pajtohen që të revoltohen për të qenë të lirë”. Historia e Europës, e vendeve më të zhvilluara demokratike na mëson se liria nuk dhurohet,

por merret, fitohet dhe meritohet. Personi plotësisht i lirë është personi “i cili nuk është i lirë të zgjedhë të keqen” (Fromm, 1998: 94). Volteri i madh pyeste: “Pse është aq e rrallë liria?” Përgjigjej vetë: “Sepse është e mira më e madhe” (Cit. Jorgaqi, 2016: 19).

Sartri, si intelektual dhe humanist e ka vënë vazhdimisht në pikëpyetje shoqërinë modern në emër të njeriut e të lirisë së vet.

A kanë qenë dhe a janë të lirë intelektualët në Shqipëri? Më parë, jo; aktualisht, vetëm pjesërisht. Argumentat përse mendojmë kështu janë:

- Intelektuali i lirë është i përgjegjshëm për fatet e atdheut e të popullit të tij. Nuk e kemi parë dhe ndeshur akoma këtë përgjegjshmëri.
- Sovraniteti i vetes mbi veten është quajtur liri. Ky sovranitet mungon tek intelektualët shqiptarë.
- Liria e mendimit tek intelektualët mund të ekzistojë vetëm kur qeveria ndihet e sigurtë: E pasigurtë qeverisja në pushtimin osman, në kohën e Zogut, në shtetin komunist dhe pas viteve 90. Dhuna, frika, terrori e bëjnë të pasigurt qeverisjen.
- Mos të shohësh nga e ardhmja do të thotë të kesh frikë nga liria. Intelektualët shqiptarë edhe dje, edhe sot nuk kanë patur një vizion të qartë për të ardhmen.
- Njeriu pa liri humbet të drejtën për t’u mbrojtur. Është kjo arsyeja që intelektualët shqiptarë as dje, as sot nuk kanë qenë të aftë të mbrojnë vetveten, aq më tepër qytetarët e tyre.

Platoni thoshte: “Robëria më e rëndë është robëria e robit të robëruar prej robërve” (Cit. Qosja, 2014: 344). Ta thjeshtosh lirinë vetëm tek arritja e mëvetësisë, do të thotë të nxisësh individin të mbyllet në vetvete, çka e bën atë indiferent. Lëvizja e lirë është edhe një lëvizje çlirimi, hapjeje, gatishmërie, pra jo vetëm një lëvizje shkëputjeje dhe ngadhënjimi, por edhe pjesëmarrjeje (Monuier, 2006: 92). Pseudointelektualët sot mendojnë se lirinë mund ta blejnë me para. Në të vërtetë atyre

u merren paratë dhe nuk u jepet liria. Se liria është vlerë, e cila nuk mund të paguhet me kurfarë parash (Qosja, 1997: 304).

Që intelektual i ketë mendje të pakushtëzuar, ai nuk duhet të ketë varësi as politikisht, as ekonomikisht dhe asnjë lloj varësie tjetër nga askush. Realiteti shqiptar nuk ja ka plotësuar këto kushte. Është kjo arsyeja që ai nuk ka menduar, nuk ka vepruar me mendjen e tij të lirë. Në kushte e rrethana të tilla, të papranueshme për një shoqëri të lirë e demokratike, ai ka qenë pasiv, i ngathët, i tërhequr e në disa raste edhe servil ndaj pushtetit.

Njerëzit dhe strukturat kanë autonomi, idetë automatikisht kanë pavarësi të plotë. Tiranët e urrejnë njeriun e pavarur. Frika dhe dhuna nuk e lejon individin të aspirojë për pavarësinë dhe personalitetin e tij të pacenuar. Intelektuali servil ndaj pushtetit e humbet pavarësinë e mendimit të tij. Një intelektual i tillë të kujton Gregor Zamzen, personazhi kryesor i veprës “Metamorfoza”, për të cilin Kafka thotë se është pjellë e padronit, një njeri pa shtyllë kurrizore e i trashë e që zvarritej përtokë si një gjymtyrë pa jetë (Kafka, 1992: 6).

Ibrahim Rugova merr si shembullin e intelektualit Pjetër Bogdanin dhe shkruan për të:

Bogdani ishte një intelektual i madh, shkrimtar i pavarur që kishte formuar fizionominë e vet intelektuale dhe pavarësinë në gjykime, në vlerësime dhe në zgjidhjen e problemeve në shqyrtim” (Rugova, 1982: 43).

Intelektuali i pavarur ka një vizion shumë herë më të madh për ndryshimin sesa intelektual i servil i pushtetit. Servilizmi i intelektualëve shqiptarë, lidhet edhe me një faktor tjetër të rëndësishëm, për të cilën ka folur dekada më parë Nebil Çika. Këta intelektualë janë nën ndikimin e një rrethi që bën kredinë. Ky rreth i detyron dhe i shtrëngon të rrinë duarkryq e fatalist e t’i trembin me gogolin e “komprometimit”. Ky rreth ka lindur tipe njerëzish, të cilët për

të bërë karrierë ose për smirë e xheloz, nuk durojnë të ulen, në dinakërinë e tyre, gjer në përdorimin e mjeteve politike të shpifjes e të keqinterpretimit të paramenduar për të të paraqitur si njeri me “qëllime të errëta” ose si “të shitur”. Ky rreth ka lindur hipokrizinë dhe dallkaukllekun dhe kanë sjellë zënien e ofiqeve me rëndësi prej “miqve” dhe hipokritëve, në dëm të interesit të përgjithshëm.

### **Shoqëritë në krizë dhe nevoja për të vërtetën**

Një shoqëri është e pushtuar prej krizës kur gënjeshtreve u lejohe të sundojnë jetën dhe shoqëria nuk ndjen nevojë për të vërtetën. Intelektualët e vërtetë nuk pranojnë që të luajnë me të vërtetat, në të cilat besojnë. Ne kemi plot shembuj kur intelektualët nuk kanë bërë kompromise me të tjerët për vlerat e mendimet e tyre si Sokrati, Pali i Tarsus, Giordano Bruno, San Juan, De La Cruz, por edhe intelektualë që kanë bërë zgjedhje të gabuara si Giovanni Gentile, Martin Heidegger, Carl Shmit.

Sipas psikologëve, shkak i bashkëlidhjes së njeriut fanatik me të keqen, është frika e tij e brendshme. Kjo e shtyn atë të shkojë pas të tjerëve, edhe atëherë kur nuk është i ndërgjegjshëm për rrugën, në të cilën është nisur. Nuk do t’ia dijë më nëse rruga është e moralshme, e amoralshe apo dhe e imoralshme. Këtë pikë të dobët e shfrytëzojnë politikanët e sëmurë nga ndjenja e pushtetit të verbër. (Imeraj, 2012: 172).

Për Çurçillin “E vërteta është e padiskutueshme, e keqja mund ta sulmojë atë, injoranca mund ta përqeshë atë, por në fund ja ku është ajo, triumfoi” (Thënie të njëjërve të mëdhenj, Telegraf, 23.1.2013, f. 5).

Sipas Rexhep Qosjes në intervistën me titull “Demokracia nuk i vret qytetarët e vet”: “Nuk bëhesh shkencëtar për honorar, nuk bëhesh shkrimtar për të shkruar një libër, shkrimtar bëhesh për të thënë të drejtën dhe të vërtetën, për të qenë në anën e të vërtetës, të drejtës dhe të popullit... A

është më mirë të heshtësh apo të thuash të pavërtetën? Absolutisht heshtje. E mira është të kesh guximin e të thuhet e vërteta, edhe pse mund të kushtojë shumë shtrenjtë. Por kur nuk ekziston kjo mundësi e ku çmimi është shumë i shtrenjtë, është më mirë të heshtësh se sa të thuhet e pavërteta. Kjo është e pamoralshme” (Gazeta Shqiptare, 25 janar, 2011, fq. 5).

Intelektuali që nuk e mbron të vërtetën është intelektual i rremë, të cilin Nizani e quan “qen roje”. Radikalizmi intelektual çdo herë shtyhet përpara në saj të argumentave dhe qëndrimeve të intelektualëve të rremë (Sarter, 1986: 127).

Është për t'u kujtuar dhe për t'u përshëndetur deklarata e gushtit të vitit 1992 e disa gazetarëve të cilët u larguan nga gazeta Rilindja Demokratike (gazetë e Partisë Demokratike – që atëherë kishte ardhur në pushtet), sepse - siç shkruajnë ata e ndjejnë se raporti i gazetës me të vërtetën është thyer dhe kjo ndodh hap pas hapi, se kriteri bazë i gazetarit, siç është profesionalizmi dhe vërtetësia, janë zhvendosur me militantizmin. Duke mos dashur të jemi ushtarë symbyllur, të bindur të PD-së, apo të çfarëdo klani të saj, shpresojmë që akti do të kontribuojë në krijimin e një shtypi të pavarur, të lirë e jashtëpartiak (Letër drejtuar redaksisë së gazetës RD nga një grup gazetarësh, RD, 15 gusht 1992).

Prometeu i bënë thirrje për të hequr dorë nga “shpikja e tij”. Por ai nuk u dorëzua para presioneve, frikës kërcënuese dhe ndëshkimit të madh për jetën. Ai sakrifikoi jetën e tij, për t'iu lënë njerëzve të vërtetën dhe për t'i ndihmuar ata. Edhe pse e dinte se e preiste vdekja, ai vazhonte të demaskonte Zeusin dhe nuk u tërhoq nga idetë dhe idealet e tij.

“Herman thotë fjalë bosh me vend.

Të këshillon të respektosh zemërimin.

Hiq dorë nga kokëfortësia!

Dëgjoje! Je i mençur! Është turp,

Për t'urtin këmbëngulja në gabim” (Eskili, 1986: 114)

Intelektuali beson tek e vërteta, tek njerëzit që e mbrojnë të vërtetën, të drejtën. Pseudointelektuali beson në gënjeshtat e pushtetit, bëhet pjesë dhe përcuese e tyre te qytetarët për poste e përfitime financiare.

Intelektuali beson tek njerëzit me integritet të lartë moral. Pseudointelektuali beson tek njerëzit me moral të dyshimtë e pa moral sepse ata janë bashkëpunëtorët më të mirë për të arritur qëllimet e mbrapshta e të dyshimta se ata i shesin parimet pa u dridhur qerpiku e pa iu skuqur surrati.

Intelektuali beson në doktrinën dhe programin që u shërben qytetarëve, që i ndihmon të ecin përpara në rrugën e dijes, të demokracisë, në rrugën e progresit. Pseudointelektuali beson në doktrinën dhe programin që i sjell fitime e privilegje etj.

Intelektuali di çfarë kërkon. Kërkon drejtësi, barazi, shtet ligjor, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, luftë kundër korrupsionit. Pseudointelektuali është kundër shtetit ligjor se kështu përfitimet e tij janë më të mëdha dhe jetëgjatësia e shefave të tij në pushtet, të cilëve u shërben me përlësi, është më e madhe. Barazia, drejtësia për të janë koncepte marksiste, komuniste. Sipas tij një vend nuk mund të zhvillohet pa korrupsion në zhvillimet e para kapitaliste.

Intelektuali kërkon qarkullimin e elitave në pushtet, në politikë. Pseudointelektuali kërkon përjetësimin e tyre. I frikësohet procesi të qarkullimit se nuk e ka të lehtë (është edhe i pabesueshëm) të lidhet e të punojë me përkushtim, për elitat e reja. Përshtatja e tij është e suksesshme dhe e lehtë ndaj një pushteti me vota të vjedhura dhe i korruptuar. Intelektuali kërkon zgjedhje të lira e të ndershme se vetëm kështu realizohet qarkullimi i elitave. Pseudointelektuali i trembet votës së lirë se e nxjerr jashtë loje shefin e tij, pra edhe atë, të cilit i thur këngë e himne, thërret e brohoret në meetingje e takime, në konferenca e gëzime familjare.

Intelektuali di çfarë bën. Është i ditur dhe ekspert në fushën e tij. Di kur dhe si ta bëjë kritikën. Pseudointelektuali hiqet si i

ditur, por e ka kokën bosh. Bën gjithnjë atë që i thotë shefi. E bën sa më shpejt e sa më mirë për t'i hyrë akoma më shumë në zemër.

Intelektuali ndërton me sukses ura komunikimi me publikun, organizon anketa, sondazhe për të kuptuar më mirë kërkesat dhe sensibilitetet e tij. Pseudointelektuali komunikon vetëm me shefin e tij, përpiket të shfrytëzojë publikun për interesat e tij, të klanit të tij, të shefit të tij. I injoron kërkesat dhe sensibilitetet e publikut. Intelektuali është në pararojë në punën e tij, bën parashikime për të ardhmen dhe mbështet pa rezerva të renë, rininë dhe teknologjinë e re. Pseudointelektuali si i paaftë që është zvarritet, zvarritet gjithnjë pas shefit në punën e tij. Nuk është i zoti të parashikojë. Urren të renë, progresiven se e nxjerr jashtë loje politike shefin e tij edhe atë. Nuk e mbështet teknologjinë e re se është i paaftë ta përvetësojë e ta zbatojë.

### **Shqyrtim rastesh e tipash të intelektualëve me integritet dhe kurajo**

Intelektuali nuk frikësohet, nuk trembet dhe nuk tërhiqet pavarësisht nga pasojat që mund të ketë në të ardhmen kur është fjala për të mbrojtur lirinë, të drejtën dhe të vërtetën. A nuk ishte Galileu që tha para turrës së druve, ku do të digjej... e megjithatë rrotullohet”.

Nga 1200 profesorë universitarë 1188 u betuan për besnikëri ndaj fashizmit në Itali. Vetëm 12 profesorë nuk pranuan ta bëjnë betimin, duke humbur vendet e punës. Këta e meritojnë emrin “intelektualë”. Këta 12 akademikë shpëtuan nderin e universitetit dhe të kombit. Është e rëndësishme të thuash “jo” edhe kur je në minorancë dhe mund të rrezikosh, jo vetëm karrierën politike apo shkencore, por edhe jetën.

Ambasadori amerikan Dold në Berlin (1933-1934) e kritikoi publikisht regjimin e Hitlerit për politikën e tij antisemitike, një qëndrim që dukej si fyerje për nazistët dhe bezdisës për qeverinë amerikane. Është

kjo arsyeja që ai dha dorëheqjen dhe u kthye në SHBA.

Nobelitet francezë Monak, Monod, Kastler, Jakob dhe Lvof i dërguan një telegram De Golit - Presidentit të Francës, më 7 maj 1968, ku i kërkonin që ai të bënte një gjest vetjak për të ulur gjakrat e studentëve dhe kërkonin amnisti për studentët e dënuar, hapjen e fakulteteve dhe respekt ndaj studentëve. Charl de Gol u tha ministrave: “Shteti ka vetëm një të drejtë të ligjshme: të godasë ata që e godasin”. Më 8 maj me një grup deputetësh u shpreh: “Është e pamundur të tolerohet dhuna e rrugës” Motoja e tij mbeti gjithnjë: “Pushteti nuk do të tërhiqet” (Rama, 2003: 255-256).

Kjo i kushtoi De Golit largimin përfundimtar nga pushteti. Pra, mund të jesh drejtues i rëndësishëm në një institucion shkencor, në media, shkrimtar, shkencëtar, por je shërbëtor i pushtetit, servil, konformist me të për interesa pushtetore e pasurore. Kështu nuk ke kurajon të mbrosh të vërtetën dhe nuk e meriton emrin “intelektual”. Të tillë individë akademiku Rexhep Qosja i ka parë dhe analizuar në tre këndvështrime. Së pari, intelektualit që në rastet më të shpeshta mendon si të fitojë sa më shumë dhe të jetojë sa më mirë.

Apeli i 215 intelektualëve të Kosovës, më 21 shkurt 1989 drejtuar Kuvendit të RS të Serbisë dhe opinionit të Jugosllavisë “Për mbrojtjen institucionale dhe afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës të RS FJ-së” është shembull i kurajës dhe i pjekurisë intelektuale.

Intelektuali ka guxim e të thotë e të mbrojë të vërtetën, edhe pse kjo mund të kushtojë shumë shtrenjtë: punën, familjen, burgosjen, jetën. Në fund të fundit është më mirë të heshtësh sesa të thuash të pavërtetën. Në raportin heshtje-e pavërtetë, është më e pranueshme e para. Por edhe heshtja e cënon rëndë integritetin e intelektualit. Të mos harrojmë fjalët e Gorkit: “Heshtja e njeriut



të mençur i bën më shumë dëm shoqërisë sesa të folurit e shpifaxhiut”.

Në vitet '1930-të Vangjel Koça shkruante:

Ka intelektualë dhe fatkeqësia më e madhe e tyre është se këta janë të rinj, të cilët nuk kanë kurajon e mendimit të tyre. Këta janë hajdutët e kulturës, sepse një kulturë e vërtetë, jo vetëm mendore, por edhe shpirtërore, u jep kurajë atyre që e kanë dhe jep ndjenjën e misionit të tyre (Koça, 1930).

Presidenti i SHBA-ës, Barak Obama në shkrimin me titull “Arsimi në të ardhmen” bën thirrje të mos dorëzohemi asnjëherë, aq më tepër intelektual i “sepse kur dorëzoheni dhe lëshoni veten, ju jeni dorëzuar edhe për vendin tuaj” (Gazeta Mësuesi, 30 shtator 2009: 12)

Kurajua intelektuale merr forcë ose zbehët, venitet e pse jo edhe shuhet në vartësi se sa dëgjohet zëri i tyre, sa shpërblehen dhe vlerësohen materialisht e moralisht, por “këta njerëz të mençur jetojnë në një vend ku sukcesi është i kushtëzuar nga kuraja për të shkelur apo shpërfillur ligjet, prandaj ndjesia e inferioritetit dhe vetëdija se të kesh intelekt dhe të respektosh ligjet është pesë me hiç në një vend, ku e kundërta ofron më shumë dinamikë dhe shanse e i bën intelektualët të struken në realitetin pesimist të të kënaqurit me pak (Artan Mullaj në shkrimin me titull “Misioni i intelektualit”, gazeta “Tema”, 4.12.2011, f.9.)

Dritëro Agolli, duke iu referuar shembullit të Prof. Rexhep Qoses, shkruan:

“... të gjithë intelektualët e vërtetë janë në opozitë me pushtetin. Në mënyrë figurative ata janë redaktorë të këtij pushteti. Pushteti është një libër që jepet për botim. Rexhep Qosja e mori dhe e redakttoi këtë libër. Po meqë libri kishte shumë gabime, ai bëri shumë vërejtje. Mirëpo kjo nuk i pëlqeu pushtetit në Shqipëri. Është në traditën e të parëve. Nuk do vërejtje, do vetëm lavdërime. Prandaj e sulmon dhe e sulmon aq ashpër redaktorin”. Vazhdon mendimin e tij duke na thënë se “Rexhep Qosja nuk ka frikë se kush je ti dhe

çfarë pozite ke. Gjithmonë pushteti ka patur frikë nga intelektualët, prandaj i ka sulmuar ata. Kështu është edhe sot. Ka ndryshuar vetëm kostumi...” (Agolli, 2011: 205).

Jo vetëm në Shqipëri pushteti ka frikë nga intelektualët, por edhe në vende të tjera. Në majin e vitit 1968 Sartri u përfshi në revoltat e njohura të Parisit dhe i pa ato “si diçka të realizuar që i afrohet lirisë”. Thuhet se policia donte ta arrestonte “si nxitës të revoltave” De Goli pat thënë: “Dëgjoni, nuk arrestohet Volteri”.

### Disa përfundime

Së pari, një komb është në rrezik kur njerëzit mediokër janë në krye të punëve. Shekuj më parë, Viktor Hygoi këshillonte: “Vështrimet të mos i drejtojmë më nga sundimtarët, por nga mendimtarët, prandaj tërë vendi duhet të dridhet kur qoftë edhe një prej tyre largohet nga kjo botë. T’i njohim, t’i vlerësojmë, t’i propagandojmë intelektualët si komb, por edhe ata të jenë në ballë të përpjekjeve e të luftës për emancipimin e shoqërisë shqiptare, për demokratizimin e jetës, zhvillimin e ekonomisë, rritjen e mirëqenies dhe bashkimin e trojeve shqiptare.

Mesazhi dhe filozofia e Ukshin Hotit e këtij mendimtari të shquar shqiptar duhet të jetë udhërrëfyes për çdo intelektual:

“Nëse nuk dëshiron të jetosh rob dhe i nëpërkëmbur, bëje lirinë ose vdis! Nëse nuk dëshiron të jetosh si urithi, por të jesh zot në tokën tënde, bëje lirinë ose vdis! Nëse nuk don të jetosh nën robëri e skllavëri, vepro, fito ose vdis. Nëse e meriton të vdesësh për liri, vdis sepse ashtu fitohet liria dhe përjetësia.” (Qeriqi, 2005: 132),

Ai e dha shembullin, vdiq si hero për kombin e tij dhe fitoi përjetësinë. Intelektualët i udhëhoqën shqiptarët e Kosovës drejt lirisë.

Sot në elitat politike në Shqipëri nuk ka vend për më të zotët, por për militantët partiakë, për të paafët, për servilët me formim gjysmë të cunguar. Kohët moderne dhe shoqëritë moderne kërkojnë menaxhim shkencor të shoqërisë, me barazi dhe drejtësi (Ngjela, 2006 : 193). Kjo nuk mund të arrihet me militantët partiakë në administratën shtetërore. Kjo nuk mund të realizohet kur shkelet barazia në punësim. Kjo betejë nuk mund të fitohet kur njerëzit e pushtetit vjedhin, grabisin pasurinë e popullit dhe bëhen të pasur brenda natës dhe pse janë me partinë në pushtet, nuk u hyn gjëmb në këmbë.

Rebelimet nuk fillojnë nga vuajtjet që përjetojnë njerëzit, rebelimet fillojnë nga idetë dhe vizionet për një të ardhme ndryshe. (Rama, Shenasi, 2012: 67).

Së dyti, një inteligjencë aktive është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e vendit e të demokracisë. Shqipëria është në krizë institucionale, ekonomike, sociale, psikologjike, politike. Është pikërisht momenti që intelektualët të realizojnë misionin e tyre historik shpëtimin e kombit. Për intelektualët është e rëndësishme iniciativa personale: është këmbëngulës në realizimin e ideve të tij? A ju reziston presioneve që i bëhen? A punon në mënyrë të pavarur? A është në pritje të udhëzimeve

nga lart apo u jep zgjidhje vetë problemeve? A punon për ndryshimin? Si punon me informacionet që merr dhe sa ndikojnë ato në marrjen e vendimeve të duhura? Intelektuali duhet të jetë gjithmonë në veprim, verifikim, realizim, komunikim dhe përmirësim të gabimeve.

Së treti, mendja bëhet udhëheqëse dhe rregull për të menduar e vepruar. E para gjë që do të pyesim duke dëgjuar një mendje është se kush e thotë. Jo nga meraku, por të dimë ç'rëndësi t'i japim. Një mendje nuk gjykohet vetëm nga përmbajtja e saj, por edhe nga vlera që ka në hierarkinë shoqërore ai që e thotë (Koça, 1938).

Kur flasim për fabrikën e ideve kemi parasysh: krijimin e një dijeje të re, shumëfunktionalizimin e saj, karakterin e pavarur dhe vënien e saj në shërbim të interesave kombëtare. Epoka e globalizmit, duke mos qenë thjesht epokë e imitimeve, ka nevojë urgjente për atë që quhet “forcë e butë”, që rrit konkurrencën e ideve dhe të demokracisë për ta bërë prirjen dominuese të shekullit XXI (Pëllumbi, 2013: 119).

Intelektualët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në përballimin e gjendjes në të cilën ndodhemi sot. Ngushtimi i hapësirës për veprimin e intelektualit vë në pikëpyetje zhvillimin e demokracisë.

## REFERENCAT

- Agolli Dritëro. 2011. “Demonstratat, protestat janë pjesë e demokracisë”, *Gazeta Shqiptare*, 27 janar.
- Agolli, Dritëro. 2011. *Kam pendën e mprehtë, mendjen të kthjelltë*, Tiranë: UET Press.
- Aron, Raymond. 2005. *Opinionit i intelektualëve*, Tiranë: Dituria.
- Carter, Stephen. 2008. *Integriteti*, Tiranë: Vernon Publishing.
- Eskili. 1986. *Tragjeditë*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”.
- Fernand Braudel. 2004. *Gramatika e qytetërimeve*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.
- Fromm, Eric. 2007. *Anatomia e Destraktivitetit Njerëzor Vëllimi II*, Tiranë: Fan Noli.
- Grup Gazetarësh. 1992. “Letër drejtuar redaksisë së gazetës së RD-së”, *gazeta Rilindja Demokratike*, 15 gusht.
- Imeraj, Lekë. 2013. *Konfliktit*, Lezhë: Enti Botues “Gjergj Fishta”.
- Isaiha, Berlin. 1996. *Idetë politike të shekullit XX dhe katër ese mbi lirinë*, Tiranë: Onufri.
- Jorgaqi, Nasho. 2016. *Perlat e mendimit*, Tiranë: Lindita AE.
- Kafka, Franz. 1992. *Metamorfoza*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Fan Noli”.

- Koça Vangjel, 1938. "Mendja e intelektualit", Revista *Kombi*, Nr.4.
- Meksi Aleksandër. 2009. "Intelektuali në demokraci", Gazeta *Shqiptare*, 26 korrik.
- Monuier, Emanuel. 2006. *Personalizmi*, Tiranë: Dita 2000.
- Mullaj Artan. 2011. "Misioni i intelektualit", Gazeta *Tëma*, 4 dhjetor.
- Ngjela, Spartak. 2006. *Reformë shqiptare*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Enrico Cuccia".
- Noli Fan. 1930. "Përgjigje e hapur Ikonomit Stavrofor At Josifi", Gazeta *Republika*, nëntor.
- Noli, Fan. 1968. *Vëpra*, Prishtinë: Rilindja.
- Obama Barak. 2009. "Arsimi në të ardhmen", Gazeta *Mësuesi*, 30 shtator, fq. 12.
- Pëllumbi, Servet. 2013. *Etikokracia*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Morava".
- Qeriqi Ahmet. 2005. *Fenomene shqiptare, Prishtinë: Rilindja*.
- Qosja Rexhep. 2011. "Demokracia nuk i vret qytetarët e vet", Gazeta *Shqiptare*, 25 janar.
- Qosja, Rexhep. 1997. *Fjalor Demokratik*, Tiranë: Toena.
- Qosja, Rexhep. 2014. *Ditar IV*, Tiranë: Toena.
- Rama, Luan. 2003. *Sharl de Gol – një legjendë e gjallë*, Tiranë: Duda.
- Rama, Shemsi. 2012. *Përrallat e tranzicionit shqiptar*, Tiranë: Botimet Princi.
- Redaksia. 2013. Rubrika: "Thënie të mençura", Gazeta *Tëlegraf*, 23 janar.
- Rugova, Ibrahim. 1982. *Vëpra e Bogdanit, 1675-1685*; Prishtinë: Rilindja.
- Sartre, Zhan Pol. 1986. *Situatat*, Prishtinë: Shtëpia Botuese "Rilindja".
- Stefani, Andrea. 2011. *Komploti kundër lirisë*, Tiranë: Onufri.

## ABSTRACT

The Concept on Intellectual Integrity: To be incompatible with the wrong. To announce that he is doing what he thinks is right even when others disagree. The intellectual with integrity is the catalyst for the democratic processes. The intellectual with integrity defends the individual's freedom and fights for it. The intellectual with integrity defends and tells the truth and only the truth. The intellectual that does not defend the truth is a pseudo-intellectual. The intellectual with integrity has independent thinking otherwise he loses credibility before his citizens. People and structures have autonomy, ideas automatically have complete independence. Tyrants hate the independent man. The intellectual with integrity has the courage to say things openly without being afraid of government pressures and penalties. The intellectual is not intimidated or withdrawn, despite the consequences he may have for defending freedom, justice, and truth. The intellectual with integrity believes in the truth, in the people who defend the truth and the right. The pseudo-intellectual believes in the lie of power, becomes part of their conduct for positions and for financial gain. The intellectual with integrity believes in the doctrine and the program that serves the citizens, which helps them move forward in the path of knowledge of democracy and the path of progress. The pseudo-intellectual believes in the doctrine and program that brings him profits and privileges.

**Keywords:** *intellectual, integrity, freedom, independence of thought, courage.*



# LIDERSHIPI SHËRBËTOR – NËNË TEREZA

## MISHËRIM I KËSAJ QASJEJE

Fejzi LILA

*Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë  
Kolegji Universitar i Biznesit, Tiranë  
E-mail: fezilila@gmail.com*

---

### PËRMBLEDHJE

Referuar qasjeve mbi Liderhipin, shumica definojnë se: “Udhëheqja është një proces përmes të cilit ndikon të tjerë për të arritur një qëllim të përbashkët”. Pra, procesi kërkon që lideri të ketë ndikim në jetën e atyre që udhëhiqen, ndërsa mbi ndryshimin në shoqëri është domosdoshmëri bartja e demonstrimi nga liderhipi e një barrë të madhe etike dhe përgjegjëshmërie. Hulumtimet mbi qasjet “orientuese”, funksionalizuese, pushtetin e kontrollin, përgjegjësinë e ndjeshmërinë ndaj pasuesëve e jetës së tyre, sugjerojnë se udhëheqja nuk është një fenomen amoral, por proces me dimensionin moral e të dallueshëm nga llojet e tjera të ndikimit, si shtrëngimi ose kontrolli despotik. Udhëheqësi shërbëtor përfshin vlerat, respektin, drejtësinë dhe karakteristika që përbëjnë konceptualizimin e liderhipit shërbëtor. Sjellja e liderit shërbëtor si bërthamë udhëheqje, dëshmon një proces shumë dimensional. Sipas kësaj filozofie udhëheqëse, referuar rritjes së performancës të ndjekësve, performancës organizative dhe ndikimit shoqëror, shembulli tipik i kësaj qasje është kontributi i Nënë Terezës ndaj të uriturve, të pastrehëvedhe në krijimin e Misionarëve të Bamirësisë. Nënë Tereza (1910-1997) mishëron modelin që e kupton fuqinë e individit, ndikoi jashtëzakonisht në gjithë botën, ndikoi në trajtimin e të dëbuarëve të shoqërisë, njerëzve me HIV/AIDS, lebrozë dhe tuberkuloz. Forca lëvizëse e saj ishte besimi, dhëmbshuria për njerëzimin duke tejkaluar bindjet personale e fetare. Nënë Tereza si komunikuese e madhe, e vëmendshme, e përtulur, e kujdesur dhe gjithmonë në shërbim të njerëzve, ndikoi në mbarë opinionin botëror duke na lënë kontribut të shkruar e të përkthyer në të gjitha gjuhët e botës.

**Fjalë kyçe:** *Udhëheqja shërbëtoare, Nënë Tereza, vlera, përgjegjësi sociale, shoqëri*

Fejzi LILA është doktor i shkencave në profilin “Shkenca Politike & Marrëdhënie Ndërkombëtare” nga Universiteti Europian i Tiranës (UET). Më herët ka kryer Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej” Tiranë (bachelor & master i shkencave), si dhe posdiplomën për “Lidership & Menaxhim Krizash” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare & Diplomaci” pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare (ADSH). Ai është bashkëautor i librit “Lidershipi Shqiptar përmes Historisë së Ushtrisë” si dhe autor i librit “Lidershipi Shqiptar - Shqipëria Politike: 1912 – 1989”. Është gjithashtu, autor i mjaft punimeve shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë, pjesë e institucioneve të sigurisë kombëtare dhe e Akademisë Diplomatike Shqiptare (ADSH).

## Hyrje

Studimet mbi lidershipin politik përmbajnë dilema të ndryshme, të cilat burojnë nga vështirësitë, momente e mjaft procese që e shoqërojnë këtë subjekt. Vështirësia ka rrënjë historike, ndërsa proceset shoqëruese kanë rritur e provuar liderët. Studimet mbi fushën e Lidershipit dhe ndikimin e tij në shoqëri ka tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve, shkencëtarëve, studiuesve, gazetarëve, njerëzve të thjeshtë që janë marrë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me lidershipin, pushtetin e tij dhe ndikimet në shoqëri. Këto studime kanë shpalosur formate të ndryshme liderash, ndërsa shoqëria ka evidentuar lidera në fusha të ndryshme si lidera fetarë, ushtarakë, ekzekutiv, ekonomistë, diplomat, akademik. Në lidership ndikojnë fenomene, procese të ndryshme, faktorë objektiv e subjektiv, të brendshëm e të jashtëm, ambicjet e një kombi për bashkëjetesë apo vasalitet deri në asimilim. Kapërcimi në lidership cilësor parakupton një transformim shumë të thellë dhe kompleks në botëkuptim, metodologjinë e ndjekur dhe etikë të demonstruar.

Transformimet kualitative në lidership kërkojnë sigurim idesh e metoda të reja, një etikë krejtësisht të re politike. Këto transformime ndodhen midis sfidave të së shkuarës dhe të së ardhmes, midis mbylljes dhe hapjes, midis mentalitetit autokrat, oriental, lindor dhe modelit transparent, bashkëpunues, gjithëpërfshirës të demonstruar përgjithësisht nga lidershipi perëndimor. Kjo sfidë transformuese dhe me ndikim shoqëror kërkon lidership me memorje, kualitet sasiorë e cilësorë, me kointunitet permanent, me demonstrim vlerash dhe prioritet interesash, me objektiva afatmesme dhe afatgjatë në një trajektore të mirëpërcaktuar (Lila, 2018:33-34).

Raporti lidership - elite - shoqëri civile përbën thelbin dhe vetë - ekzistencën e mirë funksionimit të vetë kombit, por edhe në marrëdhënie me kombet e tjerë. Shoqëritë

*“ushqejnë llojin e liderit që ajo dëshiron, i mban në rrugën e tyre, në zakonet e vjetra kulturore të zgjedhura, ...ku liderët nuk mund të transferohen lehtë nga kultura në kulturë”* (Levis, 2013:104-105). Evolucioni kulturor e fizik po prodhon të *“mbijetuar dhe dështakë, ndërsa për individë e kulturave që dështojnë, çnimi mund të shkojë nga asimilimi i butë prej kulturave të tjera e deri te vuajtjet e mëdha dhe vdekja masive, e parakohshme, përshtatja dhe mënyrën se si ta udhëheqim ndryshimin tregon se ne mund të mos jemi të gjithë aq të mençur në krabasim me paraardhësit tanë”* (Chirot, 2012:25). Në fillimet e krijimit të shtetit fituan rëndësi të madhe dy lloj individësh, ndërmjetësuesit dhe udhëheqësit. Në të gjitha ngjarjet e fitores apo humbjes, në prosperitet apo recesion, *“një shoqëri ka nevojë për tu organizuar, të përshtatur dhe të riorganizuar sipas presionit të jashtëm dhe objektivat e veta, grupet e kulturore organizohen në mënyra të ndryshme dhe për çështje të tilla si autoritet, pushtet, bashkëpunimit, qëllimet, rezultatet dhe kënaqësi në një shumëllojshmëri mënyrash”* (Levis, 2013:16). Ndërmjetësuesit dhe udhëheqësit mund të ndihmonin grupet shoqërore duke imponuar zgjidhje të favorshme gjatë konflikteve. Këta njerëz u etiketuan nga antropologët si shaman, dukeshin si udhëheqës, ndërmjetësues dhe këshilltarë. Shtimi i konflikteve iudha përparësi aftësive të udhëheqësve të luftës dhe priftërinjve - shaman. Nëse një individ i vetëm do t'i kombinonte këto cilësi, atëherë ai kishte mundësi të bëhej udhëheqës i madh.

## Qasja teorike

Qasjet studimore mbi lidershipin janë të hershme, nga ajo e tipareve deri tek fundi i shekullit të 19-të e fillim të shekullit të 20-të, zgjeruar me futjen e konceptit të universalitetit dhe detajimin me fusha të shkencave sociale. Qasja teorike u zgjerua si cilësi e karakteristika, të cilat nuk janë tërësisht të lindura e trashëguara, por ato mund të fitohen edhe nëpërmjet proceseve

mësimore dhe eksperiencave të ndryshme. Evoluimi dhe zhvillimi i koncepteve të udhëheqjes është një fenomen historik, i lidhur ngushtë me strukturën organizative të shoqërisë. Evoluimi i shoqërisë dhe qeverisja në rende të ndryshme demostroi një tërësi cilësish e tiparesh liderash të papërshtatshëm për situata të ndryshme. Udhëheqja është një subjekt i rëndësishëm me ide konfuzë dhe terminologji të hapur për interpretime gjërësisht të ndryshme, ...përkufizimet dhe përshkrimet e lidershit ndryshojnë jashtëzakonisht shumë.

Konceptet mbi lidershipin kanë evoluar, nisur nga qëllimet, metodat e përdorura nga klasa politike për të ngritur lidershipin dhe zbatuar politikën qeverisëse. *“Një lider është shumë i mirë kur populli thjesht e njeh që ai ekziston, jo shumë mirë kur populli i bindet dhe e duartroket atë, keq kur ata e shpërfillin dhe përbuzin atë”* (Tzu & Ching, 1988: 19).

Evoluimi i shoqërisë dhe zhvillimi i koncepteve të udhëheqjes është e lidhur jo vetëm si një fenomen historik, por edhe me strukturën organizative të shoqërisë. Ky evoluim identifikon *katër faktorë* më me ndikim mbi lidershipin, që janë: Lideri, Njerëzit, Komunikimi dhe Situatat. Studimet u thelluan rreth *“tetë fusha kyçe të zhvillimit”*, ku qasjet studimore në modernizëm dhe postmodernizëm orientojnë kërkimet në fushën e etikës. Këto qasje studimore e vendosin lexuesin brenda zhvillimeve historike në filozofinë dhe teorinë sociale si pjesë jo vetëm nga mënyrat e tërheqjes, rrjetet, orientimi në detyrë, shqetësimet, statusi i paraqitur, zinxhiri komandues, stili i menaxhimit, motivimi i punonjësve, gjuha e menaxhimit, përdorimi si funksionet kryesore të lidershit por edhe nga elementë të tjerë mbartës të saj. Këto qasje bashkëkohore ofrojnë domosdoshmëri që lidershipi të mishërojë e demostrojë një barrë të madhe përkushtimi, etike dhe përgjegjësie.

Përkufizimet mbi lidershipin janë të shumta e të diversifikuara, ndërsa

përshkrimet e udhëheqjes thjesht si një model teknik, proces, stil ose filozofi na ndihmojnë të sqarojmë mënyrat kryesore të kuptuarit e të shpjeguarit se çfarë do të thotë udhëheqja. Qasja universale e lidershit e përcakton si një zonë hulumtimi dhe një aftësi praktike, në lidhje me aftësinë e një individi apo organizate për të “udhëhequr” ose udhëzuar individë të tjerë, ekipe ose organizata të tëra. Lidershipi paraqet sfidë të kuptuarin e natyrës udhëheqëse. Autorë si Stogdill (1974:7) dhe Fleishman E.A. (1991) referuar hulumtimeve të fundit citojnë rreth 65 sisteme të ndryshme klasifikimi të zhvilluara për përcaktimin e lidershit (Stogdill, 1974: 7; Northouse, 2013: 4).

Disa autorë sugjerojnë lidershipin si *fokusin e proceseve* të grupit, të tjerë nga *një perspektivë personaliteti*, në aspektine *marrëdhënies së pushtetit* që ekziston midis liderëve dhe pasuesit, *fuqi të ushtruar* e të patur ndryshim në të tjerët, nga një *perspektivë e aftësive*, të lidhur me *konceptin e fuqisë*, nga *spektri holistik* që mund të lindi nga nivelet e pushtetit, nga energjitë mendore, nga aftësitë e larta dhe niveli më i lartë i vlerave, urtësisë, spiritualiteti ku çdo lider buron nga një përzjerje e veçantë të një ose nga shumë faktorë të mëparshëm (Lila, 2018: 40).

Autorët Burns 1978, Heller & Van Til 1983, Hollander 1992, Jago 1982, Rost 1991 udhëheqësit dhe pasuesit i shohin *si qëllim të përbashkët*. Këta autorë liderët dhe ndjekësit i shohin të përfshirë bashkarisht në procesin e udhëheqjes, ku liderët kanë nevojë për pasuesit dhe pasuesëve u nevojiten udhëheqës, fillojnë marrëdhënien, krijojnë lidhjet e komunikimit dhe mbartin barrën për ruajtjen e marrëdhënieve. Udhëheqësit kanë një përgjegjësi etike e përkushtimi në nevojat dhe shqetësimet e pasuesve. Liderët nuk janë më të mirë se pasuesit dhe lidhja e tyre duhet të kuptohet në lidhje me njëri-tjetrin dhe në një raport kolektiv në shoqëri. Ata janë në marrëdhënie udhëheqje bashkarisht, si dy anët e të njëjtën monedhë. Ndërsa Jago, A.G. (1982), në librin

“Leadership: Perspectives in theory and research, Management Science”, sugjeron se udhëheqja është një fenomen që banon në kontekstin e ndërveprimeve ndërmjet liderëve dhe ndjekësve dhe e bën udhëheqjen dispozicion për të gjithë ku lidershipi mund të vërehet në sjelljet udhëheqëse. Autori Roderick Kramer i referohet inteligjencës politike dhe aftësive politike makiavieliste. Referuar autorit Joseph S. (2008) citohet se *“frikësimi, manipulimi dhe negociatat janë të lidhura me pushtetin e vështirë, por politika përfshin edhe frymëzim, marrëveshjeve të reja e të dobishme, zhvillimin e rrjeteve të besimit, që janë tipike e fuqisë së butë”*.

### Udhëheqja shërbëtoare

Udhëheqja Shërbëtor (Servant Leadership) është filozofi lidershipi dhe grup i praktikave udhëheqëse me aksione shërbëtoare. Kjo qasje lidershipi vendos primare nevojat e të tjerëve, duke i ndihmuar njerëzit të zhvillojnë dhe të kryejnë sa më shumë të jetë e mundur këto nevoja. Fillesat e kësaj qasje lidhen me udhëheqjen e shërbëtorit nga Tao Te Ching dhe i atribuohen Lao – Tzu diku midis viteve 570 p.e.s dhe 490 p.e.s në Kinë. Udhëheqja shërbëtor mund të gjenden në shumë teksteve fetare, edhe pse filozofia e kësaj qasje e kapërcen traditat e veçanta fetare. Në traditën fesë së Krishterë, asaj Islame dhe fevetë tjera botërore e kanë përqafuar prej kohësh filozofinë e udhëheqjes së shërbëtorit” (Lila, 2018). Udhëheqja tradicionale në përgjithësi përfshin grumbullimin dhe ushtrimin e pushtetit në krye të piramidës, ndërsa qasja e udhëheqjes shërbëtoare është në kundërshtim me këtë sens të përbashkët. Qasja universale e udhëheqjes nuk përkon me të qenit shërbëtorë. Pyetja lindse si mundet që udhëheqja të jetë edhe shërbim dhe ndikim? Edhe lider dhe shërbëtor në të njëjtën kohë? Lidershipi shërbëtor paraqitet kontradiktor dhe sfidon besimet tradicionale mbi udhëheqjen, por kjo qasje

udhëheqje ofron një perspektivë unike (Northouse, 2013:219).

Udhëheqja shërbëtoare fillimet e saj i ka në shkrimet e RobertK. Greenleaf (1970) dhe vazhdon të ketëinteres i madh prej rreth pesë dekadash. Deri tani studimet mbi këtë qasjejanë të pakta, shumica e shkrimeve e studimeve akademike dhe jo akademike të paraqitura kanë qenë urdhëruese dhe sesi mund të jetë ideale, në vend të fokusimit në udhëheqjen shërbëtoare praktikisht të vërtetë (Dierendonck, 2011). Studimet e botime të shumta në dekadën e fundit kanë ndihmuar për të sqaruar udhëheqjen shërbëtorin dhe kanë mbështetur supozimet e saj themelore.

Çfarë është lidershipi shërbëtor? Studiuues të ndryshëm e kanë adresuar këtë qasje nga shumë perspektiva dhe rezultojnë në një shumëllojshmëri përcaktimesh të udhëheqjes shërbëtoare. RobertK. Greenleaf (1970) jep përkufizimin se udhëheqja shërbëtoarefillon me ndjenjën e natyrshme të personit që dëshiron të shërbejë për herë të parë dhe më pas një zgjedhje të vetëdijshme të po vetë personitqë aspiron për të udhëhequr. Dallimi manifestohet në kujdesin e marrëfillimisht nga personi (shërbëtori)për të siguruar se nevojat më prioritare e njerëzve të tjerë janë duke u shërbyer. Testi më i mirë është; të bëjë njerëzit (pasuesit) që u shërben të rriten si persona, ndërsa duke u shërbyer këtyre njerëzve të bëhen të shëndetshëm, më të mençur, më të lirë, më të pavarur, me prirjen që në ardhmen për t’u bërë shërbëtorë? Efektet do ndikojnë në shoqëri,ku kjo e fundit do përfitojë ose më e pakta këta njerëz (pasues) të përfitojnë e të mos të privohet edhe më tej (Graham, 1991: 105-119).

Teoritë udhëheqëse afrohen tek aftësitë, qasja e stilit, ndërsa qasja shërbëtoare fokuson udhëheqjen nga këndvështrimi i liderit dhe sjelljet e tij/saj. Udhëheqja shërbëtoare fokuson vëmendjen ndaj shqetësimeve të pasuesve, i thekson dhe i dëgjon ata, dhe i ushqenvazhdimisht që të përmirësohen. Drejtuesit shërbëtorë vendosin si primar ndjekësit, i fuqizojnë ata dhe i ndihmojnë të



zhvillojnë kapacitetet personale. Udhëheqësit shërbyes më tepër “*janë etikë dhe që i shërbejnë të mirës më të madhe të organizimit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi*” (Northouse, 2013: 219). Dijetarë kanë adresuar këtë qasje nga shumë perspektiva e shumëllojshmëri të ndryshme përcaktimesh të udhëheqjes shërbëtorit. Krahas Greenleaf (1970, 1972, 1977) kjo teori është hulumtuar nga Graham 1991, Hale & Fields 2007, Walumbwa & Hartnell & Oke 2010, Ehrhart 2004 dhe Spears 2010. Në këto studime përcaktohen idetë themelore të udhëheqjes shërbëtoare, ku kjo qasjeprej shërbëtori shihet si një sjellje. Robert K. Greenleaf, themeloi Qendrën për Etikën e Aplikuar në vitin 1964, (Greenleaf Center for Servant Leadership), shpiku termin e udhëheqjes së shërbëtorit. Ai është autor e themelues në mënyrë të konsiderueshme se si lidhshipi shërbëtor është zhvilluar në nivelin praktik dhe teorik.

Pas një experience të gjatë në këtë qendër, aktualisht nga Robert K. Greenleaf kemi qasje udhëheqje se si institucionet funksionojnë dhe se si ato mund ti shërbejnë më mirë shoqërisë. Ky studiu i intriguar nga çështjet e fuqisë dhe autoritetit të individëve në

organizata, kundër lidhshiptit shtërngues ofroi qasjen e të mbështeturit tek njëri-tjetri në mënyrë krijuese dhe mbrojtje përdorimit e komunikimit e të ndërtuarit e konsensusit në grupe.

Sipas Greenleaf përveç vuajtjes, një lider shërbëtor ka një përgjegjësi sociale për të qenë i shqetësuar në lidhje me “të paprivilegjuarit” dhe ata më pak të privilegjuar. Në shoqëri kupabarazitë dhe padrejtësitë shoqërore janë evidente dhe ekzistojnë, një udhëheqës shërbëtor përpiqet për të hequr ato, përdor më pak fuqi institucionale dhe kontrolli, zhvendos autoritetin, mundësi përballje për individët që përjetojnë ndërvarësinë, respekt, besim dhe rritje individuale (Graham, J. W. (1991).

Pas rreth tre dekadash mbi studimet origjinale të R.K.Greenleaf, u pranua gjërisht se kjo qasje ishte mënyrë drejtimi sesa qasje teorike dhe me vlera të forta të mësuari e praktike. Autorë e studiuës si Bennis (2002), Blanchard & Hodges (2003), Covey (2002), DePree (2002), Senge (2002), dhe Wheatley (2002) adaptuan udhëheqjen shërbëtoare si një filozofi urdhëruese në organizata të mëdha ndërkombëtare. Kjo qasje ishte romantike

**Tabela 1:** Karakteristikat kryesore të lidhshiptit shërbëtor (Dierendonck, 2011)

Laub (1999)	Dennis & Bocarnea (2005)	Barbuto & Wheeler (2006)	Wong & Davey (2007)	Sendjaya, Sarros, & Santora (2008)	Van Dierendonck & Nuijten (2011)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i njerëzve</li> <li>• Ndarja e udhëheqjes</li> <li>• Shfaq autencitet / originalitet</li> <li>• Vlerësimi i njerëzve</li> <li>• Sigurimi i udhëheqjes</li> <li>• Ndërtimi i komunitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fuqizimi</li> <li>• Besim</li> <li>• Përrulësi</li> <li>• Dashuri</li> <li>• Vizion</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thirrje altruiste</li> <li>• Shërimi emocional</li> <li>• Planifikim bindës</li> <li>• Kujdestari organizative</li> <li>• Urtësi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimi dhe duke zhvilluar të tjerët)</li> <li>• Konsulencë dhe përfshirje e të tjerëve</li> <li>• Përrulësi e vetëmohim</li> <li>• Modeli i integritetit dhe origjinalitetit</li> <li>• Frymëzues dhe ndikues tek të tjerët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikim transformues</li> <li>• Varësi vullnetare</li> <li>• Vetë-autentike)</li> <li>• Natyrë përçuese / transmetuese</li> <li>• Marrëdhënie të besueshme</li> <li>• Moralisht i përgjegjshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fuqizim</li> <li>• Përrulës</li> <li>• Suportues/ mbështetës</li> <li>• Autenticitet / originalitet</li> <li>• Falje</li> <li>• Guxim</li> <li>• Përgjegjësia</li> <li>• Drejtimi</li> </ul>

dhe njëkohësisht paradoksale por rezultoi e sukseshme dhe ideale për të drejtuar këto organizata (Spears, 2010: 11-24).

Studiues të ndryshëm po shqyrtojnë bazat konceptuale të udhëheqjes shërbëtor me synimin për të ndërtuar teori duke rezultuar në një grup modelesh, në karakteristika funksionale (shenja dalluese të vëzhguara në vendin e punës), karakteristika shoqëruese që rrisin këto sjellje, në krijimin e modeleve të karakterizuar nga virtyte dhe që formojnë sjelljet e udhëheqësve shërbëtorë (Patterson, 2003). Tabela e mëposhtme na jep një përmbledhje të këtyre studimeve, duke ilustruar me karakteristikat që lidhen me udhëheqjen shërbëtor. Tabela tregon se si udhëheqja e shërbëtorit trajtohet si një fenomen tiparësh (p.sh., guxim, përlësi), ndërsa në studime të tjerë e konsiderojnë atë si një proces të sjelljes (p.sh., duke shërbyer dhe zhvilluar të tjerët). Këto studime ofrojnë bazat e nevojshme për zhvillimin e një modeli të rafinuar të kësaj qasje (Northouse, 2013).

Autori Spears (2002), në studimet e tij identifikon dhjetë karakteristikat të cilat përbëjnë modelin e parë ose konceptualizimin e lidershipit shërbëtorit. Këto karakteristika përfshijnë; dëgjimin, ndjeshmërinë, shërimin, ndërgjegjësimin, bindjen, konceptimin, largpamësinë, drejtimin, angazhimin, ndërtimin e zhvillimin e komunitetit.

1. Dëgjimi (listening) e komunikimi mes liderëve dhe ndjekësve është një proces interaktiv, që përfshin dërgimin dhe marrjen e mesazheve. Ata pranojnë se të dëgjuarit e të hapur ndaj të tjerëve që kanë për të thënë, është një disiplinë e të mësuarit.

2. Ndjeshmëria (empathy) është vendosja e vetes në pozicion të tjetrit ose vendosja “këmbë në këpucë” e tjetrit, duke u përpjekur për të parë botën nga pikëpamja e atij personi. Udhëheqësi shërbëtor tregon ndjeshmëri, ajo është e konfirmuar dhe në vlerësimin për ndjekësit. Kjo i bën ndjekësit të ndjehen të konsideruar e të veçantë.

3. Shërimi (healing) lidhet me kujdesjen e udhëheqësit shërbyes për mirëqenien

personale të pasuesve të tyre, duke i ndihmuar ata për të kapërcyer problemet personale. R. K. Greenleaf argumenton se procesi i shërimit është një rrugë dykahëshe, ndihmon pasuesit dhe vetë liderët shërbëtor.

4. Ndërgjegjësimi (awareness) dhe vetëdija është një cilësi brenda udhëheqësve shërbyes, të përshtatur dhe të hapur për mjediset e tyre fizike, sociale dhe politike. Ai përfshin të kuptuarit e vetes dhe ndikimin që këta persona kanë për të tjerët në kontekstin më të madh të situatës.

5. Bindja (persuasion) është komunikimi i qartë dhe i vazhdueshëm për të ndryshuar. Në krahasim me përdorimin tradicional të autoritetin që pozicionon e që detyron pajtueshmërinë, bindja krijon ndryshim përmes arsytimit e përdorimit të argumentit të butë e jo gjykues.

6. *Konceptimi* (conceptualization) i referohet aftësisë së një individi të jetë vizionar dhe i qartë në synime dhe në drejtim.

7. *Largpamësia* (foresight) e parashikimi përfshin aftësinë e prijësit shërbëtor për të ardhmen. Kjo është një aftësi që merr në konsideratë memorijen historike dhe të tashmen, aftësia vjen e bazuar në atë që ndodh në të tashmen dhe atë që ka ndodhur në të kaluarën. Për Greenleaf, largpamësia ka një dimension etik, të ndjerit përgjegjës për dështimet, të arsyeshmën që mund të parashikohet dhe të veprohet.

8. *Drejtimi* (stewardship) është marrje përgjegjësie për rolin e besuar të lidershipit, të pranojë përgjegjësinë për të menaxhuar njerëzit e organizuar gjatë udhëheqjes së tyre. Gjatë drejtimit, lideri mban mirëkuptim e mirëbesim në organizatë e në shoqëri.

9. *Angazhimi për rritjen e njerëzve* (commitment to the growth of people). Udhëheqësit shërbyes angazhohen për të ndihmuar çdo person në rritjen personalisht dhe profesionalisht. Angazhimi me mundësi për zhvillimin e karrierës, zhvillimi i aftësive të reja të punës dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje.

10. *Ndërtimi i komunitetit* (building community). Një komunitet është koleksion


individësh me interesa të përbashkëta, ndjenjë uniteti dhe lidhje midis tyre, sigurimi i një vendi ku njerëzit mund të ndjehen të sigurt dhe të lidhur me të tjerët, të lejuar që të shprehin individualitetin e tyre.

Këto karakteristika të lidërshiptit shërbëtor përfaqësojnë punën e shërbëtorit si lider dhe ofrojnë kompleksitetin e udhëheqjes shërbëtor. Modeli i lidërshiptit shërbëtor përbëhet e bazohet në nga tre komponentë kryesorë: kushtet e mëhershme, sjelljet e udhëheqësit shërbëtor dhe rezultatet e lidërshiptit. Fokusi kryesor i modelit janë sjelljet e liderëve që janë të ndikuar nga konteksti dhe kultura, atributet e kryetarit dhe perceptimi i ndjekësve ndaj këtij lloji të udhëheqjes. Angazhimi në udhëheqjen e nëpunësit sjell përmirësim rezultatesh në nivel individual, organizativ dhe shoqërorë. Këto komponentë sqarojnë fenomenin e lidërshiptit shërbëtor dhe sigurojnë një kornizë për të kuptuar kompleksitetin e saj (Liden et al., 2011):

*Kushtet e ngjarje të mëparshme* kanë ndikim në udhëheqjen e shërbëtorit, në kontekstin dhe kulturën, atributet e udhëheqësit dhe pranueshmërinë e ndjekësve. Këto kushte nuk përfshijnë të gjitha kushtet

që ndikojnë në udhëheqjen shërbëtor, por përfaqësojnë faktorë më ndikues në procesin e lidërshiptit. *Sjelljet e udhëheqësit shërbëtor* i referohen kryesisht konceptktualizimit, shërimit emocional, vendosjen parësore e pasuesëve, dhënien e ndihmës pasuesëve që të rriten e të bëjnë kujdes, demonstrimin e sjelljes etike, fuqizimin dhe krijimin e vlerës për komunitetin. *Rezultatet* lidhen përformancën e pasuesëve dhe aftësimi i tyre në rritje, performance organizative dhe impakti në shoqëri (Northouse, 2013: 226-32). Ky model qeverisës fokusin kryesor e përqëndron rreth *shtatë sjelljeve të liderëve shërbëtorë* si; konceptimi, emocionet shëruese, vendosja e ndjekësve të parë, ndihmesa që pasuesit të rritet dhe të kenë sukses, sjellja etike, fuqizimin dhe krijimin e vlerës për shoqërinë. Këto sjellje janë të ndikuara nga konteksti dhe kulturës, cilësitë eliderit dhe perceptimi i ndjekësve ndaj këtij lloji të udhëheqjes. Kur individët angazhohen në këtë model udhëheqje e nëpunësit (shërbëtorit), pritshmëritë për të përmirësuar rezultatet në nivel individual, organizativ dhe shoqërorë janë në rritje. Identifikimi i këtyre sjelljeve të udhëheqësit shërbëtor janë bërthama e procesit të kësaj qasje.

**Tabela 2:** Model i Lidërshiptit Shërbëtor



Autorë si Liden R. C., Wayne S. J., Zhao H. & Henderson, D. (2008) e zhvilluan qasjen e udhëheqjes së shërbëtorit dhe dëshmojnë për qëndrueshmërinë e *shikimit së udhëheqjes shërbëtor si një proces shumë dimensional*. Edhe pse udhëheqja e shërbëtorit fokusohet kryesisht në sjelljet udhëheqëse, është e rëndësishme shqyrtimi i udhëheqjes shërbëtor sipas *rezultateve të mundshme*, të rritjes së performancës së ndjekësve, performancës organizative dhe ndikimit shoqëror.

### Nënë Tereza

Nënë Tereza përbën shembullin shumë të dukshëm e ndikues të udhëheqjes shërbëtorëve. Siç thekson Greenleaf në punën e tij origjinale (1970), qëllimi kryesor i udhëheqjes shërbëtorë është të krijojë organizata të shëndetshme e të ushqejnë rritjen individuale, të forcojnë performancën organizative dhe në fund të fundit, të japin një ndikim pozitiv në shoqëri. Shumica e studiuesëve duke analizuar profilin e Nënë Terezës argumentojnë se sjellja e saj prej shërbëtorit përqëndrohet drejtpërdrejt në njohjen e ndjekësve dhe duke i ndihmuar ata të realizojnë potencialin e tyre njerëzor. Rezultati pritshëm nga puna e Nënë Terezës për ndjekësit është vetë-aktualizimi më i madh i tyre. Nënë Tereza arriti të edukojë ndjekësit, t'i ndihmonte ata në qëllimet e tyre personale, t'u japë atyre siguri e kontroll dhe ndjekësit do të kuptojnë aftësitë e tyre të plota.

Agnes Gonxhe Bojaxhiu, e njohur si Nënë Tereza, është një nga pesë motrat e lindur në Shkup nga familje shqiptare katolike. Mjedisi shoqëror e familja ndikuan në formimin e zhvillimin e saj. Babai i saj sipërmarrës, besimtar e praktikues në kishën lokale, përkrahës i zellshëm i pavarësisë shqiptare. Nëna e saj me ftesat e hapura të darkës së qytetit me familjen e saj, ndikuan në formimin e saj. Në moshën 8 vjeçare babai i saj u sëmur e vdiq. Ajo krijoi një lidhje të jashtëzakonshme me nënën e saj,

e cila pohonte vazhdimisht: “Fëmija im, kurrë mos ha asgjë vetëm nëse nuk e ndan me të tjerët”. Nënë Tereza ndoqi shkollën fillore dhe më pas një shkollë të mesme të drejtuar nga shteti. Në moshën 12 vjeçare ndjeu një thirrje për një jetë fetare dhe në moshën 18 vjeçare (viti 1928), vendosi të ndiqte jetën e një murgëshe.

Një rezultat i udhëheqjes së shërbëtorëve të mishëruar tek profili i Nënë Terezës, vërehet një ndikim të favorshëm në performancën e pasuesëve, referuar mënyrës se si ndjekësit kryejnë punën e tyre të caktuar. Krijimin e një rendi të ri fetar, Misionarët e Bamirësisë nga Nënë Tereza, përbën shembullin e ndikimit të udhëheqjes shërbëtorë që janë shumë të dukshme në shërbimin ndaj të uriturve, të pastrehëve dhe të padëshiruarëve. Ky urdhër tani ka më shumë se një milion punonjës në mbi 40 vende të botës që operojnë në shkolla dhe spitale për të varfërit. Udhëheqja e shërbëtorëve të Nënë Terezës ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në shoqëri e në të gjithë botën (Northouse, 2013: 216-230).

Qasja shërbëtor e mishëruar tek Nënë Tereza përputhet me vartësit të cilët ishin të hapur për këtë lloj udhëheqjeje, ku rezultatet ishin pozitive. Vartësit nën këtë sjellje u bënë më të efektshëm në përmbushjen e punëve të tyre dhe në përmbushjen e përshkrimeve të tyre të punës. Nënë Tereza duke demonstruar etikë, trajtimin e fuqizimin e pasuesëve, arriti të prodhonte një efekt të mprehtë e të krijojë më shumë udhëheqës shërbëtorë. Kjo është hipotezë që kërkon hulumtime të mëtejshme për tu provuar. Udhëheqja shërbyesve e Nënë Terezës ndikoi në mënyrën e funksionimit të ekipeve organizative. Qasja udhëheqëse e saj ndikoi në efektivitetin e ekipit duke rritur besimin e përbashkët të anëtarëve se mund të ishin efektivë si një grup pune, kontribuoi pozitivisht në potencialin e ekipit duke rritur procesin e grupit dhe qartësinë e tij. Studimet e mëtejshme vërtetojnë se mënyrat direkte dhe indirekte që lidhshipi shërbyes demonstron se janë

të lidhura me performancën organizative (Northouse, 2013: 231).

Ndikimi shoqëror është tjetër rezultat i prituri i udhëheqjes shërbëtorit me ndikim pozitiv në shoqëri. Shembuj tipik i ndikimit të liderit shërbëtor është puna e Nënë Terezës në shërbim të uriturve, të pastrehëve, dhe rezultoi në krijimin e një rendi të ri fetar, të Misionareve të Bamirësisë. Modeli i leadershipit shërbëtor të Nënë Terezës ka pasur një ndikimi i jashtëzakonshëm në shoqërinë në të gjithë botën, ku themeloi Misionaret e Bamirësisë, një bashkësi fetare katolike romake në vitin 1950. Kjo bashkësi, nën drejtimin e Nënë Terezës, trajtuan të dëbuarit e shoqërisë, njerëzit me HIV/AIDS, lebrozë dhe tuberkulozi. Ajo e kuptoi fuqinë e ndikimit të një personi. *“Unë vetëm nuk mund të ndryshojë botën, por unë mund të hedh një gur në të gjithë ujërat për të krijuar shumë gurgullimë”* (Northouse, 2013: 232). Forca lëvizëse e Nënë Terezës ishte besimi i saj, por dhembshuria e saj për njerëzimin tejkalon çfarëdo bindje personale e fetare. Ajo ishte një komunikatore e madhe, krerët e shteteve në mbarë botëne dëgjuan dhe i kushtuan vëmendje, ajo ishte e vërtetë për veten, e përlurur, kujdesur dhe gjithmonë në shërbim të njerëzve. Ajo ka shkruar më shumë se 25 libra të përkthyer në të gjitha gjuhët e botës.

Nënë Tereza demonstronte konsideratë të individualizuar, duke ofruar një klimë mbështetëse në të cilën ata dëgjojnë me kujdes për nevojat individuale të pasuesve – si *lider transformues*. Nënë Tereza demonstronte *karizmë ose ndikimi i idealizuar*. Kjo qasje komplekse e përshkruan Nënë Terezën si model të fortë për ndjekësit, ku pasuesit kërkojnë të identifikohen dhe duan të imitojnë atë. Kjo qasje komplekse ka standarde shumë të larta të sjelljes morale e etike, duke bërë gjënë e duhur, respektohet shumë nga pasuesit duke vendosur një marrëveshje të madhe të besimit në to dhe ofron pasuesëve vizion dhe një sens të misionit.

Pjesën më të madhe të jetës së saj Misionarja me origjinë shqiptare Nënë

Tereza e jetoi në Indi, ku besohet se mënyra e jetesës formoi një përshtypje të pashlyeshme në mendjen e saj. Ideologjitë e demonstruara nga Nënë Tereza i tejkalojnë edhe identitetet kulturore si klasat, ngjyrat, gjinitë, hierarkinë, pronësinë dhe racat si fakti themelor i këtij dialogu. Organizata “Misionareve të Bamirësisë” është aktive në 133 vende të botës ku operon me shpërndarësit dhe klinikat e lëvizshme, me programe këshillimi për fëmijë dhe familje, me jetimore dhe shkollat. Organizata ka rregullore specifike që qeverisin këtë organizatë, ku anëtarët e rendit duhet t’u përmbahen premtimeve të delirësisë, varfërisë dhe bindjes dhe premtimit për t’i dhënë “shërbim të plotë me gjithë zemër më të varfër nga i varfër” (Muggeridge, 1971:105). Në vitin 1979 mori Çmimin Nobel për Paqen për punën e saj humanitare.

Gjatë aktivitetit bamirës, Nënë Tereza u ballafaqua edhe me kritika. Kritika më tronditëse ndaj Nënë Terezës gjendet në librin e Christopher Hitchens *“Pozicioni Misionar: Nënë Tereza në Teori dhe Praktikë”*, në të cilin Hitchens argumenton se Nënë Tereza lavdëronte varfërinë për qëllimet e saj dhe siguroi një justifikim për ruajturi institucionet dhe besimet që ruanin varfërinë e përhapur.

## Përfundime

Qasja e leadershipit shërbëtor funksionon ndryshe nga teoritë e tjera, të cilat orientohen nga tiparet e caktuara specifike, ndryshe nga qasjet e stilit apo teoritë e qëllimit. Kjo qasje përqendrohet në ekspozimin e sjelljeve udhëheqëse për t’i vendosur ndjekësit të parë dhe për t’i mbështetur ata të rriten e përmirësohen. Lideri shërbëtor është i shqetësuar me mënyrën sesi trajtojnë vartësit dhe mbi rezultatet që është e pritshme që ka të ngjarë të shfaqen.

Ky model përbëhet nga tre përbërës: kushtet e mëparshme, sjelljet e udhëheqësit shërbëtorë dhe rezultatet. Shtatë sjelljet e udhëheqësve që nxisin Udhëheqjen e

shërbëtorëve: konceptimi, shërimi emocional, vendosja e ndjekësve të parë, ndihmesa e ndjekësve të rriten dhe të kenë sukses, të sillen në mënyrë etike, të fuqizojnë dhe të krijojnë vlera për komunitetin, përbën fokusin qendror të këtij modeli. Këto sjellje ndikohen nga konteksti dhe kultura, atributet e liderit dhe pritshmëria e ndjekësve ndaj kësaj lloji udhëheqjeje. Kur individët përfshihen në udhëheqjen e shërbëtorëve, ka të ngjarë të përmirësojnë rezultatet në nivelin individual, organizativ dhe shoqëror.

Udhëheqja është subjekt i rëndësishëm, me plot ide konfuzë dhe terminologji të hapura për interpretime gjërësisht të ndryshme, ku përkufizimet dhe përshkrimet e lidershipit ndryshojnë jashtëzakonisht shumë. Liderët dhe ndjekësit duhet të ballafaqohen në raport me secilin hulumtim paraprak dhe tek rëndësia e adresimit të çështjeve që përballen pasuesit e liderët. Qasjet teorike mbi lidershipin kanë evoluar nga qasjet tipar tek ato të fundit në modele grupi apo filozofike.

Hulumtimi mbi udhëheqjen e shërbëtorit ka disa *përparësi*. *Së pari*, ajo është unike, sepse ajo e bën altruizmin si komponentin kryesor të procesit të udhëheqjes. *Së dyti*, udhëheqja shërbëtor ofron një qasje kundër intuitive dhe provokuese për përdorimin e influencës në ndryshim nga qasjet e tjera, ku udhëheqësit marrin kontrollin në vend që të kërkojnë kontroll. *Së treti*, hulumtimi ka treguar kushtet në të cilat lidershipi shërbëtor nuk është një lloj e preferuar i udhëheqjes. *Së katërti*, hulumtimet identifikojnë shtatë dimensionet e të veçantat e procesit, të cilat kanë rezultuar në një masë të shëndoshë të udhëheqjes shërbëtoare.

Por kjo qasje ka edhe kufizimet e saj. *Së pari*, ato lidhen me natyrën paradoksale të titullit dhe zhurmës semantike që zvogëlon vlerat potenciale të qasjes. *Së dyti*, nuk ekziston një konsensus e një kuadër të përbashkët teorie për udhëheqjen e shërbëtorit. *Së treti*, qasja shërbëtor ka një rrjet utopik që bie ndesh me qasjet tradicionale ndaj lidershipit. *Së fundi*, ekziston paqartësi rreth “konceptimit” si një karakteristikë përcaktuese e udhëheqjes së shërbëtorit. Pavarësisht nga kufizimet, kjo qasje lidershipi vazhdon të jetë një qasje për udhëheqjen premtuese. Hulumtimet dhe supozimet e udhëheqjes shërbëtoare do t’na çojnë në proces e në një kuptim më të mirë të kompleksitetit (Northouse, 2013: 248-9).

Në shoqërinë e sotme është gjithnjë e më vështirë udhëheqja mbi një vizion të qartë të realitetit. Situatat janë komplekse, konteksti ndryshon me shpejtësi; obligimet dhe detyrat janë jo të mirëpërcaktuara plotësisht e të kufizuara mirë. Hartat e udhëheqëse të shekullit aktual fshehin dilema pushteti dhe kontrolli, të cilat janë zbuluar vetëm përmes leximit të kujdesshëm dhe krahasues. Hartat e lidershipit ende nuk kanë trajtuar në mënyrë adekuate dilemat e pushtetit, detyrimit dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërsa udhëheqjen e bazuar në besim që rishpërndahet brenda një kornize vlerash. Udhëheqësit e mirë nuk janë të lindur. Udhëheqësit e vërtetë vendosin prioritet të lartë në reciprocitetin e përcaktimit të qëllimit si një proces krijues dhe social. Udhëheqësit e mirë bëhen, sepse ata punojnë në shumë dimensione strukturore, me pasion dhe dhembshuri. Asnjë model i vetëm, asnjë lloj i vetëm teorie, i orientuar nga modelet, filozofitë, stilet apo ndonjë kategori tjetër, nuk i mbulon të gjitha këto aspekte.

## REFERNCAT

Avolio, B.J. & Locke, E.E. 2002. “Contrasting different philosophies of leader motivation: Altruism versus egoism”, *Leadership Quarterly*, 13, 169–191

Barbuto, J. E., Jr., & Wheeler, D. W. 2006. “Scale development and construct clarification of servant leadership”, *Group and Organizational Management*, 31, pp. 300–326.

- Bass, B. M., & Steidlmeier, P. 1999. "Ethics, character, and authentic transformational leadership behavior", *Leadership Quarterly*, 10(2).
- Bennis, W. 2002. "Become a tomorrow leader", in L. C. Spears & M. Lawrence (Eds.), *Focus on leadership: Servant-leadership for the twenty-first century*, (pp. 101–110). New York: John Wiley & Sons.
- Blanchard, K., & Hodges, P. 2003. *The servant leader: Transforming your hearts, heads, hands, and habits*. Nashville, TN: Thomas Nelson.
- Boudette, N. E. 2006. March 10). Kalamazoo, Mich., pegs revitalization on tuition plan. *The Wall Street Journal*, p. A1.
- Burns, J. M. 1978. *Leadership*. New York: Harper & Row.
- Chiro, D. 2012. *Si ndryshojnë Shoqëritë*, Tiranë: AIIS.
- Citulla, J. B. 1998. *Ethics, the heart of leadership*. Westport, CT: Greenwood.
- Covey, S. R. 2002. "Forward", in R. K. Greenleaf (Ed.), *Servant leadership: A journey into the nature of legitimate power and greatness* (pp. 1–14). New York: Paulist Press.
- Dennis, R. S., & Bocarnea, M. (2005). Development of the servant leadership assessment instrument. *Leadership & Organization Development Journal*, 26, 600–615.
- DePree, M. 2002. Servant-leadership: Three things necessary. In L. C. Spears & M. Lawrence (Eds.), *Focus on leadership: Servant-leadership for the twenty-first century* (pp. 27–34). New York: John Wiley & Sons.
- Ehrhart, M. G. 2004. Leadership and procedural justice climate as antecedents of unit-level organizational citizenship behavior. *Personnel Psychology*, 57, 61–94.
- Graham, J. W. 1991. Servant leadership in organizations: Inspirational and moral. *Leadership Quarterly*, 2, 105–119.
- Greenleaf, R. K. 1970. *The servant as leader*. Westfield, IN: The Greenleaf Center for Servant Leadership.
- Greenleaf, R. K. 1972. *The institution as servant*. Westfield, IN: The Greenleaf Center for Servant Leadership.
- Greenleaf, R. K. 1977. *Servant leadership: A journey into the nature of legitimate power and greatness*. New York: Paulist Press.
- Hale, J. R., & Fields, D. L. 2007. Exploring servant leadership across cultures: A study of followers in Ghana and the USA. *Leadership*, 3, 397–417.
- Heifetz, R. A. 1994. *Leadership without easy answers*. Cambridge: Harvard University Press.
- Hersh, Zh. 1998. *Habia Filozofike*, Tiranë: Dituria.
- Hesse, H. 1956. *The journey to the East*. London: P. Owen. Hu, J., & Liden, R. C. (2011). Antecedents of team potency and team effectiveness: An examination of goal and process clarity and servant leadership. *Journal of Applied Psychology*, 96(4), 851–862.
- Joseph S. & Nye J. R. 2008. *The Powers to LEAD*, Oxford: Oxford University Press
- Kidder, T. 2003. *Mountains beyond mountains: The quest of Dr. Paul Farmer, a man who would cure the world*. New York: Random House.
- Laub, J. A. (1999). Assessing the servant organization: Development of the servant organizational leadership assessment (SOLA) instrument. *Dissertation Abstracts International*, 60 (02), 308. (UMI No. 9921922)
- Levis, R. D. 2013. *When Cultures Collide – Leading across Cultures*, third edition, London: Nicholas Brealey International.
- Liden, R. C., Panaccio, A., Hu, J., & Meuser, J. D. (in press). Servant leadership: Antecedents, consequences, and contextual moderators. In D. V. Day (Ed.), *The Oxford handbook of leadership and organizations*. Oxford, England: Oxford University Press.
- Liden, R. C., Wayne, S. J., Zhao, H., & Henderson, D. (2008). Servant leadership: Development of a multidimensional measure and multi-level assessment. *Leadership Quarterly*, 19, 161–177.
- Lila, F. 2018. *Lidershipi Shqiptar: Shqipëria Politike 1912 – 1989*, Tiranë: GEER.
- Lyse, Langlois. 2011. *The Anatomy of Ethical Leadership*, Published by AU Press, Athabasca University.
- Meuser, J. D, Liden, R. C., Wayne, S. J., & Henderson, D. J. (2011, August). *Is servant leadership always a good thing? The moderating influence of servant leadership prototype*. Paper presented at the meeting of the Academy of Management, San Antonio, TX.
- Miller-Adams, M. 2009. *The power of a promise: Education and economic renewal in Kalamazoo*. Kalamazoo, MI: W. E. Upjohn Institute for Employment Research.
- Neubert, M. J., Kacmar, K. M., Carlson, D. S., Chonko, L. B., & Roberts, J. A. (2008). Regulatory focus as a mediator of the influence of initiating structure and servant leadership on employee behavior. *Journal of Applied Psychology*, 93, 1220–1233.

- Northouse, Peter G. 2013. *Leadership Theory and practice*, Sixth Edition: USA etc.: SAGE
- Rachels J & Rachels S. 2000. *Elementët e Filozofisë Morale*, Tiranë: Dita.
- Russell, R. F., & Stone, A. G. (2002). A review of servant-leadership attributes: Developing a practical model. *Leadership & Organization Development Journal*, 23, 145–157.
- Schaubroeck, J., Lam, S. S. K., & Peng, A. C. (2011). Cognition-based and affect-based trust as mediators of leader behavior influences on team performance. *Journal of Applied Psychology*, 96(4), 863–871.
- Sendjaya, S., Sarros, J. C., & Santora, J. C. (2008). Defining and measuring servant leadership behaviour in organizations. *Journal of Management Studies*, 45(2), 402–424.
- Senge, P. M. 2002. Afterword. In R. K. Greenleaf (Ed.), *Servant leadership: A journey into the nature of legitimate power and greatness* (pp. 343–360). New York: Paulist Press.
- Spears, L. C. 2002. Tracing the past, present, and future of servant-leadership. In L. C. Spears & M. Lawrence (Eds.), *Focus on leadership: Servant-leadership for the 21st century* (pp. 1–16). New York: John Wiley & Sons.
- Spears, L. C. 2010. Servant leadership and Robert K. Greenleaf's legacy. In D. van Dierendonck & K. Patterson (Eds.), *Servant leadership: Developments in theory and research* (pp. 11–24). New York: Palgrave Macmillan.
- Spinoza, B. 2015. *Etika*, Tiranë: Biblioteka Filozofike.
- Stogdill, R. M. 1974. *Handbook of leadership: A survey of theory and research*, New York: Free Press.
- Tzu, Lao & Tao Te Ching. 1988. *A New Version, with foreword and notes by Stephen Mitchell*, London: Macmillan.
- Walumbwa, F. O., Hartnell, C. A., & Oke, A. (2010). Servant leadership, procedural justice climate, service climate, employee attitudes, and organizational citizenship behavior: A cross-level investigation. *Journal of Applied Psychology*, 95, 517–529.
- Wheatley, M. 2002. The work of the servant leader. In L. C. Spears & M. Lawrence (Eds.), *Focus on leadership: Servant-leadership for the twenty-first century* (pp. 349–362). New York: John Wiley & Sons.
- Wong, P. T. P., & Davey, D. 2007. *Best practices in servant leadership*. Paper presented at the Servant Leadership Research Roundtable, Regent University, Virginia Beach, VA.

## ABSTRACT

### Servant leadership - Mother Teresa; the embodiment of an approach

Referring to approaches to Leadership, most define leadership as an influential process to achieve a common goal. The process requires the leader to have an impact on the lives of those who lead, and on change in society it is imperative that the leadership bear a great deal of ethical responsibility and responsibility. Research on “orientation”, “functional” approaches, power and control, responsibility and sensitivity to their followers and their lives, suggests that leadership is not an amoral phenomenon, but rather a process of moral dimension distinct from other types of influence such as coercion or despotic control. The servant leader includes the values, respect, justice, and characteristics that constitute the conceptualization of servant leadership. Bringing the servant leader as the nucleus of leadership proves a multi-dimensional process. According to this guiding philosophy, referring to increased follower performance, organizational performance, and social impact, the typical example of this approach is Mother Teresa's contribution to the hungry, the homeless, and to the creation of Charity Missionaries. Mother Teresa (1910-1997) embodies the model that understands the power of the individual, influenced tremendously throughout the world, in treating society's outcasts, people with HIV / AIDS, leprosy and tuberculosis. Its driving force was faith and compassion for mankind, transcending personal and religious beliefs. Mother Teresa as a great communicator, attentive, humble, caring and always in the service of people, influenced the whole world by leaving a written and translated contribution in all the languages of the world.

**Keywords:** *Servant Leadership; Mother Teresa; Values; Social Responsibility; Society*



# OBSERVATIONAL TECHNIQUE IN SOCIAL ENQUIRY: RATIONALIZATION AND ETHICAL CHALLENGES

**Sola ALUKO-AROWOLO**

*Department of Sociology, Olabisi Onabanjo University, Ago-Iwoye, Nigeria;  
Centre for Bioethics, Bashorun, Ibadan, Nigeria*  
E-mail: sola\_titi@yahoo.com

**Akinmayowa LAWAL**

*Department of Sociology, Olabisi Onabanjo University, Ago-Iwoye, Nigeria*  
E-mail: akinmayowa.lawal@oouagoiwoye.edu.ng

**Isaac A. ADEDEJI**

*Department of Sociology, Olabisi Onabanjo University, Ago-Iwoye, Nigeria;  
Centre for Bioethics, Bashorun, Ibadan, Nigeria*  
E-mail: adedeji.isaac@oouagoiwoye.edu.ng

**Oludele M. SOLAJA**

*Department of Sociology, Olabisi Onabanjo University, Ago-Iwoye, Nigeria*  
E-mail: solaja.oludele@oouagoiwoye.edu.ng

---

Dr 'Sola ALUKO-AROWOLO had his B.Sc, M.Sc from the University of Lagos, Lagos and PhD from University of Ibadan. All in Lagos. A member of International Sociological Association, Nigerian Sociological and Anthropological Association. A well-travelled researcher with articles in reputable journals both nationally and internationally.

Lawal S. Akinmayowa holds a PhD in Global Health from Trinity College Dublin. In 2010 he was a Key Correspondent at the 2010 Irish Forum for Global Health Biennial Conference which held in Maynooth, Ireland. In 2011, Akin Lawal was a visiting scholar to Mailman School of Public Health, Columbia University, USA where he received training on Health Assessment, Program Design, Program Monitoring in Emergencies, Priorities in Global Health and Fundamentals of Health Systems in Developing Countries. Akin is a Health Sociologist and Global Health Professional. Akin is a NIH/Fogarty Global Health Fellow 2018-2019.

Dr Isaac A. Adedeji is a Faculty member in the Department of Sociology at Olabisi Onabanjo University, Ago-Iwoye, Ogun State, Nigeria. He teaches courses in Sociological theory, Medical Sociology, Statistical applications, Migration and Development. He has received training in Social Science research methodologies, policy communication and advocacy in East Africa; and policy oriented research at the Bergen Summer Research School, Norway. He is a collaborator and co-author in the Global Burden of Disease estimates of 2015 and 2016.

Dr Oludele Mayowa Solaja teaches at the Department of Sociology, Olabisi Onabanjo University. Oludele does research in Social Policy, Qualitative Social Research and Quantitative Social Research. His current project is on Plastic Waste Management and Ecopreneurship Development. He is also a member of Junior Sociologists Network, International Sociological Association (ISA), International Institute for Policy Review and Development Strategies (IIPRDS), International Society for Development and Sustainability (ISDS), United Nations Virtual Institute on Trade and Development (UNVITD).

## ABSTRACT

The paper discussed the conceptual and intellectual discourse on the use of the observational technique in social enquiry. The paper examines the essence of observational technique, differences between observation and ethnographic, types of observational technique as well as rationalization and ethical challenges involved in the use of an observational technique for a social survey. It also discusses the advantages and disadvantages of observational technique. The paper utilized both descriptive and explanatory design with an extensive review of academic literature sourced from current and relevant archival sources. The paper revealed that in spite of the heuristic benefits associated with the application of observational technique in social researches, there are also some ethical issues that predispose the observational technique to contextual dynamics and social impulses making analytic generalization of the finding of the study conducted using observational technique very weak compared to other findings that were derived based on logical argument, high-level of validity as well as sound reliability.

*Keywords: observation technique, challenges, ethics, rationalization, social survey*

## Introduction

Observation technique is among the qualitative methods employed to carry out research. It is a major data-gathering technique within the ethnographic tradition (Berg, 1995; Gribich, 1999; Schwandt, 2007). Research particularly embodies creative and systematic work undertaken to expand the stock of knowledge, including knowledge of organic, non-organic, animals, humans' culture and society. Research as systematic inquiry involves quantitative and qualitative procedures or techniques in both composite and complementary dimension to describe, explain, predict and control the observed phenomenon (Babie, Wagner III & Zaino, 2019 & Oyafunke-Omoniyi, 2017). Research can also be explained as a careful consideration of study regarding a particular concern or problem using scientific methods to acquire more insights on phenomena of particular interest to the expansion of knowledge frontier. Observation research therefore, is a technique employed to conduct an exploratory or descriptive study in which investigator(s)/ researcher(s) observe(s) elements/or group of people intensely either by being a part of the group in their routine activities or maintain a measurement of

distance from the research group/object (Macionis, 2010). The qualitative technique has its heuristic benefits to examine smaller groups, race, community and those with the elemental structure to act as a sub-group/culture within society. However, it is not without overbearing ethical challenges to the participants and researchers in terms of understanding and interpretation of the milieu and structure of interview contextually. Individual actor predisposes to act towards others on the basis of how he interprets the symbolic action at a given period. The same action can be interpreted differently by different people (Larkan, Lawal; Cuffe, 2017 & Oyafunke-Omoniyi, 2017). Flowing from this mainstream, this paper examines the essence of observational technique, differences between observation and ethnographic, types of observational technique as well as rationalization and ethical challenges.

Interpretation may be based on effective or emotional action – this stems from an individual's emotional state at a particular time. It may also flow from traditional action – this is based on established custom-people act in a certain way because of built-in habits. People have always done things that way as specified by the norms and tradition. Each of us has an idea in the back of our

minds of ‘the generalised other’ – which is basically society – what society expects of us, which consists of different norms and values associated with different roles in society. These social roles are not specific or fixed; they can be interpreted in various different ways. Otherwise, the interpretation may be as a result of rational action – involves a clear awareness of a goal and therefore viewing the phenomenon objectively. Understanding of the situation may be inferred directly or indirectly. Max Weber (1864-1920) referred to the two types of understanding as ‘*Aktuellesverstehen*’ and ‘*erklärendesverstehen*’. ‘*Aktuellesverstehen*’ is direct observational understanding of situation, event or phenomenon; and ‘*erklärendesverstehen*’, is when the researcher(s) trying to understand the meaning of an act in terms of the motives that have given rise to it (Rossides, 1978). However, to achieve this type of understanding one needs to put oneself in the shoes of the person whose behaviour/ motives and/or activity one is trying to capture, understand and explaining. Worthy of note, however, is that most field research or people-centered qualitative researches are exploratory and descriptive that may be understood when situated directly or indirectly. In all, ethical and scientific integrity of the observational technique as it is with any ethnography method may be suspect as a result of motive(s) behind it. Acting out social roles is quite demanding and so in addition to the immediate observable phenomenon aspect of our lives, we also have cultural norms. Most social action is neither fully ‘sincere’ nor fully ‘contrived’ and most people would rather play with words to embellish, exaggerate, sarcastic and oscillate between sincerity and throughout the day and throughout the role, they are playing. This can be the case with either researcher or participant or both (Larkan, et al 2017); however, observation as a technique is not the same as the ethnographic method.

### **Observation and Ethnographic: Need for Clarification**

There is, however, the need to explain the tendency in the use of the terms ‘ethnography’ and ‘observation’ interchangeably. Both are, however, the result of the need for keen and deep involvement of researchers in the study of object or phenomenon to get to the root of ‘matter’ derived from the discipline of anthropology. There are differences between the two. ‘Ethnography’ is a methodology, while ‘observation’ refers to a technique. ‘Ethnography’ involves the description and explanation of the regularities and variations within a culture, interpreted within a specific framework. Observation is one of the techniques of carrying out this (Alexander, 2005; Addison, 1992).

Observation, as both descriptive and exploratory, involves the direct observation of phenomena in their natural setting. It is descriptive because it does not involve numbers. Investigators start from deductive logical thought-reasoning to specific inductive logical thought through transforming what has been observed into specific realities, testable and predictable. And exploratory because it is conducted for a problem that has not been clearly defined. It often occurs before one knows enough to make conceptual distinctions or posit an explanatory relationship. However, it is differentiated from experimental research in which a quasi-artificial environment is created to control for spurious factors, and where at least one of the variables is manipulated as part of the experiment. The investigator in the case of observation is actively participating in the group routine way of life or takes a keen than passive interest without necessarily hob-knobbing with such a specific group. Hence, the observer merely observes the group and takes note of their activities as a non-participant observer or get actively involved in the group’s activities

as a participant observer. It sometimes involves spending up to a year living in a community, learning the language, gaining an understanding of societal structures and becoming familiar with the customs and behaviours of the group before starting to record data (Yin, 2011). This initial settling-in period is followed by several years of data collection, analysis and interpretation, using observation and formal and informal interviewing (Yin, 2011). The investigation culminates in the researcher(s) leaving the location, undertaking further data interpretation that stands the test of time (Edewor, 2002; Gribich, 1999). In other words, the observation technique is a means to an end; it helps determine the best research design, data collection method and selection of subjects for further probing.

Observation method is used to generate qualitative data to support survey or quantitative data as the case may be (Edewor, 2002; Babbie, 1998; Bauchamp, Faden, Wallace & Walter, 1982), or, can also be used alone to narrate verbatim experiences and contacts with the research elements/group in the fields. Such research usually involves a range of methods such as informal interviews, direct observation, and participation in the life of the group, collective discussions, and analyses of the personal documents produced within the group, self-analysis, and life-histories. Incipiently the method originated in the fieldwork of social anthropologists and in the urban research of the Chicago School as pioneered by Park and Burgess (Scott and Marshall, 2009; Kornblum, 2000; Broom, Selznick, Darroch, 1981). Others are John Lofland's study of the Moonies in *Doomsday Cult* (1966), Laud Humphrey's study of homosexuals in *Tearoom Trade* (1970), and William Foote Whyte's study of the gang (*Street Corner Society*, 1955) (Scott and Marshall, 2009). In whatever form this mode of investigation is conducted there are two layers of information for the

presentation of data; either overtime, where the researcher spaces his/her own perceptions and those of others to demonstrate transition and change; or by presenting the perceptions of many people regarding a single event or situation. In this way, story after story can open different windows on a situation, a person or an incident. This technique can also be used to provide a dialogue with the self, where different aspects or tones are taken in a monologue (Gribich, 1999).

Observation method varies from non-participant observation, participant observation, and covert observation to overt observation depending on the level of participation or involvement of the researcher in the activities of the group or community he is studying. It is commonly used by historians, cultural and social anthropologists to study groups and small communities. But other social sciences including sociology and psychology and public health disciplines are now embracing the technique due to its prospects and uses in the study of people-oriented studies. However, this is not without some challenges or inherent bias (Scott and Marshall, 2009; Gribich, 1999; Babbie, 1998). The challenges are social assumptions or idiosyncrasies which all researchers bring to their work and which invariably, sometime though; inadvertently determine their method and outcome of research of their observations. It has been argued by some that all enquiries (including 'pure' science) are simply a reflection of such biases (Scott and Marshall, 2009; Broom, Selznick, Darroch, 1981). In any event, researchers are usually encouraged to make any known biases explicit in reporting their findings; this is to assist others wishing to reach a judgment as to the findings/ results of the research.

Furthermore, in using this technique to study small communities or groups, the researcher/observer may observe or study certain research elements/group from a

distance and record their activities for data gathering purposes. Here, such an observer is a non-participant-observer; but to get involved actively and for the researcher(s) to live in the study community and/or making frequent trips or create a forum for suzerainty or deep camaraderie with the group for a period of one to two years as they participate in the day-to-day activities of members of the community to observe the people in their “natural” settings, this effort is regarded as participant observation – I intend to explain this in detail subsequently.

### Types of Observation Technique

#### *Non-Participant Observation*

An observational mode whereby the researcher watches the subjects of his or her study with their knowledge, but without taking an active part in the situation under scrutiny (Erinosh, 2006; Galibert, 2004; Broom, Selznick, Darroch, 1981). This approach is sometimes criticized on the grounds that the very fact of their being observed may lead people to behave differently, thus invalidating the data obtained; a good example is the famous case of the so-called Hawthorne effect on the factory workers of Western Electric Company (Macionis, 2010; Kornblum, 2000, Olurode, 1988). Also, in non-participant observation, the observer does not have clarity about certain events on activities. He cannot clear his doubts by asking various questions to the group members. Therefore he has to simply understand and interpret what he sees. This lack of understanding may make some of his findings biased and coloured by his personal prediction, belief and pre-conception.

Again, the observer can observe only those events which take place in front of him. But that is not enough and only a part of the phenomena as a vast range of information required for the research. He can know many things about the group

when he participates in the group and interacts with the group members. And, the members of a group become suspicious of a person who observes them objectively. In front of an outsider or stranger, they feel conscious and provide only some formal information's in an unnatural way. It creates bias and what the observer collects is not an actual or normal thing but only formal information's. This may also result in inconvenience to the respondents such that the members of a particular group always feel uncomfortable when they know that their behaviour is critically analyzed by an outsider. Therefore in some cases, the natives do not allow an outsider to watch their socio-cultural activities. It is always better for a researcher to become a member of the group in order to learn much about it.

To overcome this, researchers normally observe a number of similar situations, over a period of time. Although video-recorders can now be used in non-participant observation, this too may alter -indeed almost certainly will alter - the behaviour of the research subjects.

#### *Participant Observation*

Cultural anthropologists use participant observation to study intensely communities, associations, cartel and large homogenous societies. This is called fieldwork and the outcome of the fieldwork is called ethnography. Participant observation is a major research strategy which aims to gain a close and intimate familiarity with a given area of study (such as a religious, occupational, or deviant group) through an intensive involvement with people in their natural environment (Macionis, 2010; Scott and Marshall, 2009; Isiugo-Abanihe, 2002; Gribich, 1999; Babbie, 1998).

A researcher using participant observation method to study the likes of Boko Haram insurgent group in the North-Eastern Nigeria, for example, would most likely have the same mien, characteristics

and perception like the insurgents to study them or a religious sect such as the Celestial Church, for example, would have to join the church, wear a white garment and go bare-footed to church on a Sunday and participate in all of the church activities. There, he would participate in the religious activities and rituals while he observes their mode of worship first hand. This method could also be used to study sex workers, a homosexual group, New/Social Movements, drug cartel, Gang, a club or organisation like sea pirate, Religious Separatist, etc.. This, however, is similar to covert observation.

#### *Covert Observation*

The researchers do not reveal their identity. They seldom identify themselves. Either they mix in with the subjects undetected, or they observe from a distance. The advantages of this approach are: (1) It is not necessary to get the subjects' cooperation, and (2) The subjects' behaviour will not be compromised by the presence of the researcher. However, there are ethical misgivings with the deception involved in this approach. Be that as it may, covert observation may be used because researcher(s) access to the social unit under study would normally be denied, or to ensure that the researcher's presence does not affect the behaviour of those being observed (Gribich, 1999; Babbie, 1998; Scott and Marshall, 2009). The method raises serious ethical problems (Yakubu, 2008; Cooper, Lewis, and Urquhart, 2004; Federman, Kathi, & Laura, 2003) among which is that participants consent was not sought and also not opportune to benefit from the research outcome. On the other hand, it may wittingly put the researcher(s) at risk if his anonymous status is uncovered.

#### *Overt Participant Observation*

The researchers identify themselves as researchers and explain the purpose of their research. The problem with this

approach is that subjects may modify their behaviour when they know they are being watched (Cooper, Lewis, and Urquhart, 2004; Olurode, 1988). They portray their "ideal self" rather than their true self. The advantage that the overt approach has over the covert approach is that there is no deception or run afoul of ethical prescriptions on human research because participant observation is carried out with the agreement of the subjects being studied. This agreement may be tacit or formally expressed and the subjects themselves are then invited to give explicit permission for the research to proceed. And, if otherwise, the research is discontinued. In the former, the researcher also reveals his or her identity as an outsider, but states the purposes of the study less clearly, usually in the form of a general statement of interest in the subjects. This particular approach is suitable for Focus Group Discussion (FGDs), In-depth interviews, case study, and so on. There are other issues apart from the approaches above.

#### **Issues in Observation Technique**

There is a number of general issues peculiar to the design of observation research that must be addressed especially participant observation study; such as the location of the study, the size of the group for the study and sampling procedure.

#### *Location*

The question is: should the researcher observe in a setting where he is stranger and where the researcher has no prior work experience? Or should he use past experiences to facilitate entry and acceptance? Entering a known setting means that, one is familiar and understands of the culture and people are already in place. Either to enter incognito into unfamiliar terrain or where one is known to have its merits and demerits. Entering an unknown setting allows the

researcher to observe without preconceived ideas, but that very lack of prior knowledge can be costly in terms of time. Extra time would be spent to gain an understanding of the workings and language of the group, and of the meanings that people have constructed (Gribich, 1999; Babbie, 1998; Scott and Marshall, 2009). While familiarity with the group may facilitate good rapport but if they know they are being studied they may behave in an ideal way against reality as expected perhaps to please the researchers.

### *Group size*

William Foot Whyte (1984; in Gribich, 1999) asserts that a single researcher should not attempt to observe more than 15 people in a study. Others consider five to eight sufficient for an in-depth study, with larger groups being more appropriate for teams' researchers, or where more general information is being gathered. The process of gaining access and entry into a setting should be documented. Special attention or priority should also be paid to negotiation with religious leaders, opinion leaders, the chief of the locality or chairman of local government area - people with the power to facilitate or inhibit access - as this documentation may give an insight into the hierarchies and dynamics of interaction within a setting. This also will help in the sampling procedure as it is rather unthinkable to interview everybody in such circumstance.

### *Sampling*

This is also usually related to access and ease of entry. Secondly, the group must be defined, using the sampling strategies and procedure for a qualitative study. Apart from the broad scanning of a setting, it also involves locating an individual or group of people and focusing on their actions and behaviour over a period. Short term time sampling can also be used in some settings where the researcher, instead of

observing the environment, individuals, groups or behaviours continuously, observes in blocks of time, such as every two, five or ten minutes for periods of two, five or ten minutes. This approach can produce intense and very detailed information, which is usually recorded on the spot in a 'total observer' situation. Needless to say, most researchers vary their approach depending on the questions, the stage of the study, the location and the events under observation.

The researcher must also decide what forms of time sampling to include maximising the view of the setting. Is it more appropriate to view continuously for several hours, or to use limited observation periods? Viewing continuously will give broad information only, and may be profitable if used early in the study when the researcher is not revealing himself in the scene. Limited observation periods are more usual, and are generally used in settings that have a lot of continuous activity. When intense observation is occurring, one hour is about the maximum most researchers can recall accurately (Gribich, 1999).

### **Advantages of observation technique**

A lot of detailed information could be obtained as a participant observer listens to conversation daily and sometimes interviews members in an informal way. The observations are carefully recorded at the end of each day as soon as he gets a home/office. It is inappropriate and not advisable to record in the presence of members of the group. This is to avoid being suspected to be an agent, a spy or an enemy, especially when one is studying a dangerous group such as a gang like the insurgents in Nigeria – Boko Haram, drug cartel, oil bunkering or sea pirate. Although more detailed information could be obtained from the group or community studied using this method, the results are not generalized as in the case of social/clinical survey but the

results can be used as a building block for a more detailed and elaborate survey (Gribich, 1999; Babbie, 1998; Isiugo-Abanihe, 2002; Scott and Marshall, 2009).

### *Disadvantages of Observation Technique*

The central methodological problem of observation research technique is balancing subjectivity with objectivity (Larkan, et al, 2017; Galibert, 2004; Isiugo-Abanihe, 2002; Germov, 2000; Oluode, 1988). Since a major aim of participant observer is to enter the subjective worlds of those studied and to see these worlds from participants point of view (a method akin to the notion of understanding of another state of mind or viewpoint or *Verstehen*), the problem of adequate objectivity is posed directly: how can researchers know that they are accurately representing the point of view of the others, rather than imposing their own views upon the research subject? Here the problem of maintaining adequate objectivity is posed: namely, that of maintaining enough distance to be able to locate the subject's view in a wider theoretical and social context. Participant observers are forever trapped in this dilemma: too much detachment weakens the insights that participant observation brings, but too much involvement will

render the data questionable for research in health and humanity (Yin, 2011; Macionis, 2010; Galibert, 2004; Warwick, 1982).

### *Concluding Remarks*

The use of observation technique can be said to be illustrative and evocative and provides a more close-up view of the study. Conversely, for a researcher with a primarily qualitative orientation, which focuses on social processes in a rich and proximate detail, the inclusion of some background history, way of life of the group and variation in the people's behaviour during contacts with sampled research group can go a long way to bring out the reality as against superficial ideal-type result of the problem under study often associated with quantitative research. However, there is enormous variation and diversity in narrative studies and descriptive writings, from factual to subjective accounts of the investigators. These perhaps give credence to the fact that observation researches often suffer analytic generalization in a manner of generalising the finding of the study to other situations that were not studied based on logical argument, theory development or replication all due to the poor test of validity and reliability.

## REFERENCES

- Addison, R.B. (1992). "Grounded hermeneutic research" In *Doing qualitative research* ed. Benjamin F. C. & William. M. Thousand Oaks, CA: Sage: 110-124.
- Alexander, B.K. (2005). "Performance ethnography: The re-enacting and inciting of culture", In *The Sage handbook of qualitative research* ed. Norman, K. D. & Yvonna. S.L (3<sup>rd</sup> ed. Pp. 411-441). Thousand Oaks, CA: Sage.
- Babbie, Earl; William E. Wagner, III & Jeanne Zaino (2019). *Adventures in Social Research: Data Analysis Using IBM SPSS Statistics 10<sup>th</sup> Edition*.
- Beauchamp, T., Faden, R.R. Jay Wallace, & Walters, L. (1982). *Ethical issues in Social Sciences* London & Baltimore, John Hopkins University Press.
- Berg, B.L. (1995). *Qualitative research methods for the social sciences*, London: Allyn and Bacon.
- Broom, L, Selznick, P. & Darroch D.B. (1981). *Sociology: A text with adapted readings 7<sup>th</sup> Edition* New York. Harper Row Publishers and Smith, C.D.
- Cooper Janet, Lewis Rachael and Urquhart Christine (2004). Using participant or non-participant observation to explain



- information behaviour *Information Research* vol. 9 No. 4, July.
- Edewor, P.A. (2002). "Basic method of social research" in: *The science of society* Shoremi, M.O. Edewor, P.A. & Olutayo, O.A (eds.). Ago-Iwoye: CESAP 36- 51.
- Federman, Daniel D., Kathi E. Hanna, and Laura L. Rodriguez, (eds) (2003). *Responsible Research*. Washington, D.C.: The National Academic Planning.
- Galibert, Charlie (2004). Some preliminary notes on actor-observer anthropology interactive *Social Science Journal* (Sept 181: 455-465).
- Germov, John (2000). Imaging Health Problems as social issues in: Germov, John (ed) *Second Opinion: Introduction to Health Sociology* (Revised edition): Melbourne, Oxford University Press.
- Gribich, C. (1999). *Qualitative Research in Health: An Introduction*: Australia, Allen and Unwin.
- Isiugo-Abanihe, U.C. (2002). "Quantitative research technique" in *Currents and perspectives in Sociology* eds. Isiugo - Abanihe, U.C., Isamah, A.N., & Adeshina, J.O. Malthouse: Lagos: 52 – 72.
- Korn, Blum, W. (2000). *Sociology in a Changing World* (5th Edition), Forth-Worth. Harcourt College Publishers.
- Larkan, F., Lawal, A.S. & Cuffe, J. (2017). "Ethnographic Fieldwork" in *Research Methods in Social and Management Sciences: Quantitative and Qualitative approaches* ed. Adetola, B.O. Aborisade, R.A. & Fasanmi, S. Ibadan, University of Ibadan Press. 347-362.
- Macionis, J.J. (2010). *Sociology: Annotated Instructor's Edition 13<sup>th</sup> Edition* Boston: Prentice Hall.
- Olurode, Lai (1988). "Social Science as Science" in *Readings in Introductory Sociology* ed. Olusanya A & Olurode, L. Lagos: John West 18- 27.
- Oyafunke-Omoniyi, C.O. (2017). "Ethical issues in Social Sciences Research" in *Research Methods in Social and Management Sciences: Quantitative and Qualitative approaches* ed. Adetola, B.O. Aborisade, R.A. & Fasanmi, S. Ibadan, University of Ibadan Press. 387-398.
- Rossides, W.D. (1978). *The History and Nature of Sociological theory*: Boston, Houghton Mifflin Company, USA.
- Scott, R. Marshall, G. (2009). *Oxford Dictionary of Sociology*, New York, Oxford University Press.
- Schwandt, Thomas (2007). *The Sage dictionary of qualitative inquiry (3<sup>rd</sup> ed.)*. Thousand Oaks, CA: Sage.
- Warwick, D.P. (1982). Types of harms in Social Research in Beauchamp, T., Fadden, R.R. Jay Wallace, & Walters, L. (Eds.), *Ethical issues in Social Sciences* London & Baltimore, John Hopkins University Press.
- Yakubu, J.A. (2008). *Ethics in Research* in: Olayinka, A.I, Popoola L., Ojebode, A (eds) *Methodology of Basic and Applied Research: Proceeding of a Workshop* Ibadan, University of Ibadan, 234-236.
- Yin, R. K. (2011). *Qualitative research from start to finish* London, The Guilford Press



# JOB SATISFACTION OF TEACHERS IN ALBANIAN PUBLIC HIGH SCHOOLS

**Enida KUME**

*University Aleksander Moisiu of University, Durres*

*Faculty of Education*

E-mail: enidak@hotmail.it

---

## ABSTRACT

This study uses interview data from 215 teachers in public high schools. A structured questionnaire was used for the online interview, the main part of which consisted of questions from which were generated the 19 independent variables with 5-point Likert. Gender, age, work experience and civile status were treated as independent variables. Overall Job Satisfaction (OJS) was used as the dependent variable. OJS among teachers in public high schools was statistically influenced ( $p < 0.05$ ) by 11 variables. By importance they can ranged: Job satisfaction with pupils, remuneration for work, work environment, community assessment, outside of normal time commitment, occupational challenges, teamwork, training and career opportunities, quality of training, communication with the managers. Policies aimed at enhancing OJS among teachers in public high schools should be designed keeping in mind the gender, age and civil status of teachers. Policies should vary depending on the professional experience of teachers. In these policies, particular attention should be paid to remuneration for work, capacity building and quality in training, environmental improvement interventions and communication.

*Keywords: Job satisfaction, teacher, public high school*

Job satisfaction is “a positive or pleasant emotional state resulting from a person’s appreciation of his/ her own job (Locke, 1976). Miller (2009) support the idea that this definition of job satisfaction is the most referenced and generally accepted description, characterizing the necessary component needed to depict what is meant

**Enida KUME** holds the academic title Prof. Assoc. Dr., since 2016. She is a full time lecturer at the Faculty of Education of “Alexander Moisiu” University, Durres. She has completed her Bachelor’s degree in “Social Work” and Master of Science in “Organization and Programming Social Policy” at the University of Turin Italy, and her doctoral studies at the Faculty of Social Sciences, University of Tirana. During the period 2009-2019 she worked as a specialist in the Ministry of Education, Youth and Sports of Albania. She is the author of 11 scientific articles published in Albania and other countries, participating in 19 international scientific conferences, as well as the author of a monograph.

by broad construct of job satisfaction. Rahma, M.M et al. (2012) underline that “The degree of satisfaction is determined by the ratio outcomes against the desire of employees from their respective jobs”

Job satisfaction is multidimensional, whether it comes to job satisfaction by itself or in wages, workplace safety, to promotion possibilities, recognition and appreciation, decision-making power and influence and of course carry a sense of productive work, useful and well done. Each of these dimensions may contribute to varying degrees, in shaping their sense of job satisfaction.

Job satisfaction, understood as a way of reporting the individual to his work situation, is determined by several factors, some of individual order - age, education, skills, work experience, other organizational arrangements - organizational climate, working conditions, policy and organizational management, and not least personality factors.

Job satisfaction is not a new phenomenon at all in organizational science and organizational behaviour. Many studies have been done on this particular topic for over six decades now and thousands of articles have been published (Zembylas, M., Papanastasiou, E.2004). Most of the studies have been done in the developed countries such as United States of America, United Kingdom, Canada and New Zelande, ect..

Job satisfaction among the teacher in Albania it is a new subject study in the research on organizational behavior and in process for compiling the policies that have as their object the enhancement of quality in providing the education services for new generation. The first comprehensive and scientific study on the evaluation of job satisfaction of teachers in Albania and the identification of the factors that influence the overall level of teacher`s job satisfaction was carried out by Bezati, F. (2012).

The purpose of this study is to examine the factors that are associated with job satisfaction among the teachers in Albanian public high schools.

The objectives of the study are: (i) to identify the most important factors of job satisfaction and to ranked it by their importance, (ii) to evaluate the relationship between job satisfaction and factors of job satisfaction.

## Methodology

### *Sample Design*

The targets of this study are 215 teachers in public high schools. The demographic features of the respondents: age, gender and time of employment are provided in Fig.no. 1.


A structured questionnaire was developed to which the respondents was asked to react using a five step bi-polar scale ranging from strongly disagree (1) to strongly agree (5). The questions was developed following the different authors (Bezati, F. 2012, Ayele, D. 2014)

At the end of the questions, a final question was added: “Overall I am satisfied about my job”. This question was intended to measure the respondent’s reaction to the job satisfaction.


### *Methods*

SPSS 17.0 has been used to process and analyze the data. ANOVA has been used to analyze the relationship of job satisfaction factors with overall satisfaction of employees. T-tests have been performed to test the statistical significance of the parameters at 5% level of significance. Statistical parameters like mean, standard deviations will be estimated. In order to estimate the relationship among dependent and independent variables, the multifactorial regression analyze will be performed, following the regression model:


**Figure 1:** Percentage of the responders by age




**Figure 3:** Percentage of the responders by gender



**Figure 2:** Percentage of the responders by work experience



**Figure 4:** Percentage of the responders by civil status



### Demographic characteristics of respondents

19 4

$$OJS = \alpha + \sum_{i=1}^3 \beta_i X_i + \sum_{i=1}^4 \gamma_i Y_i + \epsilon_t$$

Where:

- OJS-Overall Job Satisfaction
- X1 - Job satisfaction with the pupils
- X2- Adequate remuneration for work
- X3 - Community assessment
- X4- Available opportunities for promotion
- X5 - Occupational challenges
- X6- Recognition for good work
- X7- Satisfaction from non-financial rewards
- X8 - Job evaluated reward
- X6- Career opportunities
- X9- Feel proud of job
- X10- Training program regularly
- X11-Satisfied with the quality of training
- X12-Satisfactory work environment

- X13-Works in line with expectations
- X14- Commitment outside of normal time
- X15- Job meaningful
- X16- Relationship with colleagues
- X17- Timework
- X18- Communication with managers
- X19- Exchange of ideas between superior and subordinates
- Y1- gender of responder
- Y2-age of responder
- Y3 -work experience
- Y4-civil status
- $\epsilon_t$  - Error Term

and  $\alpha$  is a constant and

$\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5, \beta_6, \beta_7, \beta_8, \beta_9, \beta_{10}, \beta_{11}, \beta_{12}, \beta_{13}, \beta_{14}, \beta_{15}, \beta_{16}, \beta_{17}$  are coefficients to estimate.

$Y_1$  is a dummy variable with values 0 or 1,  $Y_2$  a categorical variable with values 1, 2, 3, corresponding to the age groups of responders,  $Y_3$  and  $Y_4$  - categorical variable with values 1, 2, 3 corresponding to the work experience and civil status of responders.

**Table 1:** *Descriptive Statistics*

Variable	$\bar{x}$	sx	Variable	$\bar{x}$	sx
Job satisfaction with the pupils	4.61	0.491	Training program regularly	3.06	0.472
Adequate remuneration for work	3.05	0.592	Satisfied with the quality of training	3.04	0.370
Community assessment	4.12	0.143	Satisfactory work environment	4.01	0.412
Promotion opportunity	3.22	0.722	Work is in line with expectations	4.25	0.782
Occupational challenges	2.98	0.982	Job meaningful	4.01	326
Recognition for good work	2.32	0.783	Relationship with colleagues	3.96	0.649
Satisfaction from non-financial rewards	3.01	0.693	Teamwork	3.92	0.547
Job evaluated reward	3.14	0.421	Communication with managers	3.41	0.195
Career opportunities	3.07	0.712	Exchange of ideas between superior and subordinates	3.04	0.185
Feel proud of job	4.02	0.538			
OJS-Overall Job Satisfaction	3.12	0.582			

## Results

The mean value and standard deviation of variables are showed in Table no.1. The mean value of the most parts of the factors is more than 3.0 which is between the neutral and agree in the scale showing the average teacher perception about job satisfaction. The greater value has the factors related to “Job satisfaction with the pupils” following by “Work is in line with expectations”, “Community assessment”, “Feel proud of job”, “Job meaningful”

From Table no.2, it is seen that there is a significant correlation between dependent variable and independent variables. At 5% level of significance the

correlation is 0.751. Adjusted R square is 0.564 that means that about 50.2% variation of dependent variable is explained by independent variables included in regression model.

Table no. 3, shows that the regression equation explaining a statistically significant portion of the general variability of dependent variable. This linear model reflects the linear relationship between the dependent variable and the explanatory independent variables ( $P < 0.01$ ). Based on this model we can conclude that the Overall Job Satisfaction (OJS) of the teachers in Albanian public high schools depends on the factors that have entered in the model.

**Table 2:** *Model Summary*

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.751a	.564	.512	0.112

a. Predictors:(Constant), Job satisfaction with the pupils, Adequate remuneration for work, Community assessment, Promotion opportunity, Occupational challenges, Recognition for good work, Satisfaction from non-financial rewards, Job evaluated reward, Career opportunities, Feel proud of job, Training program regularly, Satisfied with the quality of training, Satisfactory work environment, Work is in line with expectations, Commitment outside of normal time, Job meaningful, Relationship with colleagues, Teamwork, Communication with managers, Exchange of ideas between superior and subordinates

**Table 3: ANOVA**

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	563.12	22	25.596	16.2	.00b
	Residual	304.97	193	1.580		
	Total	868.09	214			
a. Dependent Variable: Overall Job Satisfaction						
b. Predictors:(Constant), Predictors:(Constant), Job satisfaction with the pupils, Adequate remuneration for work, Community assessment, Promotion opportunity, Occupational challenges, Recognition for good work, Satisfaction from non-financial rewards, Job evaluated reward, Career opportunities, Feel proud of job, Training program regularly, Satisfied with the quality of training, Satisfactory work environment, Commitment outside of normal time, Job meaningful, Relationship with colleagues, Teamwork, Communication with managers, Exchange of ideas between superior and subordinates						

**Table 4: The partial regression coefficients between dependent and independent variables**

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sign.
			Std. Error			
1	Constant	-1.812	0.201		2.78	0.05
	Job satisfaction with the pupils	0.458	0.124	0.298	3.76	0.00
	Adequate remuneration for work	0.339	0.218	0.221	3.07	0.00
	Community assessment	0.302	0.382	0.201	3.98	0.00
	Promotion opportunity	0.086	0.256	0.086	1.02	0.11
	Occupational challenges	-0.248	0.098	-0.128	4.96	0.00
	Recognition for good work	0.021	0.325	0.021	1.53	0.12
	Satisfaction from non-financial rewards	-0.156	0.035	-0.156	-1.25	0.08
	Job evaluated reward	0.106	0.275	0.056	1.28	0.08
	Career opportunities	0.287	0.141	0.097	4.87	0.00
	Feel proud of job	0.011	0.107	0.011	1.07	0.12
	Training program regularly	0.276	0.306	0.106	4.98	0.00
	Satisfied with the quality of training	-0.212	0.094	-0.028	4.23	0.00
	Satisfactory work environment	0.313	0.456	0.208	4.05	0.00
	Commitment outside of normal time	-0.324	0.621	-0.197	-1.18	0.14
	Job meaningful	0.116	0.121	0.116	3.79	0.00
	Relationship with colleagues	0.104	0.220	0.104	1.27	0.14
	Teamwork	-0.293	0.286	-0.117	4.16	0.00
	Communication with managers	-0.227	0.649	-0.016	3.74	0.00
	Exchange of ideas between superior and subordinates	-0.026	0.472	-0.012	-1.09	0.17
Gender	0.092	0.104	0.132	2.98	0.05	
Age	0.258	0.231	0.239	3.26	0.00	
Work experience	-0.297	0.328	-0.241	4.12	0.00	
Civil status	-0.118	0.407	-0.108	4.22	0.00	
a. Dependent Variable: Overall Job Satisfaction						

**Table 5:** *Rank order of variables*

Variables	Value	Rank order based on the weight of the impact
Job satisfaction with the pupils	0.298	1
Adequate remuneration for work	0.221	2
Satisfactory work environment	0.208	3
Community assessment	0.201	4
Commitment outside of normal time	-0.197	5
Occupational challenges	-0.128	6
Teamwork	-0.117	7
Training program regularly	0.106	8
Career opportunities	0.097	9
Satisfied with the quality of training	-0.028	10
Communication with managers	-0.016	11

The t-values of the partial regression coefficients corresponding to Job satisfaction with the pupils,

Adequate remuneration for work, Community assessment, Occupational challenges, Career opportunities, Training program regularly, Satisfied with the quality of training, Satisfactory work environment, Job meaningful, Teamwork and Communication with managers show that these factors have the statistical significant influence on the general variances of Overall Job Satisfaction among the teachers in Albanian Public high schools. This result indicates that these are the main factors responsible for Job satisfaction among these teachers.

The effect of gender, age of teacher, work experience and civil status are statistically significant ( $p < 0.05$ ).

The coefficients for other independent variables are not statistically significant which implies that these factors have inconsiderable impact on Overall Job Satisfaction, consequently these should not be taken into consideration.

Referring to the values of standardized coefficient of partial regressions that correspond to the variables that have statistical significant effect on OJS, in Table no 5, are ranked the variables that should

be taken in consideration by the decision making body in drafting policies that have as objectives increase of job satisfaction level among the teacher in Albanian public high schools.

## Discussion

The above results shows that Overall Job Satisfaction among teachers in Albanian Public high schools is a result of the action of a plurality of factors related to specific characteristics of the teaching profession, salary, work conditions in school, relation with the parents of pupils and colleagues, administration from the administration board, opportunities for training and career.

The Overall Job Satisfaction among the teachers varies depending on their gender, age, work experiences and civil status. Such results are comparable with the results communicated in the literature (Grady, Th. L. 1984; Kim, I., Loadman, W. 1994; Correnti, R., et al. 2002; Bernal, J.G., et al., 2005; Jyoti, J., Sharma, RD. 2006; Tasnim, Sh. 2006; Akhtar, Sh. N., et al 2010, Bezati, F. 2012, Anees, A. 2013; Bota, O.A. 2013; Tilak R., Alita, L. 2013; Ayele, D. 2014).

Teachers in Albanian Public high schools consider very important the opportunities offered by this working place for the



realization of their professional expectations. Working with the young people estimated very well by them. They estimate that job satisfaction is affected in a considerable degree by the opportunities for career advancement offered by the organization. The adequate remuneration for work and community assessment are considered as very important factors from teachers. Taking into account the above results we can affirm that in order to increase the job satisfaction and consequently effectiveness of the teachers in Albanian Public high schools is necessary to create better opportunities for their promotion and qualification. The identification of results that they achieve at work and their estimation are important factors, with positive effect, that increase their commitment to work with students. Creating a collaborative environment between teachers, teacher and administrative staff, exchange of information and opinions between teachers and parents community, improvement the conditions for effective use of working time are among the factors that teachers consider important and effective in their job satisfaction.

## Conclusions

This study analyzes job satisfaction among the teachers in Albanian public high schools.

The overall job satisfaction of teachers in Albanian public high schools is associated with 11 variables. These variables are the most important among all the 19 variables that taken in consideration in this study.

The job satisfaction depends by the gender, age, work experience and civil status of the teachers.

This study gives a message to the policy makers and employers that if they want to improve job satisfaction of teachers then they have to consider the following factors:

Remuneration for work, Promotion opportunity, Provide teachers with opportunities to meet the challenges of the profession, Recognition for good work, Implement an efficient system for non-financial rewards and Job evaluated reward, Support the career opportunities, Organize and carried out regularly the effective training programs, Improve the work environment, The smallest commitment outside of normal time, Support to create a friendly environment for the relationship with colleagues, teamwork, Communication with managers and exchange of ideas between superior and subordinates

Policies that will have as their objectives increase of the job satisfaction among the teachers in public high school should be developed in line with demographic features of teachers-gender, age, civil status and their work experience.

## REFERENCES

- Anees, A. (2013) A Comparative study of Job Satisfaction of Teacher Educators working in Public Funded Institutions in Relation to their Work Motivation. *Excellence International Journal of Education and Research*. Volume 1 Issue 3. p.250-260
- Akhtar, Sh. N., Hashmi, M. A., Naqvi, S. I. H. (2010) A comparative study of job satisfaction in public and private school teachers at secondary level. *Procedia Social and Behavioral Sciences* 2 (2010) 4222–4228.
- Ayele, D. (2014) Teachers' job satisfaction and commitment in general secondary schools of Hadiya zone, in Southern Nation Nationality and people of regional state. Department of educational planning and management. Institute of education and professional development studies. Jimma university Ethiopia.

- Bota, O.A. (2013) Job satisfaction of teachers. 2nd World Conference on Educational Technology Researches – WCETR2012. Procedia - Social and Behavioral Sciences 83 (2013) 634 – 638.
- Bernal, J.G., Castel A.G., Navarro, M.M., and Torres P.R., (2005), “Job satisfaction: empirical evidence of gender differences”, *Women in Management Review*, vol. 20, No. 4.
- Bezati, F. (2012) Faktorët që ndikojnë në kënaqësinë e punës së mësuesve të arsimit bazë në Shqipëri. Tezë doktore, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tirane, Shqipëri
- Correnti, R., Miller, R.J., Rowan, B. (2002). What large-scale survey research tells us about teacher effects on student achievement: insights from the prospects study of elementary schools. *Teachers College Record*, 104(8):1525-67.
- Grady, Th. L. (1984). The relationship between job satisfaction and teacher performance of vocational agriculture teachers in Louisiana. PhD The Louisiana State University and Agricultural and Mechanical Col.
- Jyoti, J., Sharma, R.D. (2006). Job satisfaction among school teachers. *IIMB Management Review*, 18(4):349-363.
- Kim, I., Loadman, W. (1994). *Predicting Teacher Job Satisfaction*. Columbus, Ohio State University, Peter Lang: New York
- Locke, E.A., (1969), “What is job satisfaction”, *Organizational Behavior and Human Performance*, Vol. 4, Iss. 4, pp. 309-336.
- Locke, E. A. (1976). The nature and causes of job satisfaction. In M. D. Dunnette (Ed.), *Handbook of industrial and organizational psychology* (pp. 1297–1349). Chicago: Rand McNally
- Miller, H. A., Mire, S. & Kim. B. (2009). Predictors of job satisfaction among police officers: Does personality matter? *Journal of Criminal Justice*, 37, 419 - 426
- Rahman, M.M. Das Gupta, A., Moudud-Ul-Huq, S. (2012) Job Satisfaction of Female Employees in Financial Institutions of Bangladesh: A Study on Selected Private Commercial Banks in Chittagong. *Global Journal of Management and Business Research*. Volume 12 Issue 14 Version 1.0
- Tasnim, Sh. (2006) Job Satisfaction among Female Teachers: A study on primary schools in Bangladesh. PhD thesis. Department of Administration and Organization Theory The University of Bergen, Bergen, Norway
- Tilak R., Alita, L. (2013) Job satisfaction among teachers of private and government school: A comparative analysis. *International Journal of Social Science & Interdisciplinary Research IJSSIR*, Vol. 2 (9), September (2013)
- Zembylas, M., Papanastasiou, E. (2004). Job satisfaction among school teachers in Cyprus. *Journal of Educational Administration*, 42, 357–374.

# POLITIKA NDËRMJET UTOPISË DHE PRAGMATIZMIT

Leke SOKOLI

*Universiteti Aleksander Moisiu Durrës (UAMD)*

*Instituti Shqiptar i Sociologjisë (AIS)*

E-mail: lsokoli53@gmail.com; lsokoli@sociology.al

---

## PËRMBLEDHJE

Nëse do t'u përmbahemi klisheve që mbizotërojnë në mediat e sotme të Shqipërisë, Kosovës apo edhe të vendeve të tjera, pavarësisht nga niveli i zhvillimit, atëherë do të kishte vetëm dy lloj politikanësh: utopistë dhe pragmatistë. Të parët, utopistët, ngrënë hundën drejt qiellit, duke përbuzur realitetin. Por që zakonisht bien në gjunjë, sapo ndeshin pengesat e tij. Të dytët, pragmatikët që, duke i dhënë peshën e duhur realitetit, zhysin hundën në tokë, pa pyetur për vizione e programe. Ku qëndron politika, a mund të jetë ajo utopike, apo pragmatike; a përfaqësojnë politikë këto qasje të skajshme, utopia – nga njëra anë dhe pragmatizmi – nga ana e kundërt; apo politika kryhet në hapësirën mes tyre? Rreth këtyre pyetjeve shtjellohet ky artikull. Përgjigjen e tyre autori e kërkon në radhë të parë në veprën e Erhard Epler “Rikthimi i Politikës”. Sikurse edhe në veprat e autorëve të tjerë, shumë përpara por edhe pas tij. Por nga ky trajtim arrihet në një përfundim disi ndryshe nga ai i Eplerit: utopia dhe pragmatizmi po redin drejt njëra-tjetrës, ndoshta me një shpejtësi aq marramendëse sa që dekada më parë nuk mund të imagjinohej. Por rendin, pikërisht, duke përshkuar hapësirën e politikës. Le ta marrim këtë përfundim si një hipotezë për një shqyrtim të mëtejshëm...

**Fjalë kyçe:** *Politikë, utopi, rikthimi i utopisë, pragmatizmi, shoqëri e mirë*

**Prof. Dr. Lekë SOKOLI** është Zv.Rektor për Kërkimin Shkencor i Universitetit A. Moisiu të Durrësit dhe Kryetar i Këshillit Shkencor të tij. Është, gjithashtu, drejtor themelues i Institutit Shqiptar të Sociologjisë, themelues i Forumit Sociologjik të Ballkanit (BSF) dhe presidenti i parë i tij, si dhe drejtor themelues i revistës “Studime Sociale” [Social Studies]. Për më se 30 vjet ai është marrë me studime, botime dhe mësimdhënie në fushën e sociologjisë, filozofisë e shkencave të tjera sociale. Është autor i mbi 25 librave (monografi apo tekste universitare) të botuar në shqip dhe anglisht dhe i mbi njëqind artikujve shkencorë të botuar në Shqipëri apo në vende të tjera. Është, gjithashtu, anëtar i Këshillit të Organizatave Kombëtare të International Sociological Association (ISA), si dhe president themelues i Shoqatës Sociologjike Shqiptare (ALBSA).

## Hyrje

Në këtë punim, sikurse është njoftuar në numrin e kaluar të kësaj reviste,<sup>1</sup> do t'i referohemi në mënyrë të veçantë politologut dhe filozofit gjerman Erhard Epler (1926-2019), për arsye që i kami shpjeguar në artikullin e kaluar (shih) dhe sidomos veprës së tij “Rikthimi i politikës”. Në kapitullin e gjashtë të librit të tij Epler, nga këndvështrimi i një studiuesi të politikës, trajton pikërisht raportin mes utopisë dhe pragmatizmit (Eppler, 2001: 59-71). Më pas, ai kalon në analizën e raporteve dilematike midis politikës dhe shkencës, ose interesit dhe së vërtetës (2011: 73-80) për të vijuar me konsiderata e vlerësime morale të politikës, sidomos në pjesët “Moralit kundër politikës?” (2011: 81-90). Kemi të bëjmë, gjithsesi, me një qasje filozofike të politikës.

Raportit midis politikës, utopisë dhe pragmatizmit përfaqëson një temë mjaft aktuale. Nëse do t'u përmbahemi klisheve që mbizotërojnë në mediat e sotme të Shqipërisë e Kosovës dhe, në një masë të konsiderueshme edhe të vendeve të tjera pavarësisht nga niveli i zhvillimit apo vendi që zenë në indeksin global të demokracisë, atëherë do të kishte vetëm dy lloj politikaneësh: utopistë dhe pragmatistë. Të parët, utopistët, zakonisht e përbuzin realitetin dhe ‘ngrenë hundën drejt qiellit’. Të dytët, pragmatikët, zakonisht larg çdo lloj ideologjie, i japin peshën e duhur realitetit. Por pa pyetur për vizione e programme. Sidoqoftë ata njohin problemet dhe merren me to, pra “i zgjidhin.”

Ku qëndron politika, a mund të jetë ajo utopike, apo pragmatike; a përfaqësojnë politikë këto qasje të skajshme, utopia – nga njëra anë dhe pragmatizmi – nga ana e kundërt; apo politika kryhet në hapësirën mes tyre? A ka nevojë politika e mirë për utopizëm dhe/apo pragmatizëm? Nëse

‘po’, në çfarë dozash? Rreth këtyre pyetjeve shtjellohet ky artikull.

Nëse pikënisje e këtij trajtimi është vepra e Eplerit (2001), përgjigjen e këtyre pyetjeve do të karkojmë në ballafaqim me veprat e autorëve të tjerë, klasikë apo bashkëkohorë. Pra, le të shohim fillimish dhe shkurt, disa koncepte bazë mbi politikë, utopinë dhe pragmatizmin. Për të vijuar, më pas, me raportin ndërmjet tyre.

## Politika si instrument për të krijuar ‘Shoqërinë e Mirë’

Politika vazhdon të tërheqë vëmendjen publike më shumë se çdo veprimtari tjetër. Kjo, së pari, sepse politika lidhet me interesat jetësore të njerëzve. Por interesat janë të shumëllojshme: ekonomike, politike, ideologjike, shpirtërore, arsimore, shkencore, profesionale, kulturore, shëndetësore, estetike etj. Interesat e individëve, ashtu si dhe interesat e grupeve të caktuara shoqërore, janë ndër dukuritë më të rëndësishme të jetës sociale (shih, Sokoli, 2003: 5-6). Me të gjitha merret politika, natyrisht jo vetëm ajo. Ndaj edhe ‘kufiri’ i politikës është i pakufizuar. Pavarësisht debateve, të paktën në parim, edhe përgjegjësia e politikës është e pakufizuar. Ajo shtrihet përtej pushtetit që njerëzit i delegojnë asaj (temë më vete). Madje politika mban përgjegjësi edhe për mostrajtimin e çështjeve të caktuara.

Nga ana tjetër, politika është emocionuese. Ajo, megjithë lodhjen prej saj (siç na rezulton edhe nga sondazhet), politika vazhdon të emocionojë. Kjo, së pari, sepse njerëzit nuk bien dakord. Ata nuk bien dakord rreth mënyrës se si duhet të jetojnë, se si duhet të shpërndahet pushteti dhe burimet e tjera, nëse shoqëria duhet të ketë për bazë bashkëpunimin apo konfliktin e kështu me radhë. Njerëzit, gjithashtu, nuk bien dakord për mënyrës se si duhet

<sup>1</sup> Nga “Politika dhe standardet etike; Refleksione nga ‘Rikthimi i politikës’ i Erhard Eppler”, Studime Sociale [Social Studies], Vol. 13, Nr. 3 (47) 2019, fq. 81-92.

të zgjidhen këto lloj çështjesh, se kush duhet të vendosë për to, si duhet të marren vendimet kolektive, sa ndikim duhet të ketë çdo person etj. etj. Sipas Aristotelit, këto e bëjnë politikën “shkencë madhore” dhe, për nga natyra, njeriu është “qenie politike”.

Mbi të gjitha, politika është dialog, asnjëherë monolog. Individët vetmitarë, si Robinson Kruzo, mund të krijojnë një ekonomi të thjeshtë, të krijojnë art e të tjera, por ata nuk mund të merren me politikë. Sidoqoftë, njerëzit nuk janë në një mendje as për atë që e bën “politik” ndërveprimin social, as në mënyrën se si mund të analizohet dhe të shpjegohet më mirë veprimtaria politike. Referuar veprës “Politika” të Andrew Heywood (2008), ndoshta vepra më e mirë e llojit të vet,

politika është asgjë më pak se veprimtaria ndërmjet së cilës qeniet njerëzore përipien të përmirësojnë jetën e tyre dhe të krijojnë Shoqërinë e Mirë (Heywood (2008: 24).

Jo pa kundërshti është edhe të ushtruarit e politikës. Nga njëra anë, pranohet që njeriu nuk mund të mos merret me politikë. Sidomos njeriu i sotëm, sepse “jetojmë në një epokë demokratike dhe jemi dëshitarë të zhvendosjes së pushtetit për poshtë”, siç argumenton Fareed Zakaria në veprën “E ardhmja e lirisë” (2004). Politika, pra, është e tillë që edhe kur individit nuk ka punë me politikën (siç pretendohet shpesh) është politika që ka gjithnjë punë me individin.

Politika (më saktë veprimi politik),

është aq e rëndësishme saqë nuk mund të mos shoqërohet, apo paraprihet, nga mendimi (politik). Çështjet me të cilat merret politika nuk mund të zgjidhen “pa u menduar”. Veçse duhet pranuar se, nga njëra anë, të gjithë jemi gjithnjë gati që të merremi me politikë dhe, nga ana tjetër, nuk jemi as gati, madje as të prirur, për të zhvilluar mendimin politik, e për t’iu referuar atij. Politika, në vetvete, është joshëse. Udhë e mendimit nuk është aspak joshës (Tinder, 1991: 11).

Por edhe nocioni ‘politikë’ krijon në vetvete keqkuptime. Përse bëhet fjalë, më ekzaktesisht: për “polity”, për “Policy”, apo për “Politics”? pyet Erhard Epler.<sup>2</sup> Pra, çfarë garanton që politika të përbëjë një tipar të pashmangshëm të gjendjes njerëzore? Dy gjerë mund të veçohen. E para, prania e pashmangëshme e diversitetit (ne nuk jemi njëlloj) dhe, e dyta, pamjaftueshmëria (asnjëherë nuk ka mjaftueshëm për të gjithë).

Koncepti “politikë” është thellësisht i diskutueshëm. Dhe, pavarësisht të kundërtave dhe alternativava në shpjegimin e thujtë gjithçkaje që ka të bëjë me politikën, ekziston një ‘konsensus’ të paktën mbi katër shtylla (mund të shihet Heywood, 2008: 25-32), që janë:

- (1) politika si art i qeverisjes;
- (2) politika si çështje publike;
- (3) politika si kompromis e konsensus;
- (4) politika si pushtet dhe shpërndarje

e burimeve.

Por, përvoja jetësore e ushtrimit të politikës i ka detyruar studiuesit që të

<sup>2</sup> Ka popuj, shkruan politologu gjerman Epler (2011: 7) tradita politike e të cilëve është pasqyruar atje ku është e pranishme, për këdo e në çdo çast: në gjuhë. Në gjuhën angleze është ruajtur përvoja e shumë shekujve për diskutimin politik; gjermanët, tepër gjatë pa kryeqytet, pa parlament kombëtar, pa gazeta të lira, të shitura nga Konstanz-a deri në Flensburg, nuk kanë arritur ta fitojnë këtë përvojë. Atje ku ne, gjermanët, përdorim vetëm fjalën “politikë”, britanikët mund të zgjedhin midis tri fjalëve. Kur e kanë fjalën për format e politikës, për institucionet në të cilat zhvillohet ajo, atëherë thonë “*polity*”; politika e përditshme, lufta për përfitimet e vogla, paraqitet pak a shumë vanitoze për ekranet televizive janë veçori të përhershme të “*politics*”. Por e gjithë kjo ka kuptim vetëm atëherë kur bëhet e durueshme, kur lidhet me një “*policy*”, pra me një drejtim politik, me mesazhe politike, të cilat janë pjesë e një koncepti. Vetëm atëherë dallohet se për çfarë hyjnë ose duhet të hynin në punë të mërzitshmet “*politics*”. Të trija së bashku përbëjnë atë që, në gjermanisht (edhe në shqip, apo në gjuhë të tjera L.S.), në vija shumë të trasha, quhet politikë.

tërheqin vëmendjen ndaj disa dukurive, siç është politicizimi. Ai shprehet në disa forma. E para i referohet qasjes së individëve ndaj politikës. Po citojmë, për ilustrim, Sami Frashërin (1978; 57) i cili, në kohën e tij, shkruante:

Në kohën tonë të gjithë po merren me politikë; kjo punë ka bërë që të rinjtë të harrojnë zbatimet e tyre, pleqtë - hallet e tyre, gratë - qeverisjen e shtëpive të tyre, adhuruesit - adhurimin, tregtarët - fitimin dhe mjekët - të sëmurët e tyre.

Siç duket, edhe politicizimi i vetë politikës apo militantizmi i saj kanë njëfarë “tradite” edhe në botën shqiptare. Madje vetë Sami Frashëri (1978; 91) në përpjekjen për të orientuar debatin politik, këshillonte:

Mos diskuto me partizanin (e një çështjeje), sepse po të jesh pro anës që përkrah ai, diskutimi mbaron para se të ketë filluar; po të jesh kundër, duhet të grindesh me të.<sup>3</sup>

E tillë është edhe shkalla e lartë (e tepruar) e identifikimit politik të individit, masa (e testuar nga studiuesit) e ‘besnikërisë së verbër’ ndaj subjekteve politike (mund të shihet, Sokoli, 2008: 39-45).

### Frymëzimet utopike dhe totalitarizmi

Forma tjetër e shfaqjes së politicizimit të çon më tej. Ajo lidhet me fenomenin totalitar, për të cilin na duhet të japim njëfarë përkufizimi, bazuar në pesë karakteristika të tij:

Totalitarizmi përfaqëson një regjim (i) të një partie monopol (ii) të frymëzuar nga një

ideologji (iii), përmes së cilës shteti merr një monopol të dyfishtë, atë të mjeteve të forcës dhe të lavazhit të truve (iiii), ku shumica e veprimtarive ekonomike e profesionale - në mos të gjitha - i nënshtrohen shtetit (iiiii) dhe që, nga çasti kur çdo veprimtari është shtetërore dhe i nënshtrohet ideologjisë, çdo gabim i kryer në një aktivitet ekonomik apo profesional, vlerësohet si gabim ideologjik dhe politik (iiiii).

Ky, siç duket, është rasti më tipik i politicizimit të shoqërisë, siç kanë argumentuar studiuesit socialë (Aron, 2005; Poliakov, 1987; Eppler, 2001; Tinder, 1993) e shumë të tjerë. Pra, politicizimi dmth mpleksia e një ideologjie me politikën, përfaqëson një karakteristikë themelore të regjimeve totalitare. Në to politika dhe ideologjia mbështetëse u shfaqen si një fe e re e njerëzimit.<sup>4</sup>

Çështja është se *regjimet totalitare kanë pasur gjithnjë frymëzime utopiste*. Në Europë, vala totalitare ishte reaksion ndaj kasaphanës së Luftës së Parë Botërore. Ishte koha kur utopistët filluan të ngrinin në qiell “të drejtën e më të fortit.” Kjo sidomos në Gjermani. Nazistëve u hypi në kokë që ta rindërtonin botën jo në përputhje me idealin e drejtësisë, por sipas kriterëve selektive, biologjike ose “teozologjike”, për të mirën e ‘racës’ së tyre, duke i kthyer popujt e tjerë në skllëvër, apo duke i asgjësuar (Poliakov, 1987: 10).

Në pjesën tjetër të Europës, në lindje të saj (Rusi e gjetkë), utopistët ndezën flakë proletarët kundër klasave të privileguara. Edhe bolshevikëve u hypi në kokë që ta rindërtonin botën jo në përputhje me idealin e drejtësisë, por sipas kriterëve selektive klasore “për të mirën e klasës së tyre”

<sup>3</sup> Mund të shihet edhe “Çmilitantizimi i mendjes”, në Sokoli, 2006: 160-166.

<sup>4</sup> Në hyrje të veprës së tij të njohur “Opiumi i intelektualëve” (2005: 5), Raymond Aron citon, nga njëra anë, Marksën sipas të cilit “Feja është opium për popullin” dhe, nga ana tjetër, citon Simone Weil, sipas të cilit “Marksizmi është kryekëput një fe, në kuptimin më të papastër të fjalës... Ai ka të përbashkët sidomos faktin se është përdorur vazhdimisht, sipas fjalës së vetë Marksit, si një opium për popullin.”

(proletariatit) duke përmbysur, kthyer në skllave, apo duke i asgjësuar klasat e tjera.

Në veprën “Totalitarizmat e shekullit XX” (Poliakov, 1987: 53-57) ka një kapitull të emërtuar “Utopia në pushtet” në të cilin autori argumenton se ngritja në pushtet ishte një moment kapital, gati apokaliptik, për bolshevikët në Rusinë e vitit 1917. Ai jep fakte për një “dehje utopike” masive, për një valë ngazëllimi popullor ku ‘xurxullosja’ e motivuar nga ideja “borgjezët kanë pirë mjaft, tani e kemi radhën ne” bëri kërdrinë në kryeqytetin rus, por edhe në Ukrainë e kudo në tokën e revolucionit. Utopizmi popullor rus është përshkruar mjaft qartë edhe nga amerikani John Reed, në librin e tij “Dhjetë ditë që tronditën botën” (Cit., Poliakov, 1987: 55), ku shkruan:

Unë kuptova papritur se populli fetar rus nuk kishte nevojë për priftërinj që t’i hapej rruga drejt qiellit. Ai po ndërtonte vetë mbi tokë një mbretëri më vezulluese se ajo e qiellit, për të cilën e kishte nder e lavdi të vdiste.

Në Lindjen e Largët, megjithë veçoritë, totalitarizmat u shfaqën sërish si reaksion ndaj një kasaphane të madhe, Luftës së Dytë Botërore (jo të parës) dhe përgjithësisht zëvendësuan regjime të huaja kolonialiste dhe jo regjime vendase ‘imperialiste’. Të frymëzuar edhe nga modeli i tyre i utopizmit aziatik, katër diktatorë: Mao Ce Duni në Kinë, Pol Poti në Kamboxhia, Ho Shi Min në Vietnam dhe Kim Ir Sen në Korenë e Veriut, u frymëzuan dhe u maskuan, secili në

mënyrën e vet<sup>5</sup> nga një utopizëm ‘më global’, nga doktrina e Marksit dhe Leninit. Madje, më e pakëndshmja në utopinë marksiste ishte se ajo nuk donte të ishte e tillë. Autorët e saj i njohën vetes meritën kryesore: atë të shndërrimit të utopisë në shkencë. Por, nuk rezultoi të ishte kështu.

### Rikthimi i utopisë...?

Ky është titulli i një libri të sapobotuar në Itali. Autori i tij (Mordacci, 2020) përpikat të argumentojë se “në kushtet e sotme, kemi nevojë urgjente për utopi”. Por, le të kthehemi pas në kohë. Që prej viteve ’1950-të qëkur, falë edhe kontributit të Hanah Arendit u shfaq nocioni i totalitarizmit, botën e preokupon polemika nëse

utopitë për politikën janë ndihmëse dhe motivuese, apo vetëm të rrezikshme dhe destruktive; nëse ato janë të domosdoshme apo të panevojshme; nëse tensionet për realitetin që ato prodhojnë janë të frytshme apo vetëm se pengojnë një veprim të arsyeshëm (Eppler, 2001: 59).

Ndërsa, që prej shpërbërjes së komunizmit, ka mendime se polemika është zgjidhur: utopia çon në qorrsokak dhe në rrugë të tërthorta e të përgjakshme të historisë. Por, a është vërtet kështu?

Për besimtarët e vërtetë të doktrinës, Marksi dhe Engelsi nuk kanë folur për utopi si disa socialistë të orëve të para, por kanë bërë shkencë<sup>6</sup> Ndryshe nga

<sup>5</sup> Në vendet komuniste, përgjithësisht, kriteri bazë selektiv, ishte përkatësia klasore, bazuar në vendin që zinin njerëzit përkundrejt mjeteve të prodhimit. Normalisht, bazuar në teorinë e Marksit, njerëzit ishin ose proletarë (dmth të zhveshur nga pronësia mbi mjetet e prodhimit) ose borgjezë, kapitalistë (dmth pronarë mjetesh të prodhimit).

Por në vende të ndryshme, ky ‘kriter’ u interpretua dhe u zbatua “në mënyrë krijuese”, “originale”. Kim Ir Sen, për shembull, shkoi shumë më tej. Ai e ndau popullsinë në Korenë e Veriut në 51 kategori, njëzet prej të cilave përfshinin “elementët e akuzuar për përtaci, jetë luksoze, apo shturje”, me fjalë të tjera “kapitalistë”, “klasë armike” që përbënte 27 për qind të popullsisë, e cila duhej riedukuar... Kjo ishte veç klasës që nuk mund të riedukohet, por duhej eliminuar, pra “klasës armike të rivalëve të vjetër” të cilët u eliminuan të gjithë përmes proceseve gjyqësore “spektakolare” (Poliakov, 1987: 17).

<sup>6</sup> Engelsi i kushtoj kësaj çështje veprën e njohur “Shndërrimi i socializmit nga utopia në shkencë” (1877).

Tomas Mori<sup>7</sup>, në shekullin e 16-të, që vinte përballë realitetit të kohës së vet një vend “askund”, Marks i njohu ligjet e historisë, të cilat, përmes socializmit dhe komunizmit, duhej të çonin në shoqërinë pa klasa. Edhe në vjeshtën e 1989-ës (në vitin e rënies të Murit të Berlinit, pra tepër vonë) Erik Honekeri mendonte se “një fitore e kapitalizmit mbi socializmin ishte një lloj sikur uji i lumenjve të donte të ngi tej maleve përpjetë; pra një fitore e tillë binte ndesh me ligjet e historisë, siç e kishte mësuar nga Marks.” Ndaj vijon Epler (2001: 60) nuk është plotësisht bindëse që t’i bësh

gjyqin utopisë me ndihmën e një teorie që e kujton veten shumë më lart se utopitë.<sup>8</sup> Ai u referohet autorëve që përpiqen të “shesin mallin parademokratik për një botë në harmoni të plotë dhe pa kontradikta, për një gjendje shoqërore me mungesë të plotë të sundimit.” Mite të tilla “vëllazërimi”, vijon ai, janë apolitike pasi

politikë, të paktën politikë demokratike, nuk do të thotë harmoni, pasi ajo e ka origjinën në polemikën vlerësuese, në vlerat që konfrontohen; është praktikë e lirisë dhe “ka si parakusht dhe përmbajtje diferencat.

<sup>7</sup>Tomas More (More, Thomas 1477/8 – 1535), mendimtar humanist, autor i doktrinës së socializmit utopik dhe i veprës “Utopia”, që e përjetësoi emrin e tij si një nga personalitetet më të shquara në historinë e mendimit politik e shoqëror. I lindur në Londër në familjen e një gjykatësi, ai pati mundësi të arsimohej për shkencë humane dhe të merrte një specializim për drejtësi në Universitetin e Oksfordit në kohën kur atje jepte mësim Erazmi i Roderdamit, i cili u lidh në një miqësi të përjetëshme me të. Madje pedagogu dhe mik i tij, Erazmi i Roderdamit, në shkrimet e veta pas largimit nga Londra do ta vlerësonte T. Morin si “model për inteligjencien e Europës” dhe si “njeri për të gjitha kohët”. Por ai u konfliktua me mbretin e Anglisë, Henrikun e VIII-të, u akuzua për tradhëti dhe u ekzekutua në vitin 1535. Megjithatë, libri i tij “Utopia”, çeli një vijë të re në letërsinë politiko-filozofike europiane dhe pati vazhdimësi në veprat e tilla si “Qyteti i Diellit” i Kampanellës, “Atlantida e Re” e Bekonit, “Testamenti” i Meliesë etj. Kjo e bëri T. Morin të pavdekshëm. “Utopia” është i shkruar në formën e një debati, ndërsa pikëpamjet e autorit janë vënë në gojën e Refaelit, të një udhëtarit portugez i cili paraqitet si personi që ka jetuar pesë vjet në ishullin Utopia. Subjekt i tregimit të udhëtarit është ishulli i mrekullueshëm i Utopisë, që vetë emri me prejardhje nga greqishtja do të thoshte se bëhej fjalë për një vend dhe për një shoqëri që në fakt nuk ekziston askund. Ishulli përshkruhet si i organizuar në mënyrë të përsosur, që dallonte në mënyrë thelbësore nga rendi ekonomik-shoqëror i Anglisë së periudhës së akumulimit fillestar të kapitalit; kur dhjetëra mijë fshatarë ishin shpronësuar, kishin mbetur pa strehë, pa punë dhe pa asnjë mjet jetese; kur qarkullonte shprehja: “Delet hanë njerëz”. Përballë një realiteti të tillë, T. Mor i prekur thellë nga faktet e shumta të vuajtjeve masive, kalon nga e veçanta te e përgjithshmeja, te thelbi i problemit dhe arrin në përfundimin se burim i të gjitha të këqijave është prona private, prandaj ajo duhet zhdukur për t’u zëvendësuar me ndarjen e drejtë të pasurisë dhe të mirëqenies për të gjithë. “Ku ka pronë private, ku gjithçka e matin me para, atje vështirë që ndonjëherë të ketë ndonjë rrjedhë të rregullt e të sukseshme të punëve shtetërore”, shkruante T. Mor. Në këto rrethana, si humanist i shquar që ishte, ai e pa të udhës që idealin e tij për të ardhmen (në rolin e një proteste intelektuale), ta sintetizonte me shtetin përrallor të Utopisë, ku

të gjithë njerëzit jetojnë me punë të ndërgjegjshme, marrin nga magazina e përbashkët atë që u nevojitet pa ndërmjetësinë e parave, ku nuk ka as të pasur, as të varfër dhe as parazitë, kurse dallimet midis punës mendore dhe asaj fizike, midis fshatit dhe qytetit nuk ekzistojnë më.

Shkenca dhe arti, siç tregon Refael që përfaqëson autorin, zënë një vend tepër të rëndësishëm në jetën e ishullorëve që zotërojnë e respektojnë të gjitha zanatet, ndërsa kohë pas kohe, merren me bujqësi dhe me përgatitjet për mbrojtjen e ishullit. Qeliza prodhuese bazë është familja e tipit patriarkal, ku pushtetin e kanë më të moshuarit. Megjithatë, T. Mor nuk është konsekuent përderisa përligj ekzistencën e skllëverve në ishull duke thënë se kjo është një metodë humane e ndëshkimit të kriminelëve dhe një mënyrë e zgjidhjes së problemit të punëve të pa preferuara. Libri “Utopia” i T. Morit është lexuar pareshtur nga pasardhësit, veçse nga secili në mënyrën e vetë, nga shumë si një kritikë argëtuese, por nga disa edhe si i dobishëm për reflektime filozofike dhe etike në funksion të së ardhmes (mund të shihet: Pëllumbi, 2010).

<sup>8</sup> Edhe vetë Karl Poperi (1996) e akuzonte marksizmin para së gjithash se jo vetëm pretendonte të kishte parë në letrat e lojës së historisë, por sillej sikur t’i kishte këto karta në duart e veta.



Autori i veprës “Rikthimi i politikës” (2001) përdor disa koncepte mbi utopinë, si “utopi të Perëndimit”, “utopi të varfëra”, “utopi konkrete”, “utopi e emancipuar”, “vakum utopik” etj., gjithnjë në raport me politikën. Sipas tij utopitë e Perëndimit, që të japin flatra, s’janë në fund veçse pasqyrimë të shpresave për një tokë e qiell të ri, në të cilat politika nuk do të nevojitej më, pasi aty, një Adam e një Evë tjetër, do t’i takonin njerëzit si vëllezër e motra, atëherë është po aq e pakuptimtë dhe e rrezikshme të krijosh Adamin e ri me mjetet e të vjetrit. Por, a nuk mund të ndodhë që Adamit të vjetër t’i jetë ngulitur një nevojë e pashtershme për utopi, saqë nuk mund të mësojë kurrë të mendojë pa utopi dhe nuk reziston gjatë në një vakum utopie?

Diçka flet në favor të kësaj, vijon ai (fq. 61) para së gjithash ato çfarë unë dëshiroj t’i quaj utopitë e varfra, të cilat hyjnë tinëzisht pikërisht aty ku përqeshen utopitë e botës së re. Këto utopi të varfra e pa pretendime kanë të përbashkët me të mëdhatë faktin që janë të paarritshme, që nuk do t’i arrijmë dot kurrë. Por ato ndryshojnë nga të mëdhatë në faktin që nuk janë ëndrrat fantastike të Adamit dhe Evës së re, por dëshirat e vjetra disi banale të Adamit dhe Evës së vjetër. Utopia e varfër nuk nënkupton as shoqërinë e re, por të vjetrën, ku zë vend egoja: secili për vete. Shënjestër e utopisë së varfër është egoja, jo shoqëria. Por ajo ka një funksion shoqëror: të ofrojë një zëvendëse për utopinë që jep flatra.

Karakteristikë e rëndësishme e utopisë së varfër është se paraqitet me kokën lart, si realizëm. Ajo mund të shfaqet shumë mirë si polemikë kundër çdo utopie. Ajo nuk ka as nevojë për revolucion. Duhet, kështu thonë profetët e saj, vetëm të veprohet si deri tani, të lihet tregu të bëjë punën e vet dhe, atëherë, egoja e vogël borgjeze do të marrë gjithçka i dëshiron zemra: mirëqenie të përsosur dhe siguri të plotë.

Por Epler (2001: 62-63) tërheq vëmendjen, kur pohon,

përfytyrimi se nëse çdokush e lë veten të shtyhet nga egoizmi, të gjithë do të bëheshin të pasur e madje të lumtur, është po aq utopik sa dhe premtimi për siguri të plotë, qoftë kjo siguria pa të meta nga jashtë, kur të mbyllen hermetikisht të gjitha “dritaret e cenueshmërisë”, qoftë siguria e garantuar kundër krimit që ndërkohë po bëhet një mall i rregtueshëm. Këto utopi janë të afërta me ato çfarë Ernst Bloch i ka quajtur “ëndrra në diell të tipit komod, të lehta, ikanake, kuturu, paralizuese”.

Po utopitë konkrete? Me “utopi konkrete” kuptohet ajo çka nuk ekziston ende, por që mund të ekzistojë një ditë. Ngjashëm ndodh edhe me nocionin “utopi e emancipuar”. Utopia e emancipuar duhet të ndërmjetësojë mes “ndërgjegjes dhe realitetit të ardhshëm.” Ajo nuk duhet të jetë “një model statik”, por të modifikohet vazhdimisht përmes “reflektimit kritik”.

Epler bën diferencimin midis utopisë dhe konceptit, por njëherësh, operon me terma si “projekt”, “ide rregullatore” (madje i referohet Kantit), etj., etj. Atë çfarë të tjerët e kanë quajtur “utopi e emancipuar”, Epler e quan thjesht “koncept”. Konceptet mbështeten në realitet, ato janë modifikime të realitetit, mund të kritikohen dhe të modifikohen, por edhe të realizohen e të zëvendësohen nga koncepte të reja. Kur dikur, nga fundi i shekullit të 19-të, sindikatat ngritën kërkesën për ditën 8-orëshe të punës, prapa qëndronte projekti për një botë në të cilën jeta e punëtorit duhej të ishte më shumë se vetëm punë, në të cilën të ishte e mundur një jetë pas dhe përkras punës. Natyrisht që sindikatave iu tha atëherë që kjo ishte utopi. Ndërkohë “asgjekundi” është kudo, të paktën në Europë. Tashmë diskutohet për javën 35-orëshe, 32-orëshe të punës, apo deri në shkurtrimin e javës së punës në katër ditë.

Gjithçka që sot e konsiderojmë si të vetëkuptueshme, ka qenë dikur objekt i një koncepti: heqja e pagesës për arsimin, rregullorja e ndërmarrjes, e drejta për të

bashkëvendosur, pushimi vjetor, sigurimi ndaj papunësisë. Edhe demokracia parlamentare ishte fillimisht një koncept, i cili, për dekada me radhë, shihej si utopi. Sipas tij, edhe imazhi orientues i “sustainable society” nuk është utopi, por koncept.

Atëherë, mendimi i Eplerit (2001: 59; 62), mund të përmblihet:

Politika mund dhe duhet të bëjë pa utopi. Ndoshta edhe ëndërrat (utopitë) duhet të ekzistojnë por, në politikë, më mirë jo. Aty ëndërrimtarët janë figura të çuditshme...

### Pragmatizmi, jashtë politikës...?

Këtë çështje do ta trajtojmë më gjerësisht, bazuar në veprat klasike mbi pragmatizmin, sidomos ato të William James (2005 [1907]), por edhe në disa botime të viteve të fundit (Richard, 2003; Michale, 2012).

Tani për tani, do t'i referohemi Eplerit i cili mban, pak a shumë, të njëjtin qëndrim si për utopinë, ashtu edhe për pragmatizmin. Ai pohon, madje pa ekuivoqe, se këta tipa idealë nuk bëjnë politikë: as vizionari dhe as pragmatiku. Politika kryhet në hapësirën mes tyre. Ky ballafaqim i thjeshtëzuar i utopistëve dhe pragmatistëve ka, natyrisht, ndikim edhe në shkencë. Rruga e politikës është e përcaktuar qartë: nga utopia e arsyes, që planifikon me çdo mënyrë të shkenca e mbijetesës, shkruan Epler (2001: 68-69).

Pragmatikët, kështu dëgjojmë të thuhet çdo ditë, nuk kanë nevojë për projekte dhe as për vlera themelore. Për ta programet janë penguese. Ata nuk janë “tradicionalistë.”

Pragmatikët zgjidhin probleme. Pikë! Por çfarë problemesh? “Ato që paraqiten, që janë urgjente”, përgjigjen ata.

Natyrisht që ndodh edhe kështu: Kur një çarje tubash rrezikon furnizimin me ujë të qytetit, ato duhen riparuar. Atje ku është problemi, atje është edhe zgjidhja. Dhe ka (mund të ketë) vetëm një të tillë. Shoqatat sportive, për shembull, kërkojnë një sallë të re sporti etj., etj. Pra, kjo është politika, ajo është gjithnjë vendore, zgjidhje problemesh – thonë pragmatikët.

Por, sipas Eplerit, as kryetarit të njësisë vendore, nuk i vijnë aspak në ndihmë kur i themi se problemet duhen zgjidhur me pragmatizëm. Ai duhet t'i zgjidhë ato sipas radhës. Por, në çfarë radhe? Kush ka përparësi? Dhe si duhet të vendosë? Dhe, gjithnjë, i duhet të bindë qytetarët se vlerësimi i tij është i drejtë. Kujt duhet t'ia prishë qejfin? Kundërshtarëve apo përkrashësve?

Sidoqoftë, thënë shkurt, çdo politikan duhet të veprojë me pragmatizëm dhe, ashtu si çdo udhëtar, duhet t'i hedhë hapat njëri pas tjetrit. Vetëm se edhe ai që udhëton ka nevojë, të paktën, për një hartë.

Por, kush kërkon ta fusë të gjithë politikën në skemën problem-zgjidhje, mund të humbasë realitetin. Dhe kjo mund të ketë pasoja të rënda.<sup>9</sup> Filozofia e zgjidhjes “pragmatike” të problemeve prodhon një konservatizëm pak a shumë të ndërgjegjshëm. Nëse kudo shkëputen nga e tëra detyra të veçanta dhe përkufizohen si probleme – çfarë duhet pranuar se shpesh nuk mund të shmangen, - nëse çdo projekt që parashikon ndryshime duket i tepërt, atëherë edhe “zgjidhjet” e suksesshme të problemeve s'bëjnë gjë tjetër veçse

<sup>9</sup> Ai i referohet Hanah Arendt, e cila merr një shembull të skajshëm, atë të “problem solvers” të punësuar nga qeveria e SHBA-ve për të zgjidhur problemet në Vietnam. Arendt (Cit., Eppler, 2001: 69-70), shkruan për problemzgjdhësit: “Ata ishin jo vetëm inteligjentë, por edhe krenarë për racionalitetin e tyre pa sentimentalizëm.” Por, për Hanah Arendt, tronditëse ishte ana tjetër e zgjidhjes së problemeve të tilla: “Për ata që zgjidhin problemet, që janë të specializuar në përkthimin e fakteve në shifra dhe përqindje, është ndoshta e natyrshme që nuk ishin asnjëherë të vetëdijshëm se çfarë mjerimi të parrëfyeshëm nënkuptonin zgjidhjet e tyre – programe paqëtimi dhe zhvendosjeje, napalm dhe bomba”.

riparojnë ekzistuesen. Pragmatiku i vërtetë, zgjidhësi pa perspektivë i problemit, është konservativ në ndikimin që ushtron. Dhe aq më keq, nëse nuk arrin ta vërë re këtë.

Dhe, konkludon: Konservativët e bindur e të vetëdijshëm janë më të parapëlqyer se konservativët pa dashje. Konservativi i bindur bën politikë, ai di se çfarë do. Ai vlerëson dhe vendos të ruajë diçka. Kush bën, në fakt, të njëjtën gjë pa dashur, lëviz jashtë politikës. Ndodh kështu pasi politika zbatohet në fushën e tensionit mes konceptit dhe realitetit, mes synimit afatgjatë dhe zgjidhjes aktuale të problemit, mes programit themelor dhe “muddle thought.”

Këtë nuk e kundërshton as fakti që politika zhvillohet kryesisht me hapa të vegjël. Çështja nuk qëndron në madhësinë e hapave, por në njohjen e drejtimit. Në një farë mënyre, çdo politikë është pragmatike. Por ajo mbetet politikë vetëm kur mbetet e dallueshme, pra kur, përmes hapave të vegjël bëhet e dallueshme se në ç'drejtim duan të lëvizin protagonistët (Eppler, 2001: 71).

Duket sikur Eppler ka të drejtë në gjithçka thotë. Por, megjithatë në vizionin e tij ka një thjeshtim të pragmatizmit, theksimin e ‘sensit praktik’ të tij, reduktimin në një çështje jo vetëm pa vizion, por edhe pa empirizëm. Kjo na nxit për ta parë pragmatizmin disi më veçmas. Kjo sepse, nga njëra anë, pragmatizmi ka rrënjë historike. Ai përfaqëson një “emër të ri për një mënyrë të vjetër të menduari” (James, 2005). Nga nga ana tjetër, pragmatizmi përfaqëson kontributin temelor të filozofisë amerikane në filozofinë botërore (Richard, 2003; Michale, 2012).

Sidoqoftë, për të përmbledhur, mund të themi se përfundimi që na rezulton nga ky trajtim është ky: Utopia dhe pragmatizmi po rendin drejt njëra-tjetrës, ndoshta me një shpejtësi aq marramendëse sa që dekada më parë nuk mund të imagjinohej. Por rendin, pikërisht, duke përshkuar hapsirën e politikës. Le ta marrim këtë përfundim si një hipotezë për një shqyrtim të mëtejshëm (vijon në “Studime Sociale”, Vol. 14, No. 2 (49), 2020).

## REFERENCAT

- Aron, Raymond. 2005 [1995]. *Opiumi i intelektualëve*, Tiranë: Dituria.
- Bacon, Michale. 2012. *Pragmatism, an Introduction*, Cambridge: Polity Press.
- Bregman, Rutger. 2019. *Utopia për realistët*, Tiranë: Minerva
- Engels, Friedrich. 1980 [1877]. “Shndërrimi i socializmit nga utopia në shkencë”, në Marks & Emgels, *Vëpra të zgjedhura*, Vëllimi II, Tiranë: 8 nëntori, fq. 91-160.
- Eppler, Erhard. 2001. *Rikthimi i Politikës*, Tiranë: ISPS & Rinia 2000
- Heywood, Andrew. 2008. *Politika*; botimi i dytë, Tiranë: Botimet Dudaj
- James, William. 2005 [1907]. Pragmatizmi, Tiranë: Plejad.
- Kelmendi Ibrahim & Lekë Sokoli. 2011. “Parathënie e përkthimit shqip” në Eppler, Erhard, *Rikthimi i politikës*, fq. 5-8
- Lyman Tower Sargent. 2010. *Utopianism: A Very Short Introduction*. Oxford: Oxford University Press.
- Mordacci, Roberto. 2020. *Ritorno a Utopia*, Roma & Bari: Editori Laterza.
- More, Thomas. 2002 [1907]. *Utopia* (Revised ed.), New York: Cambridge University Press.
- Pellumbi, Servet. *Etikokracia; refleksione mbi teorinë dhe praktiken e demokracisë*, Tiranë: Morava
- Pëllumbi, Servet. 2010. *Fjalori i filozofisë*, Tiranë: Morava
- Piketty, Thomas. 2016. *Kapitali në shekullin e njëzetë e një*, Tiranë: PAPIRUS
- Poliakov, Léon. [1987] 1995. *Totalitarizmi i shekullit XX; Një dukuri historike e kapërcyer?*, Tiranë: Botime Përpjekja
- Popper, Karl. 1996. *Mjerimi i historicismit*, Tiranë:

- Onufri & Fondacioni Soros.
- Posner, A. Richard. 2003. *Law, Pragmatism and Democracy*, Cambridge: Harvard University Press.
- Sokoli, Leke. 2003. *Interesat dhe harmonizimi i tyre; Vështrim sociologjik*, Tiranë: ISPS & Rinia.
- Sokoli, Leke. 2006. “Çmilitantizimi i mendjes”, në *Sociologjia dhe jeta e përditshme*, fq. 161-166.
- Sokoli, Leke. 2007. “Pluralizmi në perceptimet e qytetarëve: interesi publik për politikën dhe votimet”, në *Refleksione Sociologjike*, fq. 12-46.
- Sokoli, Leke. 2019. “Politika dhe standardet etike; Refleksione nga “Rikthimi i politikës” i Erhard Eppler”, *Social Studies* [Studime Sociale], Vol. 13, No. 3 (47), fq. 83-92.
- Tinder, Glen. 1993. *Mendimi politik; Çështje të përgjithshme*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike
- Zakaria, Fareed. 2004. *E ardhmja e lirisë*, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit.

## ABSTRACT

If we stick to clichés that prevail in today’s media in Albania, Kosovo or even other countries, regardless of the level of development, there would be only two types of politicians: utopian and pragmatic. The firsts, the utopians, raise their nose to heaven, despising reality. But that they usually fall to their knees as soon as they encounter obstacles of the reality. The seconds, the pragmatic who, by giving due importance to reality, sink their nose to the ground, without asking for visions and programs. Where politics stands, can it be utopian or pragmatic; do these extreme approaches represent politics, utopia - on the one hand, and pragmatism - on the other; or politics carried out in the space between them? This article discusses just these questions. The answers are primarily sought in the work of Erhard Eppler «The Return of Politics». As in the works of other authors, long before and after him. But from this treatment comes to a conclusion somewhat different from that of Eppler: utopia and pragmatism are running towards each other, perhaps at a speed that it could not have been imagined decades ago. They are running, precisely, through the space of politics. Let’s take this conclusion as a hypothesis for further considerations...

**Keywords:** *Politics, Utopia, Return of Utopia, Pragmatism, Good Society*

# KOHEZIONI SHOQËROR E MBARËKOMBËTAR DHE RREZIKUESIT E TIJ

**Rexhep QOSJA**

*Akademik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës*

E-mail: rexhep.qosja.office@gmail.com

---

**M**ë 15-16 nëntor 2019 në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës është zhvilluar konferenca ndërkombëtare “Institucionet sociale në shoqërinë bashkëkohore; Bashkëveprimi ndërmjet arsimit, familjes, besimit fetar, politikës dhe ekonomisë” [“Social institutions in Contemporary Society; The Interaction between Education, Family, Religion, Politics, and Economy”], organizuar nga:

Instituti Shqiptar i Sociologjisë - Shoqata Sociologjike Shqiptare (Konferenca e 14-të Ndërkombëtare Vjetore) , Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës Shqipëri, Universiteti i Mitrovicës Isa Boletini Kosovë, Qendra e Studimeve “Confronti” Rome Itali dhe Shoqata Ndërkombëtare e Sociologjisë (ISA).

Akademiku, Prof. Rexhep QOSJA ishte folës kryesor i konferencës. Ai u nderua me Çmimin e Nderit “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, me këtë motivacion:

Për kontribut të shquar e shumëdimensional në zhvillimin e kulturës, arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Kosovë dhe në mbarë botën shqiptare; si studiues i shquar i shkencave albanologjike; si themelues dhe drejtues i institucioneve, programeve të studimit e organeve shkencore; si studiues i letërsisë, në veçanti i letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare; si historian i letërsisë e kritik letrar; si shkrimtar, publicist e polemist; si një zë origjinal në trajtimin e problemeve të mëdha të kohës, bazuar vetëm në kriterin e së vërtetës; si veprimtar shoqëror e politik, si një ndër intelektualët më të shquar të kombit shqiptar; si shembulli më i mirë i akademikut, studiuesit, krijuesit e intelektualit; si Nder i Kombit.

Në vijim është fjala e mbajtur nga Prof. Rexhep QOSJA, akademik]

**I.**

Të nderuar të pranishëm, pedagogë e studiues shkencorë, të nderuar studentë!

Më vjen mirë që më është dhënë rasti t'Ju përshëndes dhe njëkohësisht t'Ju falënderoj që me pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje po e miratoni dhënien e titullit të lartë Doctor Honoris Causa dhe ashtu po shprehni nderim për autorin të cilit i jepet ky titull.

Megjithëse mosha në të cilën jam dhe përvoja me të cilën më ka pajisur jeta në vendet banor i të cilave isha më kanë privuar prej mezipritjes së gëzimeve për dekorime e titullime nderuese ashtu si edhe prej dëshpërimeve për mohime që mund të më bëhen, ky titull që po më dhurohet sot këtu prej jush, më gëzon.

Pse mund të them kështu?

E para, mund të them kështu sepse është titull që më jepet prej një Universiteti i cili mban emrin e njërit prej artistëve më të mëdhenj shqiptarë dhe më të lavdishëm evropianë, mban emrin e Aleksandër Moisiut.

Aleksandër Moisiu ishte artist në të cilin ishin bashkuar disa dhunti me të cilat nëna natyrë mund ta stolisë – njeriun.

Ishte artist me mendje të pavarur dhe me etikë të palëkundshme.

Ishte artist me sjellje e me veprime të fisme në kohë të mirë e në kohë të ligë.

Ishte artist i pajisur me dhuntinë e jashtëzakonshme të pushtimit artistik të skenave teatrore dhe i adhuruar e i dashur prej publikut.

Ishte artist që kishte pamje jashtëzakonisht delikate, të brishtë, por ajo pamje ashtu delikate, ashtu e brishtë, ishte e përbërë prej një trupi jashtëzakonisht të qëndrueshëm dhe prej një fytyre jashtëzakonisht shprehëse, të paharruar, madje madhështore.

Aleksandër Moisiu ishte i veçantë me të gjitha: i veçantë me pamjen, i veçantë me karakterin, i veçantë me dhuntinë, i veçantë me zërin e tij magjik, i veçantë me gjithë jetën dhe, më në fund, i veçantë me ndarjen nga jeta. Kishte vdekur në moshën më të mirë krijuese siç kishin vdekur disa protagonistë tragjikë rolet e të cilëve i kishte përjetësuar në skenë.

E dyta, mund të them se titulli që m'u dhurua prej jush më gëzon edhe për arsye se më dhurohet pikërisht këtu, në Durrës.

Durrësi është njëri prej qyteteve më të lashta shqiptare. I ndërtuar në vendbanim ilir.

Durrësi është qytet me jetëshkrim jashtëzakonisht të pasur.

Të pasur dhe dramatik.

E jetëshkrimin e tij të tillë-të pasur e dramatik në masë të madhe e kushtëzoi pozita gjeografike e qytetit me qytetërim tokësor e me qytetërim detar që ia kishte caktuar natyra dhe historia.

Në historinë e tij aq të gjatë Durrësi do të jetë qytet me vite të priturash e të papriturash, me vite gëzimesh e me vite dhembjesh, me vite lirie e me vite pushtimesh, me vite të qytetit shtet e me vite të qytetit kryeqytet.

Kurrë, qoftë i sunduar, qoftë sundues, Durrësi nuk do të pushojë të jetë pasardhës i dëshmuar i ilirëve.

Do të shquhet me aftësinë e madhe të përvetësimit të kulturave e të qytetërimeve të ndryshme të kohëve të ndryshme e me pasurinë e madhe të monumenteve kulturore të të gjitha kohëve, më së shumti të paraardhësve e pasardhësve rrënjës.

Të jesh qytetar i Durrësit, me jetëshkrim të tillë aq të pasur, është kënaqësi dhe njëkohësisht obligim. Kënaqësinë, ja, po e përjetoj këtu, por obligimin a do të mund ta sendërtoj, nuk e di a do të më japë afat mosha.

## 2.

Me pamjen dhe gjendjen e tij të sotme Durrësi flet shumë jo vetëm për veten, po për gjithë Shqipërinë, për Shqipërinë e Kosovën, për gjithë shqiptarët.

Shqipëria, më shumë se gjendje, sot është mundësi.

Koha në të cilën jeton brezi ynë është kohë e gjasave tona.

Dhe, këto gjasa na u dhuruan në fundin e shekullin 20 dhe në fillimin e shekullit 21.

Gjatë, me shekuj, ishim popull i pushtuar.

Gjatë, me shekuj, jetuam duke u tkurrur trojet tona.

Gjatë me shekuj, pa u ndalur, shumë prej bashkëkombësve tanë u larguan prej trojeve tona.

Gjatë, me shekuj, çapuum ngadalë, lodhshëm, pas popujve të kontinentit të cilit i takojmë: pas popujve evropianë, madje edhe pas disa popujve ballkanikë.

Koha që na solli gjasa, shpresa, solli ndryshim në gjendjen tonë historike. Sot jemi popull jo me një po me dy shtete. Çështja kombëtare shqiptare, me krijimin e shtetit të dytë shqiptar – Kosovës, pjesërisht është zbutur. Emri ynë në marrëdhëniet ndërkombëtare sot tingëllon më mirë e më pranueshëm. Është shtuar numri i shteteve që na nderojnë si popull dhe na e njohin shtetin e dytë. Paragjykimet me të cilat dikur shiheshin identiteti ynë, aftësitë tona shtetkrijuese, kulturore e qytetëruese janë komprometuar njëherë e përgjithmonë nën ndikimin e dy shteteve tona, të letërsisë, të arteve e të shkencave tona, të kulturës e qytetërimit tonë.

### 3.

Të gjitha këto që u thanë për gjendjen tonë historike, sot dëgjohen gëzueshëm. Por, nuk do të duhej të harronim e ta mosduronim mendimin: një popull quhet politikisht dhe etikisht i pjekur në qoftë se i sheh qartë, me sy kritik, edhe të metat, veset, gabimet, të këqijat e veta.

Historia, thuhet, është mësuesja më e urtë në jetën e njeriut. Në qoftë se duam të mësojmë prej saj atëherë duhet të pranojmë se përbërësi më vendimtar i njësisë sonë shpirtërore – kohezioni shoqëror dhe mbarëkombëtar është cenuar apo, madje, është rrezikuar sot, sa apo më shumë se në disa periudha të mëparshme historike. Për krijimin, ruajtjen, forcimin e këtij kohezioni janë bërë shumë përpjekje në epokën e Skënderbeut, në epokën e Rilindjes Kombëtare, që i ka ndërtuar themelet e kohezionit shoqëror e mbarëkombëtar, mes dy luftërash botërore dhe në periudhën e komunizmit.

### 4.

Kemi menduar se në periudhën pjesëmarrës të së cilës jemi - në periudhën e demokracisë do të përmirësohet shpejt jeta jonë në të gjitha fushat e saj. Por, shpejt do të jemi të detyruar t'i besojmë shkrimtarit të madh francez, Andre Zhid, i cili thotë: “Lirinë më lehtë e fitojmë se ç’do të dimë ta shfrytëzojmë”. Shumë më shpejt se ç’mund të na ketë shkuar mendja po shihet se sa e se si po cenohet, madje, kur e ku po rrezikohet kohezioni ynë shoqëror dhe mbarëkombëtar.

Shumë shpejt në të dy shtetet tona janë shfaqur krahinorizmi dhe lokalizmi. Janë paraqitur, madje, edhe predikuesit e krahinorizmit të cilët, fjalës centrizëm ia vejnë parashitesë emrin e shtetit a krahinës ku jetojnë dhe atë trillim të tyre, që cenon kohezionin shoqëror e mbarëkombëtar, e shpallin shtyllë kurrizore të shoqërisë dhe të kombit të Kosovës, përkatësisht të Shqipërisë!

Me ndikim cenes, të veçantë, ndaj kohezionit shoqëror dhe mbarëkombëtar është ideja e kombit kosovar, predikuesit e së cilës janë të mbledhur në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Njëri prej ish kryetarëve të kësaj Akademie do të deklarojë me një rast se “pakicat kombëtare, sidomos ajo serbe, sigurinë e tyre në Kosovë do të mund ta realizojnë vetëm me krijimin e kombit kosovar!”. Kryetari tjetër i së njëjtës Akademi thotë në mjetet botore se Kosova e Shqipëria s’duhet të bashkohen – kurrë!

Ndikues që dëmtojnë dukshëm kohezionin shoqëror dhe mbarëkombëtar janë: rënia e klasës së mesme, rendi politik oligarkik shumë i korruptuar në Shqipëri e në Kosovë, ndarja gjithnjë e më e shprehur e shoqërisë sipas klasave e brezave e prejardhjes, trajtimi gjithnjë e më i pabarabartë i dinjiteteve.

Nuk ka dyshim se ndikim veçanërisht cenes në kohezionin tonë shoqëror dhe mbarëkombëtar po sjell konflikti i gjatë, i pandalshëm, i forcave politike sidomos në Shqipëri dhe gjithnjë e më i dukshëm edhe në Kosovë. Është e ditur se aty ku nuk durohen,

në të vërtetë ku konfliktohen forcat politike aty qytetarët ndihen të pasigurt dhe kjo pasiguri e dobëson lidhjen e tyre me vendin e tyre duke ua nxitur dëshirën për emigrime.

Është pa dhe është dëshmuar se në cenimin, madje, në dobësimin e kohezionit shoqëror dhe mbarëkombëtar ndikim të madh ushtrojnë edhe sidomos papunësia, veçmas papunësia e të rinjve, padrejtësitë e ndryshme që më së shpeshti u bëhen të varfërve, korrupsioni që pengon zhvillimin marrëdhënies demokratike dhe sjell shumë dëshpërim ndaj shtetit, nepotizmi që favorizon të vetët, familjarët, miqtë, bashkëpunëtorët, bashkëpartiakët dhe diskriminon të tjerët duke nënçmuar aftësitë, prirjet, të drejtat dhe meritat e të tjerëve; mandej zhvendosjet gjithnjë e më të shpeshta, në mënyrë të veçantë të të rinjve, dhe, dhe, dhe shpërfilljet e krijimtarisë letrare, artistike e shkencore dhe zëvendësimi i tyre me televizionet dhe rrjetet sociale!

## 5.

Çka duhet të bëjmë në këtë gjendje kaq të rrezikuar të kohezionit tonë shoqëror dhe mbarëkombëtar?

Kujt, i takon rol i veçantë në përpjekjet për parandalimin e kësaj të keqeje?

Përgjigjja ime është: rol i veçantë iu takon intelektualëve dhe universiteteve.

Si institucione të arsimit të lartë, që çmohen shumë prej popullit, që financohen prej shtetit, që krijojnë mendjen e zhvillimit të shoqërisë, të kombit e të shtetit, universiteteve si qendra të intelektualëve iu takon detyrë e veçantë për t'i hetuar posa shfaqen dhe për t'ia treguar opinionit të gjitha të këqijat që dëmtojnë interesat e përgjithshme. Këtë detyrë e kanë universitetet tona për t'ia bërë opinionit qartë të dukshme krizën e vlerave, krizën e moralit, dobësimin e shpejtë dhe me pasoja të mëdha të kohezionit tonë shoqëror dhe mbarëkombëtar.

Në universitete janë kuadrot e specializuara për të gjitha shkencat. Pedagogët e tyre me fjalën e me shembullin

e tyre duhet t'i mësojnë të rinjtë që të kenë mendim të pavarur e kritik, që të jenë mendërisht të pafrikësuar prej censurave e prej pasojave të tjera administrative.

Universitetet duhet t'i bëjnë bindje të përgjithshme shoqërore e kulturore të vërtetat:

se shkencat është themeli i zhvillimit të përgjithshëm në shekullin njëzet e një,

se kultura kurrë nuk mund të jetë e kaluar, sepse është e gjithmonshme,

se kultura është ajo përmbajtja e madhe që e krijon dhe e pasuron identitetin e çdo kombi,

se në kushtet e ringjalljes së nacionalizmave të popujve të mëdhenj e të zhvilluar të Bashkimit Evropian, ne mund të mbahemi, mund të ruajmë e mund të pasurojmë identitetin tonë, të sotmen e të ardhmen tonë në atë Bashkim, të shumëvlershëm, madhështor, në të cilën pashmangshëm duhet të hyjmë, duke e nxitur, duke e çmuar e duke e vlerësuar krijimtarinë shpirtërore: shkencat, letërsinë, artet, në përgjithësi kulturën tonë.

Kjo rëndësi e jashtëzakonshme e shkencës, e arteve, e kulturës në përgjithësi për zhvillimin tonë në shekullin në të cilin ecet përpara vetëm me dijet e sakta, të gjera e të thella, me të vërtetat e të drejtat e shtron edhe nevojën e afirmimit të vlerave tona shkencore, letrare, artistike, kulturore në përgjithësi.

Dhe, këtë afirmim do ta sendërtojmë jo duke pritur të huajt që të vijnë e të kërkojnë vlerat tona krijuese, se ata nuk vijnë t'i kërkojnë si dikur, por t'ua përkthejmë vetë ato që duhet të përkthehen dhe të botuara, bashkë me veprat e arteve që s'kanë nevojë për përkthim e botim, t'ua ofrojmë me shpjegimet dhe përimtimet e nevojshme – ashtu, më në fund, siç po bëjnë sot për afirmimin e krijimtarisë së tyre shpirtërore një varg shtetesh jo vetëm në këtë Ballkanin tonë.

S'ke mundësi të dukesh, të shquesh, të afirmohesh me teknologjinë, me ekonominë, me pasurinë e me fuqinë hajde duku, shquaju, afirmoju me vlerat e arteve, të shkencave, të kulturës, që është afirmim më i përhershëm e më lavdisjellës se të gjitha afirmimet e tjera.



## VEPRA & AUTORË

---

### NJË VEPËR E RËNDËSISHME PËR SHKENCËN SHQIPTARE


Nga Prof. Asoc. Dr. Sabri KIÇMARI  
*Universiteti i Prishtinës*

Rreth veprës  
**Fjalori i marrëdhënieve  
ndërkombëtare dhe diplomacisë**

Me autorë  
**Ahmet EMIN DAĞ dhe Ali PAJAZITI**

Këto ditë shtëpia botuese “Logos-A” i paraqiti auditorit shkencor dhe më gjerë një vepër kapitale, me titull *Fjalori i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë* të autorëve Ahmet Emin Dağ dhe Ali Pajaziti. Fjalorët janë një lloj i veçantë i krijimtarisë dhe kanë rëndësi të madhe për fushën e shkencës në përgjithësi. Në ta paraqiten njohuritë në një fushë të caktuar shkencore në mënyrë të përmbledhur dhe alfabetike, u shërbejnë studiuesve dhe të interesuarve për të marrë shpejt informacione themelore për një temë, ngjarje, teori, autor, fenomen ose nocion.

Fjalori i këtyre dy penave ka karakter shkencor dhe përmbledh një numër të gjerë prej rreth 15 mijë nocionesh, temash, ngjarjesh dhe teorish të marrëdhënieve



ndërkombëtare dhe diplomacisë. Me gjuhë me nivel, strukturë të lakmueshme dhe shpjegime koncize, ky fjalor është shumë i rëndësishëm për ata që merren me studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë si dhe për ata që interesohen ose punojnë në institucione të përfaqësimit diplomatik.

Autorët kanë zgjedhur një metodë të dyanshme të paraqitjes së nocioneve, dukurive dhe ngjarjeve në fjalorin e tyre. Në raste të caktuara ata kufizohen vetëm me përkthimin e nocionit, ndërsa në raste të tjera japin shpjegime me hollësi për ngjarjen, fenomenin ose

nocionin diplomatik apo të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë këto shpjegime më të gjera vërehen në temat që ndërlidhen me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian ose ngjarjet që kanë të bëjnë me zhvillimet politike dhe shoqërore në Lindjen e Mesme.

Nocioni kryesor i librit është diplomacia. Përcaktimet mbi këtë nocion janë të shumta dhe të ndryshme. Autorët e kanë përmbledhur përkufizimin për diplomacinë si “art i përfitimit në favor të shtetit vetjak gjatë zhvillimit të marrëdhënieve dhe takimeve ndërkombëtare”. Sipas tyre, “diplomacia është vegël e politikës së jashtme për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare përmes metodave paqësore e jo përmes atyre ushtarake”. Për të shpjeguar këtë fenomen ata kufizohen në numërimin e dy detyrave kryesore të diplomacisë: negocimin dhe përfaqësimin.

Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare po ashtu zënë një vend të rëndësishëm. Liberalizmi në këtë vepër me peshë përcaktohet si “paradigmë e marrëdhënieve ndërkombëtare që mbron idenë se vlerat etike globale do t'i bëjnë marrëdhëniet ndërkombëtare më të rregullta, më të drejta dhe më bashkëpunuese. Sipas këtij botëkuptimi, anarkia dhe luftërat ndërkombëtare mund të pengohen vetëm në sajë të reformave institucionale, që do ta përforconin të drejtën (dhe organizatat) ndërkombëtare”.

Kurse realizmin e shpjegojnë si një “qasje teorike që thotë se në marrëdhëniet ndërkombëtare aktori kryesor është shteti dhe se këto marrëdhënie janë identiteti i përplasjes së forcave. Sipas realizmit, sistemi ndërkombëtar është anarkik. Për shtetet, me rëndësi është që në kuadër të kësaj anarkie të ruhet siguria kombëtare. Për këtë arsye shtetet para se gjithash duhet të jenë të forta në aspektin ushtarak”. Në të dyja këto përkufizime autorët kanë përmbledhur në mënyrë mjaft precize disa prej karakteristikave themelore

të dy drejttimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Fjalori është i pasur edhe për nga të dhënat historiografike në lidhje me zhvillime të veçanta ndërkombëtare. Në të shpjegohen dy luftërat botërore, luftërat e shumta në Lindjen e Mesme, konflikti arabo-izraelit etj. Edhe ngjarjet dhe fenomenet që kanë të bëjnë me Kosovën zënë një vend të rëndësishëm në *Fjalor*. Në të jepen shpjegime për EULEX-in, KFOR-in, Grupin e Miqve të Kosovës, çështjen e Kosovës, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, planin paqësor për Kosovën, operacionin e forcave aleate me rastin e ndërhyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë etj.

Në fakt, ky është fjalori i dytë që Ali Pajaziti, pas një pune katërvjeçare – përkthim, plotësim, zëra të rinj – ia ofron lexuesit shqiptar. Ndërsa *Fjalorin e sociologjisë* ai na e solli si vepër vetjake para disa vitesh, për të plotësuar një nevojë imediate të studiuesve dhe studentëve të sociologjisë dhe shkencave të tjera sociale, *Fjalorin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë* ai na e sjell në bashkëpunim me shkencëtarin turk Ahmet Emin Dağ. Kontributi i autorit shqiptar është i veçantë në kontekstualizimin e këtij produkti, në latimin e terminologjisë për auditorin shqiptar, në frymimin shqip të tij.

Ajo që e bën të veçantë *Fjalorin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë* është trigjuhësia e tij (anglisht - frëngjisht - shqip), përkatësisht shumëgjuhësia e tij. Shumica absolute e nocioneve janë përkthime nga anglishtja dhe frëngjishtja në shqip, kurse jo pak nocione janë përkthime nga latinishtja, por edhe gjermanishtja dhe gjuhë të tjera.

Dağ dhe Pajaziti ua sollën lexuesve dhe bibliotekave tona një libër të rëndësishëm dhe me këtë mbuluan edhe një hapësirë të ndjeshme për zhvillimin më tutje të dijes shkencore ndër shqiptarë në përgjithësi dhe të lëmit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë në veçanti.

**MAGJIA E MARRËDHËNIES  
DIASPORË - ATDHE DHE  
PATRIOTIZMI NË DISTANCË.  
RASTI I KOSOVËS**

Nga Prof. Dr. Lekë SOKOLI

Mbi monografinë  
“**Kthimi i shpejtë i shqiptarëve  
të Kosovës në trojet e tyre  
mijëvjeçare në verën e vitit 1999**”

me autor

**Dr. Skënder Demaliaj**  
UMSH Press, 2020

E hënë, 17 dhjetor 2018. Jam ulur për të shkruar recensionin e librit “Kthimi i shpejtë i shqiptarëve të Kosovës në trojet e tyre mijëvjeçare në verën e vitit 1999”, të studiuesit dhe pedagogut Skënder Demaliaj. Libri përfaqëson një analizë shumëdimensionale me shtrirje tematike dhe kohore të ngjarjeve të Kosovës derisa ajo u shkëput nga shpërbërja e përgjakshme e ish-Jugosllavisë, fitoi lirinë më 1999 dhe shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Autori sjell fakte dhe dëshmi mbi konfliktin nga lindi Republika e Kosovës, konflikt që mori trajtën e pastrimit etnik në përpjekjen agresive për të krijuar një hapësirë etnikisht homogjene pa shqiptarët, në territore pastërtisht shqiptare. Autori argumenton se gjithçka ishte pjesë e një strategjie afatgjatë, zbatim i një platforme për të cilën u angazhuan të gjitha forcat më të kualifikuara serbe: politikanë, ideologë, klerikë, akademikë. Siç dihet, pastrimi etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës u ndërkombëtarizua aq sa çoi në ndërhyrje diplomatike dhe, më pas, edhe ushtarake të perëndimit dhe NATO-s.

Siç dihet, represioni politik, gjenocidi e lufta sistematike për pastrim etnik, kanë qenë dhe mbeten faktorët bazë të emigrimit ndërkombëtar. “Ditari ballkanik” është një shembull domethënës, madje dhe



mjaft i studiuar. Rasti i Kosovës është marrë si një rast gati-gati unik edhe në studimin e marrëdhënies midis diasporës dhe atdheut (Diaspora-home relations), apo patriotizmit në distancë (long distance patriotism). Këto tipare i ka analizuar në veçanti Andrés Solimano, autor i një libri të botuar nga Universiteti i Kembrixhit më 2010 (International Migration in the Age of Crisis and Globalization; Historical and Recent Experiences). Ai argumenton se këto tipare karakterizuan në mënyrë më tipike shqiptarët e Kosovës në luftën për lirinë dhe pavarësinë e saj.

Kolegu Demaliaj ka bërë objekt të studimit të tij pikërisht këtë rol të jashtëzakonshëm të Shqiptarëve të diasporës së re, madje kthimin e tyre *të shpejtë* - siç është vënë në titullin e librit – për të kontribuar me gjithçka e për të realizuar një ëndërr shekullore.

Jo rastësisht në hyrje të këtij shkrimi recensionues vendosa edhe datën. Sepse pikërisht më 17 dhjetor 2018, me kërkesë të Serbisë, është mbledhur Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara për të diskutuar

mbi vendimin e parlamentit të Kosovës për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Pra, më është dashur që paralel me librin, t'i kushtoj vëmendje edhe protokollit të Këshillit të Sigurimit të OKB. Sepse kjo është një dëshmi e faktit se, dy dekada pas çlirimit të Kosovës, pretendimet e Serbisë mbi sovranitetin e Kosovës nuk kanë ndryshuar dhe, siç duket, vështirë se kanë për të ndryshuar. Pra, sfidat vazhdojnë... Në këtë vështrim, monografia e autorit Skënder Demaliaj trajton në thellb një temë 'të ditës', një temë që mbetet aktuale.

Libri i kolegut Demaliaj është një libër sa publicistik, aq edhe shkencor. Gjithsesi, sipas mendimit tim, ai plotëson përgjithësisht edhe kushtet e një punimi shkencor, që janë: (1) ka një temë të qartë e të dallueshme; (2) ka risi dhe origjinalitet, ndonëse për këto çështje sidomos për gjenocidin serb ndaj shqiptarëve ka tanimë një literaturë mjaft të gjerë; (3) është i dobishëm dhe i adresohet një kategorie të gjerë lexuesish, nga nxënësit e studentët, te studiuesit e publiku i gjerë; si dhe (4) libri është i mbështetur në burime dhe ka një sistem referencash që e adresojnë lexuesin në burimet autentike të informacionit të përzgjedhur.

Kemi, në këtë punim, rastin e një teme që autori nuk e ka përzgjedhur rastësisht, apo i nxitur thjesht dhe vetëm nga interesa 'të ftofta' akademike. Ai është nxitur nga shtyrsa të brendëshme, nga ndjesitë individuale, familjare dhe krahinore. Autori është vetë nga malësia e Gjakovës, madje pjesëtar i një familjeje të njohur atdhetare. Kemi, në një farë mase, rastin e një studiuesi që dijen, njohjen e lidh me të kuptuarit në mënyrë emocionale, siç shkruante Maks Veber.

Autori i monografisë është përpjekur të dokumentojë, të japë fakte dhe dëshmi mbi gjenocidin dhe qëndresën e shqiptarëve. Por ai shkon më tej. Ai është përpjekur të interpretojë, të argumentojë, të kërkojë shkeqë e të arsyejojë. Nga njëra anë, ai analizon doktrinat famëkeqe që frymëzuan dhe mobilizuan serbët dhe të gjitha

strukturat shtetërore në akte të pastrimit etnik dhe, nga ana tjetër, ai pasqyron qëndresën e shqiptarëve, kundërpërgjigjen e tyre e cila çoi në dështimin e spastrimit etnik të Kosovës. Autori argumenton se gjenocidi serb ndaj shqiptarëve të Kosovës ka qenë, të paktën që prej dy shekujsh, i pandërprerë, i mirëorganizuar dhe i drejtuar nga strukturat më të larta shtetërore e partiake, nga Kisha Ortodokse serbe, nga Akademia e Shkencave të Serbisë. Qëllimi final i këtij gjenocidi ka qenë shfarosja apo dëbimi me dhunë i shqiptarëve nga trojet e btyre.

Libri përbëhet nga dy pjesë, të lidhura me njëra-tjetrën dhe që plotësojnë njëra-tjetrën. Por, që reflektojnë gjithsesi, qasje të ndryshme metodologjike. Në pjesën e parë trajtohen kryesisht gjenocidi serb ndaj shqiptarëve të Kosovës në vështrim historik dhe gjatë vitit 1999, përgatitja psikologjike e strukturave paraushtarake dhe ushtarake serbe për të realizuar gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës, ideologjia shoviniste serbe dhe ideologët e saj, si dhe jepen fakte tronditëse për gjenocid e shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve. Autori është përpjekur të depërtojë në faktorët etnopsikologjikë, historikë dhe politikë të zhvillimeve dykahëshe, represionit serb – nga njëra anë dhe qëndresës së shqiptarëve – nga ana tjetër. Pjesa e dytë, ndryshe nga e para, ka më shumë kujtime, ese, reportazhe, deri elementë folklorikë që pasqyrojnë tablonë e ballafaqimit historik shqiptaro-serb.

Por, gjithsesi, monografia është e strukturuar. Literatura është e bollshme, me libra në shqip dhe në gjuhë të huaja, me burime arkivore, materiale nga revistat e gazetat e mëparshme apo të kohës. Janë analizuar faktorët etnopsikologjikë që i shtynë shqiptarët e Kosovës të ktheheshin në trojet e tyre, duke operuar me koncepte si: dashuria për atdheun, shpirti i sakrificës, optimizmi për të ardhmen etj. Po kështu, janë analizuar faktorët historikë e politikë, koniukturat dhe aleancat ndërkombëtare

etj. Përfundimet janë rrjedhim logjik i problematikave të trajtuara në monografi.

Sipas autorit, edhe pse kanë kaluar rreth dy dekada, as strukturat e larta shtetërore të Serbisë, as Akademia e Shkencave nuk kanë kërkuar ndonjëherë falje për gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës. Përkundrazi urdhëruesit dhe ekzekutorët e tij janë shpërblyer apo dekoruar si “shembuj të heroizmit e patriotizmit”. E vetmja pendesë e tyre lidhet me dështimin e luftës për asgjësimin dhe asimilimin e plotë të shqiptarëve, por jo me vetë luftën.

Ky përfundim i autorit Demaliaj përkon me përfundime të autorëve dhe të tjerë, edhe përendimorë. Studiuesi i njohur amerikan Fareed Zakarian, për shembull, në librin e tij “E ardhmja e lirisë” (2010) rrëfen rastin e politikanit dhe aktivistit të njohur francez Jack Lang, ish-ministër i kulturës së Francës. Ai shkoi në Beograd për të mbështetur protestat kundër Millosheviçit në vitin 2006. Por udhëheqësit e lëvizjes e deri të

deprtamenti i filozofisë së universitetit të Beogradit e shpallën “armik të serbëve”, ndërsa autoritetet urdhëruan largimin një orë e më parë nga vendi i tyre. Ai kuptoi se demonstruesit kërkonin largimin e Millosheviçit jo se ai e bëri luftën, por thjesht dhe vetëm se ai nuk e çoi atë deri në fund, pra pse ai e humbi luftën. Sipas Lang, forcat e demokracisë në Serbinë e pas Millosheviçit nuk ishin aspak forca të harmonisë dhe paqes etnike.

Demaliaj i referohet Biblës, në një thënie mbi kujtesën: “Kujdesu shumë që të mos i harrosh ngjarjet që ke parë me sytë e tu, që të mos largohen ato prej zemrës sate asnjë vit të jetës sate. Ndaj u duhet folur për to fëmijëve të tu dhe fëmijëve të fëmijëve të tu”. Këtë porosi të rëndësishme shqiptarët nuk duhet ta harrojnë, thotë autori.

Monografia e Dr. Skënder Demaliaj mund të shërbejë edhe si literaturë plotësuese për studentët e disa programeve të studimit, si: Shkencave politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Psikologji, Sociologji etj.



## **Social Studies: Author's guide**

### **In general**

ISSN 2309-3455 (Print)

ISSN 2309-3471 (Online)

“Social Studies” is the official Journal of Albanian Institute of Sociology (AIS), and Department of Sociology of University Aleksander Moisiu Durres, Albania. Founded in 1997, it is certified as scientific journal by the High Commission of the Assessment of Academic Titles, with decision No. 170, 20. 12. 2010.

“Social Studies” is a bilingual Journal. The articles can be written either in English or Albanian.

### **How to submit an article?**

The article can be submitted to: [studime.sociale@gmail.com](mailto:studime.sociale@gmail.com); [albsa@sociology.al](mailto:albsa@sociology.al); The submitted article will be select for publishing by the anonymous reviewers, though a blind review process.

### **Organize the manuscript in the following order:**

Title, author(s), name(s) and institution(s), e-mail address (es), abstract (no longer than 150-200 words), text, references (Harvard System of references), notes on contributor/s (a short CV of a maximum of 10 lines, including both academic and organizational experience, and listing up to three selected publications).

### **Short references in text**

Weber (1998); (Weber, 1998: 156); or Weber (1998: 156); (Lazesfeld and Berelson, 1990); (Olzak, Shanahan & West, 1986); (Larsen et al., 1989); (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999); 2011a, 2011b.; (Tocqueville [1835] 2010), etc.

### **References following the text**

List authors alphabetically, by surname.

Merton, Robert. [1949] 1968. *Social Theory and Social Structure*, New York: Free Press.

Buss, Loreta. 2010. “Childhood in Sociology and Society; the US Perspective”, *Currant Sociology*, Vol. 58, No. 2, pp. 355-350.

### **© Copyright: the author(s) of the articles**

For more details, contact the Secretary of the International Editorial Board

[www.sociology.al](http://www.sociology.al)

## **ALL ANNUAL CONFERENCES (2006-2020)**

### **15<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Comparative Studies in Modern Society; Balkans in European and Global Context  
Universiteti of Prizren Ukshin Hoti, KOSOVO: 6-7 November 2020

### **14<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Social institutions in Contemporary Society  
[The Interaction between Education, Family, Religion, Politics, and Economy]  
Durrës-Albania: 15-16 November 2019

### **13<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Continuity & Change; Balkans in European, and Global Context  
[Balanced Perspective of Past, Present & Future]  
Mitrovica-Kosovo: 16-17 November 2018

### **12<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Good Society – a multidimensional Approach  
Tirana-Albania: 17-18 November 2017

### **11<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Education & Sustainable Development: the future we are creating  
Skopje-Tetovo, Macedonia: 18-19 November 2016

### **10<sup>th</sup> Annual International Conference:**

How Migration is shaping the Contemporary Society?  
Pristine-Kosovo: 20-21 November 2015

### **9<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Law and values in contemporary society  
Tirana-Albania 21-22 November 2014

### **8<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Democracy in Times of Turmoil; A multidimensional approach  
Durrës –Albania: 22-23 November 2013

### **7<sup>th</sup> Annual International Conference:**

Identity, image and social cohesion in our time of interdependence  
Vlora-Albania: 26-28 November 2012

### **6<sup>th</sup> Annual International Conference**

Education in turbulent times: The Albanian case in European and global context  
Tirana-Albania: 21-22 November 2011

### **5<sup>th</sup> Annual International conference:**

The social problems: their study, treatment and solutions; Albania in global context  
Tirana-Albania: 7-8 June 2010

### **4<sup>th</sup> Annual International conference:**

Twenty Years of Democratic Transformations: Albania in East European Context  
Tirana-Albania: 10 December 2009

### **3<sup>rd</sup> AIS Conference:**

World Economic Crises and its impact on the Albanian Economic and Social Life  
Tirana-Albania: 22 May 2009

### **2<sup>nd</sup> Annual Conference:**

Issues and Models of Communitarian Organization  
Tirana-Albania: 27 June 2008

### **1<sup>st</sup> Annual Conference:**

Political pluralism and Albanian political thought  
Tirana-Albania: 15 June 2007

### **Funding Meeting and the Founding AIS Conference:**

Sociology in Albania and the need of its Institutionalization  
Tirana-Albania: 21 November 2006; Tirana International Hotel